Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi

DIJA

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 11/2013, viti XI, Ulqin
Numri 1 doli më 2003

Kryeredaktor
Hajro Ulqinaku

Anëtarë të redaksisë:
Dr. Gani Karamanaga
Dr. Simë Gj. Dobreci
Dr. Shefkije Islamaj
Dr. Maksut Haxhibrahimi
Dr. Zhilbert Tafa
Inxh. arch. Mentor Llunji

E boton:
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi.
Është themeluar më 12 nëntor 2002, në Ulqin.
U riregjistrua: Ministria e Punëve të Brendshme,
Podgoricë, Vendimi nr. 6308, më 13.02.2013.

Ky numër u botua me financimin e Fondit për Mbrojtjen
dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave në Mal të Zi

PËRMBAJTJA

NË VEND TË EDITORALIT
DIJA nr. 11/'13 7

Esad MEKULI
Porosia 9

LETRARE

TRADITE
Jeronim de RADA
KËNGËT E MILOSAOS.
Këngë e vashave 14
NJË PASQYRË SHTEGTIMI NJERËZOR
Këngë e Bazdari 14
Këngë e Serafinës 14
Këngë e Bazdarit 15
Këngë e Serafinës dhe shoqeve 15
Erdhi Ditë e Arbërit! 15

POEZI
Bardhyl LONDO
1913 17
Ismail KADARE
Vendet e shkombëtarizuara 17
Hamit ALIAJ
Shtëpinë e kam pesëqind metra larg dhimbjes 18
Rexhep FERRI
Rozafa 19
Mirko GASHI
Gjarpri i shtëpisë 19
Moikom ZEQO
Një kostum prej flake 20
Rrahman DEDAJ
Unaza e verdhë 20
Azem SHKRELI
Kështjella e Krujës 21
Liqeni 21
Fatos ARAPI
Është e dhimbshme Aulona 22

Duke u larguar nga Vlora 22
Deti 23
Pse paskam frikë t'i afrohem detit 24
Kishte çelur lulja e ullirit 24
Anton GOJÇAJ
Dhjetë ndoshta pse Çun Mulja shkon në Amerikë përkrye Meksikës ..25
Nana eme shqype kryebardhë e molisun, por gjallë se gjallë 26
Idriz ULAJ
Ballkani 26
Arben KONDI
Kalimthi në Janinë 27
Basri ÇAPRIQI
Të kanë parë tek u lexon vargje atyre në Had 28
Alban RRAHMANI
From Ulqin, with love! 29
Çun LAJÇI
Ulqin, më rope e s'u ngope 30
Arif BOZAXHI
Tri haiku 31
Bedri HYSA
Harta e mëmëdheut 32
Pablo NERUDA
Trupi i gruas 33
Për zemrën time 33
Këtu të dua 34

PROZË
Jaho KOLLARI
Autobiografia e Tafë Tofit 35
Gjella që la një uri këndellësh 36
Sofra 37
Sreten ASANOVIQ
Lufta për Neretvën 39
Dasma 40
Jovan NIKOLAIDIS
La convivenza in Dulcigno 44
Andrej NIKOLAIDIS
I Biri 49
Ag APOLLONI
Dashuri e sertë 51

MEMOARE
Ndoc NIKAJ
KUJTIME TË NJI JETËS SË KALUEME
Kryengritja e Malcis së Madhe 59
Lufta me Mal të Zi 57
Luftat Ballkanike 59

EX-LIBRIS
Nail DRAGA
Vepër komplekse antropologjike 66
Ag APOLLONI
Një roman *rock'n'roll* 70
ESE: për vepra për fëmijë
Ardita RAMA
Margaritarët e axhë Hajros 75
Asllan BISHA
SHPIRTI – VEPRA E TIJ DETI:
"*Tritoni*" letrar magjik i Hajro Ulqinakut, Proza magjike e shkrimtarit Hajro Ulqinaku; "*Kënga e detit"* e Hajro Ulqinakut 77
Ali SALAJ
Hajro Ulqinaku dhe obsesioni për detin 80

STUDIMORE

HISTORIKE
Maksut XH. HAXHIBRAHIMI
Zhvillimi i Uulqinit nëpër shekuj 83
Statuti i Ulqinit i hartuar nga mesi i shekullit XIV 87
Xhafer BELEGU
Lufta Shqiptaro-turke për dorzimin e Ylqinit 91
Dinko FRANETOVIQ – BURE
Detaria e dikurshme e Ulqinit 94
Gjiri i Valdanosit, Krruçi dhe ishulli Ulqini i Moçëm 96
Tharja e liqenit të Zogajve dhe formimi i portit të Gjeranave – "Milenës" 98
Simon LUFI
Lufta e Parë Ballkanike dhe problemi shqiptar 101
Xheladin Shala
Konferenca e Ambasadorëve më 1913 e ndau popullin shqiptar 108
Hajrudin S. MUJA
100 vjet nga *Dita e Kijametit në Tokë* 126

GJUHËSI
Shefkije ISLAMAJ
Gjuhësia shqiptare në 100-vjetorin e pavarësisë 140
Gjovalin SHKURTAJ
Një mbërritje me rëndësi të autores 146
Shefkije ISLAMAJ
Botimi i plotë i veprës së fishtës – thesar i kulturës shqiptare 150
Sutki MALOHOXHA
Hafiz Ali Ulqinaku në kujtimin e brezave 157

ARKITEKTURË
Mentor LLUNJI
Evolucioni i (jo)transparencës së inxhinierisë strukturale 162

SHKENCË KOMPJUTERIKE
Zhilbert TAFA
Algoritme të reja për analizën dhe përmirësimin e barrierave sensorike në implementime stohastike ushtarake 170

PSIKOLOGJI
Leonora HASANGJEKAJ
Paragjykimet dhe diskriminimi gjinor tek të rinjtë 187

MJEKËSI
Artur ZOTO, Elez SELIMI
Dëmtimet pulmonare në dermato-polimiozit 203
Gojard CERGA
Biopsia 211
Ganimete HOXHA
Kala-azar 217

FARMACI
Mehrixhana DERVISHI - LLAZORJA
Bimët mjekësore në trajtimin e çrregullimeve nervore 221

NË VEND TË EDITORALIT

DIJA Nr. 10/'12

*Sot jemi tubuar që të shënojmë daljen nga shtypi numrit jubilar "**Dija" 10**.*

Mbas themelimit të BKSH/MZ, në nëntor vitit 2002, në vitin e ardhshëm u botua numri 1 i revistës.

*Qëllimet e BKSH/MZ**:** Kontinuiteti i kulturës të gjuhës shqipe në MZ, ofrimi që të gjithë shqiptarët të jenë në një organizatë. Organizimi i kulturës, shkencës dhe letërsisë. Të përcillen ngjarjet lidhur me kulturën dhe historinë e kombit shqiptar. Gjithashtu koordinimi me organizatat e tjera joqeveritare, pa ndikimin në pavarësinë dhe veprimtarinë e tyre. Organizimi i tubimeve profesionale dhe shkencore.*

Po i numërojmë disa prej aktiviteteve të BKSH/MZ: Përveç "Dijes", me emrin të Bashkimit janë botuar më tepër se 20 libra në gjuhën shqipe. Është realizuar ekspozita e piktorëve shqiptarë në vitin 2003: në Ulqin, Tuz, Shkodër, Tiranë dhe Cetinë. Gjithashtu është bërë përurimi i shumë veprave të autorëve nga Ulqini, Shkodra, Tuzi e Prizreni.

Me 20.02.2003 është organizuar tubimi i parë për kthimin e Valdanosit.

Revista "Dija" është: për art, shkencë, kulturë dhe letërsi. "Dija", sipas kualitetit të vlerave që përfshin, numrit të rubrikave dhe të autorëve, me volumin e saj rreth 400 faqe, pa hamendje ka zënë vendin e parë të revistave të këtij llojit ndër shqiptarë. Deri tani janë botuar nëntë numra të kësaj reviste. Kjo revistë e BKSHMZ kryesisht disponon me këto rubrika: Letërsi, Studime, Histori, Gjuhësi, Mjekësi, Etnografi, Arkitekturë dhe Vështrime, artikuj të veçantë. Siç shihet nga mozaiku i pasur i rubrikave që ka, kjo revistë është e hapur për çdo intelektual që krijon vlera të qëndrueshme në fushën e vet.

Deri tani "Dija" është financuar prej disa sponsorëve. Ministria për Drejtat e Popujve Pakicë, në Qeverinë e Malit të Zi, kur ka qenë ministër Fuad Nimani, e ka mbuluar pagesën për daljen e dy numrave. Për këtë numër jubilar kemi konkurruar te Fondi për Pakica në Mal të Zi, në krye me drejtorin Safet Kurtagiq.

"Dija" nuk është revistë vetëm për një qytet, as për një lokalitet të caktuar. Redaksia gjithmonë ka qenë e hapur për autorët nga tërë pjesët

e Malit të Zi: Ulqinit, Malësisë, Plavës, si dhe nga të gjitha vendet shqipfolëse: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni. Lirisht konstatojmë: "Dija" është gjithëshqiptare dhe gjithëkombëtare.

Dhe në fund: "Dija" nuk do të botohet pa angazhimin e gjithmonshëm të kryeredaktorit Hajro Ulqinaku i cilit i uroj shëndet dhe jetë të gjatë. Do ta përmend edhe redaktorin teknik Gazmend Çitaku i cili i radhiti të gjihë numrat e "Dijes".

Dr. prim. Gani KARAMANAGA

Esad MEKULI

POROSIA

(*Kushtuar jo vetëm letrarëve)*

Para se të nisësh
të punosh
mendo se
pesëdhjetë vjet
ikën
e nuk je
as ti,
as ata
që në pyetje
të marrin gjykojnë
(kur arkivat e tyre,
pandarë,
dikush trazon:
shfleton,
analizon.
Pra, shkruaj
e puno
që të mos turpërohesh
para atij
njeriu të panjohur
gjykatës të vërtetë,
sot n' ardhmëri –
lufto për të vërtetën,
mos u mbështet
në të paaftët,
lajkatarët –
në ata të pakurrizë
(që janë të përhershëm
siç është
prore historia
e marrëzisë njerëzore!).
Qëndro e kurrë
mos vër maskë
në fytyrë:
ji
fanar
i popullit –
i botës
për të mbarë!

(1987)

.....

VITI 2013 - 20 VJET TË SHKUARJES NË AMSHIM

Esad Mekuli (1916-1993) "Para së gjithash, ishte mësuesi i shkrimtarëve të Kosovës, kurse shkolla e tyre ishte *Jeta e re*. Të dy këto role Mekuli i luajti më shumë mjeshtri, me aq mjeshtri sa këtë e pranojnë pa dallime shkrimtarët më cilësorë që ka Kosova, të cilët janë edhe nga më të mirët që ka letërsia shqipe në përgjithësi. Ndihmesa e Esad Mekulit në këtë drejtim edhe në formimin e një letërsie në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, sidomos në Kosovë, por edhe në nivel të shqiptarëve në ish-Jugosllavi është e pakrahasueshme dhe vendimtare". *(Haxhi Shabani)*

LETRARE

TRADITË

Jeronim de RADA

KËNGËT E MILOSAOS

Ç'po më shkojnë sot në det
Mendja dhe zemra ime!
Se në djeg anijet turke
Erdhën, panë dhe u fshehën

Erdhi Ditë e Arbrit!
Domosdo që do të vdesim,
Jo në shtrat; po do të vihemi
Përpara shtëpive ton.

E në dhe s'do të harrohen
Shokët e vëllezërit
Gurat dhe toka jonë!

Tashti që nata e zezë
Me të butin shi po zbret,
Kudo udhët m'i përfbalt,

Ju e hapni atë derë,
Ku shtathedhurat drenusha
Po këndojnë e hedhin valle.

Atje vasha trimëreshë
Ta rrëmbejë që nga dora
Atë nure buzagaze
E përpara të ma sjellë.

Pa fytyra flakë t'i bëhet,
Me atë shenjën më mes,
E me shpirt të buzëqesh.

Këngë e vashave

Si ndrit dhe qielli përmbi kodrën tonë!
Atje sipër gështenjash përmbi fshat,
Me një yll tok, u ngrit e bardha hënë;
Atje dhe djalli ndëhet, zotëron,
Si një që pamë e në gji na qëndron!

Arat valëzojnë agimit e era buar
Çdo gjurmë bishe fushës së vetmuar,
Me shokët ti në hije pakëz rri,
O qiparis bujarësh, sy-ulli.
Sa ty të njohëm, zemra na mbet
Që tash e gjer në mbrëmje në qytet.
Atje si delli qiellit kur kalon,
Ti ndër bujarët jetën hijeshon!

NJË PASQYRË SHTEGTIMI NJERËZOR

Këngë e Bazdarit

Nga të huajt i përzënë, shkuar java
Çanga e njohur që kur leva s'do më kthejë
Në qytet, ku eh, një ëndrre unë i ngjava.

Gjithë mburrje se të doja, ndokujt mirë
Nuk i bëra, por për ty nuk pata vlerë.
Po sot dole, moj e bukur, lamtumirë!

Këngë e Serafinës

Dola rrahës të më nginjësh këta sy,
Dhe një herë, sa jam zonjë e fatit unë,
Sepse zemra ime loset, vjen me ty
Të të zgjejë zgjuar, dhe në gjumë!

Më shko me shëndet! E në vend të huaj,
Ku m'i hijshmi do jesh ndër bujarë,
Mos më rri helmuar, bindjen ti e ruaj

Se sërish do kthehesh, një orë të bardhë,
Zemra t'i ngushëllohet dhe murgeshës shkretë!

Këngë e Bazdarit

Me shëndet më mbeç! E n'e ligë ty t'ardhtë,
Jetullën e gërshetës m'ia lidh një lumbardhe,
Ma nis që nga dera, e si të më zej'hera,
Te këmbët e tua, vashë, kam për t'ardhë.
Pa sytë e tu t'ëmbla botën mos të gjettë!

Këngë e Serafinës dhe shoqeve

Kallëzohet lashtit, na u nda një herë
Prej vashëzës trimi dhe shkoi detit gjerë.
Vasha na e priti sa e re më s'dukej,
Por anije s'sheh e shpresa po i këputej.

Një mëngjes te zalli me shpirt helmrrëmbyer,
Në mingëll të hollë, vasha na është kthyer!

As plakej, as rritej. Edhe një të hënë
Trimin shqotash rrahur pranë ia ka shpënë.

Aq të bukur vasha kurrë s'e kish parë;
Me lule të bardha, pa zili, mbulohet
Për t'i thënë trimit – "zemra më gëzohet!"

ERDHI DITË E ARBËRIT!

Përse të venë në det
Mendimet, zemra ime?
Zbardhuan anijezat,
Panë këndej e u fshehën...
Erdhi Ditë e Arbërit!
Doemos do vdesim
Në shtrat, në mos rënçim
Përpara shtëpive tona,

E nën dhe do na harrojnë
Shokët e vëllezërit
Krojet e katundi ynë.
Tani që nata e zezë
Me shiun e saj të butë
Kudo i përbalti udhët,
Hapnie ju derën
Tek të përhedhurat çupa
Lozin të harruara.
Vasha forëmadhja
Ma rrëmbeft' nga dora
Atë buzëhieshmen
E ma sjelltë mua përpara.
Kanë për t'iu ndezur faqet
Me atë henjëzën në mes,
Kur e drojtur të më qeshë,
Veç në sy të shihemi,
Pa dhe bota të përmbyset.

.....

1903 – 2013: 110 VJET PA DE RADËN

Jeronim (it. ***Girolamo***) ***de Rada*** ishte personaliteti më i shquar i botës italo-arbëreshe dhe njëra ndër figurat më madhore të Rilindje Kombëtare. Ishte poet, dramaturg, filolog, estet, gramatikan, gazetar, më i pari ndër arbëreshë dhe në botën shqiptare në përgjithësi.

Lindi më 1814 në katundin Maki, afër Shëmitër Korones (Kakalbri – Itali), që ishte qendër e kolegjit arbëresh, në të cilin, babai i tij, një prift ortodoks, ishte mësues i gjuhëve të vjetra: greke dhe latine. Edhe De Rada do të mbarojë këtë Kolegj ku, me 1832, do të shkruajë poemën e parë *Odisea*, pra, kur ishte vetëm 18-vjeç. Ndërsa, më 1836, kur ishte 22-vjeçaar do të botojë kryeveprën e tj, *Këngët e Milosaos.* Më 1848 nxori revistën e parë shqiptare *L'albanese d'Italia* (*Arbëreshi i Italisë*). Më 1883 nxjerr në gjuhën arbëreshe dhe italiane gazetën *Fjamuri i Arbërit,* që do të bëhet e famshme.

De Rada pat një jetë me shumë tragjika, duke i vdekur gruaja dhe fëmijët; shiti tokë e mall për të botuar veprat që, vitet dhe çastet e fundit të jetës, ai gjigant i kulturës, të shuhet i vetmuar, i harruar fare. Vdiq dhe u varros në vendlindje, më 1903.

Krijoi vepra me vlera letrare dhe shkencore, përveç të përmendura më lart: *Serafina Topia*, dy drama: *Numidët* dhe *Sofonizba*, *Rrëfimet e Arbërit*, *Parimet e estetikës*, *Lashtësia e kombit shqiptar*, *Rapsodi të një poemi arbëresh*, *Skënderbeu i pafan*, *Pasqyra e një jete njerëzore, Gramatika e gjuhës arbëreshe* (me të birin, Zefin), *Autobiologjia I-IV, Pellazgët dhe shqiptarët* e shumë të tjera. (H. Ulq.).

POEZI

Bardhyl LONDO

1913

Anglia ishte tepër aristokrate
Franca tepër e spërdhredhur.
Greqia ishte tepër dinake,
Rusia tepër cariste.
Gjermania ishte tepër ushtarake,
Serbia më tej se barbare.
Italia ishte tepër diplomatike.
Austria tepër e plakur.

Dhe Shqipëria, ah, Shqipëria,
Si gjithmonë - tepër e përgjakur.

Ismail KADARE

VENDET E SHKOMBËTARIZUARA

Aty këtu mbi djerrinë një shushurimë bari,
Ca shkëmbin me gurmaz të shqyer,
Kjo është gjithçka
Që ka mbetur nga grahma e fundit e gjuhës.

Në hapësirë, a e sheh?
Vijnë rrotull ca rrathë të çuditshëm ajri,
Janë varret e valleve.

Ku janë baladat, eposi, kujtesa e kombit?
Çimiterin e tyre mund ta gjesh,
Aq sa të gjesh çimiterin e bubullimave.

Hamit ALIAJ

SHTËPINË E KAM PESËQIND METRA LARG DHIMBJES

Shtëpinë, mbështjellë me një re të bardhë,
Në *Veri* e kam, pesëqind metra larg dhimbjes,
Piramida 6 përballë.

Miqtë e mi të letrave kanë surpriza të zymta kur më vizitojnë
Dil nga legjendat, më thonë kritikët, po ç'të bëj:
Ashtu real, jashtë çdo fantazimi,
I marr për dore dhe ua prezantoj
Vitin '13, çunak të përgjakur.

Ç'të bëj. Toka ime s'ka klithur kurrë në qiell,
Klithmat i ka lënë në gurë e në drurë,
Në një djep klithmash jam rritur,
Dhe themelet e shtëpisë klithma i kam
Pesëqind metra nga *piramida 6*.

Gjumin s'e kam pasur kurë të qetë:
Rënkon toka pranë shtëpisë sime në Kasaj
Nga prerja e madhe e *vitit trembëdhjetë.*

Net për net më duhet
Të zgjohem nga britma fëmijësh të prapë,
Të dal jashtë, t'i kap për veshi:
Bismarkun, Lord Grejin, Bikonsfildin,
Kral Petrin, Nikollën, Çubrilloviqin
E më të rinj që emrin s'po ua them,
Në gjuhë të ndryshme shahen ndytë,
Zihen si rrugaçë
Aty te *piramida 6*.

... Shtëpinë e kam pesëqind metra larg dhimbjes

Pranë një meridiani të këputur e kam,
Të tjerat merren me mend.

Rexhep FERRI

ROZAFA

Rozafa me hapa të lehtë hyri në det.
Erdhi vala, vala, vala.
Ajri ishte i ëmbël dhe i ngrohtë.
Ani e zezë Rozafa e bardhë.
E hollë, e trashë. E gjatë, ani e shkurtër.
E ndershme dhe pakëz kurvë mbeti shtatzënë.

Nëna i kishte thënë të ruhet nga sytë e djemve.
Nëpër të kalon meridiani i tokës.
Kur e pyeta për ngjyrën e zezë,
Zoti e di përse, unaza e diamantit.

Edhe për detaje kishte imagjinatë
Nga Shkodra erdhi në Dardani.
Në Dardani asgjë s'e tremb.
E vetme arma ishte moda e re e shqiptarëve.
Në pjesën e parë të historisë.

Mirko GASHI

GJARPRI I SHTËPISË

Thuaj fëmijës
Le ta vrasë
Gjarprin e shtëpisë

Le të mos presë
Sepse kur të zë gjarpri i shtëpisë
Në loçkë të zemrës të nxen
Varra të është e thellë
Sa një shpellë
E dhembja
Zog në qiell

Moikom ZEQO

NJË KOSTUM PREJ FLAKE

Të mund të ktheja të gjithë akrepët e orëve
të botës mbrapsht
Të sfidoja kohën e gjithçka,
Të rikthehesha te ai mëngjes i papërsëritshëm prapë,
Te ai çast i emocioneve të mëdha.

Ti ishe e kthjellët, e mirë, e thjeshtë,
E jashtëzakonshme
Kaq shumë doja të të flisja ahere,
Po u desh të jetoja paradokset,
Ai mëngjes të bëhej një muzg i tmerrshëm.

Kështu do të kujtoj gjersa të kam fuqi
(këtë të drejtë s'ma mohon askush)
Se gërshëra e akrepave të orëve ma ka prerë kostumin
Prej flake gjersa të bëhem shkrumb!

Rrahman DEDAJ

UNAZA E VERDHË

Tërë jetën kalon nëpër atë unazë të verdhë
Në fund të detit të harruar
Dhe gishtat i humb diku në rërë

Atë unazë floriri të verdhë
Të këputur nga kurrizi im
Dikush përherë të ka pritur
Në kryq të rrugëve
Për ta vjedhur hapin si të thneglës

E ti një pëllumb ke lëshuar të mos harrosh
Këngën prej erës së jugut
Prandaj je vonuar të mbërrish në këtë qytet bukurie

Hajni pesë shekuj ka ëndërruar
Mollën tënde në një shtizë
E çuditshme është ajo unazë e verdhë
E këputur nga kurrizi im

Azem SHKRELI

KËSHTJELLA E KRUJËS

A ndrit shkëlqimit të saj i tërë Ballkani?
A heq rreth saj kufomën e vet Ballkani?

A lëkunden gurët? A i vjen era dheut?
A vringëllon natën shpatë e Skënderbeut?

A ndihet deri n'Tomor hingëllimë e kalit të tij?
A por Migjeni thërret *Nji gjen të ri?*

LIQENI

Flas me ty,
Ti hesht e luan me valë.

Ti s'je më syri
Im as loti i saj.

Flas me ty
Ti shikon pulëbardhat.

Për Shën-Naumin
Paske zemër të gjerë.

Flas me ty
Ti kotesh mrekullie.

Më vjen të zbres në fund të fundit
Të vdes i gjelbër me algjet.

Fatos ARAPI

ËSHTË E DHIMBSHME AULONA

Ka një çip në mendimet e mia për ty:
Atje ku puqet Adriatiku me Jonin,
Ku yjet si zilet e shkollës
Tingëllojnë mbi fëmijërinë time.
Është një endth midis qiparisave të urtë
Të Ishullit* tim:
Atje, prej zërave të shkumës së detit
Do të ribëjë sërish.
Mbaj një përrallë në sytë e mia për ty:
Është tepër e dhimbshme Aulona e zhdukur...
Dhe dashurive moderne
Iu dashka të shkelin nëpër rrugët antike të vdekjes.
.....
* *Ishulli i Manastirit – Vlorë.*

DUKE U LARGUAR NGA VLORA

Po nisem pa u përshëndetur me detin.
Vetëm kësaj radhe
Nuk dola në brigjet e njohura të përfalesha
Me pulëbardhat e mia... Nuk durokam dot
me ndarjen prej tyre.
Ndoshta po plakem.
Po fillon lodhja e qelizave ndoshta...
Zemra po zburet
Dhe s'mund të mbajë më dit
Shkëputjen e trupit prej trupit.

Më duhet të nisem?
Pa kthyer kryet pas.
Vetëm nëpër të plasurat e buzëve
Më djeg jodi dhe kripa e detit

DETI

I vogël, me pantallona të shkurtra,
Me këmbë të zbathura e një këmishë humaie,
që e qepte vetë gjyshja...
Ashtu darkë për darkë dilja në breg.
Ndër gishtërinj të këmbës së ftohtë më rridhte rëra.
Unë prisja me orë të tëra,
Gjersa përnjëherësh, tutje nëpër fushat e gjera të natës,
Ngriheshin kope të çuditshme,
të panumërta kuajsh të bardhë.
Nëpër hapësirat e pafundme suleshin aradhë – aradhë.
Turfullonin. Binin me këmbë të thyera,
Rrokulliseshin duke gulçuar nëpër të zezat humnera.
Mbi ta fluturonin të tjerë.
Jelet e hakërruara dallgë-dallgë fushën e qiellit fshihnin.
Hingëllimat e frikshme para tyre bridhnin.
Ata vini afroheshin drejt meje.
Gjokset e mëdha e të bardha
lëshonin përpjetë;
këmbët e para rrihnin në erë...
Sytë u flakronin.
Një çast, dhe nën thundrat e tyre do të më copëtonin.
Kur ja, me poterë, si një gjëmim i madhërishëm
përplaseshin te këmbët e mia.
Nga flegrat gjigante
miliarda grimcëza të kristalta
shfrynin për të fundit herë.
Të tjerët hingëllinin nëpër fushën e gjerë të natës.
Me gëzim e frikë, orë të tëra
unë shihja kuajt e bardhë
të suleshin nëpër furtunë.
Thyenin këmbët, rrokulliseshin,
fluturonin njëri mbi tjetrin.

Dhe tani, kudo që jam,
ashtu fantastik e i madhërishëm, më ndjek pas deti....

PSE PASKAM FRIKË T'I AFROHEM DETIT

Përse paskam frikë t'i afrohem detit?
Kaq kohë pa *e* parë...
Kaq kohë pa *u* parë...
Unë e Joni...
rritur me njëri-tjetrin...
Së largu më mbështjellin zëra të njohur,
Gjëmimi i përmallshëm, hetues i detit.
Po si kthehem në?
A jam ai diellori,
Ajo hare fluturimi e zogut të qiellit,
Ai çast i dhimbjes së kristaltë
Të thërrmimit së stërkalës –
Ai mendim universal deti?!

Përse paskam frikë t'i afrohem detit...

KISHTE ÇELUR LULJA E ULLIRIT

Kishte çelur lulja e ullirit.

Asaj nate, sigurisht, ajo ishte me mua.

Unë nuk i fola për aeroportet. Për ndarjet,
Nuk i fola për trishtimet supermoderne.
Pikonte mbi ne nata luleulliri....
Unë nuk i fola asaj për nostalgjitë e metropoleve,
Për kuptimin e vdekjeve të dashurive të mia.
E ndolla me sy dhe në heshtje i thashë:
- Sonte kam nevojë, më pritet fryma,
S'jetoj dot pa regëtimën e trupit tënd,
s'jetoj dot pa shpirtin tënd të ullirtë.

Ajo qau.
Unë s'e shtriva dorën t'i fshija lotët.

Anton GOJÇAJ

DHJETË NDOSHTA PSE ÇUN MULJA SHKON NË AMERIKË PËRKRYE MEKSIKËS

ndoshta Çun
një mollë të kafshoi si gjarpër në zemër ta Çun
e ti tani ikën ta harrosh historinë
ndoshta Çun
t'u mërzitën pushka e mushka
e planetëve tjera me raketë do të shkosh
të luftosh
në zenit i pari ta ngulësh bajrakun
ndoshta Çun
ti shkon të përjetosh zverdhjen e gjethit
ose ta matësh detin kripor që sytë i ndan prej shpirtit
ndoshta Çun diku në gjithësi jep shpirt një yll i ri
e ti detyrohesh të lëvizësh vendit
kjo quhet ligjësi
ndoshta Çun
të thanë se në Kalifornia një çupëz
të pret si princin me durim skaj rrugës
ndoshta Çun
ti shkon jo pse vendlindjen s'e do
po diellin ta shoqërosh thellë në perëndim
gjithmonë e pate gjakim
ndoshta Çun
vëllai të hidhëroi e ti durim më nuk ke
po dije mirë o trim se shtat' maleve
gjakun borxh ua ke
ndoshta Çun
ti ecën në gjumë
e ndoshta edhe në aeroplan të përhaptë je
ndoshta Çun
një arsye tjetër më e thellë
rrugë tjetër s'të mundësoi
e dhembshme atëherë është ajo
ndoshta Çun
jeta është pikërisht kjo.

NANA EME SHQYPE KRYEBARDHË E MOLISUN,
POR GJALLË SE GJALLË

Me shkambin ndrron fjalë për durimin
Për ‘i vorr të hapun çi e pret me e çlodhë
Për copa t’zemrës tret’ rruzullimit
N’ fund të arkës e ruan ‘i mollë

Ka me ardhë nanën me e pa
Me g-juhë të fëmijnis’ dheut ka me i folë
Në derë të oborrit ku vetëm e la
Ka me e gjetë ‘i kokërr mollë

Kapidan andrrash çi s’ di se ç’lyp ‘
‘i plak fantast me sy fëmijë
Ka me e gjetë ‘i ditë ‘i qyp
‘i mollë mbështjellë mjedis shamije

Ullinjve u rrëfehesh për dashni
Për ‘i çast çi nuk ndodh’
Ban kryq e n’ gjumë e vjerr’ me dorë
Për rreze t’ diellit ‘i kokërr mollë.

Idriz ULAJ

BALLKANI

Gjeografi e brishtë
Në shpirtrat e etërve të dërrmuar

Shpirt i lodhur në maja heshtash

Fole murgjish e pashallarësh
Me etje barbarësh

Qiell i rëndë
Mbi horizonte të udhëkryqeve polare

Emër i egër
Në shpirt të dykrenoreve të thinjura

Kështjellë hienash
Me përkrenare të vjedhura

Në male të bardha e fusha
Plot nektar e pelin

(*16 prill 1990*)

Arben KONDI

KALIMTHI NË JANINË

Sërish i pagjuhë,
Gojëkyçur në Janinë,
Ndiej vështirësi në frymëmarrje.
Me sy e pa sy qëndroj,
Në dritare të autobusit.

Thirrje gjaku,
Kushtrimi i të parëve,
Sikur përhumbet, tretet
Pas valëve lasgushiane
Në gjol të Ali Pashait.

Po çfarë ndriu?
Ç'shkëlqeu ashtu papritur
Përmbi pasqyrë të liqenit?

Një dallgëz e kaltër?
Një rreze e zbehtë dielli?
Apo një stërkalëz gjaku
Prej gjakut të gjyshit tim
Më 1913?

Basri ÇAPRIQI

TË KANË PARË TEK U LEXON VARGJE ATYRE NË HAD

(Ali Podrimjes)

E kam ditur Ti
S'mund të vësh kokë mbi jastëk
Kur merr rrugë aq të largët
Për me gjetë të bardhën
As një gur nën kokë si suljotët
Nuk vë

Unë e kam ditur
Ti do lidhje duart pas koke
Do e shtrëngoje fort
Fort derisa ushtimë e vargut
Të pëlcasë

Gjithë ata gurë të ngulur brinjave
Deri te Uji i madh Një rrjedhë uji
Pranë një pylli
T'i sjell te koka për me t'ba gjamën

Vetëm yjet do mbajtur në dorë
Asgjë tjetër s'të lënë
Atje në fund të asaj rruge në fund
E rrugë tjetër s'ka me mbajtë dritën ndezur

Të kanë parë
Kah u lexon vargje tash atyre në Had
Ti i njëjti
I ke sharë si mund të nguleni këtu përgjithnjë
Mor të mjerë

E ke vendosur
T'i ngresh ata nga gjumi
Ku kanë rënë
Përulësisht

Te lumi Styks të kanë parë Ti
I njëjti si mbi Dri
Një dallëndyshe ke gjuajtur nga lartësitë
Në atë lumë të fryrë përmbi brigje
Me pa a e kap flaka
A e lag uji
Se
Lumë i vështirë ai lumë

Alban RRAHMANI

FROM ULQIN, WITH LOVE!*

Me njat' mall për ujin
Qi t'vjedhke zallin ndër duer,
Me njat' zell t'zojave t'randa
Qi metshin tuj ba naze vere,
Thrritke i vlueshmi Ulqin.

M'ardhke si e vrant' pamja kote
Kur më mungojshe deri n'verë
E nuk dojasha qi me trazue
Qetësin' tande kryenaltë
Se inat' më marrke deti idhnak.

Për nji serenat' vaji
Të trazueme deri n'fund gotës
Për nji puthje deri n'dehje
Pritke kryenaltë edhe nji verë
I dehuri Ulqin!

Ulqin, 14.8.2013

.....
* Angl. *Nga Ulqini, me dashuri*.

Çun LAJÇI

ULQIN, MË ROPE E S'U NGOPE

Kur erdha
Më përkëdhele
Si barkën mbi valë
Gjithçka m'ofrove!
Unë i lumtur
Nga dallgët
E freskia jote
Të kurseva.
Mora vetëm diell e ujë
Dhe kripën
Që më mbeti në pore.
Por ti mua Më rope
Lëkurë pas lëkure
M'i rope E s'u ngope!
Dhe prapë
S't'u hidhërova.
"S'e rope t'parin",
Thashë me vet
Dhe ula kokën
Nga frika
Se po t'humbas
Si Tivarin!
Dhe durova
Durova kripën
Diellin e valën,
Por kur fytyra m'u nxi
Bërtita fort:
- I njelmët deti,
Por i ëmbël
Ulqini, O Perëndi!

Ulqin, 31.07.2013

Arif BOZAXHI

TRI HAIKU

Përgjimi

Në një pikë shiu
Përgjoj
Ushtimën e detit

Ëndrra ime

Në shtratin e shiut
Ëndrra ime
Pikë e etur

Etja e detit

Deti për ta shuar etjen
Qoftë edhe për një pikë shiu
Trazohet dhe del nga shtrati

Ulqin, 27.08.2013

In memoriam

Bedri HYSA

HARTA E MËMËDHEUT

Ullinjtë e Ulqinit janë balli
i mrrolur me plagë i Mëmëdheut
shkëmbinjtë e Krujës janë stralli
flamur kështjellë truri i Atdheut

Krahë i djathtë Kosova fushëdet
me male epike kokën përpara
burrëri kreshnike pinë retë
te Çamëria këmbët të çara

Dy dete... t'Arta të pasosme fusha
liqene... Drin i menduar... Drilon
lashtësia... bjeshkë sokola drenusha
gjuhë e moçme thellelartë shqipon

Shqipot botës shumë shumë rendin
vdesin me mall të çmuar
por shpirtin lidhur për Vendin
e lënë banorë t' amshuar

Me kostume veshur Mëmëdheu
valle e zemrës i mat me qiell
në tirqe me plis Atdheu
këngën e ngjizur me diell

Bedri Hysa, i lindur në Mitrovicë, më 1935. Më 2013 vdiq në Prishtinë, e varros në Stagovë të Kaçanikut.

Ka mbaruar fakultetin – Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Shërbeu në arsim dhe në kulturë. Ishte themelues dhe drejtor i Bibliotekës Universitare në Prishinë.

Disa nga veprat poetike: *Paskajore, Këtu është Troja, Maja, Te(k)st(l)ament*.

Nobelist

Pablo NERUDA

TRUPI I GRUAS

Trupi i gruas, kodër bardhoshe, kofshë bardhoshe,
i epur, botës m'i ngjan.
Trupi im prej bujku të egër të lavron,
dhe birin e nxjerr nga thellësitë e tokës

I vetmuar isha si tuneli dhe prej meje zogjtë iknin,
në mua nata me tërë fuqinë vërshonte .
Për të mbetur gjallë, në armë të farkova,
të mora për shigjetë të harkut tim, për gur të bahes sime.

Por vjen ora e barazimit dhe unë të dashuroj,
Trup lëmashku dhe lëkure, të qumështit të njomë e dashurues.
O kupë e gjinjve! O sy mungese!
Trëndafil pulisi! Zëri yt i pikëlluar dhe i prajtur!
Trup' i gruas sime, do të mbetem në hirin tënd.
O etje, dëshirë e pamasë, shteg i pacak!
Rrjedhjet e errëta ku dëshirë e përhershme kullon
dhe lodhja rrjedh dhe dhembja e pakufi.

PËR ZEMRËN TIME

Për zemrën time mjaftojnë gjinjtë e tu,
e lirisë sate me flatrat e mia,
Nga buzët e mia do t' arrij gjer në qiell
e gjithë ajo që flente në shpirtin tënd.

Në ty është iluzioni in çdo dite.
Qasesh si vesa petaleve.

Me mungesën tënde horizontin rrezikon.
Përherë je në ikje si vala e detit.

Tash, kënduar ke në erë
në mes pishash dhe jarbolesh.
Porsi hedhur je dhe prajtë.
Edhe pikëllimin nxit shpejt, si udhëtimin.

Je e afrueshme si rrugë e vjetër, e njohur.
vetëm jehon brenda janë banorët e tu.
U zgjova, e nganjëherë dynden dhe ikin
zogjtë që flinin në shpirtin tënd.

KËTU TË DUA

Këtu të dua.
Në mes pishash të vrazhda era shthuret,
Hëna shndrit mbi ujëra të hutuara.
Kalojnë ditët e njëjta duke ndjekur njëra-tjetrën.

Shthuret reja në figura vallëzonjëse.
Pulëbardhë e argjendtë ere shkëputet nga perëndimi.
Nganjëherë ndonjë velë. Yjëzit e lartë, të lartë.
Apo kryq i zi i ndonjë vapori.
I vetmuar jam.

Nganjëherë agoj dhe shpirtin e kam të lagur.
Kumbon, deti i largët duke jehuar.

.....

Pablo NERUDA (1904 – 1973) poet kilian. Autor i poezive me frymëzim social dhe revolucionar. Ishte i frymëzuar nga qytetërimi parakolumbian. Çmimi *Nobel* në vitin 1971. Disa nga veprat: *Buqetë perëndimesh* (1923), *Spanja në zemër* (1973), *Këngë universale* ((1950), *Duart e ditës* (1968), *Fundi i botës* (1969) etj.

PROZË

Tregim i shkurtër

Jaho KOLLARI

AUTOBIOGRAFIA E TAFË TOFIT

Nuk jam eunuk, aq më pak beqar, që mund të jetë se është një virtyt i mirë imi, ngaqë nuk jam ai që jam nga dhuna, por nga dëfrimi! Ditar s´kam mbajtur kurrë (as që do të mbaj), ai është imponues dhe bën që të mos shkulesh nga trivialiteti.

Një koleg tim të zanatit nuk mund ta kuptoj më. Ai në aspektin artistik është sinonim i asaj thënies së mirënjohur: *duke u rritur e duke u çoroditur, si zogu i gomarit*! Ndodh që kolegu i sipërcekur është në rrjedhën e sipër të ngjarjeve dhe se jam unë ai që s´mund ta kuptoj (më) këtë çoro-botë!?

Jam i lindur jo për të vdekur, por për të mos jetuar! Dhe, ai i cili nuk jeton, nuk mund edhe të vdesë, që nxjerr atë që mbase s´do të kem qenë i lindur kurrë në kuptimin deng të fjalës.

Jo rrallë njerëzit më të vetmuar janë ata që jetojnë në një turmë, e unë i tillë jam! Vetmi hë për hë nuk do të thotë mosshoqërim me të tjerët, vetmi e vërtetë është çmarrëdhënie midis individit dhe kopesë. Shoqëria e sotit ka marrë formën e përbindëshit për syreshin. Nuk jam asocial apo androfob, mund të them vetëm se ne, sa më tepër që kujtojmë, apo sa më tepër që bindemi (ose e bindim veten) se jemi individualistë, aq më tepër e më thellë përfundojmë në gopin e tij.

Jam në vazhdën e një fushate ku vjel (apo përpiqem të nxjerr nga konverzimet që bëj me ta) mendimet e kolegëve të mi për sa më përket mua. Këtu, apo në këtë bashkëdyzim, është më se vendimtare parashtrimi i pyetjeve dhe, natyrisht, analiza e përgjigjeve. Mjeshtëria e shtrimit të pyetjeve dëshiroj të mbetej fshehtësi ime profesionale, kurse për analizë të gjegjeve mund të them se atyre nuk u duhet asfare analize; kolegët e mi vuajnë nga po e njëjta lëngatë e pashërueshme që ka vuajtur dhe do të vuajë kjo botë: nga zilia...

Mbase do të pyeteni, përse të jenë ziliqarë ndaj meje (siç dihet, unë jam vetëm një asht i thatë)?! Mjeshtëria e vënies së pyetjeve, që në fushatën e sipërcekur aplikoj, bën që përgjigjet e tyre të jenë të fashulluara, kryesisht nga smira. Pyetjet e mia nuk janë aq të sinqerta, sikundër përgjigjet që si kundërvlerë të tyre arrijnë veshin tim nuk janë, pra, aq afër sinqeritetit! Si është e mundur që nga ky josinqeritet i dyanshëm të nxirrej një zili e sinqertë?! E po kështu funksionon kjo botë; zili të pasinqertë vështirë të ekzistojë! Për të mos qenë i pasinqertë duhet të them se nuk jam duke shkruar më, apo më saktë, nuk jam duke botuar më atë që krijoj.

Dhe kështu do të mbesë përderisa libri të vazhdojë të jetë vetëm një dekor rafti...

GJELLA QË LA NJË URI KËNDELLËSE

Kjo s´ është një ngjarje e trilluar

Ajo u shtrua në një sofër burrash të dheut, të fortë e të vjetër sa s´bën më, që pinin *venë me anë bote* dhe bisedonin masllahate të moçme.

E tërë filloi pas një mbrëmjeje të stërmoçme, në një ambient antik, ku u lexua vargje, strofa e periudha të gërshetuara me lashtësinë dhe zymtësinë e kohëve dhe nuk dihej nga hynte e nga dilte fjala...

Ata më të moçmit, që do të hanin Gjellën, nuk u mblodhën për të ndëgjuar pallavrat e mbrëmjes letrare, por ky qe një tubim paraprak, i cili bëri që këta të rivistroheshin në një gjellëtore vjetarake për t´i lloçur bulqitë në çorbë të nxehtë.

Ata nuk ishin lloftarë, moçmakët tanë, që ndodheshin në qiellin e shtatë dhe kjo, jo vetën nga lezeti që iu ofronte të ngrënit, në mos më tepër nga pandehma se ishin të zgjedhur t´ia thithin lëngun Gjellës!

Kjo se ishin *të zgjedhur* nuk binte edhe gjithaq çudiplote, nëse s´do të zihej në gojë fakti se ata u vetëzgjedhën, ndërzgjedhën dhe rizgjedhën... meqë *burrat e dheut me kupa bote përplot venë të moçme nga rrushi i vreshtave të Mendrës së Ulqinit* ishin pakicë, ata në shumicë u shpërndanë pas mbrëmjes letra ha... ha... hare dhe, humbën si shurra e

pulës diku në pjesën e re të qytetit, të ngopur lakuriqhane, ku nuk përjashtohej mundësia të kulloten sytë.

Aty isha edhe vetë, midis atyre që kullotnin (ishte ky një tubim prapaprak i të moszgjedhurve, nuk merrej vesh), në mes atyre që as erën s´ia ndienin Gjellës, megjithatë ajo na kishte mbetur në rryl të fytit dhe, kështu, duke kullotur... sytë na kishin dalë në kodër.

Nuk isha, pra, kurrgjëri prej atyre të stërmoshuarve. Por, edhe sikur të isha me një këmbë në varr, kush më kishte *qi n´rrush,* gjë që bën me të moçmin që kisha pranë. Këtij i vinte shumë keq. I vinte, pra, keq. Shumë keq i vinte…

Kur pas disa vjetëve sërish e pata takuar, ai vazhdimisht ndiente uri keqardhëse!

Ulqin, gusht 2005

SOFRA

Jam aq namuzli sa kurrë në jetë s´kam përdorur pasha një fjalë të ndyrë! As në kënd të mendjes nuk më binin, le më t´i përdor, siç bëjnë disa *rrugaçë... të shëmtuar*! Por një ditë, nja shtatë vjet pasi isha martuar (pra, pasi kisha hangër paragjellën), gruaja ime kishte parë mut në gjumë (i turpërohem jashtëzakonisht fjalës *mut*, po ç´t´bëj, s´mund ta quaj mjaltë, ndonëse ky i fundit nganjëherë quhet: *muti i bletës*). Pra, asaj i qe shtirë muti në ëndërr dhe filloi të më kriposë mendjen se gjoja do të fitojë në lojrat e fatit (kishte pasion të luante një lloj lo(to)je dhe disa *mutëra* i kishin thënë se, nëse sheh mut në gjumë, do të thotë se do të fitosh para)!?

Unë kisha tepër problem me tretje, sa fryhesha si rrëshiq. Të them të drejtën, jashtëzakonisht i gëzohesha pjerdhjes dhe dhierjes (prapë kërkoj ndjesë që jam i detyruar t´i përdor këto fjalë të shëmtuara)! Tani pata vërejtur se të dy, si unë si ime shoqe, i gëzoheshim mutit (ajo ende s´kishte fituar në lojrat e fatit, por e mbante uzdaja, kurse unë kur dhihesha apo pirdhja, lirohesha nga tendosja e shëmtuar).

Pleqtë thonë se njeriu kur lidh jetë bashkëshortore, faktikisht e *ha mutin* (s´janë të rrallë ata që hanë dy apo tre). Unë e kisha hangër një, bajagi të madh, sikundër edhe gruaja ime, dhe tani, si unë si ajo, jemi duke u përpjekur t´i shkojmë drejt fundit një tjetrit, që ishte enorm, e që çuditërisht kish një emër: ***kurbet***! Merreni me mend, pra, këta relacione: të martuar, në kurbet, dy fëmijë (që mjaft e shtonin porcionin tonë pëgërik), dhe në fund: ***jetonim***!

E jeta është *kryegjella e kësaj sofre të begatë muti* (tani kam filluar të mos ju kërkoj ndjesë në lidhje me përdorimin e dendur të kësaj fjale të shëmtuar, por besoj e kuptoni përsenë).

Ju falënderoj për vëmendje dhe më falni që askujt s´po mund t´i them: ***bujrëm***!

Linköping, janar, 1999

Sreten ASANOVIQ

LUFTA PËR NERETVËN
(*Bitka za Neretvu*)

Ngutej rrëpirës, përpara çetës, këmbëgjatë dhe skofiare, ndërsa bishtalecat sikur kamxhikë i binin shpinës.

Ngutesha pas saj – unë më i ri dhe më i vogël se Mila – duke mos lejuar të më ikte fort, dhe mezi që ia dilja të ecja përpara luftëtarëve.

Neretva mbetej pas nesh, thellë atje poshtë.

Dolëm majë një rrafshine me gropa dhe grumbuj bore, ndërsa mbi bënin ballë shkëmbinjtë dhe shkrepat kërcënues.

Edhe pse armiqtë vendorë kishin pozita më të mira dhe na e kthenin me egërsi, brigada me një sulm të rrufeshëm i shpartalloi.

E vazhduam ndjekjen duke gjuajtur në vrap, nga dora,

Kah e ka Mila mendjen të shkojë, pyesja vetveten, duke e përcjellë.

Fillimisht para sysh u zhdukën kalorësit e tyre. Këmbësorët që kishin mbetur prapa largoheshin me një vrap e panik, fshiheshin pas shkëmbinjve e prozhmes duke hedhur pushkët dhe torbat.

Me ngulm përpiqesha ta arrija Milën. Nuk mundja të jetoja pa të, prandaj gjithherë jam përpjekur të jem së paku në afërsi të saj.

Vetëm atë e shihja përpara vetes; shokët i kishim pas nesh, duke depërtuar në një vargan të gjatë.

I kapërceja të vdekurit dhe të plagosurit, shikoja vullnetarët dhe të mobilizuarit që dridheshin nga frika, të grumbulluar tubë, me duart lart mbi koka.

I shkelja shubarat me kokarda, pajime dhe armë të luftës.

Assesi ta zeja Milen.

Dezertorët gjuanin të gjitha nga vetja, kapelat dhe mallotat, të kërrusur dhe, plaçkat e grabitura: enët e kallajisura, legenët dhe ibrikët, jelekët e stolisur dhe shamitë laramane, pirunë dhe thika shtëpiake.

Mila bënte leqe, ulej, kapte diçka nga toka dhe i fuste në parzëm.

Nuk mundja ta dalloja se çka mblidhte.

Përpara më bëhej dritë e terr, më gumëzhinte në veshë e kokë, e dhimbët më thernin gjithandej trupin.

Dallova sesi i ngriheshin gjinjtë, sesi ajo bluza mjaft e madhe italiane e ngushtuar në bel i fryhej e zgjerohej.

Mezi merrja frymë kur Mila u ndal para një grumbulli gurësh, ra në gjunjë dhe zuri të nxirrte gurë, të hapte gropë.

Kur iu avita fare afër, e dallova se çka kishte mbledhur rrugës.

E hapi një gropë në atë mogile dhe ia nisi të nxirrte nga parzma, përnjëherë, nga disa kapica kuqezi, cërnagore, dhe i rraste në atë gropë.

Kur të gjitha ato kapele i futi brenda, i mbuloi me gurë dhe, më në fund, shfreu, sikur të kishte hedhur një barrë të rëndë.

E kam ditur se secila punë na është e kotë – turpin nuk kemi mundur ta fshehim.

DASMA

(Svadba)

Shtëpi të ndërtuara me mure të thata, të mbuluara me kashtë, janë humbur nëpër fushën e djegur që di9mrit e shpërlajnë shirat dhe erërat, ndërsa verës dielli e thanë dhe e djeg dhe drurin dhe gurin, dhe gjethin dhe fijen e barit. Shtëpizat e heshtura që kurrë s'u mbyllen dyert, sa dallohen në atë rreth, sepse të të njëjtës ngjyrë është edhe kashta e kalbur dhe muret, si dhe arat e livadhet me ledhe nga shirat me mullarë të vegjël sane; çka nuk është gur e pluhur duket sikur të jetë larë me ujë të valuar dhe kripë të derdhur mbi to. Asgjë nuk lëviz, çdo gjë është ndalur; as njerëz as bagëti nëpër oborret me pluhur, nëpër rrafshinën e shtuar me zhur gurë papërdhokë.

Papritmas një kukamë u dëgjua nga shtëpiza jerevi nën atë fojletën që bënte pak hije. Zëri u dridh dhe humbi diku në largësi. Në atë gojën e hapur të derës së shtëpizës u dukën dy figura me një shkalc.

"Fusha e Cemit rri e hapur dhe e heshtur. Nëpër tërë Zetën nuset shkurtojnë bishtalecat që u derdhen nëpër krahë e shpina. Sot është Krishtlindjet e tridhjetetretë nga lufta e madhe, ndërsa nga kjo tokë e zhveshur vdekjet s'iu ndanë. Pushkat heshtën ashtu që nuk paralajmërojnë as për lindjet e djemve. As për vdekje s'dëgjohen.

Knjazi vjet u kurorëzua mbret, ndërsa ne ende na grin kolera. Kot e punuam këtë tokë të thatë, gjurmët na i treti vrastarja. Nga dita në ditë,

duke mos pritur as të ftohen, ag e terr çojmë nga dy tri vigje te pragu i kishës...”

Meitin e çojnë drejt varrezës nëpër të njëjtën rrugicë nëpër të cilën e bartën edhe fëmijën para do ditësh. Burri bart përpara, i heshtur i bërë dru e gur; kunati ecën mes dy dorëzave të shkalcit, duke shikuar i humbur në nusen e veshur me fustan dasme, dhe lëviz buzët sikur të thotë ndonjë magji.

“Askush nuk na pyet se kah jemi nisur, nuse; askënd nuk e shohim me rroba festive; Pak janë dasmorët e mjerë, katundin e ka pllakosur gjëma. Hasmin s’e sheh, ndërsa godet rreptë ku s’e pret. Shpresa ende ka, të fundit ende nuk e bartën”.

“Ftohtë do të të presë Bregu i mermertë dhe kishëza; edhe ata janë ngopur me gjakun tonë të hidhur. Pse më shikon ashtu? A s’e sheh burrin që i përhumbur ecën përpara këmbëve? Asgjë s’i ke thënë para haxhillëkut? Po çka t’i themi të mallkuarit?”

Ecnin me ngadalë, anashkalonin gardhiqe dhe driza. Kur sa dolën nga katundi pranë u kaluan dy gra në të zeza dhe një plak i veshur solemnisht. As që u përshëndetën. Çdo gjë ra në njëfarë qetësie, vetëm dëgjoheshin hapat nëpër zhurinë dhe ndonjë dallëndyshe ngarendte ulët qiellit.

“Nuk do të shkojmë më bashkë në Sade, ndërsa drithi u bë për t’u korrë; Edhe yjet do ta djegin, sepse siç ka filluar, ata ë të pafatët do ta kaçin shatin në dorë. “

“A e di, nuse e huaj, se të kam ledhatuar ndryshe se ka hije?! Kur atëherë, para një viti punonim në bahçe, ti kallëzoje për ujkonjën që ta nxori gjumin, për bletët e egra dhe shkëmbin nga ke nxjerrë mjaltë. E unë kujtoja se shullaja të ka ngrohur për mua. Kujtoja të merrja botën në sy me ty, e i humba të dy botët! Kur ajo kërma zuri të më brente, kapa shatin. Ti brofe në atë klithmë dhembjeje. U preve kur pa gishtin e madh timin të prerë, të zuri gjaku i përzier me dhe. Pasi ma pastrove dhe lidhe vrragën, më pyete: si ndodhi kjo.

E vërteta e turpshme nuk pranohet. a lëndova që të vij në vete? U fsheha pas stalle; gishti i madh i dorës më ngjasoi në kokën e breshkës që ka dalë nga zhgualli, andaj i rashë me shat... qe... Edhe pse askush nuk qeshi që të mos ketë hutim, mendoj, nuk të ra në mend. A të dhemb – më pyete. Jo deri sa je ti... – të thashë hapur. Atëherë ti re në mendime të thella...”

Oborri i kishës në Bregun e Mermertë është i vogël, i rrethuar me një avlli mur i thatë, me dy – tri fojleta, dhe sa dallohen muret e asaj kishëze. Nëpër muranat e veshura me likene e myshqe vetëm hutini bën çerdhe. Natën si ndonjë gogolë duken mullarët në ugare. Hëna e ndriçon zbetë dhe e bën të ftohtë dhe trishtuese.

Shpejt treten kufomat në gropa në tokën zhurinë. Nuk kaloi as viti dhe mbetën vetëm lara të rralla në koret ose xhamadan, të murrme e të djegura, dhe eshtrat sikur të shpesëve. Edhe ujin edhe njeriun e përpinë toka e egër.

"Iknim nga vetvetja; në shtëpi nuk zura vend deri atë natë kur djali lahej në djersë dhe digjej nga zjarrmia. I kishte zënë gjumi e ti rrije pranë vatrës dhe terje shpërganjët. Zjarri digjej me ato shkarpa që s'bënin gaca. Pelenat nuk ishin terë as përgjysmë, ndërsa djali të lahej në djersë e i duheshin mënelat e terura. Ti silleshe nëpër shtëpi, e kur t'u duke se na mori gjumi, ti u zhveshe. Flaka e fundit e zjarrit të ndriçoi sikur të ka lindur nëna. Ledhatoje gjoksin tënd, sikur të shikoje a janë mjaft të ngrohta. Kur nise të pështillje trupin tënd me ato mnela të lagura, më shkoi në mend se ashtu do t'i terësh. E veshur re në shtrat dhe u mbulove me kokë. E unë kam kujtuar se epshi yt shfrenohet; unë kisha të ftohtë, nuse. Dola ngadalë nga jorgani, të mos dëgjoje ti, askush të mos dëgjonte; e vesha qyrkun dhe dola në natë. Jashtë më priti shiu, pikat sa kokrra e arrës. Furtuna gjëmonte nëpër lëndina dhe vetëtimat loznin mbi Majën e thatë. Të gjitha ato nuk e shuam zjarrin e dreqit që ndizej në mua. Vrapova kah Bregu i Mermertë, atje asgjë përveç manaferra dhe ferra të thata, askund një dru që t'i rripja lëkurën; edhe ato, më bëhej, i ka mbledhur mjerimi. Ngarenda matanë deri sa nuk arrita te kishëza, duke më ndriçuar rrugën vetëtima dhe shkreptima, mblodha kryqat e kalbur që i kishte rrëzuar era e fortë. Ti nuk më hetove kur u ktheva, të kishte marrë gjumi. I theva ato dru dhe ndeza një zjarr të madh, sikur të ishte për ndonjë dasmë. Të shikova me djallëzi dhe të zgjova: ngrehu, mnelat t'i terësh! Nuk the asgjë, por në fytyrë të ta dallova marren, e kuptove se nuk flinim të gjithë. Pelenat i nxore poshtë trupit ndërsa ende ishe ratë, dhe iu qase vatrës t'i terje. Rrija kundruall teje dhe kujtoja se çfarë djalli të ka nisur në këtë fushë të etur që ta zbukurosh dhe ta fusësh në të zeza..."

Hijet me vig ngadalë lëviznin përpjetë Bregut të Mermertë. Me koka të ulura, të dy burrat sikur të shikonin në brendi të vetes. Lart në kodër i priste një varr i ri i cektë, nën atë qiell të ulët me re të murrme, nga ana e jugut një rreze e diellit shënjonte mu në lese.

"Dasmë, dasmë! A sheh, dielli të ka dalë përpara! Në gjëmë na erdhi, nuse! U tera atë ditë kur pashë se së shpejti edhe ti do të shkosh në Bregun e Mermertë. Aty do ta mundim gjëmën, ti e dëlirë, ndërsa unë mëkatar pa mëkat..."

Dy njerëzit e lëshuan vigun pranë varrit, por nuk i pështynë duart. Burri ende rrinte shtangur në një pikë, ndërsa kunati shihte fytyrën e prishur të gruas në vig. Pas një pushimi të vogël, kunati hyri në gropë dhe e mori nga vëllai nusen dhe me kujdes e lëshoi nën këmbët e tija. U drejtua, shikoi edhe një herë, pastaj doli lart. I shtruan rrasat dhe dheu u bë grumbull varri. Qetësia e thellë e ndërpreu zëri i kunatit, që sikur t'ia nxirrte shpirtin, u përhap nëpër atë shpat: "Kuku për mua, bir, kuku!" Maja e zhveshur ashtu thatë e ktheu: "Bir, kuku!" dhe qetësia prapë e mbylli atë lug që të fshihte atë dhe pikëllimin e tij.

Jovan NIKOLAIDIS

LA CONVIVENZA IN DULCIGNO
(*Suživot u Ulcinju*)

Nuk dëshiroj të më bësh asgjë
Nuk dua të të bëj asgjë
Por dëm assesi!
(gegënisht)

S'du mem ba askurgja
S'du met ba askurgja
Por qeder assesi!
(ulqinakçe)

Neću da mi ništa učiniš
Neću da ti ništa učinim
Ali – štetu nipošto!

Mogu biti ljudi muslimani ili hrišćani,
Jeveji mogu biti ili pagni –
No samo dvije sektesu oista prave:
Pametni bez vjere, i s vjerom ali prazne glave!

Al-Ma'arri, Luzum ma la jelzem, slijepi arapski filozof i pjesnik (973 – 1058) , kontroverzan sa svojim racionalizmom i napadom na religijske dogme.

1.

Me vite Nikolla nga Mikuliqi nën Rumi, ku kanë djegur qymyrin, ka bartur pa pra qymyr deri në qytezën e Ulqinit dhe ua ka shitur kafexhinjve dhe nëpër shtëpia. Kishte kursyer para me atë punë të mundimshme të qiraxhiut dhe nga ajo fitesë në Sokakun e furrave e bleu

duganjën me të gjitha orenditë. Që kur ishte bërë gati ta përtërinte zanatin e trashëguar të babës, mirëpo rrethanat që ia solli koha, e penguan në atë qëllim. Tash me gjithë familje ishte vendosur në qytet, fëmijët i janë rritur t'i vijnë në krah, andaj dëshira i rritej sikur edhe qyteti që i duhej edhe një furrë buke.

Monopol mbi miellin e ka pasur magazja e usta Jakubit, dhe ky u nis tek ai për të biseduar, të siguronte material dhe me ndihmën e Zotit të fillonte nga puna. E gjeti në oborr, rreth tavoline, shoqërinë e njohur: Damjanin, tregtarin e lëkur dhe krypë, imam Mujalin, karrocierin Zajo dhe Jakubin vetë. Pinin çaj dhe qetë bënin llafe. I përshëndeti me merhaba (ata po me merhaba ia kthyen) dhe u ul në vendin që ia ofruan.

- Çka rrini kaq të heshtur, mos ka shkuar kush në ahiret? – i pyeti ky të pranishmit.

Asnjëri nuk nxitoi t'i përgjigjej, duke rrufitur çaj nga sheqeri i djegur, por shpejt e mësoi ku ishte shkaku i bisedës së pakëndshme, andaj edhe ai ia nisi të fliste me pështpëritje. Pastaj bënë muhabet për të rejat nga Parruca e Shkodrës, komentuan arrdhjen e trabakullës italiane në Portin e Gjeranave, i përmendën të vdekurit dhe i lëvduan të gjallët, deri kur Jakubi më fund i dha selamin: "*Hajrli zogu me bisht të gjatë*!" – bisedë që Nikolla e priti të çelej.

- Ke ndier që kam blerë simitçihanen?
- Kemi dëgjuar, të voftë mbarë puna!
- Por miell nuk kam, usta Jakub.
- Miell? Po çka i duhet furrës mielli, - u qesh me zë Jakubi.
- Të ndez zjarrin me të, - zotni Jakub.

Buzëqeshën tharbët me këtë shaka, por biseda së rish u vazhdua për ngjarjen që i kishte mbledhur rreth tavoline. E komentonin pa u nxerë, por me hidhërim: fajtori ishte i njohur, por që papërshtatshmëria te këta njerëz, të cilët secilës fatkeqësi ia kanë dhënë kuptimin e fatalitetit, nuk kishte ndikuar në këtë shoqëri as me urrejtje e as akuza. Në bisedë kërkonin zgjidhje që s'kishte, as që mund të gjendej.

Në një çast Jakubi iu kthye Nikollës, futi dorën nën brez, dhe nga aty e nxori një tubë me çelësa, të lidhur në një zinxhir prej sermi, të trashë sa një gisht.

- Miell s'ke, po thua, ndërsa furrën e ke, a është kështu, Nikollë? – me gaz foli tregtari, duke zgjedhur një çelës.

- Kështu është, Jakub efendi!

Jakubi në grumbullin e çelësave e gjeti një kallauz mjaft të madh, e ngriti para syve të Nikollës dhe e lëshoi në tavolinë.

- Ti e di magazen time në Totosh?

- E di.

- Ky është çelësi i asaj magazine. Aty ka thasë me miell misri dhe miell të vrugtë. Në fuçitë prej kartoni ka miell të bardhë, një miell si pudra prej Selaniku. Merr çka ke nevojë dhe sa të lypet. Kur të çohesh në këmbët tua – ma kthe kallauzin.

Nikolla e shikoi i çuditur, por e përmbajti veten, e kapi çelësin dhe e futi në parzëm. Të pranishmit nuk e bënë llaf bamirësinë, ndërsa Damjani prapë e ktheu bisedën për ngjarjen e padëshiruar. Jakubi e thirri rrogëtaren që mysafirëve t'u sillte edhe një turrë sherbeti dhe muhabeti i shtruar zgjati deri në mesditë.

Ngjarja dhe biseda që e dëshmonin lexuesit ndodhi po atë vit. Po të asaj jave dhe po atë ditë kur në Ranë të Ulqinit, në breg të ranishtës, keqbërësit e rrënuan Xhaminë e Marinarëve.

Miqtë, myslimanë dhe të krishterë rrinë rreth të njëjtës tavolinë, pa trazim, por me mall, për atë krim pa gjyq të okupatorit dhe bënin bisedë.

Pa kaluar një vit pas kësaj, Nikolla, kur furra e tij "*qëndroi në këmbë të veta*", duke nxjerrë simitet më të mira në qytet ("*Simite me mill grunit, na ka pjekë Kola i Naumit*!") me përpikëri e ktheu të gjithë miellin e marrë hua, si dhe kallauzin, ashtu siç e kishte marrë, ia ktheu efendi Jakubit. Sa është marrë miell nga magazja dhe sa ishte kthyer në vend të vet, për këtë zotërinjtë e asaj kohe as që kanë bërë llaf.

Në fillim të qershorit të vitit 2012, pas tetë decenieve, është rindërtuar Xhamia e Marinarëve në Ranë të Ulqinit. Në mes të shumë donatorëve, të cilët me zemër kanë dhënë kontributin për ringritjen e përmendores, u gjet edhe emri i nipit të Nikollës.

2.

Viti 1995, 1996, 1997...

Vite të rrezikshme në lumin e Bunës, në brezin kufitar në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, përplot me ngjaje që s'parashikoheshin dhe lajme konfuze. Kontrabandistë me mallra me pak e me shumicë: cigare, naftë, drogë, armë... Tregti me njerëz dhe të palejuar: me materiale ndërtimore, me teknikë të bardhë dhe pjesë rezerve për makina e automobila. Shpijuna dhe vrasës, fukaraja e tmerruar në rrugën për në Eldoradon e vet të imagjinuar dhe tregtarë të rafinuar me qëllime të qarta, me shtigje të ditura dhe para të sigurta. Ushtri dhe polici, të dyja të korruptuara dhe me shtigje të siguruara kalimi për klientelën e mashtruar.

I gjithë ai kaos i lulëzuar nuk i ka ndalur peshkatarët në Bunë, që të heqin dorë nga shoqërimi në kasollet e tyre, që e kanë nisur ku ta dish nga e cila kohë. Më të pasur e të varfër, të shkolluar dhe analfabetë, besimtarë dhe të pazotë, djelmosha dhe pleq, myslimanë dhe të krishterë, shqiptarë, malazez dhe serbë, por që të gjithë njësoj: peshkaxhi në Bunë, do të mblidheshin në tarracën e kasolles së peshkatarit më të suksesshëm në atë sezonë dhe do ta festonin gjonjën. Zjarr në mangalle, llamba karbiti, zjarre në rërë, do të ndriçonin fytyrat e qeshura. Kallëzime të moçme dhe ngjarjet më të reja, plane dhe dëshira, shpresat e kota dhe planet e fshehta. Piqej peshku dhe derdhej vera. Në natën me lagështi në lumë, rridhte biseda, të qeshur i përmbajtur dhe me një zë të shtruar ia thoshin këngës: "*Vajzë e mirë, vajza ime, unë jam peshkatarë nga Ulqini, ti kur të vish në anijen time të vogël, do të lundrojmë nëpër det*..."

Në njërën na netët e tilla (dëshmitari i ka treguar shkrimtarit se ka ndodhur në tetor të vitit 1997), në një kohë para mesnate, peshkatarët që veç u kishte rënë pija në kokë, i shqetësoi zëri i çjerrë i një shokut të tyre. Milan Vorgliq-i klithi fjalinë, një tetërrokësh lahute: "*Od Bojane pa do Trsta, krstice se su tri prsta*!" (Që nga Buna deri në Trieste do të kryqëzohet me tre gishta). Dhe zuri ta përsëriste, me një zë gjithnjë më të lartë, duke imituar sikur i binte lahutës. Meqë nuk kishin ngjarë shqetësime të tilla, të gjithë mbetën pa gojë. Në lumë është respektuar shoqërimi dhe rrallë ka ndodhur të prishet qetësia dhe solidariteti mes peshkatarëve. Jeta e njërit pranë tjetrit nuk ka duruar sjellje e as shprehje të pamatura. Ata kanë qenë peshkatarë, punëtorë në ujë dhe shokë nga fllugat.

Kur është lodhur duke përsëritur të njëjtën gjë, e mori një shishe përgjysmë të zbrazët, bëri kryq dhe atë e fërfëlloi në natë. Kur është kthyer me kokë kah shokët, nga ndriçimi i zjarrit peshkatarët kanë parë buzët e shtrembëruara nga rridhte jargë.

I pari i gjend Hamo Bajraktari. U ngrit dhe iu avit shokut të dehur, ia qiti dorën në shpinë dhe e çoi te stoli ku rrinte. E uli pranë vetes. Iu drejtua shoqërisë: Do t'ju kallëzoj një tregim të vërtetë, për atë sesi vjehrri im, pastë rahmet, në kohën e sundimit të egër të Hasan Jusufit, e ka shpëtuar nga vrasja e sigurt këtë shokun tonë dhe vëllanë e tij. Millani jonë atëherë ka qenë katërmbëdhjetëvjeçar. E përqafoi, afroi pijanecin në gjoksin e vet, e puthi në kokë dhe vazhdoi të fliste. Foli në gjuhën shqipe, që e dinin të gjithë peshkatarët. Edhe gjuha malazeze edhe gjuha shqipe kanë qenë gjuhë e tyre.

"Muratbegët dhe Vorgliqët kanë jetuar në Mera, shtëpi pranë shtëpisë, oborr pranë oborrit. Asnjë fjalë të keqe, asnjë veprim të gabuar. Fëmijët janë rritur, pikëllimet janë ngushëlluar, gëzimet janë ndarë.

Në fillim të vitit 1944 ia ka behur para shtëpive të tyre prijësi ballist, kuislingu Hasan Jusufi, me nja dhjetë ushtarë. Kali kërr i tij luante pa pra para vjehrrit tim, të cilin e njihte Jusufi. Me britmë ai kërkonte vëllezërit Vorgliq, që si pjesëtarë të gueriles së qytetit t'i çonte në Shkodër dhe atje t'i burgoste. "Kë të marrësh me vete, vëlla Hasan?" "Korrierët komunistë", bërtiti rreptë kuislingu Jusuf dhe ua bëri shenjë me dorë ushtarëve të hynin në shtëpi. Në atë çast plaku Muratbegu i thirri të tre djemtë e tij. Djelmoshat fluturim i gjendën para babës së vet. Ai i nisi t'i nxirrte nga shtëpia djelmoshat e kërkuar nga shtëpia fqinje. Bijtë dëgjuan, ndërsa plaku iu kthye Hasanit: "Këta janë komshinj të mi, ndërsa fqinji është i shenjtë, vëlla Hasan. Dhe djemtë e mi do t'i shtinë në shtëpinë e Muratbegëve. Kur t'i vrasësh djemtë e mi, do t'i marrësh robër vëllezërit Vorgliq. Mirëpo kthehu ti në Shkodër, e ne të mbetemi bashkëvendas të ndershëm, njihemi prej kohësh, vëlla Hasan". Ia ktheu shpinën dhe me djemtë hyri në shtëpi, duke mbyllur derën pas vetes. Hasan Jusufi edhe ndonjë çast ka qëndruar në rrugë me kalin e tij kërr, e pastaj i dha urdhër dhjetëshes së vet që të kthehet prapa. Me galop shkoi xhadesë drejt Zogajve".

Në mes të qetësisë së mesnatës në vatrën në rërë kanë kërcitur shkarpat e sallangoçit.

Hamoja iu drejtua shokut të dehur: "Ti, Milan, e di këtë kallëzim, mua ma ke përsëritur disa herë. Unë tash për herë të parë po e kallëzoj para shokëve... Hajt, t'ia themi këngës edhe njëherë! Dhe ia nisi kënga: "*Vajzë e mirë, vajza ime, unë jam peshkatarë nga Ulqini, ti kur të vish në anijen time të vogël, do të lundrojmë nëpër det...*"

Kori i peshkaxhive me tercinë ia dha ison melodisë...

Shkrimtarit të këtyre rreshtave i kujtohet plaku Muratbegu për një detaj, vjehrri i Hamos e ka pasur adet që rregullisht, edhe pse shumë i plakur, kur rekrutët i kanë përcjellë në stacionin e autobusëve, në Armatën Popullore të Titos, me shishe rakie në dorë i ka vizituar prindërit e rekrutëve, me ta e ka cakërruar dhe ka vërritur: "*Hajri, hajrli për trimat! Mashalla, mashalla*!"

Plaku nuk e ka ditur nashken, por që të tjerët e kanë ditur gjuhën shqipe dhe e kanë marrë mirë vesh se çka ka dashur plaku t'u porosisë.

Andrej NIKOLAIDIS

I BIRI

Vozitja me ngadalë. Në secilin gur pranë rrugës, vetëm nëse shikon pak më me kujdes, vetëm nëse përpiqesh të kuptosh, do të shohësh shkaqet e gremisjes. Rrugës nëpër të cilën kaloj është ngjitur ushtria malazeze kur e ka pushtuar Ulqinin. Lart, në rrah, prej ku nga njëra anë sheh hapësirën e zbrazët të kaltër, gjithandej deri në Otranto, nga tjetra – fushën e Shtojit dhe basenet e Kripores, janë përleshur me një njësit të vogël turk. Pastaj teposhtë Meterizit kanë zbritur para mureve të Qytetit të Vjetër. Kur sulmi i tyre është zmbrapsur, në tërbim e kanë ndezur një pjesë të qytetit, që është ndërtuar e re, që sot, *o kënaqësi e eufemizmit!*, thirret Mëhalla e Re. Shtëpitë prej druri dhe me qindra ura të vogla janë djegur deri në agim, duke ua ndriçuar ulqinakëve udhën në ardhmëri.

Kur më në fund e ka zaptuar Ulqinin, kral Nikolla ka urdhëruar që nën muret e Qytetit të Vjetër të ndërtohet kisha. Thonë se në muret e kishës janë vënë gurë të bedenave ciklopike, të vjetër me mijëra vjet. Ato që kanë rrënuar gjatë shtetrrethimit, pjesë të mureve që janë gremisur në det nga të shtënat e topave, i kanë vënë në muret e kishës. Më vonë, rreth kishës kanë ndërtuar vendbanim. E kanë rrafshuar varrezën myslimane në ç'vend, me shekuj, ulqinakët kanë varrosur të vdekurit e vet. I kanë rrëzuar mezaret, i kanë hedhur në det, sikur me thundra e kanë shkelur tokën, thuaj se aty kurrë kurrgjë s'ka pasur dhe, *mu* aty i kanë ngritur shtëpitë e veta.

Ku në të gjitha këto ekziston mundësia e lumturisë? – mendova. Në vdekje, në rrënime, në grabitje? Dhe gjithmonë ashtu, dhe vetëm ashtu, mendohesha, duke gjetur kënaqësinë në moralizimin në të cilin – vaj! – i jam lëshuar për pak kohë.

Makinën e parkova para murit me të cilin është rrethuar kisha. Kjo është largësia më e vogël që do t'i afrohem, mendova. Rruga më e shkurtër deri në Kala ishte nëpër oborrin e kishës, por që kurrë nuk më ka shkuar mendja të kaloja atypari. Nëse kam pasur mllef ndaj katolicizmit, mosinteresim ndaj judaizmit, nëse e kam ankuar islamizmin, ndërsa e kam rrejtur protestanizmin, pravosllavja më është gërditur. Prandaj, në vend nëpër oborrin e kishës, kam shkuar përreth, pranë kontejnerëve përplot bërllok, të cilin ndërmarrja komunale me ditë të tëra s'e ka bartur. Në mes të kundërmimit të plehrave dhe kundërmimit të temjanit,

gjithmonë e zgjedh atë të parën, thashë në vetvete. Zgjedh rrugë të ndyta, në vend të petkave klerike, kujtova. Nëse jam aq i trashë dhe i dëshpëruar që të kërkoj shpëtim, që të shpresoj, do ta kërkoj në asfalt, gjithsesi jo para oltarit.

.....

(Fragment nga romani homonim i Andrej Nikolaidisit, në përkthim të Hajro Ulqinakut, botuar kohë më parë në bashkëpunim të Art Club-it dhe PEN Qendrës së Kosovës. Në përurimin që u bë në kuadër të Skenës verore – Ulqini 2013, vlerësime shumë pozitive dha në ligjëratën e tij prof. dr. Basri Çapriqi).

Roman

Ag APOLLONI

DASHURI E SERTË

Dashuria me të nisi si një keqkuptim. Isha ca ditë në Ulqin, oh në atë Ulqin që bie erë gurbetlijsh, apo siç kanë qejf të thonë, në Ulqinin e Servantesit, ngaqë, sipas një legjendeje, aty donkishotët e kishin burgosur autorin e tyre. Eh, pikërisht në atë vend shkrova poezinë *Retorika e heshtjes*, të cilën ia dedikoja ish-të dashurës sime, me të cilën i kisha dhënë fund para disa vitesh. Por, për çudi, edhe pse poezia ishte për një dashuri të kaluar mungesa e së cilës më mundonte ende, kjo vajzë e mori për vete ngaqë ngjyra e syve ishte e kaltër. Kur më pyeti nëse ishte për të, unë, ndoshta duke qenë nën ndikimin e Mefistofelit, ia pohova menjëherë dhe kjo poezi na lidhi shumë. Edhe shokët e shoqet çuditeshin sa shumë më donte, pasi s'dinte t'i fshihte ndjenjat. Ishte një lidhje pasionante. Nga britmat e saj gjatë aktit të dashurisë, disa ditë pas kësaj lidhjeje, të gjithë fqinjët i zëvendësuan dyert e dritaret e vjetra me dyer e dritare hermetike.

Por, pse përfundoi kjo dashuri e çmendur? Sepse ajo i urrente librat, e unë, fatkeqësisht, jam shkrimtar. Derisa unë shkruaja, ajo më hipte në qafë, ose më pshtetej në prehër. Atë kohë shkruaja doktoratën dhe, mund ta marrësh me mend, sesi më nxirrnin taktit lojërat e saj. Derisa unë koncentrohesha të shkruaja, ajo kërkonte vëmendje për bisedat që i kishim bërë njëqind herë. Kur s'e gjente atë vëmendje, ia mësynte vitrinës dhe hidhte gjithçka në ajër, aq sa unë i çuditur shikoja teksa fluturonin: Homeri, Eskili, Virgjili, Shekspiri, Goethe, Dostojevski, Poe, Tagora, Sabato, Kawabata, Eco, Hesse, oh jo, *Ujku i stepës!* U çova në këmbë, ajo ra në dysheme. Nuk di sa fort e kisha goditur. Dora nuk ka masë.

Prandaj, për të mos kapur sakicën, si Jack Nicholson te *The Shining*, nga vera e vitit 2011 ia bëra me dije që lidhja jonë kishte marrë fund, por ajo prapë kishte vendosur të rrinte me mua deri verën e vitit tjetër, kur ika prej saj dhe shkova në Shqipëri, ku kalova pjesën më të bukur të vitit me një kaçurrele të lazdruar (por për këtë do të flas pak më vonë), sado që ilegalisht, sa për kontakte fizike, jemi takuar edhe para ca ditësh. Ndoshta asaj i pëlqente të lëndohej nga unë dhe nuk është çudi që ajo më bie ndërmend saherë që dëgjoj:

Just gonna stand there and watch me burn
Well that's alright because I like the way it hurts
Just gonna stand there and hear me cry
Well, that's alright because I love the way you lie

Pse u ndamë? Sepse kisha frikë se kjo lidhje dramatike me grushta, e tipit *Love the way you lie,* mund të kalonte në dashuri me thikë, të tipit *Beyond here lies nothing*.

Kur e kuptoi që më nuk kishte gjasa të ishim bashkë, sepse lidhja e re tashmë më kishte përvetësuar të tërin, provoi të ndizte xhelozinë në mua duke më thënë se më kishte tradhtuar. Dhe kjo më bëri përshtypje sikur ato fjalë të m'i thoshte gruaja e këtij fqinjit që s'e kam idenë nga cila pjesë e Azisë është, megjithëse duke e njohur karakterin materialist të saj, them se ajo mund të më tradhtonte për një *Iphone.*

Nuk tradhton vetëm ti,- më tha.

Shpirt,- i thashë ëmbël për herë të fundit,- unë nuk tradhtoj, unë bëj seks.

Me kë?

Për t'i dhënë fund njëherë e mirë lidhjes, ia tregova njërin nga emrat (natyrisht ty s'të përmenda, as atë me të cilën ajo pinte kafe, as atë tjetrën përtej detit), ia tregova pikërisht atë në të cilin ajo dyshonte gati që tre vjet. Lëshoi një "jooo" të madhe sa pata frikë se do të plaste poçi elektrik, do të thyheshin xhamat, do të troshiteshin enët, do të më pëlcisnin veshët.

Ku?, më pyeti.

Meqë u bëra se u bëra i poshtër, vendosa t'i shkoja të keqes deri në fund, që kurrë më të mos mbetej asnjë grimë shprese për bashkim të sërishëm:

Në Tiranë, në atë hotelin ku ishim bashkë, në atë dhomën me atë pikturën cullak përballë.

Asaj në çast iu fikën llambat dhe u përplas në kokërr të shpinës në kuzhinën ku po fjaloseshim.

Sigurisht u pendova. U ula, e godita faqeve për ta sjellë në vete. Pas pak ajo lëshoi një zë, që m'u duk i ngjashëm me zërin tmerrues të *Michael Corleones* kur ia vrasin vajzën. Nisa ta puth për ta qetësuar se dukej që do të paralizohej, meqë ishte shfytyruar krejt. Provova ta bindja se gjoja ky ishte vetëm një trillim, por asgjë më nuk pinte ujë.

Me shpejtësinë e rrufesë kujtova pjesën e ëmbël të lidhjes sonë: një natë kur sapo u afrua mesnata, u habita pse iku nga përqafimi im dhe shkoi vrap në kuzhinë, mendova se do të merrte ndonjë thikë dhe po rrija goxha i trembur, kur ajo u kthye me një thikë... dhe me një torte, të cilën e ndava pasi ma kujtoi që kisha ditëlindjen; një natë ishte veshur me ca

veshje haremi me xhingla-mingla dhe vallëzonte për mua një muzikë të Shakirës; një natë tjetër e kishte mbushur shtratin me qirinj të kuq, kishte fikur dritat elektrike e po më priste derisa u ktheva unë pas mesnate, pasi me ca gjermanë mysafirë kisha pirë nja shtatë litra birrë, e mezi mbaja ekuilibrin dhe duke qenë dy herë në faj, i vonuar dhe i dehur, mezi iu afrova shtratit ku gati ishin fikur qirinjtë dhe, duke u munduar të shtrihem, desh dogja banesën.

Ajo, pasi i ndihmova të ngrihej, më pështyu, pastaj më goditi dhe kaq m'u desh mua që ta alivanosja sërish. Kësaj here nuk i ndihmova të vijë në vete, por nisa të vishem avash-avash. Kur ktheva kokën drejt saj, ajo po shtypte numrat e telefonit.

Kë po e thërret?

Policinë.

Guxon?

Tash ta tregojnë qejfin ata?

Ma hanë karin bashkë me ty, - thashë dhe e kapa për fyti.

Psikopat, jam e lumtur që po i japim fund. Kjo është dita më e lumtur e jetës time. More qen, more pis, more... more plak!

Uou! Unë plak?!

Ah, e dashura lexuese, kjo fyerje s'durohet! Në familjen time, nga lisi i gjakut, ka mëse njëqind vjet që nuk plaket asnjë burrë. Të gjithë vdesin porsa arrijnë të pesëdhjetat. Babai në moshën pesëdhjetë e tre, xhaxhain e masakruan po në atë moshë, gjyshi vdiq pak më i ri se të bijtë. E, si ka mundësi që unë qenkam plakur?!

Ti, ti! Dukesh si me i pasë pesëqind vjet.

Unë hapa veshët sikur po mundohesha të dëgjoja diçka, pastaj thashë:

I am Dracula. *Listen to them - children of the night. What music they make*!

Mshele! T'i kam dhënë të gjitha dhe kurrë s'më ke dashtë, - nisi të zbraste rafalin e saj. Ta kam dhënë virgjinitetin...

Virgjiniteti s'është vlerë. Me të merren vetëm serialet e lodhta që i shikon ti.

I poshtër! Ta kam dhënë trupin, zemrën, gjithçka të kam dhënë...

Oh, merri të gjitha dhe zhduku!

Më pa me një shikim blu të çuditshëm ku pikturoheshin qartë: urrejtja, dashuria, pikëllimi, mërzia dhe lodhja. Sa e bukur ishte! Më vinte ta puthja dhe të pajtoheshim prapë, por aty për aty e binda veten të mos ia shikoja gjinjtë, as buzët dhe të solla ndërmend ty, ty që s'di të më bësh nervoz kurrë dhe, mendova, meqë qenkam plakur, nuk ia vlen t'i çoj dëm ditët e fundit të jetës.

Paramendova veten si plak pesëqind vjeçar përballë kësaj vajze njëzet e dy vjeçare dhe m'u duk vetja pedofil. Sa mirë që i dhamë fund!

You know I'm free, free now baby
I'm free from your spell
Oh I'm free, free, free now
I'm free from your spell
And now that it's all over
All I can do is wish you well

Për të pata menduar të shkruaj një roman, një roman për një femër që të rraset në jetë dhe s'të shqitet prej andej, por kur e pashë filmin *Bitter Moon*, ndërrova mendje. Atë që kisha jetuar dhe që doja ta shkruaja unë, e kishte bërë para njëzet vjetësh Roman Polanski. Mallkuar qoftë!

Sot i vë gishtin kokës dhe mendoj për të. Pse e torturoja?, e pyes veten. Ndoshta sepse e doja, përgjigjem. Edhe Zoti i torturon ata që i do më shumë. Pra, unë po ndiqja rrugën e Zotit. A nuk thonë edhe librat e shenjtë që *Ai e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vetë*?

.....

***Ag Apolloni** (1982) është shkrimtar dhe profesor në Universitetin e Prishtinës.

Ka kryer studimet për Dramaturgji për Letërsi, ku edhe ka doktoruar.

Ka botuar librat "*Zomb*" (2009/2012), "Drama" (2010), "*Parabola postmoderne*" (2010) dhe "*Paradigma e Proteut*" (2013).

Ka botuar shkrime kritike në disa gjuhë të huaja, kurse monodrama e tij, "*Stefani, historia e një koleksionisti të syve*" më 2011 është botuar në gjermanishte.

"*Dashuri e sertë*" është fragment nga romani në dorëshkrim që është përfunduar në Vjenë, ku autori ka qenë i ftuar si "*Writer in Residence*".

MEMOARE

Don Ndoc NIKAJ

KUJTIME TË NJI JETËS SË KALUEME

KRYENGRITJA E MALCIS SË MADHE[1]

Pregatitjet qi ishin tue u ba për me njallë në zemrat e popullit andjen e liris kombetare, ishin me qilim qi me lanë kohë të mjaftueshme qi populli vetvetiu ta merrte vesht, e ta kuptonte mirë se cila ishte lirija e vërtetë qi duhej për gjallnin e vet. Mema na dukej neve se ishte ene e pa pjekun pse mretnonte ne ne fanatizmi fetar qi me të paren rasë mund të shkaktonte dasina të damshme tue çue popullin me disa vjet per mbrapa dhe me rrezik me humbë të gjithë mndin e bamë deri n'at herë. Na qi aso kohe, me të vertet ishim nji tubë aq e vogel atdhetarësh me ideal të rrajosun per me mbërrij lirin kombëtare sa qi mund thohet se mund njeheshin me gishta. Kishim degat në Gegëni e Toskëni por vetëm aty këtu dhe lidhje me shoqninat e komitetit të jashtem per të gjithë të pa mjete të përshatëshme per shtypjen e nji populli per me kerkue me këmbëngulje e me armë në dorë lirin e vetsundimit.

Porsi si zjarmi i ndezun kadales e i mbuluem nen shpuzë po ti largosh tek hinin e të marrin ajr gacat ndezet e merr flakë ashtu ndodhi në krahin e Malcis së Madhe të Mbishkodres.

Të shtym e të ngucun Malcorët bante kryengritje me shkajk se se Turqirisat deshne të s'armatosin Shqpnin. Ata Shqypnin e doshin të shtrueme porsi vendet tjera të Mbretnis Otomane. – Të gjithë – thoshin ata – duhet të kenë të njajtat detyrime e të njëjtat të drejta. Kuer i kerkuene armët Malcis, per mos me i idhnue shimi, u thame me i mbledhë armët e me i lanë tubë te Kisha se i cilli katund e aty, med emen të secillit të shkruem me jau shperra kur t'ishte nevoja me i dalë zot vendit e Mbretnis.

N'at të parë Malcorët e patne pranue por pak mbrapa kje derdhë fjala an e kanë se ishte nji trathti e bame dhe se dojshin me çue me i mbledhë armët e laguna neper Kishat pa dijeni të tyne. Kje derdhë fjala se lirija e dhanun me konstitucion ishte gja per faqe e tradhti per me zhdukë

[1] Kjo Kryengritje u zhvillua më 1910 dhe 1911.

kërkesat e liris së vërtetë të kërkueme pej Shqyptarve edhe në malet e Mbëdhaja iu ndez Kryengritja. Ajo kje porsi nji gacë e hjedhun në barot. Rinija e djegun per liri fryni ziarmit e u çue në kambë. Unshimi i atëdhedashtunis pat fillue me ngulë rrajë nder shumë të ri t'asaj kohe e me gjith se nene nuk ishte pjekë koha per nji vedtsundim të plotë, aj mendim pat fillue me marrë hapet. Ishte aj ma i madhi ideal i guximit të rive, të flijimit e të burrnis. Me të ndezun të luftës u ndezne ne zemrat e tyne edhe i frynte në vesh njani tjetrit per me u bashkue e me dalë në mal per me fitue lirin e plotët. Edhe ma teë ploxhmit e të pritueshmit nisne me curatë veshtë porsi kali kuer ndij hingëllimin e nji kali tjeter e kërkon me u turrë vrap mbas tij.

U pa n'at ras se shkrimi, fletoret e botimi i gjuhës shqype, në pak kohë pat ba ma të parin efekt të vetin. Ishte për atë kohë nji gja e re e djelmnija Shkodrane u ndez. Se i cili idealin e vetqeverimit e të pa mvarsis Shqyptare. Ishte koha ma e para e entuziazmit. Me gjith shtrengimet e pengimet qi nepte ushtrtija qi pat mbulue Shkodren, disas të ri gjetne shtigje per me dalë prej Shkodre me kalue në Mal të Zi e me u bashkue me Malcorët në Podgoricë e andej me ra e me u perleshë me ushtrit turkoshake.

Knjaz Nikolla, në sa gjindeshin krenët e maleve në Podgoricë, pat shkue aj vetë deri aty me u pa me ta

Nga të gjitha mbretnit e hueja lëvizja e Malcis kje njehë porsi nji të lëkundun i Shqypnis per kërkimin e liris, por mbasi koha ishte ende e pa ardhur me mjetet e mjaftueshme per me nderure nji sundim katerqind e sa vjetve.

Turkija kje kshllue me njoftë qillimin e asaj kryengritje e me shpërblye damet e shkaktueme nji popullsis qi pat luftue me dalë zot trojeve të vet. Stambolla nisi per Shkoder thasët me lira turke të verdha per shdamtimin e Kishve e të Qelave famullitare te djegura, per banimet e malcove të shkatrrueme, per gjanë e gjallë të plaçkitun e per dore të nji Komisjoni të kryesuem nga Argjipeshkvi i Shkodre, me ndihmen e të vllatë Shuk Serreqit porsi pjestar n'at komisjon u kjenë caktue shperblimet të damtuemve. Po edhe n'at rasë kjenë ndij ankime per mbi përfitimet e bame me shpedorime të poshtme t'atyne qi patne gisht nder të dame. Punë këto qi kapërcejnë rrethin e këtyne diftimeve t'ona.

Diftohej, mbassi u këthyene malcorët nder shtëpija të veta, se Knjaz Nikolla, në sa gjindeshin krenët e maleve në Podgoricë, pat shkue aj vetë deri aty me u pa me ta. N'at rasë aj kishte dashtë me perfitue per nji afrim

me malcorët per qellimet e veta. U kishte lanë të lirë shtegun per me gjetë strehë në tokët e tija kuer kjena të dbuem e të shtyem nga fuqia e madhe e ushtrive turke, u kishte dhanë ndihma në fysyhekë e n'armë, u kishte dhanë ushqim e prandej aj kishte të drejtë per nji mirnjoitje të veçant nga ana e tyne. Mbassi pagt dhanë nderime guximit e qindreses së tyne, Knjaz Nikolla i kje sjellë Dedë Gjo Lulit të Hotit qi ishte nji nder krenët e Maleve edhe nder kryetarët e asaj lëvizjed kombëtare edhe i thanka:

- Mbassi me Mbretin e Stamollës nuk gjinderni të qetë, çka kishit me thanë po ta merrshim sundimin une per mbi juve?..

Dedë Gjo Luli kenka çue pergjegjë:

- Ti na ke dhanë ndihmë qi kena pasë nevojë edhe të jena mirënjohës per të gjitha, por per pikën qi po n'a thue, ta dhaçë besën e Zotit, se jena me ty per çdo nevojë per me të shpërblye të mirat qi n'a ke ba, por, po m'erdhe te praku i derës, ta kena vue pushken sikur ja kena vue Turkis.

Knjzi, porsi brrë q ishte, u afrue e i ra krahve e i tha Dedë Gjo Lulit:

- Të lumtë goja! Këto janë fjalë burrash e une nuk dishroj tjeter por vetem misin e ngusht me burrat e Malcis.

Me aq i pat pershendetë edhe i la të lirë në punët e tyne. Çë ndryshim ndermjet të nji Malcorit me ndisij kombëtare e me nji Shkodranit të devgës mbrame!

Me aq lëvizja e Malcis muer fund por ajo pat kenë nji shkndi e parë e nji barot qi pak ma vonë do t'i nepte ziarm Ballkanit.

LUFTA ME MAL TË ZI[2]

Malazezt filluene me kaperzye kufinjt e me ba plaçkë në token Shqyptare

... Mali i Zi në luften e Kstratit kje i gatuem me ngucë turkin në kufinjt e shqypnis, ku ishte i vetmi shteg per te me u shtri e me u zgja krahësh edhe pak ma teper nder fusha buke per te cilat kishte nevojë per rrnesen e vet. Knjaz Nikolla pat ngucë e ndezë malazezt n'uzdajë e nji nxanies ma të hapët në ket anë ndermjet të malcis madhe e të ushtrive turke nuk mujt ma me i ndale e Malazezt filluene me kaperye kufinjt e

[2] Ngjarjet e vitit 1911.

me ba plaçkë në token Shqyptare. Patne fillue me u lanë krena në njanën anë e në tjetren e Turkis ju desht me çue ushtri per me ruejt kufijt. Me gjith ate Malazezt u bijshin rojeve naten, i vritshin edhe ku mujshin bashin plaçkë e ikshin. Populli gjindej i shqetsuem. Pajtimi i gjaqeve u ba me nguti.

Nji natë qi kumara i shtëpis tek Elezi, flamurtari i Lohes qi gjindej në komision të krenve, erdhen me bejt i tha Tatës 'em, shpejt kena luften me Mal të Zi. Kan ra në pre në Kelmend e kanë marrë nji tufë me berre. Asht lëshue kushtrimi, i kan ndjekë perte kufinit, kan vra nji të tyne, kanë marrë gati të gjitha berret, pse vetem pesë kanë ngelë të hapuna, kanë vra nji sish edhe janë kthye të gjith shëndosh në të banat e veta. Në kufij të Hoptit kanë ba pushkë javen qi shkoj. Kush në ket anen tonë nuk ka mbetë porse këto po janë të nghucuna e janë shenja se shpejt do të kena luften me Malazez. Janë shenje sikur nep nji re e zezë në qiell per shijn qi do të bieri. Jena tue shpejtue pajtimet per qi mos të na nzanë lufta gafil. Bafti i Zotit Gjokoo se edhe nji herë po i masim taganat me Malazez.

Malazezt qi kerkojshin të shtrimun nder tokat shqyptare prej se të ndrydhun nder malet e veta plot shkambije, ku shtoheshin e mbas disa vietve nuk kishin kahë me marrë shfrim per rrnesë e të shternguem me jetue vetem me ndihmat e tjerve të çueme atyne në drithë qi u nepte atyne vjetë per vjetë Austrija e Rusija, por nuk ju mjaftonte per nji rrnesë të pershtatëshme. Kuer gjindeshin të ngushtuem lshoheshin me tuba e bijshin nder kufijtarët diku në pre, diku në vjedhje, diku në plaçkë edhe asht mbas sa ankimeve qi baheshin në Shkoder e prej andej në Stambollë, e prej Stambolle në Xetinë, ankime qi nuk merrshin kurr perfundim të marë, shperthejshin vrasa të pergjakëshme ndermjet të dy palve kufinjarë nuk rrinte mjet tjeter shfrim veç se lufta.

Mbreti i Stambolles, n'ato rasa gjindej i shternguem me çue ushtri në Shkoder, me dhanë kushtrimin maleve, me mbledhë ushtarë në toskni e me msye Malin e Zi per me ja rrudhë guximin.

Lufta të përgjakëshme baheshin aso kohed ndermjet të Shqyptarve e të Malazezve e qi perfundoheshin gjith herë me të msyeme e perleshje në tagana tue u gri e tue u lakmue me të madhe egersi. Msyshin burrat ma të fortit e guximtarët me marrë krye në Shkja, sikur thirreshin aso kohe Malazezt e Serbt, prej Shqyptarve e kush dallohej në shenj prej tjerve me guzimin e veçantë edhe binte në lamin ushtrak të vetin kryen e nji anmiku merrte nishanin e nderimit qi e barte në parzem porsi shenjin e trimnis së bame.

Kumara i jonë Tak Elezi per posë nishanave tjerë të fituem per veprimet e tija porsi krye e flamurtar kishte gjithë herë te qepun per jelek at nishan qi e dallonted prej tjerve.

N'at vjetë kje nji luftë e madhe edhe e giatë. Turkija e merzitun prej ngcjeve të pa dame të Malazezve qi ishin nji popull shumë i vogel por i pa rysun çoj aso here nji ushtri të madhe në ta. Lshoj edhe të gjitha fuqit shqyptare qi rranë në mbas kushtrimit me uzdajë me rrudhë guximin e tyne nji herë e pergjithherë.

Mde qi une aso kohe u gjeta në tregun e Pazarit porsi shegert, që më pat vendue baba per me mujtë me largue mendje rrugen e priftnis, më ra me pa të gjitha fuqit e ardhuna prej Stamolle neper Shenjin e në Shkoder e ashtu edhe ushtrit shqyptare të maleve qi se i cilli mal, nbas flamurit të vet e Ulqinit qi aso kohë gjindeshin në duer të Malazezve.

... Me ket luftë i kjene shkund brinjt Malit të Zi qi kjo kje djegë e pjekë, por jo i mujtun shqimi pse të vuem para nga ushtrit turke, Malazezt ju rrashë maleve të nalta e shumë duelne në kufij të Austris ku u shumuene aq teper sa qi Austrija u ndermjetsue me pushue luften e turkija per mos me pasë ngucie me qeverin Austriake terhoqi ushtrit prej Malit të Zi.

LUFTAT BALLKANIKE[3]

Tuqit e ri qi patne marrë në dorë sundimin e Turkis nuk gjindeshin n'at naltësi që lypej per me drejtue nji mbretni aq të madhe e gabmet e tyne shkaktuene shqetsme per çdo vend qi gjindej nen sundimin e Stamolles. Fuqitë Europiane edhe ata të merzituname turbullimet e shkaktueme prej popujve ballkanikë, sikur Serbija, Bullgarija, Greqija e Mali i Zi, qi shum heresh me kryengeritje të pergjakshme patne kerkue lirin nga zgjedha e Turkis. Shqypnija vetem e frymzueme me fanatizem të besimit fetar, qi shumica e banorve kishte te njajtë me Otomant, n'at pshtjellim ngelne nder dysha edhe pa nji të parë e prisë per me drejtue, nw mungesë të nji bashkimi e t'idealit të liris qi nuk kje pjekun ende nder ta u vuene në rrezik me ndjekë fatin e Turki po tmos t'ishte bregu i Adriatikut dhe largësija me Turkinë per me e pshtue.

[3] Luftat Ballkanike: 1912-14. Shkodra, pas tradhëtisë që i bëri Esad Pasha, u pushtua nga malazezët, më 23 prill 1913.

Mbas shum kryengritjeve të bame per me dalë dore orej Turkis, Balkant u lidhne me i çpallë luftë Stamollës dhe ndo me dalë në liri ose me vdekë.

Turkija çoj në kambë të gjith fuqin ushtrake të veten per me i ba ballë nji ziarmit aq të hapët qi e shterngonte me shperda fuqinë në shum vende nji heri.

Pushka, topi, ziarmi ed rrenimi, per disa kohë mbretnoj nder vendet e luftës e gjaku i burrave derdhej rrshe per gjith anë.

Në sa që në vendet tjera luftohej me rreptësi kundra Turkis e ushtrit e Sulltanit mbetne të thyeme e të shpërdame nder disa vende në Greqi, Serbije e Bullgari, Mali i Zi ju afrue Shkoders e me fuqi të madhe e shtini në rreth. Shkodra kishte teper pak ushtri të rregullt të sunduese nga Hasan Riza Pasha, nji nder ma të mirët komandanta t'ushtris turke me nxeje luftarake në Gjermani, edhe Esat Pashë Toptanin, qi me vullnetar shqyptarë pat ardhë në ndimë të Shkodfres.

Qindresa e Shkoders, me nji kryetar sikur Hasan Rizan kje shembullore dhe e fortë. U kushtoj gjak shumë Malazezve të ngujuem rreth kodrave e maleve rreth e per qark të Shkoders nuk mbujti me ba hap per brenda. Luftë e përgjakëshme e per t'u mbajt mend kje ajo e bame në Lodertunë, në krah të rrajzave të maleve, ku vullnetarët shqyptarë të rrahun nga të gjitha anët, me dredhi luftarake të pa shoqe, shtin në rreth e grine e i shqymne pa mujtë me pshtue asnjë nder ta. Por me aq nuk kje veç se nji fitim i veçantë i nji vendi, pse bataliona tjerë kjene çue per me forcue at anë. Serbt qi, nga ana e tyne kishin ushtarë të tepruem per nevojat e ngutshme, u çuene malazezve ushtri të vetat per ndimbë edhe ashtu u forcuene.

Vlonte pushka batare herë në krah të Shtojit, herë të Taraboshit

Mali i Zi, tue gjetë nji qëndresë aq të fortë në Shkoder nuk gjeti t' arsyeshme me myse me fuqi të shumta e me ba dam ushtrinë e vet, të lodhun së tepërmi nder të ndeshuna të përgjkëshme, por shtini në rreth Shkodren me e marrë prej uejet.

Shkodra n'at kohë u gjet me popullsi të madhe prej se nga shum katunde ku kishin ra malazezt, banorët kishin ikë frige e shkue e ndrye në gjytet nen mbrojtjen e ushtris. Nga aj shkak ushqimi fort shpejt u sos e mungesa e bukës u ndij shumë shpejt në gjytet.

Me gjith se ueja e shterngonte Shkodren rrebtsisht, Hasan Rizau forconte qëndresat në mëndyrë që ishte ba e pa mundun me shti në dorë gjytetin me fuqi ushtarake. Kriste topi per mbi Shkoder, me natë e me

ditë vlonte pushka batare në krah të Shtojit, herë në krahtë Taraboshit. Vishin tabuta në gjytet me të vdekur e të varruam e ashtu e edhe ma teper shkoshin n'anen tjeter.

Nji ditë, u ba nji të ndeshun i fortë te bokat e Rencit afer Shkodre. Ngiati pushka per disa orë, por na të vaditun me ndij dita me ditë aso ngjarjesh, nuk u veshim ma veshin. Ishem tue shkue rrugës prej Kishet Madhe të Shkoders per te Arra e madhe edhe faqen e bokave e kishem parasysh. Me ças meni furija e të shtimeve batare e pushkve e veç u ndigiune ma rrallas në tak tuk. Shof se ushtrija turke qi pat luftue n'ato kodra asht vue në t'ikun edhe malazezt po i ndiqshin mbrapa tue qitë në ta. Malazezt nga faqja e pertejme duele në maje të koders në sa qi tjerët në t'ikun bishin teposhtë. U ba nji pshtjellim i madh. Malazeztë nuk kishin tjeter përpara veç zallin e Kirit per me hye ne Shkoder. Gjytetasit e atij krahi kishin ngelë ngri tue vrue përfundimin kur kah Pojletat e puntorve nji tubë ushtri e shuma e perbame me ermen, me turr të shpejt përballoj t'ikunit, i vuni para, vrau disa qi nuk ndigiuene me u këthye edhe ashtu së bashku me ta, u ra malazezve, i theu, i vuni para u dha kodres përpjetë edhe i holl perte kodre ku mbrapa per disa orë ngiati pushka ndermjet të dy fuqive pse u shkuen ndimba të dy palve edhe u ba n'at vend luftë shum e pergjakëshme.

Hasan Rizau, me gjith se rrethimi i Shkoders ishte shum i shterngueshem tri heresh me ushtri të vet u ra me vrull të rrebët befas e naten rojave të rrethit, duel në Zadrimë, mblodh drithë edhe e shtini në gjytet per mdimbë ushqimore.

Me gjith se Hasan Rizau pat shpërthye rrethin e Malazezve në krah të Zadrimes e mbledhë grunë e kollomoq aq se ngutsija e lejonte edhe ate e pat ba dy tri heresh, ushqimi ishte ne të sosun e populli pat ngelë pa buk. Filloj ushtrija me pre kualt e ligsht n' pare e ma vonë edhe tjerët. I kje da popullit mish kualsh qi shum pak e shtini ne gojë pse ma parë pranonin me vdekë se me hanger mish kali. U gjetne asi ndjerzish të pa shpirtë qi shitshin mjellin të përziem me ranë e me sende tjera per m e randue e me marrë çmime të mira. Filluene me vdekë ueje aty këtu neper lagje. Dy djelm të rij fqinj me shtepin Tanë ndiqne ueje në nji javë njani mbas tjeteririt.

Më ka ngelë pershtypje e randë fjala e ndijme n'at kohë të ngushtë qi nji familjar, per me pshtue robt e shtëpis nga vdeka shiti shtëpin e vet, tri anesh e llomash me kopshtë e oborr dhe në ballë të nji rruge të gjanë në vend të çmueshëm per dy koshiq kollomoq!..

Mbaj në mend me të therun zemre qi tue kalue prej dere të qelës së Shkoders në rrugen per mbrapa ndjeva nji lypsë tue britë mbas dere të nji

shtëpis, n'at rrugë tue thanë fajshëm: "Aman, të lutem për hater të Zotit ma qit nji thermi buk se diqa, më duel shpirti!.." Zanin e kishte të marrun, fuqia trupore e kishte lshue.

"Nuk kena as per veti! – i pergjegjej zani i nji gruaje prej brendi. Te e mbramja aj mbërrini me i thanë:

- Aman, ma aqit nji thermi buke ta shof me sy e t'i marr er, se, per Zotin, nuk po ta ha e po ta këthej.

Ka ishte kenë rreshkë i ngrati nder buk. Ngava vrap me kalue rrugen per mos me ndij ma at mjerim!.. E nuk ishte i vetmi qi vuente n'at mëndyrë.

Me gjith ato vuajtje Shkodra nuk nepej edhe nuk kje tue u dhanë mos t'a ligështonte trathtija.

Në sa qe Mali i Zi pat gjetë qëndresë aq të fortë në Shkoder pa mujtë me e shpërthye me ushtrit e veta pat çue me lypë ndimen e Serbve qi me shumicë rane neper Mirditë edhe msyene Shkodren kah ana e Drinit. Tubë mbas tubash, me topa të mëdhej u frene Serbt kahë fusha.

Hasan Rizau qi pati dijeni per t'ardhunt e tyne forcoj kodrat e Beltojës e të Berdicës me prita të reja e me ushtri aq sa mujte me pasë per dore. Dha urdhrat e duhuna edhe u kthye në gjytet. Nga nji vend në tjetër aj me ditë e me natë shkonte tue shikjue e tue forcue vendet edhe nepte urdhrat aj ndretë per ndreti ushtrive dalzotse të gjytetit edhe shtonte në ta guximin.

Ato kodrina qi u bane vorri i serbve e të mjerët ushtarë porsa i afroheshin telave rrxoheshin vdekun të kacavjerrun neper telat e thepisun

Pritej në Shkoder nji duhi e madhe gjylesh reja nga topat e serbve qi vijoshin nga poshtë edhe prej kodrave të Berdicës do të synofshin Shkodren me e qitë mbrendë nen germalla e popullsia rrinte në të dridhun.

Së mbrami ushtrit serbe qi deri afer Beltoje nuk patne gjetë askund qëndresë menduene se andej pari ishte qetsi e se rrethimi ishte ma mbrendë e pa kurrfarë roje as droje, me pushkë nen krah erdhe rresht mbas rreshti tue u afrue atyne kodrave ku frymë nieri nuk shifej as nuk luente gja e gjallë. Simbas urdhrave të marruna ushtrija turke qi ruente ato kodra pat ndej squet e mshehun nbas pritave e hendeqeve të çilun n'at koder, an e kan e rrethuese ne tela të thepuem deri sa ushtrit serbe u afruese në shenj të pushkës. N'at ças me nji urdhen të parit bane nji batare pushkësh të gjith nji heri e rreshtat e parë të serbve rane të korrun per dhe.

Ajo e pa pritme pshtjelloj të gjithë ushtrin në t'ardhun dhe e shkatërroj fare. U ba n'at vend nji pellg gjakut e kerdijet sa qi nuk mund shkruhet pse ushtrit e mbrendëshme me shpejti të rrufeshme mushënin e shprazshin në ta qi të habitun nuk dijshin kahë me shkue prej se në vend të pa njoftun. Ushtrit e fundit kjene të shtyme nga eprorët per me marrë me yrysh ato kodrina qi u bane vorri i serbve e të mjerët ushtarë porsa i afroheshin telave rrxoheshin vdedkun të kacavjerrun neper telat e thepisun.

Me at të thyeme të randë qi patne Serbt në kodrat e Beltojës e të Berdicës borne fare drejtimin edhe në a mendojshin kryetarët e ushtris me çue ushtri tjera. N'at vend, ushtrit Serbe patne urdhen me u terhjekë, me shpejti nga toka Shqptare.

Shkodra pshtoj nga nji rrenim i plotë, qi do të shkaktonte artileria serbe e çume në ndimbë të Malit Zi per me shpërthye rrethimin.

N'at rrethim Hasan Rizau kishte marrë dijeni per të thyemeet e mbëdhaja t'ushtrive turke per ballë ballkanasve e per ndermjetsin e fuqive t'Europës per qi turkja të lëshonte Balkanin të lirë. Balkani i Balkanasve kje vendue prej Europet, Turkija pat pranue.

Hasan Rizau, n'at rasë, u shterngue edhe ma teper në qindresë per qi mos të binte Shkodra nen Mal të Zi, n'uzdajë se vendimi me u lanë e lirë edhe Shqypnija Shkodra të përfitonte nga qëndresa e bamun.

Me ndermjetsin e fretenve të Shkoders nder të cilët kje edhe Atë Gjergj Fishta, u ba marrveshtje fshehët me flamurtarët e maleve e me parin që të gjith nji herit të naltoshin flamurin e Shqypnis edhe me ate në krye, Shkodra prej brendi e malcija prej jashti, t'i bishin Malit të Zi, t'a shpertheshin rrethimin edhe të buejshin 'andejmi. Malazezt deri perte kufinit të Shqypnis. At marrveshtje aj ja zbuloj edhe Esat Pashës, në kujtim se porsi Shqyptar aj do të t'ishte ma i pari me e ndjekë por duel e kundërta. Esat Pasha kërkoj n'at rasë me fitue per veti e u muer vesht me Xetin per me i lshue Kënjazit Shkodredn me nji shperblim tre miljonash edhe me e mposhtet per qi të mbretnonte në Shqypnin e mjesme në Durrës e përpjetë.

Per me çue ne vend qellimin e vet aj çoj e thirri nji natë prej vone te Shtëpija e vet qi kishte per ballë të banimit të tij Hasan Rizan, per lajmime të ngutshme edhe e shtini e e vrau, me doren e nji krutani qi kishte në sherbim të vet, në mjedis të rrugës, para se të kapte deren e tij. Mbas vdekjet të Hasan Rizaut atij i mbet në dorë kryesundimi.

Çoj e mblodh të parët e Shkoders, u paraqiti të pa mundësinë me qindrue pa përtej pse mungonte ushqimi e me gjith se gjet kundërshtime aj tha, se në rasë se dojshin shkodranët me qindrue aj do te terhiqte

ushtrinë e të ju u lente atyne qindresen. Kuer e pane Shkodranët at përfundim u shtruene me ja lshue vendin Malit të Zi.

Pushka mëni. Esat Pasha me milionat e marrun e me ushtri duel prej Shkodret e Shkodranët n'e nesre mbassi u nis ushtrija u duel parakryetarve t'ushtrive malazeze qi, me daullen muzhikore përpara e me ushtrijn per mbrapa hyene e muerne në dorzim gjytetin. Në kështjell e në prefekturë kje rrzue flamuri i turkis e naltue aj i Malit të Zi.

Mali i Zi qi shum heresh pat andrrue me marr Shkodren, e sikur diftohej, Kral Nikolla shum heresh nga Xetina delte në malin kundruall ku, së largu shifej Shkodra e u thonte oficerave të vet, "Nashe Shkoder", me at rrethim të mhershëm e mendoj se e pat shti ne dor. Per me ndalue gjakderdhjen e madhe qi ishte tue u ba në Balkan ndermjet t'ushtrive turke e të ballkanasve Fuqirt Europjane u mblodhen së bashku e shtrenguene Sulltanin me lirue Ballkanin. Rusija pat çue në kambë ushtrin e ashtu edhe Austrija gjindej në pregatitje. Sulltani u tremd edhe pranoj vendimet e tyne.

Mali i Zi paraqiti se Shkodra i pat kushtue shum gjak derdhje malazezve dhe ishte e fitueme me gjak e prandej do t'i leshohej Malit të Zi

Kral Nikolla qi gjindej në rrethimm të Shkoders e pau se me qindresen e bame nga Shkodra po do t'i rrshqitëte dore e përdoroj dredhin e mbrame sa per me mbajtë nderen e armve. Bashkë me Hasan Rizan gjindej Esad Pasha Toptani me vullnetarë shqyptarë. Tue njoftë karakterin e tij dhe krenin e madhnis qi aj kërkonte përfitoj e me ndermjetsi të disave e bleu.

Mali i Zi nuk pat qindresë të giatë në Shkoder pse me vendimet e dhanuna prej fuqive të mbëdhaja e me pranin e Sulltanit edhe Shqypnija n'at rasë do të lahej e lirë e vetsunduese. Mali i Zi paraqiti se Shkodra i pat kushtue shum gjak derdhje malazezve dhe ishte e fitueme me gjak e prandej do t'i leshohej Malit të Zi. At kërkesë e mpshteti edhe Rusija por Austrija nguli kambë e mblodh nji miljon bajoneta qi ja afroj kufijve të Malit të Zi e të Serbijes dhe ashtu per ballë të nji kercnimi të tillë Malit Zi ju desht me ulë kryet e me dalë prej Shkodre.[4]

Nji natë ma parë se të delshin ushtritë kje rrethue tregu i pazarit an e kan edhe nuk kje lanë të hyeme e të dalun askahi. Ushtrit, thyen dugajët, plaçkitne mallin shka gjetne aty e me lundra të mbëdhaja, neper liqe e çuene në Viri e në Riekë e mbrapa i dhanë ziarm duajve sikur t'ishin djegë gand pa ju dijt shkaku.

[4] Mali i Zi doli nga Shkodra pas tri javësh, më 14 maj 1913.

N’e netre ushtrit malazeze duele të gjitha e liruene Shkodren.

Mbas dalies së Malazezve per disa kohë Shkodra ngeli vartas me sundim të mbrendëshem të vetin të ngrehun me parinë Shkodrane e mbrapa kje caktue nji komisjon nderkombtar nga potencat Europiane të kryesueme nga Gjenerali Filips, inglez.

Gjith e cila fuqi qi muer pjesë n’at komision ndërkombëtar çoj ka nji distakament ushtarë të vetin per mbrojtjen e përfaqësuesit të vet edhe per mbrojtjen e gjytetit.

Ndermjet kohës çë prej të dalmes të Malazezve e deri n’ardhjen e nderkombëtarve Shkodra pat ngatrresa të randa ndermjet të veti. U njallë fanatizmi i fenave, nji nduer të veçantë.

Shkajku i grinieve kjen flamuri edhe shkronjat me germa latine.

.....

(Nga libri: Dom Ndoc Nikaj, *Kujtime të nji jetës së kalueme*, *Plejad*, Tiranë, 2003, përgatitur nga dr. don Nikë Ukgjini)

EX-LIBRIS

Recension

Dr. Nail DRAGA

VEPËR KOMPLEKSE ANTROPOLOGJIKE

(M. Edith Durham: *Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve, Arbëria,* Tiranë, 2009)

Botimi i veprave të ndryshme paraqet një ngjarje të veçantë për autorin dhe mjedisin përkatës. Ndërsa kur kemi të bëjmë me vepra të autorëve të huaj dhe ajo i prezantohet opinionit e përkthyer në gjuhën shqipe kënaqësia është e dyfishtë. Sepse si e tillë, vepra nuk ka më përdorim ë kufizuar të saj, por ajo bëhët pronë e të gjithë atyre që kanë shprehi dhe interesim për avancimin e çështjeve dhe njohurive përkatëse në aspektin personal dhe ate profesional. Pas rënies së sistemit monist tek shqiptarët për të parën herë në shqip janë duke u përkthyer veprat e plota të autorëve të huaj të cilët si inspirim dhe çështje preokupuese kanë pasur të kaluarën e shqiptarëve dhe të Shqipërisë. Në sajë të informacioneve që disponojmë del së interesimi i personaliteteve të huaja qofshin ata studiues, udhëpërshkrues apo aventurist si nga fusha e shkencës apo e kulturës për popullin tonë nuk ka munguar edhe më herët, por nuk ka dilemë së në shek.XIX dhe fillim të shek..XX u bë një kthesë e dukshme. Vetë ngjarjet e zhvilluara gjatë periudhës së lavdishme të Rilindjes Kombëtare zgjuan kureshtjen e personaliteteve të huaja për të vizituar viset shqiptare. Nga plejada e tyre personaliteteve s'ka dilemë së vend nderi zë zonja Edith Durham(1863-1944). Ndonëse u paraqit rastësisht në ketë regjion, ajo çështjeve ballkanike në përgjithësi dhe atyre shqiptare në veçanti iu qas me një pasion e objektivitet të rrallë, duke dhënë përfundime të qëndrueshme shkencore. Ajo, pasi u njoh në mënyrë të përafërt me popullin tonë, u bë jo vetëm një dashamire e shpirtit dhe e kulturës së tij, jo vetëm një mbledhëse e të dhënave nga fusha të ndryshme të veprimtarive shoqërore, por edhe studiuese e traditave, zakoneve dhe ngjarjeve të tij, jo vetëm një zëdhënëse e të drejtave legjitime të popullit shqiptar, por edhe një pjesëmarrëse e drejtëpëdrejtë e ngjarjeve si koroniste besnike e tyre. Më një fjalë u bë luftëtare e denjë e

çështjes shqiptare. Gjatë punës së vet prej një çerek shekulli, ajo lexuesve anglezë iu pat dhuruar këto vepra që trajtojnë shqiptarët dhe Shqipërinë:

Nëpër tokat e serbëve(1904), Brenga e Ballkanit(1905), Shqipëria e Epërme(1909), Lufta për Shkodrën(1914), Njëzet vjet ngatërresa ballkanike(1920), dhe Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve(1928).

Po ashtu duhet cekur se nga kjo ka mbetur pa u botuar një lëndë e pasur siç janë ditari që e mbajti gjatë qëndrimit në Shqipëri dhe në viset e tjera të Ballkanit, pastaj dorëshkrime të ndryshme, albume, letërkëmbime etj.

Në lidhje me veprimtarinë e saj ka qenë i pakët numri i atyre që kanë pasur mundësi të shfrytëzojnë dhe përdorin një literaturë të tillë. Këtu përjashtim bëjnë vetëm një numër i kufizuar studiuesish. Një dukuri e tillë ka qenë e pranishme në monizëm, sepse edhe kur janë cituar veprat e znj.E.Durham, ato kanë qenë të pjesshme. Një konstatim i tillë dëshmohet në mënyrë transparente në vitin 1990, kur Shtëpia Botuese "*8 Nëntori*" nga Tirana botoi një botim të veçantë me titull ***Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*** e cila në fakt paraqiste një përmbledhje të gjashtë veprave të lartëshënuara në gjithsej 579 faqe. Pra, edhe pse veprimtaria e saj ishte botuar në gjuhën angleze, para më së gjysmë shekulli, për lexuesin shqiptar mbeti e panjohur, e ç'është edhe më tragjike ndaj saj kishte njëfarë misterioziteti, madje ndonjëherë edhe paragjykime. Në gamën e këtyre veprave përkthyesi shkodran Ferit Hafizi i ka ofruar lexuesit shqiptar dy vepra të zonjës Durham në gjuhën shqipe. E para ***Lufta për Shkodrën*** e botuar nga Shtëpia Botuese "*Camaj-Pipa*" e Shkodrës në vitin 2005 dhe ***Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve***, botuar në vitin 2009 nga "*Arbëria"* e Tiranës. Nga leximi i tyre dy veprave del së kemi të bëjmë më një përkthim me përkushtim, ku veprat lexohen më endje sepse janë përdorur shprehje, terma e frazeologji që janë shprehi e një përkthyesi më përvojë nga gjuha angleze në shqip.

Vepra ***Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve***, përbëhet nga tetë pjesë, ku me materialin e prezantuar paraqet padyshim një arkiv në miniaturë për çështjet përkatëse. Nëse kjo vepër në botimin përbledhës të vitit 1990, ishte e prezantuar me gjithsej 91 faqe, tash ajo na vjen e plotë me 398 faqe, së bashku me bibliografinë. Andaj vetëm tash lexuesi shqiptar e ka të mundur ta lexojë ate në tërësi dhe të nxjerri gjykimet dhe përfundimet përkatëse. Kjo vepër padyshim paraqet një ndihmesë më vlerë të veçantë nga fusha e antropologjisë. Autorja trajton probleme më rëndësi jo vetëm për kulturën popullore shqiptare por edhe ate të sllavëve, duke theksuar sidomos ate malazeze.

Çështjet e trajtuara kanë të bëjnë më shoqërinë tradicionale si dhe organizimi i vjetër shoqëror, e drejta popullore, doket, lindja, martesa, vdekja, tatuazhi, besëtytnitë, mjekësia popullore etj. Kjo vepër është si rezultat i punës pasionuese të autorës e cila tërë materialin e ka vjelur në terren me plot vuajtje dhe sakrifica. Një material i tillë ka vlera të veçanta sepse këto të dhëna janë dëshmi e organizimit shoqëror në një mjedis me përkatësi të ndryshme sociale dhe etnike. Të dhënat e prezantuara por edhe krahasuar me ato të popujve të tjerë në ketë regjion dëshmojnë për analizën e thellë diakronike e sinkronike të autorës e cila dëshmohet nder njohëset më të dënja etnografike për këto hapësira. Edhe kjo vepër si dhe të tjerat nga kjo autore nga aspekti i stilit kanë karakter rrëfimesh apo një gërshetim në mes publicistikës dhe eseistikës. Kjo vepër sjell pasuri informacioni, fakte, ngjarje dhe dukuri duke i përshkruar me besnikëri ashtu siç i janë prezantuar. Ndonëse librat e saj i dedikoheshin kryesisht lexuesve anglofonë, ata i përdorën edhe studiues të tjerë që si fushë interesimi kishin çështjen shqiptare. Një konstatim i tillë dëshmohet me të dhënën së shumë vepra u ribotuan nga disa herë dhe atë në gjuhë të ndryshme.Kështu p.sh. libri ***Njëzet vjet ngatërresa ballkanike,*** që llogaritet ndër veprat e saja më të rëndësishme, pas botimit të tij në Londër më 1920, më vonë u ribotua në Nju Jork. Pastaj në gjermanisht në Shtutgart, më 1922, në italisht në Firencë më 1923 e me ribotim më 1930, ndërsa në gjuhën shqipe u botua në vitin 1944, ndërsa në atdheun e saj u ribotua edhe një herë në Londër me 1970.

Me qellime të caktuara për të nënvlerësuar krijimtarinë e saj disa pseudoshkencëtarë e quajnë atë si shqiptarofile e me epitete të tjera, nga i vetmi mëkat që "kishte" sepse ushqente simpati e ndjenja të sinqerta ndaj popullit shqiptar, duke u vënë në mbrojtje të së vërtetës dhe të kauzës shqiptare. Sa ishte gjallë epiteteve të tilla nuk iu përgjigj kurrë. Përkundrazi miqësinë me popullin shqiptar e konsideronte si një fat të madh që e bënte krenare dhe të lumtur. Rrallë mund të gjenden raste analoge të një përkushtimi të tillë ndaj fateve të një populli mik. Ishin kohë të vështira të bëheshe mik i Shqipërisë e më pak avokat i çështjes së saj. Por, Durhami e shpalli ndjenjën e saj fisnike për popullin tonë në mënyrë demonstrative në tërë veprën e vet. Ndonëse e rritur dhe e shkolluar në një mjedis tërësisht tjetër nga këto ballkanike ajo veçohej për nga karakteri dhe dinjiteti duke prezantuar të vërteten dhe drejtësinë. Një veprim të tillë e ka bërë me ndërgjegje dhe guxim intelektual. Nga rrethanat e kohës nuk ka mundur të përballojë intrigat dhe prapaskenat e qarqeve shoviniste të Ballkanit ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë e aq më tepër masakrat serbe e malazeze në Veriun shqiptar. Pasi ishte dëshmitare

okulare, gjen formën e saj të protestës duke ia kthyer mbrapsht dekoratat e Krajl Nikollës së Malit të Zi. Edhe pse veprimtaria e Durhamit nuk iu kushtua luftërave dhe konflikteve ballkanike ajo në siujdhesën tonë nuk kishte ardhur si një misionare e luftënxitjes, siç kishin ardhur shumë të tjerë para e pas saj. Por, ajo me tërë veprimtarinë e saj predikoj mirëqenien e popujve të kësaj hapësire, zbuloi pikat e tyre të takimit dhe ishte këmbëngulëse për mospërzierjen e të huajve në ketë regjion. Prandaj, emri dhe vepra e saj kurdoherë do të evokohen me respekt e homazhe të thella.

Dhe në fund me botimin e kësaj vepre në shqip bëhet pasurimi i fondit të albanologjisë nga autorët e huaj. Edhe pse është shkruar rreth tetëdhjetë vite më parë ky botim nuk i humb vlerat, por është e kundërta sepse më kalimin e kohës ato i shtohen, sepse kemi të bëjmë me elemente komplekse antopologjike të cilat nuk hasen më në kohën tonë. Andaj si e tillë kjo vepër do të lexohet më endje sepse lënda e trajtuar paraqet inspirim të vazhdueshëm për çdo përdorues të saj sot dhe në të ardhmen,pa marrë parasysh fahun profesional.

Ulqin, 25.02.2010

Ag APOLLONI

NJË ROMAN *ROCK'N'ROLL*

(*Vepra "Mimesis" e Andrej Nikolaidis*)

Andrej Nikolaidis (1974, Sarajevë) është shkrimtar dhe gazetar me vendbanim në Ulqin. Si shkrimtar ka shkruar librat me tregime "Shqyrtime mbi indiferencën" dhe "Katedralja në Sijetll" dhe romanet: "Pse Mira Furlan", "Ata", "Mimesis" dhe "Biri"; ndërsa si gazetar ka shkruar kolumne për disa gazeta dhe revista dhe njihet për polemikën e ashpër me regjisorin Emir Kusturica të cilin e ka quajtur "një nga yjet më të mëdhenj mediatik të kohës së Milosheviqit".

Si në gazetari, ashtu edhe në letërsi, Andrej Nikolaidis është autor që e thotë të vërtetën pa pardon. Jetën e përditshme e ka temë, prandaj vepra e tij është imituese (*mimesis*) në parim dhe kritikuese (*krisis*) në qëndrim.

Remix

Termi "mimesis" është esenca e filozofisë së Platonit dhe Aristotelit. Me *mimesis* Platoni kuptonte botën tonë që është imitim i botës ideale, ndërsa Arsitoteli, si më praktik që ishte, me mimesis kuptonte vetëm artin, pra artin si kopje të jetës. Nikolaidis e shkruan "Mimesisin" e tij sipas parimit të Aristotelit: duke e imituar jetën. Kësisoj, ai krijon një letërsi në shkallën e parë.

Në anën tjetër, Platoni e ndante letërsinë (poiesis) në rrëfim (diegesis) dhe imitim (mimesis), duke preferuar ndarjen e letërsisë në tri mënyra: mënyrë e pastër narrative (ditirambi), mënyrë e pastër mimetike (drama) dhe mënyrë mikse (epi). Ditirambin e konsideronte mënyrë të pastër narrative, sepse në të fliste vetëm autori; dramën e konsideronte mënyrë të pastër mimetike, sepse në të flisnin vetëm personazhet, ndërsa epin e konsideronte mënyrë mikse, sepse në të flisnin autori dhe personazhet.

Romani, si një formë ku zëri i autorit (ose narratorit) alternohet me zërin e personazheve, i përket mënyrës së përzier epike, pra është pasardhës i epit. Ky alternim zërash tashmë nuk bëhet në vargje, por në prozë.

Megjithatë, karakteri miks në roman, përveç alternimit të zërave, nënkupton edhe përzierje gjinish e formash, madje edhe mediumesh. Kjo

vlen sidomos për romanin postmodern, çfarë është edhe romani "Mimesis", të cilin titulli e afron më shumë me mënyrën mimetike, edhe pse i përket asaj diegjetike. Po ashtu një ndikim i madh në këtë roman vjen nga muzika, aq sa mund të thuhet se ajo i përcakton konturat (formën) dhe brendinë (përmbajtjen) e tij.

"Mimesis", pra, nuk është thjesht një mënyrë mikse, por një vepër mikse, në kuptimin më të plotë të fjalës. Në fakt, vetë jeta në Ballkan është mikse, kështu që vepra bazohet mbi këtë jetë, pra është reprodukim i këtij miksi. Jeta –mix, vepra – remix (përzierje e përsëritur).

Album

Vepra "Mimesis" e Andrej Nikolaidis, edhe pse e shkruar si roman, imiton formën e albumeve muzikore, duke u ndarë në dy pjesë (A dhe B) me nga pesë "këngë" për absurdin ballkanik. Secili kapitull emërtohet me tituj nga hitet e muzikës rock, përmbajtja e romanit është e mbushur me elemente të rockut (seks, drogë, muzikë) dhe gjithandej në roman artikulohet një rock-revoltë ndaj realitetit ballkanik.

Romani "Mimesis" (i botuar më 2003, ndërsa në shqip e ka përkthyer Hajro Ulqinaku dhe e ka botuar Asociacioni "Ulqini", më 2006) sikur albumet ose disqet kompakte (CD), ndahet në dy pjesë, ku secila syresh ka nga pesë "këngë" (kapituj). Pjesa e parë ka këta kapituj: A1: I see a darkness (Bonnie Prince Billy), A2: In the aeroplane over the sea (Neutral Milk Hotel), A3: Girl (The Beatles), A4: Love will tear us apart (Joy Division) dhe A5: Heroes (David Bowie); pjesa e dytë ka këta kapituj: B1: Losing my religion (R.E.M.), B2: Blood (Tindersticks), B3: Wayfaring stranger (Johny Cash), B4: Yes! I am a long way from home (Mogvai) dhe B5: Still ill (The Smiths).

Në të gjithë albumin e Nikolaidisit është një "narrator homodiegjetik", i quajtur Konstantin Teofilis, i cili është i dentifikueshëm me vetë autorin. Ky narrator, familja e të cilit është nga Voskopoja, por me prejardhje greke, është i lindur më 7 maj 1974 dhe e ka ditëlindjen e përbashkët me Marshal Titon. Edhe pse ka shpirt grek, biri i basistit të grupit "Albatros", nuk ndërmerr udhëtime si Uliksi, por vendos të rrijë i qetë aty ku është: *"Nëse besoni në histori familjare dhe në mësimet që i jep mitologjia gjenealogjike, gjithçka në mua thotë: udhëto! E megjithatë, unë qetë rri ratë në banesën e gjyshes në Gërbavicë"*.

Këtu mitit të Uliksit, autori ai kundërvë mitin e dembelizmit të banorit të Malit të Zi, i cili që në fillim thotë se ka marrë një letër nga e dashura Tea, e cila, pasi ka marrë ikën nga prindi që e kishte dhunuar, i

lutet (për herë të fundit) Konstantinit që të takohen në Amsterdam më 7 maj në ora 17 e 30, por ai, në vend se të niset, preferon të tregojë histori, sepse ka kohë: është 7 maj, ora 10 e 30 minuta. Pasi e tregon krejt historinë, ora tregon: 16:20. Ai nuk mund të vendosë të shkojë apo të rrijë. Mes veprimit dhe mendimit, ai i jep përparësi mendimit: *"Gjithçka me rëndësi ndodh në mendime"*.

Në anën tjetër, edhe pse e ka ditëlindjen e përbashkët me Titon, narratori nuk ushqehet me ndonjë "metarecit", çfarë ishte komunizmi, por thjesht gjithçka e sheh lëmsh, duke e pranuar kështu devizën e postmodernizmit: "*anything goes!*", ndërsa në veçanti "Republika Serpska" e sheh si më "postmodernen" në Ballkan: *"Republika Serpska është një vend derridian – parajsë e dekonstruksionit. Të rrënosh, të shkatërrosh, të ndash, të shpërndash…"*, këto janë qëllimet e saj.

Madje, fundin e brezit revolucionar, narratori e jep duke bërë një krahasim mes fqinjit dhe vetes. Fqinji pesëdhjetë vjeçar, në pikë të dimrit, çohet heret në mëngjes dhe bën ushtrime në oborr, duke cituar mendimin të cilin ai mendon se e ka thënë Njegoshi: *"Në trupin e shëndoshë – mendja e shëndoshë"*. Ndërsa narratori thotë: *"Një mëngjes kam dalë të shëtis nëpër stuhi, sepse nga alkooli i keq më dhimbte koka. Atëherë e kam kuptuar se bota ime do të shkatërrohet. Në të nuk ka pasur pensionistë të cilët ushtrojnë në acar dhe votojnë për kriminelët e luftës. Ndërsa realiteti ka qenë i përbërë me hajvanë trashamanë të tillë dhe të budallallëqeve të tyre. Në botën time nuk ka pasur njerëz të cilët kanë besuar se të gjitha urtësitë që i kanë dëgjuar në jetë – i ka shkruar Njegoshi"*. Kallëzimi për dy botë të ndara vë në njërën anë nacionalistët, në anën tjetër narkomanët e narkomanizmi dhe nacionalizmi e përjashtojnë njëri-tjetrin: *"Kur ne e kemi dëgjuar "Sonic Youth" dhe "The Cure", ata e kanë dëgjuar Miroslav Iliqin"*, thotë jo pa ironi narratori që bën pjesë në taborrin e narkomanëve.

Narratori në këtë "album" nuk është një narkoman dosido, por një njeri i zgjuar, i cili mes Platonit dhe Aristoteli ka zgjedhur të parin, sepse *"ai e ka ditur se bota vlen më pak se ideja"*. Kështu që, narratori vendos të jetojë duke iu përmbajtur motos së rockerëve: "seks, drogë, muzikë".

Dhe, duke qenë tip "destruktiv", ai ndihet me fat, sepse i ka të trija ato që i kishte motoja. Si narkomanë dhe alkoolist, ai është tejet atraktiv për femra: *"Nëse jeni rast social, alkoolist dhe dhunues, ju në Mal të Zi jeni magnet për gra"*, sepse dashuria aty është mazohiste: *"Gruaja malazeze turpërohet nëse është e lumtur në jetën bashkëshortore"*, madje *"martesat në Mal të Zi shpesh prishen, sepse meshkujt bashkëshortorë grave nuk u sigurojnë mjaft vuajtje"*.

Ndërsa seksi dhe muzika ndonjëherë e plotësojnë njëra-tjetrën, jo pa një dozë ironie: *"Kur e kam humbur virgjinitetin, në gramafonin tim është sjellë kënga e The Beatles. Kur pas ejakulimit të shpejtë jam rrëzuar nga shtrati dhe i kam ledhatuar flokët e vajzës time të parë, kam dëgjuar vetëm frymëmarrjen e saj të shpejtuar dhe Lenonin i cili këndonte: Girl…"*.

Rrëfimi bëhet kritikues veçmas ndaj femrave katundare, të cilat shkojnë në fakultet për të shpëtuar nga mjelja e lopëve dhe për të realizuar moton e jetës së tyre ("*të gjitha në jetë duhet provuar*") dhe e fundit që e provojnë është vdekja në ndonjë birucë si pasojë e drogës.

Këto femra që detyrohen t'ua ruajnë fytyrën baballarëve në fshat, ku jetohet vetëm me thashetheme, porsa të shkojnë në universitet lëshohen *"si ujkonja, të gatshme për ndërsim, ngarendin drejt qyteteve të mëdha, që atje t'i kënaqin fantazitë e veta seksuale (...) Ky është qëllimi i ekzistimit të universitetit në Mal të Zi"* në një kohë kur ereksioni konceptohet si qendër e universit.

Duke folur për seksin si një konkretizim të dashurisë, narratori bën objekt të rrëfimit të gjitha format e imoralitetit që e arrijnë kulmin me incestin mes Teas dhe vëllait të saj Goranit pë t'u pasuar mandej nga incesti mes Teas dhe babait të saj: *"Të gjitha që ia kë bërë Gorani kanë qenë, sa herë më ka rrëfyer, më me pak dhimbje nga mendimi në babanë i cili ia ka mbushur rropullitë me farën nga e cila ajo është krijuar"*.

Mali i Zi, por edhe i gjithë Ballkani, si një "dekostruksion derridian" imponon natyrën depresive te banorët e vet. Aty është e pamundur të jetohet esëll, prandaj personazhet ngushëllimin e gjejnë duke e praktikuar moton e rockerëve. Në të gjithmonë i forti e ka hëngër të dobëtin, duke ia mohuar edhe identitetin: *"shumica e popullsisë shqiptare ka qenë e detyruar të sllovenizojë llagapët, duke vënë prapashtesat: iq, oviq, Kështu që, Resulbegu do të bëhet Resulbegoviq, Abazi – Abazoviq…"*.

Nikolaidis është kritik ndaj fenomeneve, pastaj pashmangshëm edhe ndaj nacionaliteteve të cilat i japin një karakter multientik Malit të Zi. Vendasi detyrohet ta urrejë vendin e vet, Ulqinin, për shkak të turistëve të cilët shkojnë për ta kryer nevojën në plazh; për shkak të kriminelëve që marrin drogë dhe vrasin, duke mbajtur kryqin në qafë; për shkak të myslimanëve që festojnë Kurban Bajramin, me ç'rast në kalldrëmet para shtëpive i qesin lëkurët e deshve të prerë dhe i lënë me ditë të tëra e, si pasojë e kësaj, luzmat e mizave dhe qelbësira e bëjnë jetën të padurueshme; për shkak të politikanëve që nuk dinë të udhëheqin popullin dhe për shkak të popullit që nuk di t'i ndërrojë politikanët.

Madje këtu ai bën një kritikë krejt eskplicite ndaj politikës: *"Sikur te popujt që e ndërrojnë rrallë qeverinë, edhe malazezët janë qyqarë. Qëndrimi ndaj pushtetit është çështje e guximit qytetar dhe e higjienës personale. Kryetarët e shteteve janë sikur brekët: është mirë të ndërrohen sa më shpesh"*.

"Mimesis" është një imitim i jetës ballkanike, i këtij realiteti derridian. Këtë imitim Andrej Nikolaidis e bën duke ndjekur modelin e rock'n'rollit: forma – album, përmbajtja – jetë e shthurur. "Mimesis" është një roman përfaqësues postmodernist përtej letërsisë nacionale. Ai është i tillë jo vetëm pse i ironizon vazhdimisht metarrëfimet, por edhe pse rrëfen për kolapsin e civilizimit. Një rrëfim pa pardon dhe i përzier mu si realiteti të cilin e ka objekt.

ESE: PËR VEPRA PËR FËMIJË

Ardita RAMA

MARGARITARËT E AXHËS HAJRO

Para do kohësh, kur me axhën Hajro po bisedonim për organizimin e kësaj mbrëmjeje, ai më propozoi që t'i them edhe unë sonte disa fjalë për të. Natyrisht, pranova. E, kjo ishte pjesa më e lehtë. Sepse, kur u desh t'i hidhja në letër mendimet e mia, ngeca. Çka të them unë ende për Hajro Ulqinakun, e çka nuk ishte thënë më parë? *Mission impossibile*. Mision i pamundur.

Duke menduar kështu, u ula pranë kompjuterit dhe ia nisa të rreshtoj fjali të tipit: "Hajro Ulqinaku është shkrimtar për fëmijë, i cili në veprat e tij trajton tematikën e detit. I lindur në Ulqinin e bukur, pranë detit të kaltër, ku e kaloi fëmijërinë duke luajtur në rërën përcëlluese, duke notuar e duke kërkuar guaca, lundruar me barka e gjuajtur peshk, rininë e burrërinë, siç thotë vetë ai, e kaloi larg detit, larg vendlindjes. Por këtë, vetëm fizikisht, sepse çdo çast të jetës së tij ishte në Ulqin. Në mendje dhe në shkrime!"

Ja, këto ishin fjalitë e para. Dhe çka ka ë re këtu? Asgjë! Gjëra të thëna shumë, shumë herë para meje nga shumë të tjerë.

E mërzitur e mbylla kompjuterin (më duhet të shtoj, shumë më bukur do të tingëllonte po të thoja – e ula lapsin mbi fjalitë e shkarravitura në letër, por s'do të ishte e vërtetë) dhe me libra të axha Hajros në dorë u nisa të flej. M'u duk vetja qesharake – edhe pas 20 e sa vjetësh, përsëri librat e tij po më bëjnë shoqëri para gjumit. Tregimet që i kam lexuar x-herë. Lexuar e përjetuar së bashku me piratët e kusarët, "çakajtë e malit" e "ujqit e detit". Kam kërkuar ëndrra me Xheraldinën, sandallin me Gencin, peshkuar me Bindin e Tetin, lundruar me velanije, notuar me peshq të artë e fluturuar me pulëbardha. Kam shëtitur në Kala e larë në Ranë e Liman.

Por nganjëherë, e frymëzuar nda tëra këto peripeci,edhe kam shkruar bashkë me Shkrimtarin.

Kështu, libër pas libri, u ktheva përsëri në fëmijëri. M'u kujtua kur së pari u njoha me *margaritarët e rez*, ata *fëmijë të detit*, të rrezitur nga dielli, të cilët tërë ditën, të larë apo të palarë, me majica apo pa to, siç thotë shkrimtari, e kalonin duke vrapuar pas dallgëve të detit. Pastaj gjeta

çelës jo të zakonshëm, por *të artë*, duke shëtitur *mbrëmjeve* pranë bregut të detit, e shoqëruar nga *pulëbardhat*. Para meje, si me magji shfaqej *bukuria e rrallë e detit,* ajo *panoramë* e mahnitshme, që të lë pa frymë. E sikur kjo të mos mjaftonte, shkrimtari vazhdoi ta nxiste imagjinatën time me *thesare piratësh*, *gjire të shpresës*, *ishuj të gjelbër, limane të qetësisë* e *pyje të dragonjve*. Edhe *barkat*, me të cilat lundroja, ishin nga më të ndryshmet – herë *me vela* e herë *me visare*. Në Ulqinin tim kishte edhe *kolovajza në hënë, pulëbardha në antenë* e *lulëkuqe në banka*. Çfarë çudie, mësova që deti mund të kishte edhe *ligj*. Ndërsa axha Hajroja thonte: *Ani Beni, ani*, e herë ngushëllonte *Kestrinën*, që të mos qante se shkollën nuk mund t'ia marrë askush.

E ç'ishte më e bukura, nuk duhej të jetosh në Ulqin, që të jesh pjesë e kësaj bote magjike. Axha Hajroja ua solli detin fëmijëve edhe në Prishtinë edhe në Tiranë. Pastaj kur ata vinin në Ulqin, kërkonin *Gurin e Pulëbardhave*, *ishujt e koraleve*, dhe *Shpellën e Kusarëve*. Apo shëtisnin në *Pyllin e Pishave* e kridheshin për të gjetur edhe ata *Shpellën e Shpuar*. Disa kishin fat edhe e gjenin. Disa, ndoshta, edhe zbulonin diçka të re...

Kaluan vite. Fëmijët e detit u rritën. Axha Hajroja shkruan më tej. Për *detin*. *Detarët*. *Peshkatarët*. *Ulqinakët*. *Ulqinin*. Të tashmen e të kaluarën. *Legjenda e përalla. Këngë popullore e Fjalor.*

Edhe deti vazhdon të ndjellë fëmijë të tjerë në gjirin e tij. Mistrecë apo të turpshëm, vajza e djem. *Filozofë* e *Turistë. Fëmijë të Limanit* e *Alpinë.* Të gjithë – *margaritarë të zez*.

Ulqin, më 30 qershor 2012.

(Fjalë përshëndetëse në përurimin e dy librave: *Tritoni* dhe *Magjepsje nga detit*)

Asllan BISHA

SHPIRTI – VEPRA E TIJ DETI

(*Hajro Ulqinaku dhe libri "Magjepsje nga deti"*)

Libri i ri i shkrimtarit Hajro Ulqinaku me titull magjik është i njeriut që tërë jetën e jetoi me detin. Ai e frymëzoi, e nxiti të shkruajë për detin edhe kur ishte larg tij. Ai s'iu nda nga zemra. Hajro Ulqinaku s'u shkëput kurrë detit as atëherë kur ishte në Kosovë. Zemra dhe mendja e shkrimtarit rrihte për detin. Fëmijëria e tij u skalit në skicat, tregimet dhe romanet për detin. Dhe veprat panë dritën e botimit, shkrimtari nxiti imagjinatën e fëmijëve, kurse proza poetike e autorit zuri faqet e revistave dhe të librave shkollore. Ai me tematikën e tij kryesisht me detin dhe bregdetin me magjinë e shkrimit të tij trajtoi përjetimet në Ranë, në Zall, në Valdanos dhe në Adë të Ulqinit, aty ku përzihen ujërat e ëmbla dhe të njelmëta të detit. Aty ku lundrimi dhe peshkimi janë të moçëm sa vetë jeta e këtyre njerëzve dhe dëshira për ta jetuar atë. Recensionet, shkrimet, kritikat dhe artikujt e ndryshëm e përcollën krijimtarinë e Hajro Ulqinakut. Puna e tij u vlerësua dhe libri i tillë si "Magjepsje nga detit" është i rrallë dhe i mungon letërsisë shqiptare. Është një begati për të gjithë ata që duan ta njohin begatinë, krijimtarinë e gjerë të opusit letrar të Hajro Ulqinakut. Shkrimtarët që kanë shkruar për detin them se janë dy më të rëndësishëm, në jug Petro Marko, ndërsa në veri të bregdetit është Hajro Ulqinaku, me dallim të të parit sikur është më i begatë, më i përkushtuar detit dhe them se shkrimet e tij janë sot e mot magjepsje për fëmijët. Shkrimtarit, Hajro Ulqinakut ia morën punën, e lanë pa punë, as në vendlindje s'e punësuan, por s'mundën t'ia marrin dashurinë magjike për detin.

Shpirti i tij është deti dhe ai jeton, gjallon me detin në veprat e tij letrare të cilat janë vistër e gjatë e e begatë si imagjinata e tij e cila bredh buzë detit, në limanet e tij, në thellësitë e detit, gjithmonë me vellon e imagjinatës krijuese duke skalitur prozë që të lë mbresë dhe të shton dashurinë për detin. Duke përjetuar lexuesi bukurinë magjepse të detit dhe bregdetit ulqinak.

“Tritoni” letrar magjik i Hajro Ulqinakut

Hajro Ulqinaku është autor i 20 veprave letrare për fëmijë. Shkrimtar i detit magjik i cili s’e la kurrë të qetë e edhe kur ishte larg vendlindjes. Një copë det e kishte në shpirt, në zemër, e barte me veti dhe në veten e tij. Kjo dashuri e përcolli gjatë gjithë jetës. Dhe këtë e ndau me fëmijë. Dhe personazhet e tij të vendlindjes u bënë pronë e fëmijëve të Kosovës, por me kohë edhe personazhe gjithëkombëtare.

Hajro Ulqinaku tani u paraqit me një libër të ri “***TRITONI***”, që është libër i dy romaneve: “*Gjiri i Shpresës*” dhe romanin “*Limani i Qetësisë*”, romane për fëmijë dhe të rinj. Janë këto dy vepra të zgjedhura të autorit për detin ku del në pah fëmijëria, andrallat e paharrueshme për të pushtuar detin e pafund edhe pse duke u larë nëpër cekëtina shpirti i tij bridhte thellësive të detit për të zënë peshkun e artë, duke kërkuar lumturinë fëmijërore, rinore, të njeriut. Kërkimi në gjirin e shpëtimit, në limanet e qetësisë. Në këtë lundrim personazhet nxitojnë për të gjetur lumturinë të cilën e rrënojnë barbarët. Se autori jetoi në kohë barbare. Këta fëmijë dhe aventurat e tyre janë të mëdha, të guximshme për të hulumtuar hapësirat detare, për mirëqenie familjare. Në romanin “Limani i Qetësisë” autori përmes Plakut të Urtë detar paraqet fatin e njeriut të rrezikuar, i cili nuk kishte mundësi për të shijuar qetësinë shpirtërore ngase biri i tij kishte mërguar. Dhe, kjo plagë e vjetër nga lashtësia ka rënduar mbi qenien tonë kombëtare. Luftërat, ikja, shpërngulja ishin plagë e rëndë të cilën e përjetoi populli jonë. Frika nga barbarët dhe lufta janë brengë e autorit, e Plakut të Urtë, i cili gëzohet kur Djali kthehet në shtëpi me nuse. Kjo është shpresë se jeta po lind dhe ditët më të mira sikur po i kthehen kombit tonë vërehen në roman, i cili me fjali të shkurtra, me përshkrim joshës dhe poetik që është veçori e këtij autori do të jetë vepër e cila mëson, edukon fëmijët dhe të rinjtë.

Hajro Ulqinaku me përshkrime të ambientit bregdetar dhe me pasurinë leksikore të detit e begaton gjuhën tonë, ndërsa ata që s’i dinë këto fjalë, i gjejnë në një Fjalorth të librit i cili ka vlerë dhe, lexuesi nga “Gjiri i Shpresës” do të strehohet në “Limanin e Qetësisë”. Dhe, duke lexuar këtë libër të pagëzuar “Tritoni” do të përjetojë lundrim artistik të rrjedhshëm dhe të këndshëm letrar.

Proza magjike e shkrimtarit Hajro Ulqinaku

Vepra letrare e Hajro Ulqinakut, opusi i tij letrar është i lidhur ngushtë me detin dhe vendlindjen. "*Barka me vela*" është prozë poetike, me rrëfime të sinqerta për fëmijët e vendlindjes. Për andrallat e tyre për të lundruar, për të zbuluar të panjohurën, ishuj, shpella të reja, për të zënë peshkun e madh. Ëndrra e shkrimtarit është fëmijëria e thurur në vepra letrare jo vetëm për fëmijët bregdetarë, por edhe për ata që janë larg tij. Dhe them se Petro Marko dhe Hajro Ulqinaku janë shkrimtarët më të mëdhenj të Bregdetit. Proza e tyre është e veçantë dhe e papërsëritshme. Ajo lexohet dhe përjetohet nga fëmijët e të rinjtë. Gjuha e shkrimtarit, Hajro Ulqinaku është përshtatur moshës, veçohet me qartësi dhe rrjedhshmëri. Është prozë poetike. Fjalori detar me shprehje nga lundrimi dhe peshkimi e pasurojnë leksikun e gjuhës, e ngrisin vlerën artistike të librit, e begatojnë prozën e Hajro Ulqinakut, i cili me imagjinatën e tij krijuese i mahnit fëmijët dhe të rinjtë. Proza e tij është e kuptueshme, mbresëlënëse, magjike, e cila frymëzon, por edhe edukon.

"Kënga e detit" e Hajro Ulqinakut

Rrëfimi lirik në skicat e shkrimtarit është emocioni i përjetuar lirik i thurur qartë e bukur me magjinë e detit, me personazhet të cilat shkrimtari i skalit me vëmendje, kurse fëmijët i fut në botën e magjisë ëndërrimtare, në një botë interesante. Në një ambient të veçantë, i cili fëmijët i bën kureshtarë për të gjetur të panjohurën. Deti është këngë magjike e cila është si dielli në perëndim, si hëna mbi det, si aroma e detit, e cila duhet shijuar, ndjerë dhe përjetuar, si fundi i detit, ngase shkrimtari thotë se është ëndërr, përrallë e magji... Kënga e detit është një guacë e cila shkrimtarin e frymëzon, kurse Ulqini është pasuria dhe dashuria më e madhe e shkrimtarit, e cila rrjedh natyrshëm në veprat letrare të Hajro Ulqinakut.

Ali SALAJ

HAJRO ULQINAKU DHE OBSESIONI PËR DETIN

Shkrimtari ynë i njohur, Hajro Ulqinaku ishte dhe mbeti një idhull për shumë gjenerata intelektualësh dhe krijuesish jo vetëm nga Mali i Zi, por nga tërë hapësira mbarëshqiptare. Hajroja, me metaforën e tij interesante për detin na dha aventurat e veçanta artistike, të cilat për ditë e më shumë reflektojnë te lexuesit e të gjitha moshave.

Sa herë që shihemi apo dëgjohemi me telefon, Hajroja gjithnjë më fton për një raki rrushi në Ranë, në strofullën e tij pranë ujit ku ndihej zhurma e valëve dhe aroma e detit. Obsesioni tij për detin e kam hetuar që në vitet e hershme kur me poetin e ndjerë Rifat Kukaj, si dy bohemë simpatikë pinin raki dhe thurnin vargje pa fund për detin.

Deti ishte dobësia e Hajros, të cilën e përshkruante si *bukuri romantike, përrallë, ëndërr verore*...

Edhe në ndejat e përditshme me kolegët në Prishtinë, Hajron e shqetësonte deti dhe atë gjithnjë e fokusonte nëpër biseda si një fëmijë që entuziazmohet pas lodrës më të dashur të tij. Jo rastësisht Hajroja e nis përmbledhjen *Kënga e detit* me vargjet e baladës *Ymer Agë Ulqini*:

Ah, Ulqin, tanë jetën të kam pasë në zemër,
Nandë vjet të kam pa natë për natë në andërr!

Kështu përcaktohet në mënyrën më të thellë malli dhe nostalgjia për vendlindjen. Ky mall i ndezur i Hajros kurrë nuk u shua, sepse në qytetin e tij e presin baticat dhe zbaticat që e lodhin dhe e bëjnë më të ndjeshëm dhe më sublim. Ky shkrimtar të përkujton Plakun e Detit, i cili deri në frymën e fundit lufton me valët e jetës. Është ky fati i shumë intelektualëve dhe krijuesve nga Ulqini, të cilët kanë mbetur në udhëkryq dhe asnjëherë nuk u shpërblyen as moralisht për kontributin e dhënë për qytetin, shoqërinë dhe kombin.

Grekët e lashtë e kanë lënë një thënie: *Në det lëshohen plot ujëra të turbullta, por ai përsëri ngelet i pastër.*

I tillë është Hajro Ulqinaku, i cili i shtyrë nga magjia flet me gjuhën e fëmijës, duke mbetur përjetësisht i çiltër dhe i pastër.

Sidoqoftë, është nder dhe kënaqësi e veçantë që "Art Club"-i është botues i këtyre veprave ku Hajro Ulqinakun e konsideron si shkrimtarin më emblematikë në gjirin e vet.

(Fjalë përshëndetëse me rastin e përurimit të dy vepra: *Kënga e deti* dhe *Barka me vela*, në Ulqin, më 23 maj 2013)

STUDIMORE

HISTORIKE

Dr. Maksut XH. HAXHIBRAHIMI

ZHVILLIMI I ULQINIT NËPËR SHEKUJ

Në krahasim më periudhën pararendëse, kur qyteti ishte thjesht një seli e qeveritarit dhe e peshkopit, nga shekulli XII qyteti i Ulqinit u kthye në një qendër të rëndësishme ekonomike e tregtare. Rritja e rolit ekonomik u shoqërua me një rritje të konsiderueshme demografike të tij, më popullsi fshatare. Shtimi i popullsisë së Ulqinit solli shtrirjen e tij jashtë mureve të vjetra, duke formuar kështu lagjet e jashtme (*suburbia*).

Një rol të madh në intensifikimin e shkëmbimeve ndërmjet krahinave shqiptare luajti rrjeti rrugor. Në rrafshin horizontal kishin rëndësi të veçantë arteriet që lidhnin portet bregdetare të Ulqinit më viset e begata të Kosovës, të Maqedonisë, të Kosturit, të Janinës etj. Gruri dhe kripa qenë ndër produktet kryesore që eksportoheshin në Venedik, në Raguzë, në Ankonë e në qytete të tjera italiane. Në shekullin XIII, përveç qyteteve – porte të njohura, lindën një sërë tregjesh – skela, që u specializuan më tregtinë e këtyre produkteve. Të tilla ishin: skela e Shirgjit në breg të Bunës, skela e Shëngjinit, më në jug, skela e Shufadesë, e Vregut (në derdhjen e Shkumbinit), e Pirgut (në derdhjen e Semanit), e Spinaricës (në derdhjen e Vjosës), skela e Obotit, skela e Gjeranës (Porto–Milenës së sotme) dhe skela e Valdanosit, në veriperëndim të Ulqinit.

Qyteti i Ulqinit zhvilloi me kohë një formë të vetëqeverisjes, që ishte tipike për qytetet e pellgut italo–dalmatin (komuna). Elementi i rëndësishëm i saj ishte mbledhja e përgjithshme e qytetarëve, nga ku dilte *këshilli i qytetit*, që nga ana e tij caktonte nëpunësit e ndryshëm. Autoriteti më i lartë në qytet mbetej përfaqësuesi (mëkëmbësi) i *kryezotit*, që, sipas rastit, quhej *kont*, kapiten ose *qefali*.

Në shekullin XIV Ulqini kishte *statutin* e vet. Këto rregullonin marrëdhëniet e brendshme social–ekonomike të qytetit, marrëdhëniet me pushtetin e kryezotit dhe me qytetet e me feudalët fqinjë. Në atë kohë Ulqini kishte *njësitë matëse*, *peshat* e tyre dhe *prisnin monedha*. Monedha prenë qyteti i Ulqinit dhe Shasi. *Latinishtja* ishte gjuha e dokumenteve zyrtare, e statuteve, e akteve gjyqësore të komunës së Ulqinit.

Megjithëse gjatë shekullit XVI, në viset shqiptare sundimi osman u konsolidua më tej, vatrat e qëndresës dhe të luftës çlirimtare nuk u shuan asnjëherë.

Në vitin 1537, kur sultan Sulejmani, i mbiquajtur "Madhështori", Ligjvënësi, ndërmori një ekspeditë të fuqishme ushtarake drejt Italisë, për të pushtuar Gadishullin Apenin, ai ndeshi në qëndresën e himariotëve.

Në përpjekje për ta bashkërenduar luftën antiosmane me vendet Perëndimore, në vitin 1571 shqiptarët zhvilluan një varg aksionesh luftarake, në aleancë me Venedikun, kur ky ishte në konflikt me shtetin osman, për çështjen e Qipros. Në verën e atij viti, malësorët e Dukagjinit e sulmuan Lezhën dhe arritën ta çlironin përkohësisht nga sundimi osman. Megjithëse lëvizja kryengritëse e shqiptarëve u shtri pothuajse gjatë gjithë bregdeti Adriatik, për shkak të shpërbërjes së koalicionit perëndimor antiosman, më në fund ajo u shtyp nga ushtria osmane.

Ulqini dhe Tivari, në shtator të vitit 1571, ranë përfundimisht në duart e osmanlinjve.

Me vendosjen e sundimit osman në Ulqin, siç kemi thënë më parë, u bënë një varg ndërtimesh në përshtatje me kushtet e reja shoqërore dhe politike. Një nga ndërtimet e para të bëra prej osmanlinjve në Ulqin është kalaja e Ulqinit. Ata e rindërtuan atë mbi themelet e një kalaje të vjetër. Stili dhe teknika e ndërtimit të kalasë nuk ka ndonjë ndryshim nga ato të kalave shqiptare paraosmane.

Gjatë shekullit XVI – XVII, fusha kryesore e veprimtarisë ndërtimore ishte ngritja e objekteve të kultit islamik, sidomos nëqytetin e Ulqinit. U ndërtuan shumë xhami, mesxhide (xhami të vogla pa minare), teqe, medrese, hamame etj. Shumë elemente të arkitekturës së xhamive të ndërtuara në këtë periudhë u huajtën nga arkitektura e kishave vendëse (kubeja qendrore etj.). Para vendosjes së sundimit osman popullsia shqiptare i përkiste fesë së krishtere, të ndarë në dy ritë fetare: katolike dhe ortodokse. Pas pushtimit osman, në Ulqin filloi të përhapej një fe e re: feja islame. Në fillim islamizmi u përfaqua prej një pjese të aristokracisë shqiptare. Duke u islamizuar, në fillim pjesëtarët e familjeve aristokratë shqiptare, ishte më e lehtë që feja islame të përhapej më vonë edhe në radhët e popullit. Pas periudhës së stabilizimit të jetës e të veprimtarisë prodhuese gjatë shekullit XVI, në shekullin XVII, e sidomos në gjysmën e dytë të këtij shekulli, vihet re një zhvillim i shpejtë i qytetit të Ulqinit. Ulqini numëronte një mijë shtëpi. Pjesa më e gjallë dhe më aktive e qytetit të Ulqinit të kësaj kohe ishte pazari ose "çarshia". Këtu ishin vendosur numri më i madh i punishteve dhe i dyqaneve zejtare e tregtare. Gjatë shekullit XVII – XVIII në Ulqin u shtua mjaft ndërtimi me

karakter privat, publik e fetar. Këtu mund të përmenden sarajet e pashallarëve, ndërtesat administrative, krojet, hamamet, objektet e kultit fetar etj. Ajo që binte më shumë në sy në qytetin e Ulqinit ishte kulla e lartë të Sahatit, e ndërtuar në vitin 1754.

Qyteti i Ulqinit u bë qendër e rëndësishme tregtare jo vetëm ndërmjet viseve shqiptare, por edhe për rajonin e Ballkanit dhe të Adriatikut. Nga tokat shqiptare eksportoheshin kryesisht produkte bujqësore e blegtorale, lëndë drusore etj. Një rol të madh në tregtinë e rajonit të Adriatikut luante flota detare e tregtarëve të Ulqinit.

Gjatë shekullit XVIII, një numër familjesh feudale u fuqizuan mjaft ekonomikisht, duke zgjeruar pronat çifligare, si dhe të ardhurat nga sipërmarrjet e taksave. Këto familje të fuqishme në gjuhën e popullit u quajtën "oxhaqe".

Mehmet Pashë Bushatlliu, i mbiquajtur Mehmet Pashë Plaku, më të ardhur në pushtet, mori masa të forta për stabilizimin e gjendjes politike dhe ekonomike në pashallëkun e vet. Në fillim ai siguroi përkrahjen e malësorëve e të qytet të Shkodrës. Pastaj iu vu punës për eliminimin e kundërshtarëve të vet feudalë. Pasi dëboi ose asgjësoi krerët e oxhaqeve rivale, brenda Shkodrës, më 1759 ai nënshtroi agallarët e Ulqinit dhe dogji barkat e piratëve ulqinakë. Për vendosjen e rregullit dhe të qetësisë brenda sanxhakut, më 1760 sulltani e njohu atë si mytesarif, në rangun e ministrit (vezirit).

Në maj të vitit 1835 shpërtheu një kryengritje e re e madhe në Shkodër, nën udhëheqjen e Hamza Kazazit, Dashjo Shkreli etj. Për drejtimin e kryengritjes u krijua një këshill i përkohshëm. Kryengritja përfshiu edhe krahina të tjera të Shqipërisë së Veriut. Me qytetarët shkodranë luftuan vullnetarë nga Postriba, Gjakova dhe Peja. Më kryengritësit u bashkuan gjithashtu Malësia e Mbishkodrës, Ulqini dhe Mirdita.

Më shembjen e pashallëqeve në Shqipërinë e Veriut, e gjatë përpjekjeve për të zbatuar reformat, turqit prishën ndonjë bajrak. Sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, më 1878. Malit të Zi, përveç tokave të tjera shqiptare, iu dhanë edhe bajrakët Shestan, Triesh, Fundna, Kojë dhe pjesërisht ata të Anës së Malit, e Arbneshit në Krajë. Në disa vise shqiptare, me të përfunduar procesi i sllavizmit, u shkatërrua organizimi i vjetër shoqëror, si p.sh., në bajrakët Mërkot e Tuxhemil, të kazasë së Tivarit, dikur më popullsi kryesisht shqiptare, por të tërë të kthyer në myslimanë, e drejta kanunore shqiptare u zëvendësua më sheriatin, e deri më 1878 atje bajraku ruajti vetëm funksionin ushtarak. Deri në fund të shekullit XIX në Mërkot ka zotëruar dygjuhësia. Shumë familje nga Tuxhemili e Mërkoti tregojnë zanafillën e tyre shqiptare vendase ose

prejardhjen nga Kraja e Ana e Malit, emrat e fiseve më të cilët lidhen dhe trojet e të parëve (Kahreman Ulqini, *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror*, Tiranë, 1991, fq. 22).

Në shekullin XVII sanxhaku i Shkodrës ndahej në gjashtë kaza: Mali i Zi (i Vjetër), Podgorica, Ulqini, Tivari, Plava e Shkodra. Më 1769 përfshiu edhe Lezhën e Zadrimen, që iu shkëputën sanxhakut të Dukagjinit. Sipas Hanit, në mesin e shekullit XIX, në pashallëkun e Shkodrës bënin pjesë mydyrlleqet: Tivar, Ulqin, Lezhë, Sapë (Zadrimë), Podgoricë, Guci e Bjelopolje. Më 1867 Shkodra e bë vilajet dhe ndahej në sanxhakun e Shkodrës dhe të Durrësit. Një ndarje tjetër më pak ndryshime e jep H. Hekar. Sipas relacionit të Xhevdet Pashës, më 1861, vilajeti i Shkodrës kishte nëntë kaza: Shkodër, Tivar, Ulqin, Lezhë, Pukë, Mirditë, Zadrimë, Podgoricë, Shpuzë e Guci (K. Ulqini, *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror*, Tiranë, 1991, fq. 24 – 25).

Bajrakët e Malësisë së Madhe e dimëronin gjënë e gjallë në fushat e Zetës, Shtojit të Ulqinit, Bregut të Bunës, nga Gryka e atij lumi deri në Gurëz të Milotit, si dhe në trevën e Bregut të Drinit (K. Ulqini, *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror*, Tiranë, 1991, fq. 138 – 139). Duke përfituar nga rrënimi ekonomik i pronarëve të tokave, tregtarët nga qyteti blenë sipërfaqe toke të punueshme në trevën e bajrakut, që ua jepnin më qira fshatarëve vendas. Ulqinakët e pasur kishin blerë toka në Shestan e në katunde të tjera të Krajës (K. Ulqini, *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror*, Tiranë, 1991, fq. 144).

Në malet e Lezhës e të Mirditës rritej një lloj druri i quajtur *fustel*, që shërbente për ngjyrosje. Ai grumbullohej nga tregtarët lezhjanë, të cilët ua shisnin francezëve. Ata, me anijet e tyre e dërgonin në Marsejë e Ruen. Ana e Malit e furnizonte qytetin e Shkodrës më dru, qymyr e gël-qere. Malësorët i përqeshnin anamalasit, që dikur nxirrnin "*treqind shpate*" (luftëtarë), kurse tani ishin kthyer në "*treqind shatë*" (punëtorë) – (K. Ulqini, *Bajraku i në organizimin...*, Tiranë, 1991, fq. 147 – 148).

Blegtorët e Malësisë së Madhe dy herë në vit lidheshin më qytetin e Shkodrës. Në vjeshtë, pasi kishte përfunduar ndërzimi i dhenve, malësorët uleshin nga bjeshkët në Fushën e Bunës, pranë Pazarit të vjetër, ku bëhej një treg i madh: shitej bulmeti i mbledhur gjatë verës dhe bagëti. Po në këtë vend, në pranverë, kur ktheheshin nga fushat për të shkuar në kullosat verore, shisnin leshin e dhenve. Aq jetike ishin bërë lidhjet ekonomike të trevës së bajrakut me qytetin, sa qeveria kur donte të zinte ndonjë njeri ose të çonte në vend një urdhër, e kërcënonte bajrakun përkatës me "*mbylljen e pazarit*" (K. Ulqini, *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror*, Tiranë, 1991, fq. 149).

STATUTI I ULQINIT I HARTUAR NGA MESI I SHEK. XIV

Në kuadër të shtetit mesjetar, sikurse qytetet e tjera bregdetare, edhe ky qytet ka gëzuar një autonomi të caktuar, e cila ishte e rregulluar më statut. Nga mesi i shek. XIV, qyteti i Ulqinit ka administratën e vet, me kuvend dhe eprorin në krye. Zhvillohet pushteti autonom lokal në bazë të rregullimit municipial romak, më organizim ekonomiko – politik dhe kishtar. Formohet rregullimi komunal i tipit mesdhetar, i cili edhe pas ndryshimeve të shpeshta historike siguron pushtetin stabil. Rregullimi komunal, gjatë sundimit të venedikasve, në pjesën më të madhe reduktohet në formë. Kjo nuk është vetëm pasojë e politikës së venedikasve, por edhe e luftërave të kastave në qytet dhe të klasave në pronat e rrethit.

Për studimin e së kaluarës mesjetare të qytetit të Ulqinit, sidomos të marrëdhënieve shoqërore–juridike, si dhe forma e zhvilluar juridike e rregullimit komunal, burim i rëndësishëm është S t a t u t i i qytetit të Ulqinit, i hartuar pa dyshim nga mesi i shekullit XIV. Statuti Ulqinit përmendet rreth vitit 1330.

Qysh më 1350, anzhuinët, të cilët mbanin nën sundimin e tyre Durrësin, u dobësuan aq shumë sa u detyruan të tërhiqeshin duke e ruajtur gjithnjë të drejtën e sovranitetit mbi qytetin. Por, me largimin e tyre, Durrësi e fitoi autonominë dhe u kthye në një komunë të lirë qytetare. Pas shembjes së Perandorisë Serbe, edhe qytetet e tjera kryesore të Shqipërisë, si: Shkodra, Ulqini, Drishti, Tivari, Lezha, Shasi etj., ndonëse vazhduan të mbeteshin nën sundimin e qeveritarëve feudalë serbë, fituan, diku më shumë e diku më pak, mjaft të drejta për vetëadministrimin, duke u forcuar edhe ato si komuna qytetare autonome (**comuna civitatis**). Kjo u shpreh në rritjen e rolit të *këshillit të qytetit*. Këshillat administronin si dhe më parë jetën politike e publike të qytetit. Anëtarët e këshillave, zakonisht 8 ose 10 veta, zgjidheshin prej *kuvendit të qytetarëve* një herë në vit. Kuvendi i qytetarëve zgjidhte gjithashtu edhe *kolegjin e gjykatësve*. Të zgjedhurit e organeve të larta të qytetit u jepte komunave *pamjen e republikave të tipit mesjetar*.

Masat e "popullorëve" zakonisht qenë përjashtuar nga pjesëmarrja në jetën politike të qytetit. Në disa komuna edhe "qytetarët", ku më shumë e ku më pak, qenë përjashtuar prej fisnikëve nga këshilli, ku shumicën e përbënin vetëm fisnikët. Për të siguruar pushtetin, fisnikët mundën të zëvendësonin kuvendin tradicional të qytetarëve, më një këshill të madh ku pjesëmarrja e "qytetarëve" ishte gjithashtu e kufizuar. Ky këshill i madh zgjidhte këshillin e qytetit, i cili filloi të quhej **këshilli i vogël**.

Rënia e pushtetit në duart e fisnikëve i ktheu komunat në *republika aristokratike* (shih: *Historia e popullit shqiptar*, vëllimi e parë, botimi i dytë, Prishtinë, 1969, f. 205; *Enciklopedija Jugoslavije*, 8, JLZ, Zagreb, MCMLXXI, f. 416).

Komunat qeveriseshin sipas statuteve të tyre të cilat, në mjaft raste, ekzistonin edhe gjatë sundimeve të huaja. Por ato hynë plotësisht në fuqi pas kthimit të qyteteve të Shqipërisë në komuna autonome. Ne sot nuk i kemi tekstet e statuteve të qyteteve të Shqipërisë, por nga njoftimet historike dihet se qytetet si: Durrësi, Ulqini, Shkodra, Drishti, etj., kishin statute të tilla, të cilat humbën gjatë pushtimit turk. Ato ishin të shkruara në pergamenë dhe ruheshin në pallatin e këshillit të qytetit.

Komunat qytetare u detyruan të mbroheshin nga synimet e feudalëve fqinj. Durrësi, për shembull, luftoi disa herë më radhë kundër Karl Thopisë, Ulqini e Tivari kundër Balshëve, Lezha kundër Dukagjinit. Shpeshherë, për të shpëtuar të drejtën e vetadministrimit, qytetet detyroheshin t'u paguanin feudalëve tributë e rënda. Megjithatë ato ranë njëri pas tjetrit nën sundimin e feudalëve arbëreshë, të cilët ua respektuan të drejtat. Por nga ana tjetër ata i detyronin komunat qytetare t'ua paguanin tributin e vjetër ose t'u jepnin një pjesë të të ardhurave nga taksat. Tributë merrnin për shembull feudalët Thopiaj nga Durrësi, Muzakët nga Berati, Dukagjinët nga Lezha, etj.

Kundër fisnikëve, të cilët i kishin kthyer ose po i kthenin qytetet në republika aristokratike, luftonin të dy shtresat më të ulëta. Në disa qytete, si në Ulqin, në sajë të rezistencës së "popullorëve"dhe "qytetarëve", fisnikët nuk mundën t'i përjashtonin ata krejtësisht nga pjesëmarrja në drejtimin e qytetit. Këtu merrnin pjesë në kuvendin e qytetarëve që të tria shtresat. Edhe funksionarët do të zgjidheshin nga të tria shtresat: 2 gjykatësit nga fisnikët, 4 kamerarët nga "qytetarët" dhe në detyrat e tjera më të vogla do të zgjidheshin edhe nga "popullorët".

Nga njoftimet historike dihet se qyteti i Ulqinit e kishte statutin e vetë, që përmendet dhe që ekzistonte prej ose pas vitit 1330. Si edhe statuti i Tivarit, ashtu edhe ai i Ulqinit nuk u ruajtën. Pasi që statuti i qytetit të Ulqinit ishte i ngjashëm më ata të Budvës dhe të Kotorrit, atëherë, në statutin e Ulqinit kanë qenë të përfaqësuara të gjitha fushat juridike, por më shumë dispozita ka pasur nga e drejta civile. Është rregulluar raporti midis Ulqinit dhe carit, autonomia e qytetit dhe administrimi, si dhe mbi strukturën klasore dhe nacionale të popullsisë (shih: M. Luketić: *Budva, Sveti Stefan, Petrovac* (monografia), Budva, 1966; *Srednjovekovni statut Budve*, Budva, 1970).

Për në Tivar burimet arkivale dëshmojnë një luftë të ashpër e të gjatë klase. Këtu, më 1372, aristokratët, u munduan me një grusht shteti ta zëvendësonin kuvendin e popullit më një këshill të madh dhe pushtetin ta kishte në dorë këshilli i vogël. Por popullorët nuk i lanë fisnikët t'ua shkelnin të drejtat dhe, kështu, në vend të kuvendit të popullit, u krijuan dy këshilla, ai i fisnikëve dhe ai i "popullorëve". Lufta midis tyre vazhdoi shumë kohë dhe i dha rast Venedikut të ndërhynte e ta pushtonte qytetin. Ajo vazhdoi edhe gjatë sundimit venedikas (shih: *Historia e popullit shqiptar*, vëllimi i parë, botim i dytë, Prishtinë, 1969, f. 206).

Bashkitë qytetare, të krijuara në momente të caktuara historike të së kaluarës, kryenin aktet e përditshme administrative dhe gjyqësore, rregullonin edhe raportet me zotërit e vendit në bazë të statuteve të veta (*lor statuti*), të cilat ishin akte të shkruara konstitucionale e të depozituara dhe përcaktonin shkallën e autonomive qytetare, të drejtat dhe detyrimet e tyre kundrejt qytetarëve, fshatarëve dhe zotit të vendit. Në ushtrimin e përditshëm të funksionit administrativ dhe gjyqësor, ashtu edhe në raportet më botën përreth, fuqi të madhe kishte e drejta zakonore (Injac Zamputi, *Autonomitë e qyteteve shqiptare të principatës së Balshajve dhe pasojat negative të pushtimit venedikas – fundi i shek. XIV – fillimi i shek. XV*, në "*Studime historike*", nr. 3, Viti XXXIV (XVII), Tiranë, 1980, f. 170).

Venediku, synonte ta bënte çështjen e verës së vendit si një çështje të të gjithëve. Por dihet se vera ka qenë një produkt që qytetarët e pasur, si më parë fisnikët, pretendonin ta kishin në ekskluziv, në konflikt me shtresat fshatare, për të siguruar fitime në tregtinë përkatëse. Do ta ilustrojmë më një shembull: "*Ndër kërkesat e ulqinakëve më 1423, të kërkesa 34, thuhet që të priten e të shkulen vreshtat që janë në rrethin e Ulqinit ndër fshatrat shqiptare dhe të mos u lihet atyre asnjë vresht dhe askush të mos mund të vërë vreshta aty. Venediku nuk e pranon plotësisht këtë kërkesë, ashtu sikundër nuk e kishte pranuar edhe kërkesën e drishtjanëve. Përgjigja është, pra, se, ato vreshta që ekzistojnë, duhet të mbeten ashtu siç janë, por tani e tutje të mos mund të vihen vreshta të tjera*" (Injac Zamputi, *Autonomitë e qyteteve shqiptare të principatës së Balshajve,* f. 177).

"*Ulqinakët kërkojnë, për më tepër, që t'u ruhej juridiksioni i pyjeve dhe i ujërave që janë në dobinë e bashkisë, sepse kështu ka qenë zakoni qëmoti. Një tjetër kërkesë e ulqinakëve është që ata të mbajnë, më shpenzimet e vendit, një noter për nevojat e qytetit, ashtu siç e kanë mbajtur gjithmonë sipas zakonit të vjetër, sepse ky noter futej në punë për të bërë shkresurinat e bashkisë ashtu edhe për të shkruar vendimet e*

këshillave dhe të gjykatave, siç ka qenë zakoni përherë. Po ky noter pastaj futej në punë edhe për t'u mësuar këndim e shkrim bijve të qytetarëve. Dëshmia e fundit e ulqinakëve, duke na paraqitur noterin si mësues dhe si zyrtar na tregon edhe për nevojën e një arsimi, sado fillestar, që ndihej në qytet – bashki tona në fundin e shekullit XIV" (Injac Zamputi, *Autonomitë e qyteteve shqiptare të principatës së Balshajve*, f. 182).

PËRVJETOR: 1878 - 1880 - 135 VJET
të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të Kongresit famëkeq të Berlinit

Xhafer BELEGU

LUFTA SHQIPTARO-TURKE PËR DORZIMIN E YLQINIT[5]

Sulltani mbeti në pozitë që s'i pëlqente me përdorë forcë kundër Shqiptarëve, shumica e të cilëve ishin muhamedan, e as nuk donte të fitojë mëninë e tyne se i konsideronte popullin shqiptar nji nga shtyllat ma të forta të Perandoris së ti. Mirëpo nuk kishte se ç'të bante se Pushtetet e mëdha herë pas here e shtrëngonin me nota Turqin për me zbatue vendimet e Pushteteve, bile me nji notë të fundit në formë ultimatumi me inisiativën e Austro-Ungarisë dhe Anglisë i u-kërkue drejt për drejt Sulltanit që të përdori forcë kundër fuqive shqiptare që kundërshtonin dorëzimin e Ylqinit.

Për dorzimin e Ylqinit, banorët e kti qyteti i drejtuen më 24 Tetuer trupit konsullues në Shkodër këtë përmëndore në formë proteste: Në rast se do të dërgohet vërtet ushtri kundër nesh që kemi qenë nën sundimin e Turqis e nuk dumë të shkëputemi prej saj, muhamendanë e të krishtenë jemi bashkue për me e mbrojtë qytetin tonë me pushkë në dorë.

Më 22 Nanduer u-dha urdhën që t'i ndalonte mbledhjet Dega e lidhjes se kishte frikë se mos po bajë kjo ndonji veprim kundër ati. Mirëpo Shkodranët protestunë duke mbyllë pazarin, populli rroku armët kundër urdhnit të Dervish Pashës u-ba nji mbledhje e madhe. Më 22 Nanduer Dervish Pasha dha urdhën të marshoj ushtria.

Tre batalionë t'Osman Pashës hasën me fuqinë e Lidhjes në Shingjergj ku u-zhvillue nji luftim i rreptë.

Lidhja kur u murë vesht se Dervish Pasha dha urdhën me i sulmue pararojat e saj në Shingjergj, me 3000 t'armatosun bani nji mbledhje para Xhamis së vjetër, në të ciln u-vendos me luftue kundër ushtris e me thirrë të gjithë burrat nën armë. 700 Shkodranë e 300 nga rrethet u-pregatitën me i lypë barkave e me shkue për Ylqin për t'i marrë krahat ushtrisë e për me e futë ndërmjet dy zjarresh.

Priteshin edhe 500 burra që flitesh se do t'i vishin Shkodrës për ndifëm nga Gucia passi edhe Shkodra pat dërgue ndihma kur Plavë e Guci qenë në rrezik. Mirëpo kta s'erdhën se ishin duke rujtë kufinin e vet.

[5] Bëhet fjalë për ngjarjet e vitit 1880.

Batalioni turk që formonte garnizonin e Ylqinit, tins e pa u-marrë vesht u-imbarkue në luftanin "Selimie" me gjithë ç'pat edhe dulë në Shënkollë në grykë të Bunës, nga frika se mos fuqia shqiptare n'Ylqin e qiste inatin ke kta. Flota e vogël e liqenit të Shkodrës e përbame prej anivet "Ylqin" e "Tivar" runte Bunën e luftania e "Selimie" si pruni ushtarët u-nis prap për me bombardue qytetin. Turqit vijunë marshimin e fuqit e Lidhjes që kishin zanë vend ke Shkalla e Mushkës, kur panë ushtrin u-tërhoqën. Dervish Pasha, më 22 Nanduer erdh deri ke Kodra e Kuqe, ku u përpoq me ushtrin e Lidhjes e cila kishte zanë vend prapa shkambinjve të kodrës.

Shqiptarët qenë pa mjete lufte. Topat u mungojshin, armët i kishin kapakllie e barotin me pakicë e të keq. Fuqia e tyne që kishte zanë vend ke katundi Klesna në Kodër të Kuqe ishte gjithsejt 1000 vetësh dhe komandohesh prej Jusuf Agë Sokolit i cili ishte nji burrë trim e bestar i Lidhjes. Nga ana e Shqiptarvet, i a nisi pushkës i pari Fetah Agë Dragusha e pas ati të tjerët. Osman Pasha me të shpejtë i dha urdhën ushtris që të sulmojë; mirëpo në fillim kjo u-kthye e pastaj duke i ardhë ndifma të reja sulmoi prap. Pas nji luftimi të rreptë që zgjati dy orë llogoret e Shqiptarëve u-prishën prej topave. Atherë fuqia e Lidhjes u-tërhoq se e pa që çdo qëndrim ishte i kotë e sidomos si u-plagos randë komandanti Jusuf Agë Sakoli. Artileria u ndifi mjaft Turqve se shkaktoi demoralizimin e Shqiptarve. Në këtë luftë Shkodranët e Anamalasit dëftynë trimni. Asnji nuk ra në dorë të Turqve por edhe s'u-ndoqën prej tyne.

Turqit lanë në fushë të luftës 9 të vramë e 32 të plagosun, kurse Shqiptarët nga armët moderne e nga numri i math i anmikut patën ma se 50 vetë të vramë e nji numër të math të plagosunish. Shqiptarët ngulshin kambë se kishin vetëm 7 të vramë e 30 të plagosun.

Dervish Pasha si theu kundërshtimin e Shqiptarvet duke kalue para flotës së Pushteteve hyni në Ylqin. ngriti flamurin e bardhë edhe i deklaroi komandës malazeze se ishte gati me e dorzue qytetin. Për sjelljen e egër të ti Dervish Pasha u-qujt prej Shqiptarve "Dervish Kasapi".

Pas ktyne veprimeve Dervish Pasha shpalli faljen e përgjithshme edhe e la fuqin e Lidhjes të tërhiqet pa u ndjekun. Veç ktyne i ndau edhe të holla popullit të vobegët, për ndifmë.

Pas ranjes s'Ylqinit dy kryetarët e Lidhjes n'atë qytet, Mehmet Besi dhe Mehmet Gjyli u-arratisën në drejtim të pa-njoftun, kurse Jusuf Agë Sokolin e prunë në Shkodër, ku vdiq nga plagët e randa që kish marrë.

Kur ishte Dervish Pasha duke kalue kalurë nëpër rrugët e Ylqinit, i del përpara nji grua trimneshë e cila i rrëmben frenin e kalit edhe i thotë: "*Aman, more Pashë! Për hatrit të Zotit! Mos na shtjerë në dorë t'anmikut, ma mirë t'na mbysish sesa të na lashë nën Shqa!*"

Dervish Pasha nxurrë kasnecin e i bani me dijtë popullit të qytetit që të lanë Ylqinin e të shkojnë mbrenda kufinit të Perandorisë se Qeveria kishte ndërmend me i instalue gjetkë.

.....

(Pjesë nga libri: ***Xhafer Belegu***: *Lidhja e Prizrenit dhe veprimet e saj 1878 – 1881*, Shtypshkronja "*Kristo Luarasi"*, Tiranë, 1939)

Dinko FRANETOVIQ – BURE

DETARIA E DIKURSHME E ULQINIT

Kur Ulqini, më 1046, i është dorëzuar Republikës së Venedikut, nuk ka pasur shumë anije. Në kushtet e dorëzimit të qytetit, përmenden zanate të ndryshme, por jo edhe detaria; po ashtu edhe më vonë, më 1533, në "*Itinerarin*" e Giustinianit.

Para sundimit të Turqisë, më 1571, Ulqini u ka shërbyer anijeve si vendstrehim para rrezikut nga kusarët. Nga kalaja është ofruar një shikim shumë i mirë në largësi, në det. Përveç kësaj, anijet tregtare që kanë kaluar atypari, i kanë informuar ulqinakët për praninë e kusarëve, por që edhe nga anë të tjera kanë arritur lajmet e tilla në Ulqin.

Ulqini, sikur edhe Sqepi i Rodonit, kanë pozita të tilla që paraqesin vende vrojtimi të shkëlqyeshëm detar. Banorët e Sqepit të Rodonit, të cilët edhe vet në një mënyrë kanë qenë kusarë, kanë qenë armiq të kusarëve më të mëdhenj. Posa të vërenin fustat e kusarëve, ose armatën, menjëherë me flakë dhe tym, nga Kepi i Rodonit do të informonin ulqinakët. Kjo do të thoshte: kusarët janë afër.

Emri i Uluzh Aliut është ngushtësisht i lidhur me Ulqinin dhe kusarët ulqinakë. Pas Luftës në Lepant, më, 7. X 1571, ai ka lëshuar nga puna disa kusarë të vet, algjerianë, dhe ata, nja 400, i ka vendosur në Ulqinin e shkretëruar. Ata, e më pastaj edhe pasardhësit e tyre, janë bërë kusarë në zë, detarë dhe – tregtarë të njohur. Uluzhi, pas vdekjes së reizit Dragut, më 1565, ka qenë i caktuar për guvernator të Tripolit, ndërsa më 1568, për zëvendës të mbretit të Algjerisë. Pas Luftës së Lepantit, me ç' rast ishte komandant i një pjese të flotës, Sulltani e ka emëruar për kapedan-pasha (admiral) dhe ia ka dhënë emrin Kiliç Ali, që do të thoshte – këllëç (shpatë). Uluzh Aliu është me prejardhje italian, peshkatar, i lindur nga Kalabria. Karakoshi, gjithashtu, ishte renegat kalabrez. Turqit e kanë thirrur Kargoez (syri i zi), ishte kusar që s' trembej dhe kapedan i Vlorës, ndërsa është vrarë te Lepanti. Ramadani ka qenë kusari ulqinak më i shkathëti dhe më i tmerrshmi, njëkohësisht udhëheqës i tyre, i cili qe vrarë bashkë me 22 anëtarë të ekuipazhit në përleshjen me një fllugë të kapitenit Gulf, ke Dugi-Otok (Ishulli i Gjatë), në fillim të gushtit të vitit 1673, por që kusarët e tij janë hakmarrë keq për vrasjen e udhëheqësit të vet.

Gopçeviqi shkruan se kusarët e Ulqinit kanë qenë detarë shumë të mirë dhe kusarë, frikë për qytetet italiane bregdetare, kamxhik i Apulisë

dhe Sicilisë; ata kanë shkuar atje dhe kanë plaçkitur vilat e pasura, pronarët e tyre i kanë marrë rob dhe ua kanë shitur turqve. Kusarët e Ulqinit, pak pas marrjes së Ulqinit, janë organizuar, kanë siguruar barkat e nevojshme dhe kanë filluar me kusari. Barkat e veta i kanë ndërtuar shpejt dhe ashtu e kanë shtuar numrin e anijeve dhe të kusarëve. Prej barkave të tyre më së shumti kanë pasur të tipit të fustave, e pastaj edhe fregatina, brigantina e galeote. Kusarët e Ulqinit, kur ka bërë mot i lig, fustat e veta i kanë qitur në tokë në gotullën e vogël nën portën e kalasë, nën shkëmbinjtë e lartë. Aty janë fshehur para sulmit në ndonjë barkë tregtare që ishte në kalim atypari. Përveç që në vetë gjirin e Ulqinit ata janë fshehur edhe pas ishullit të Ulqinit të Moçëm, në Gjirin e Valdanosit edhe pas Gurit të Gjeranave, nga i kanë sulmuar barkat duke kaluar. Ata kanë ditur t'i afroheshin ndonjë barke me flamur të ndonjë shteti mik, e pastaj nga afërsia përnjëherë do t'i sulmonin, kur më nuk do të kishin kohë të mbroheshin. Kanë bërë kusari gjatë tërë Adriatikut dhe kanë bashkëpunuar me kusarët algjerianë nëpër Mesdhe. Ulqinakët njerëzit i kanë marrë si robër dhe për ta kanë kërkuar shpërblesa të mëdha. Ashtu, Lucia, gruaja e Ili Mërvicës, nga Përçanji, në Grykën e Kotorrit, ka qenë e detyruar ta blejë burrin për 130 talirë, e njëfarë Bozho Sbutega i Tripos, po ashtu prej Përçanjit, ka vdekur si rob në Ulqin, më 15. VIII 1668. Ulqinakët kanë ditur t'i shërbejnë atij që i ka marrë për argati, apo që u kanë bërë ndonjë punë. Vicko Bujeviqi, nga Perasti, kur ka rënë në konflikt me parinë vendore, ka ditur t'i sjellë dhe i ka lënë të ankorohen para pallatit të tij, barkat e kusarëve ulqinakë, që në rast se e sulmojnë, këta ta mbrojnë, edhe pse më vonë edhe ka luftuar kundër tyre. Por, vëllezërit Bujoviq, në rastet e sulmeve në Grykën e Kotorrit, i kanë zmbrapsur ulqinakët.

Ivan – Kërstitel Garbo, proveditor inordiner i Kotorrit dhe i Arbërisë, më 4. I. 1689, i ka lëvduar vëllezërit Vicko dhe Ivan Bujoviqin, të cilët i kanë dëbuar sulmet e ulqinakëve, dhe në më shumë ndeshje, ua kanë rrëmbyer 11 tartana përplot me kripë dhe gjëra të tjera të ndryshme, duke pasur pranë vetes perastas të zgjedhur dhe trima. Kur në vitin 1687 Herceg - Novi dhe Risani janë çliruar prej turqve, mbrojtja e Grykës së Kotorrit nga kusarët ka qenë shumë më e lehtë. Ulqinakët, kah mesi i vitit 1715, kanë ndërtuar disa galetote të mëdha. Marina e Vendikut gjithmonë i ka ndjekur kusarët ulqinakë si dhe të tjerët nëpër Adriatik, si dhe jashtë tij. Dogji venedikas, Ivan Korner, në marrëveshje me Senatin, më 9. IV. 1718, ka lëshuar dekretin me anë të të cilit, për pesë muaj, barka "*San Marco*", me kapitenin Luko Zhupa, si dhe barka tjetër me emrin "*Sv. Todor*", caktohet të ndjekin nëpër Adriatik kusarët ulqinakë.

Gjiri i Valdanosit, Krruçi dhe ishulli Ulqini i Moçëm

Gjiri i Valdanosit (Skela e moçme) – Ajo që për Dubrovnikun është limani i Gruzhës, për Ulqinin është gjiri i Valdanosit. Meqë ulqinakët nuk kanë pasur dhe nuk kanë ndonjë liman të përshtatshëm në afërsi, ata barkat e veta i kanë mbajtur në këtë gjir. Ai ka qenë vendstrehim i barkave të kusarëve ulqinakë. Ky gjir është i strehuar nga erërat nga kuadranti II, por që e rrahin erërat dhe tallazet nga perëndimi, jugperëndimi dhe veriperëndimi. Kur ka fryrë erë e perëndimi, në Valdanos janë shkatërruar mjaft barka, çka mund të shihet nga pasqyra e anijeve të dëmtuara. Ankorimi më i mirë është në anën jugore të gjirit, ku janë rrënojat e një kishe të vogël. Vaporët e "*Loydit*" dhe anijet e shoqërive të tjera, si dhe barkat me vela, kur në limanin e Ulqinit, shkaku i motit të lig, nuk kanë mundur të bëjnë punët e tregtisë, ato i kanë kryer në gjirin e Valdanosit. Vaporët janë ankoruar në anën veriore-veriperëndimore të shkëmbit të lyer bardh në anën jugore të gjirit, në thellësi prej 10 m. Në fund të gjirit, nëpër mes të bregut me zhur, tash shihen muret e rrënuara të një ish-karantine turke. Turqit, barkat e infektuara ulqinake, por gjithashtu edhe barkat që të infektuar vinin në Ulqin e Tivar, i kanë mbajtur në karantinë në Valdanos. Për atë qëllim ka qenë ndërtuar ndërtesa e përmendur. Në vitin 1833, një brigantinë ulqinake ka arritur e infektuar nga Aleksandria. Ka qenë caktuar që në gjirin e Valdanosit të qëndronte 40 ditë. Kapitaneria e limanit e ka pasur për detyrë të ruajë që njerëzit nga anija të mos dalin në tokë e të kenë kontakt me njerëz të tjerë. Sipas një lajmi tjetër, më 12. VI. 1833, ekuipazhi dhe udhëtarët në atë barkë kanë qenë fare të shëndoshë. Sipas urdhrit të pashës së Shkodrës, të gjithë kanë qenë të izoluar në ndërtesën në breg. Gjësendet e tyre çdo ditë janë ajrosur, ndërsa duke e ndërruar ujin nga bulirat, e kanë larë, pastruar barkën e infektuar. Kur shëndeti i ekuipazhit dhe udhëtarëve ka qenë e mirë, barkës, pas 30 ditësh, i është lejuar të lundronte më tutje. E përmendëm këtë rast për të parë se për çka ka shërbyer ndërtesa në Valdanos gjatë sundimit turk, dhe që të jetë e ditur se turqit në atë kohë kanë mbajtur edhe për barkat ulqinake. Është interesante që barka e përmendur, edhe pse kishte rrezik që në rastin e motit të keq ta hedhin në tokë, megjithatë në Valdanos ka mbetur 30 ditë.

Nuk është e ditur nëse Mali i Zi atë godinë në Valdanos e ka përdorur për karantinë. Me marrëveshjen me Austrinë, në vitin 1880, anijet e veta të infektuara ka pasur të drejtë t'i dërgonte në lazaret në Meline. Mali i Zi,këtë ndërtesë, që ka shërbyer si shtëpi banimi për nëpunësin e limanit në Valdanos, ndërsa në depo pronarët e barkave kanë

vendosur mallin e shkarkuar, është mbajtur në gjendje të rregullt. Kapitaneria e portit në Ranë, me njoftimin nr. 146, të datës 26. V. 1884, nga Zyra e repartit të detarisë në Cetinë, kërkon që ndërtesa në breg të Valdanosit të meremetohet për shërbime që ka kryer në kohën turke. Në vitin 1886, Ministria e Punëve të Brendshme i ka pasë dërguar vojvoda Simo Popoviqit në Ulqin, 600 forintë, për meremetimin e ndërtesës së përmendur, e cila në shkresë quhet "kvarantina". Në vitin 1900, për meremetimin e "kvarantinës" janë shpenzuar 127,54 forintë. Në këndin juglindor është një mendreq si vendstrehim për anije të vogla (sandalla). Nuk ka të dhëna se a ka qenë edhe në kohën turke. Mali i Zi këtë mendreq e ka mbajtur në gjendje të rregullt. Në vitin 1900 është bërë meremetimi i tij, ndërsa punimet kanë kushtuar 30 forintë. Kemi gjetur të dhënën se edhe në vitin 1906, për meremetimin e atij limani të vogël janë paguar njëfarë Petar Radojevit 150 korona. Në anën verilindore të gjirit, nja 100 m nga zhurina, është një krua i vogël me ujë për pije. Këtë krua e ka ndërtuar Boro Gjurashkoviqi, ushtrues i detyrës së shërbimit të limanit në Valdanos. Populli e quan: "*Kroni i Boros*". Në doracakët për lundrime shkruan se në fund të një shpelle është një burim uji. Anijet këtë ujë mund ta marrin edhe përmes të gypave dhe pastaj ta bartin deri në anije. Në të njëjtën anë janë edhe dy burime të tjera, por që qesin më pak ujë. Pak më lart kah dalja nga gjiri është një burim me ujë sulfurik. Një burim i tillë është edhe nja 500 m në perëndim të "*Kronit të Boros*". Uji sulfurik del edhe në Kepin e Mendrës, mu nën fanar, kur është moti i lig ose bien shira të mëdha. Mali i Zi, kur hyri në këtë anë, e ka dërguar ujin sulfurik në hulumtime dhe analiza. Rezultate e kësaj analize gjenden në arkivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme në Cetinë. *Rovinski* shkruan se shqiptarët *Valdanosin* e quajnë *Ditkisha*, që do të thotë *Gjiri i Kishës*. Në kepin e vogël, në anën jugore të gjirit, në gjysmën e asaj pjese të gjirit, ku zakonisht barkat ndalen në spirancë, janë muret një kishe të vogël, larg nga bregu 5,5 m. Populli thotë se këtë kishëz e kanë ndërtuar grekët. Në kohën e lulëzimit të kusarisë në Ulqin, kusarëve ky gjir u ka shërbyer si liman dhe strehim për fustat e tyre të shpejta, por edhe për të qitur anijet e tyre në tokë. Është e besueshme se, sipas urdhrit të Portës, më 1675, shkaku i kusarisë, janë vënë flakët 10 fustave ulqinake, meqë nuk tregohet se ku janë djegur ato, në Valdanos apo në ndonjë vend tjetër. Është e ditur se më pastaj, veziri i Shkodrës Bushatliu, më 1760, me rastin e sulmit mbi Ulqin, "*me urdhëresë ka fundosur barkat e Ulqinit në "Skelën e Moçme" (Valdanos), prandaj Ulqini e ka pranuar pushtetin e tij*". Edhe Hahni shkruan se, Sulejman pasha, një armik i egër i ulqinakëve, në bazë të një urdhri nga Stambolli, i ka djegur barkat

ulqinake në Valdanos, ashtu që edhe sot e kësaj dite mbetjet e atyre barkave pengojnë ankorimin e anijeve (nuk shkruan data e saktë e këtij shkatërrimi). Lugina e Valdanosit është e njohur për trungjet e bukura të ullinjve, të cilët në gjatësi prej nja 5 km, shtrihen që nga zhurina gati deri në Ulqin.

Duke pasur parasysh detarinë dhe tregtinë, turqit gjirit të Valdanosit i kanë kushtuar rëndësi të madhe. Prandaj, prej bregut të gjirit, deri në Ulqin, kanë ndërtuar një rrugë prej kalldrëmi, që edhe sot është në gjendje mjaft të mirë. Pas vitit 1880, Mali i Zi ka pasur për qëllim që në Valdanos të ndërtojë një port të sigurt për anije. Për atë qëllim inxhinieri i përmendur Slade, në vitin 1881, në gjir ka bërë hulumtime dhe matje, por që, shkaku i shpenzimeve të cilat sipas përllogaritjeve të tij do kërkesa të shpenzimeve do të ishin të mëdha, nuk është ndërmarrë kurrfarë ndërtimi.

Në kepin e Mendrës, në anën jugore të hyrjes në liman, që nga koha e turkut, ka pasur drita në breg. Në kep është një fanar i vogël, si dhe shtëpiza për kujdestarin e fanarit. Mali i Zi këtë dritë e ka pasur meremetuar dhe e ka mbajtur në gjendje të rregullt.

Tharja e Liqenit të Zogajve dhe formimi i Portit të Gjeranave – "Milenës"

Inxh. Josip Slade, në shtator të vitit 1881, e ka bërë projektin për tharjen e Liqenit të Zogajve. Këshilli shtetëror në Cetinë, në vitin 1882 ka vendosur që, me shpenzime prej 10 000 forintash, të nisin punët për tharjen e Liqenit. Por punët nuk kanë nisur asnjëherë. Në vitin 1885, knjaz Nikolla, për të njëjtën punë, e ka pasë thirrur inxhinierin rus Vladimir Ivanoviq Varmanin. Varmani e ka punuar projektin dhe, prej Liqenit deri në det, te Punta e Gjeranave, në një vijë të thyer zigzage, e ka hapur një kanal të gjatë 4,5 km, me anën e të cilit uji ka dalë (ka rrjedhur në det). Pas kryerjes së punimeve, niveli i sipërfaqes së ujit ka rënë, dhe ashtu është tharë një kompleks i madh i një toke pune në Fushën e Ulqinit. Varmani, me të përfunduar të punimeve, ka këshilluar që kanalin nuk është mirë të thellohet edhe më shumë, shkaku i rrezikut të depërtimit të ujit të njelmët të detit. Shkaku i mbushjes me lym të kanalit, është dashur të pastrohet çdo tre ose katër vjet. Pastrimi i parë është bërë në vitin 1888, nën drejtimin e vojvoda S. Popoviqit, sunduesit të Bregdetit. Në verë të vitit 1896 është bërë pastrimi i kanalit nën udhëheqjen e inxhinierit Marko Gjukanoviqi. Mirëpo, Gjukanoviqi e ka bërë gabimin të cilin Varmani e ka parashikuar dhe ka dashur ta

parapengojë: e ka pastruar kanalin, e ka drejtuar në një drejtim dhe e ka thelluar dhe më. Pas një kohe të shkurtër uji ka depërtuar nga deti në Fushën e Ulqinit dhe i ka shkaktuar dëmin e paparaparë tokës punuese, që më pastaj kurrë më nuk ka mund të kthehet bujqësisë. Në fillim të nëntorit të vitit 1896, në zonën e derdhjes së lumit të Drinit dhe të Liqenit të Shkodrës, kanë rënë shira të mëdha. Shkaku i fryrjes së befasishme të lumit të Drinit, niveli i ujit në lumin e Bunës dhe të Liqenit të Shkodrës është ngritur shumë, prandaj uji është derdhur jashtë brigjeve të Bunës te katundi Shëngjergj dhe Rrcok (Paratuk, Mëhalla). Uji, me shpejtësi të madhe, ka rrjedhur nëpër Liqenin e Zogajve, dhe nëpër kanalin e hapur ka rrjedhur drejt detit, duke e zgjeruar në atë mënyrë vijën dhe duke qitur në detin Adriatik shumë tokë e lym. Shkaku i këtij erozioni të madh, është formuar porti *Gjerana* më pastaj i mbiquajtur "*Knjeginja Milena*", më shkurt "*Milena*". Pas përmbytjes së vitit 1896, porti "*Milena*" me gjithë kanal ka qenë i gjatë 2,5 km, i gjerë 150 – 200 m, i thellë në hyrje 3 – 5, në mes 6 – 7, ndërsa kah brendia edhe deri 10 m. Pak kohë pas vërshimit, kapiteni Sulejman Bullari prej Ulqinit, nga lundrimi prej Herceg-Novit deri në Durrës, me trabakullën e vet "*Huda Verdi*" është gastuar në Puntën e Gjeranave, që të shihte sa është thellësia në grykën e kanalit për në Liqe të Zogajve. Ka hyrë me kaik në sandall, dhe duke e matur thellësinë me anën e rremit, ka konstatuar se vërshimi e ka thelluar vijën. Pastaj ka hyrë në kanal me trabakullë dhe është ndalur në spiranca. Pas tij ka hyrë edhe kapiteni Jusuf Hoti me trabakullën e tij. Bullari, e ka lajmëruar Kapitanerinë e limanit në Ulqin për thellësinë e konstatuar në hyrje të kanalit. Sipas kallëzimeve, që edhe sot mund të dëgjohen, ky, knjazit Nikolla në Cetinë, i ka dërguar telegram me përmbajtje si në vijim: "*In porto di Gospodari arrivato primo capitano Bulari*". Kapiteni Bullari, pra, ka qenë i pari që e ka zbuluar portin e ri. Për detarët ulqinakë kjo ka qenë një ngjarje me shumë rëndësi, meqë me këtë është dyfishuar siguria e barkave të tyre, sidomos për faktin se me atë liman të ri varej edhe ekzistenca e tyre si detarë. Kapitaneria e limanit në Ranë, në fillim të vitit 1897 e ka informuar Ministrinë e Punëve të Brendshme në Cetinë për portin e ri të krijuar dhe për përparësitë e tij për barkat me vela ulqinake. Në raport shkruan se si vitin e kaluar uji e ka zgjeruar kanalin, ashtu që barkat me vela të Ulqinit, pas Kepit të Gjeranave, tash kanë një vendstrehim të sigurt. Në atë kohë, në hyrje, gjerësia ka qenë 40, ndërsa thellësia 3 deri 5 m. Tutje, në raportin e Kapitanerisë përmendet se në verë do të jetë e mundshme të konstatohet se a do të qëndrojë thellësia e përmendur dhe – nëse do të jetë ashtu – atëherë duhet ndërmarrë diçka që të sigurohet gryka të mos mbyllet me rërë. Ky port, për Ulqin ka

domethënie të madhe, meqë detarët ulqinakë kanë qenë të detyruar të kërkojnë strehim në Bunë. Nën atë shkresë është shtuar: "*Ministria do të dërgojë inxhinierin që të vërtetojë se çka mund të bëhet*". Kjo informatë e vërteta është lajmi i parë për formimin e portit të Gjeranave, njoftim të cilin kemi mundur ta gjejmë. Kapitaneria e limaneve në Ranë ishte e mendimit që, për rregullimin e portit pas Kepit të Gjeranave, më parë do të duhej të formohej një komision prej detarëve, dhe për këtë dërgon një raport më 14. III. 1897 Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky është raporti i parë për rregullimin e hyrjes në portin e Gjeranave. Në vitin 1897, marina luftarake austro-hungareze, me kanonierin e vet *Kerka*, ka bërë matje bregut të detit malazez dhe me atë rast e ka bërë planin e parë për portin e Gjeranave. Nga një kopje i është dorëzuar Ministrisë së Punëve të Brendshme në Cetinë dhe vojvodës Simo Popoviqi, administratorit të Bregdetit dhe Ulqinit. Kah fundi i vitit 1897, Kapitaneria e limaneve në Ranë ka pas caktuar një nëpunës të moshuar, si ushtrues të detyrës për shërbime limanore në portin e ri të Gjeranave, i cili njëkohësisht ka qenë i aftë për pilotim të barkave. Duke pasur parasysh se gryka në port ende nuk ishte i shënuar, anijet kanë qenë të detyruara që të pilotohen. Pak kohë më përpara, në grykë ka qenë thyer një trabakull turke e ngarkuar me drithë. Kah fundi i vitit 1897 dhe në fillim të vitit 1898, porti i ri është përuruar solemnisht. Detarët e pranishëm, njëzëri kanë propozuar që ai të quhet porti i princeshës Milena, gjë që edhe është aprovuar. Sipas kallëzimeve në Ulqin, me atë rast knjazi Nikolla e ka dekoruar kapitenin Bullari, meqë i pari e ka zbuluar limanin e ri. Kapitaneria e limaneve në Ranë, nga Drejtoria e detarisë në Cetinë ka kërkua për këtë port të ri një kaik 6 m të gjatë. "*Glas crnogorca*" i datës 3. IV. 1899, se që nga koha e atij vërshimit të madh në vitin 1896, Liqenin e Zogajve e lidh një vijë e gjerë me një gji të vogël në anën kah deti, i cili, duke pasur parasysh një të ardhme më të mirë të këtij limani, u quajt "*Knjeginja Milena*".

Dr. Simon LUFI

LUFTA E PARË BALLKANIKE DHE PROBLEMI SHQIPTAR

Kërkesat telegrafike për njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë, që Ismail Qemali u dërgoi me 28 nëntor 1912 qeverive të gjashtë Fuqive të Mëdha europiane, nuk gjetën jehonë në asnjërën prej tyre. Me përjashtim të Portës së Lartë, e cila u përgjigj drejtpërdrejt për të kundërshtuar shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane, të gjitha qeveritë e Europës e lanë në heshtje përpjekjen e Qeverisë së Përkohshme. Kështu Shqipëria nuk kishte siguruar akoma njohjen e një statusi ndërkombëtar. E megjithatë diplomacia europiane u ndal në mënyrë të veçantë dhe për një kohë të gjatë mbi çështjen shqiptare. Bile çështja shqiptare u vu në qendër të luftës diplomatike midis dy blloqeve të Fuqive të asaj kohe. Ndërsa ushtritë e Aleancës po depërtonin thellë në territoret e pjesës europiane të Perandorisë Osmane, duke i shkaktuar humbje të njëpasnjëshme, Fuqitë e Mëdha filluan përgatitjet intensive diplomatike për t'u përballur me gjendjen e krijuar në Ballkan. Gjatë këtyre përgatitjeve dalin në pah pozicionet fillestare të synimeve të çdonjërës nga Fuqitë e Mëdha. Ashtu si edhe më parë, tri ishin fuqitë më të interesuara në këtë çështje: Austro-Hungaria me Italinë nga "Aleanca Tripalëshe" dhe Rusia nga "Antanta Kordiale". Austro-Hungaria ndiqte me vazhdimësi koherente një politikë që synonte të luante një rol vendimtar në Gadishullin Ballkanik. Përveç kësaj, i ashtuquajturi orientim i Austrisë drejt Ballkanit i përgjigjej një nevoje të përcaktuar politike të evidentuar pas unifikimit të Italisë. Për Perandorinë habsburge nuk bëhej fjalë vetëm për humbje territoresh të rëndësishme nga ana strategjike, por mbi të gjitha për një ridimensionim të qëndrueshëm politik të funksionit të saj në Europë, funksion më se evident nëse merret parasysh roli që kanë luajtur në këto ngjarje Britania e Madhe dhe Franca. Në rrethanat e reja të krijuara nga shembja e sundimit turk në Ballkan, fati i mëtejshëm i Shqipërisë hynte në planet e reja të politikës së tyre ballkanike. Austro-Hungaria e mendonte Shqipërinë si një barrierë të ardhshme që do të pengonte shtrirjen e "sllavizmit" në gadishull dhe si një urë për synimet e saj në Egje. Në këtë kuadër Austro-Hungaria do të angazhohej për një Shqipëri autonome ose të pavarur, duke qartësuar qëndrimin e vet se asnjë pjesë e bregdetit shqiptar nuk do të lejonte të kalonte në duart e Serbisë. Në një telegram të dt. 7 nëntor 1912, për *Edward Greyn*-in, ambasadori anglez në Vjenë, *Cartwright* e përmbledh

me këto fjalë thelbin e synimeve të Austrisë: "Kur të bisedohet për kushtet e paqes, Austria do të formulojë kërkesat e veta… Kërkesat minimale të Austrisë do të jenë që Shqipëria të mbetet një shtet autonom ose i pavarur dhe asnjë pjesë e bregdetit të Adriatikut nuk do të mbahet nga Serbia. E dyta do t'i sigurohet Austrisë hekurudha drejt Selanikut dhe liria që ai port të sigurohet për Austrinë si e drejtë për tregtinë e saj; me fjalë të tjera, kjo hekurudhë drejt Selanikut të ndërkombëtarizohet"[6]

Roli i Austro-Hungarisë është paraqitur shpesh si faktori vendimtar në dobi të Pavarësisë Shqiptare. Nuk duhet harruar këtu se qoftë varianti i parë i autonomisë së Shqipërisë, qoftë ai i mëvonshmi i pavarësisë së saj nuk kanë qenë gjithmonë zgjidhjet e preferuara të diplomacisë vjeneze. Ato kanë hyrë në planet e politikës së jashtme të Monarkisë dualiste si variante të imponuara nga situata në eventualitetin e prishjes së Perandorisë Osmane. Ajo ka qenë e preokupuar për ta mbajtur lëvizjen kombëtare shqiptare brenda caqeve të një lëvizjeje paqësore me karakter kultural-arsimor.[7]

Ndërkaq, Italia e shikonte Shqipërinë në perspektivë, si "bregun e pestë", si pjesë të domosdoshme të Perandorisë së saj koloniale, krijimi i së cilës ishte bërë ideja fikse e borgjezisë italiane. Ajo angazhohej për një zgjidhje që do të mund të pajtonte synimet e Serbisë me parimin e një Shqipërie autonome. Në një telegram të *E. Grey* të nëntorit 1912 për ambasadorin anglez në Romë, *Rodd*-in lexojmë: "Pikëpamja italiane ishte se parimi i kombësisë kërkonte një Shqipëri autonome dhe se nuk mund të lejohej asnjë kërkesë serbe që ta pakësonte atë. Pasi të rregullohej kjo, dëshira themelore e Italisë për të ruajtur paqen ndërmjet Fuqive të Mëdha e shtynte atë të bashkonte gjithë forcat e saj dhe të Aleatëve të saj e të miqve për të gjetur një zgjidhje, që do të mund të pajtonte aspiratat e ligjshme të Serbisë me parimin e një Shqipërie autonome. Italia dëshironte një pavarësi të plotë, si politike edhe ekonomike të Serbisë…"[8] Këtu kishte një bazë të përbashkët midis dy fuqive aleate dhe mbi këtë bazë ato mundën të bënin për një kohë një front unik që e mbulonte deri diku rivalitetin midis tyre. Nga ana tjetër Rusia cariste kishte planet e saj. Ajo synonte shtrirjen e influencës së saj në Ballkan nëpërmjet zmadhimit të shteteve të reja, sidomos sllave. Prandaj ishte për një copëtim të ri e të plotë të tokave shqiptare dhe për ndarjen e tyre

[6] *BD, V. IX, P. II, d. nr. 146, pp. 110-111,* tek Muhamet Shatri "Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913, Tiranë 2012, fq. 81

[7] Shih për këtë Arben Puto "Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha", Tiranë 1978, fq. 22-24

[8] *BD, V.IX, P.II, d.nr.210, pp. 159-160,* Tek M. Shatri, Po aty.

midis shteteve fqinje. Këto tendenca të kundërta, që ballafaqoheshin prej kohe në prapaskenat diplomatike, tani dolën në sipërfaqe e u shfaqën me forcë të re pas shpërthimit të Luftës Ballkanike. Britania e Madhe, në quadrin e interesave të saj koloniale, ishte e pozicionuar për shembjen e Perandorisë Otomane. Njihen publikisht marrëveshjet e fshehta të nënshkruara mes Anglisë dhe Francës për shpërbërjen e Perandorisë. Nga disa relacione të diplomatëve anglezë të akredituar në Vjenë, Shën-Petersburg dhe në Beograd, del në pah qëndrimi i tyre ndaj disa aspekteve të problemit shqiptar. Ambasadori britanik në Vjenë e cilësonte Ismail Qemalin "kryetar të shqiptarëve", duke i bërë jehonë gatishmërisë së tyre për të luftuar deri tek i fundit në mbrojtje: "kundër atyre që do të përpiqeshin ta copëtonin dhe gllabëronin vendin e tyre".[9] Edhe ambasadori britanik në Shën-Petersburg e vinte në dijeni Londrën se "nga pikëpamja etnografike Serbia nuk kishte asnjë të drejtë të kërkonte ndonjë pjesë të Shqipërisë"[10]. Ai në këtë kuadër ishte i mendimit që Serbisë t'i jepej e drejta vetëm për një dalje ekonomike në bregdetin shqiptar. Kjo pikëpamje do të përbënte një platformë për harmonizimin e qëndrimeve të Fuqive të Mëdha. Nga ana tjetër, është për t'u vënë në dukje vlerësimi denigrues i përfaqësuesit britanik në Beograd ndaj shqiptarëve, të cilët i cilësonte si "turmë të paqeverisshme e turbulluese dhe si të papërshtatshëm për vetëqeverisje". Për më tepër, sipas tij, "një Shqipëri autonome kishte gjasa që të bëhej një burim trazirash për shkak të intrigave të Austrisë dhe të Italisë"[11]

Ndërkaq, qëndrimi zyrtar i diplomacisë britanike i sintetizuar nga ministri i jashtëm *Edward Grey*, konsistonte në "formimin e një Shqipërie autonome me madhësi të arsyeshme", më e madhe se një rrip toke në brigjet e Adriatikut[12], duke shpresuar se një zgjidhje e tillë do të mbështetej nga të gjitha Fuqitë, por me kusht që Austro-Hungaria të pranonte për t'ia lënë Serbisë Shëngjinin[13].

Problemi i hapësirës serbe në Adriatik përbën vetëm një prej aspekteve të një situate shumë komplekse që bota sllave, monarkia habsburge dhe Fuqitë e Mëdha janë të detyruara të përballojnë: bëhej fjalë për të ardhmen e Gadishullit Ballkanik, dhe indirekt për atë të

[9] *Tel. i Cartwright nga Vjena i dt. 10 nëntor 1912, BD, V.IX, P.II, d.nr. 173, pp. 130,* Po aty.
[10] *Tel. i Buchanan nga Sh. Petersburgu i dt. 8 nëntor 1912, BD, V.IX, P.II, d.nr.161, pp.119-120,* Po aty.
[11] *Letër e Paget dërguar nga Beogradi me 2 nëntor 1912*, *BD, V.IX, P.II, d.nr.104, pp.84-85,* Po aty.
[12] *Tel. i Grey nga Londra i dt. 3 dhjetor 1912*, *BD, V.IX, P.II, d.nr.320, pp. 238,* Po aty.
[13] *Tel. i Grey nga Londra i dt. 18 nëntor 1912, BD, V.IX, P.II, d.nr.224, pp.169*, Po aty.

Perandorisë Otomane. Siç kishte ndodhur shpesh në momentet e krizave të potencës turke, marrëdhëniet austro-ruse përmirësohen kur qeveria e Londrës është e prirur të ripohojë çangazhimin e saj në lidhje me një luftë jo të vetën, por duke iu frikësuar, me të drejtë, faktit se nuk mund të qëndrojë spektator i thjeshtë në një konflikt që mund të përfshinte një pjesë të madhe të Europës dhe do ta angazhonte në Mesdhe dhe Detin e Veriut, në një kohë kur flota e saj rezultonte më e dobët se ajo e Aleancës Tripalëshe (Gjermani, Austri e Itali). Kjo hasi në kundërshtimin e fortë të Austro-Hungarisë, e cila grumbulloi forca të mëdha në kufi me Serbinë, duke e kërcënuar këtë me shpërthimin e një lufte. Mirëpo prapa Serbisë qëndronte Rusia dhe operacioni ndëshkues, që mund të ndërmerrte Austro-Hungaria kundër forcave serbe, kishte rrezik të kthehej në një përplasje midis të mëdhenjve. Rreziku u ndje sidomos kur Gjermania deklaroi në fund të nëntorit se në rast të një sulmi kundër Austro-Hungarisë, ajo do të përmbushte detyrimet që rridhnin nga Aleanca Tripalëshe.[14]

Të shqetësuara se mos zhvillimet e Luftës Ballkanike çonin në prishjen e paqes europiane, në momentin më pak të dëshiruar prej tyre, Fuqitë nxituan t'i futnin në quadrin e "koncertit të të gjashtëve" edhe kontraditat në zonat e reja të influencës që do të ndaheshin midis tyre. Kështu, filluan të zhvilloheshin bisedime të fshehta midis kancelarive të mëdha për afrimin e pikëpamjeve dhe gjetjen e zgjidhjeve të pranueshme. Që në nëntor, me iniciativën e kryeministrit të Francës Puankare filloi të bënte rrugë ideja e thirrjes së një konference të 6 Fuqive të Mëdha që do të mblidhej në mbarim të luftës për të marrë vendimet përfundimtare. Pikërisht gjatë këtyre bisedimeve në prapaskenë u përcaktuan, në vijat më të përgjithshme, zgjidhjet e kompromisit me anë të lëshimeve reciproke. Kështu Rusia hoqi dorë nga projektet e saj për shpërndarjen e të gjithë tokave shqiptare midis aleatëve fitimtarë. Ajo pajtohej me idenë për krijimin e një province autonome shqiptare, nën suzerenitetin e sulltanit, me kusht që ajo të përfshinte sa më pak territor që të ishte e mundur në zonën bregdetare dhe të mos kishte shtrirje të gjërë në brendësi të Gadishullit. Në të njëjtën kohë kryediplomati rus, *Sazonov*, me arsyetimin se "shqiptarët nuk ishin homogjenë dhe të denjë për një shtet", vlerësonte se "kjo do të çonte në trazira të pafund"[15] Gjithnjë sipas tij, Italia dhe Austro-Hungaria ishin Fuqitë më të interesuara drejtpërdrejt për

[14] *Tel. i ambasadorit anglez në Romë Bertie me 26 nëntor 1912, BD, V.IX, P.II, d.nr.280, pp.206*, Po aty.
[15] *Tel. i Buchanan nga Petersburgu me 19 nëntor 1912, BD, V.IX, P.II, d.nr.235, pp.177,* Po aty.

Shqipërinë, ato mund të këshilloheshin së bashku për zgjidhjen sipas vijave të marrëveshjes së tyre të vitit 1904, por asnjëra prej tyre nuk duhej të krijonte asgjë në trajtën e një protektorati për vete.[16]

Edhe ambasadori rus në Paris, *Izvolski* "ishte i mendjes që të lihej Austro-Hungaria ta bëjë provë këtë eksperiment me një Shqipëri të "pavarur" ose "autonome". Por edhe ky diplomat "nuk besonte se do të ishte e mundshme të ngriheshin malsorët e egër e të paligj në një shtet autonom." Ai në këtë kuadër shtronte pyetjen: "Kush do t'i qeveriste, "Kush do t'i mbante nën kontroll?" Do të kishte trazira të vazhdueshme, por megjithatë "le të bëhet provë kjo gjë." Në fund ai tërhiqte vërejtjen se "Fuqitë do ta shihnin se ndërtimi i një shteti autonom shqiptar, është një arrë e fortë për ta thyer."[17]

Vëmendja e Italisë dhe e Austrisë spostohet nga lufta e Shteteve ballkanike kundër Perandorisë Osmane tek e ardhmja e Shqipërisë, duke pasur qëllime të përbashkëta, megjithëse me motivacione krejt të ndryshme. Nga ana e saj, Austro-Hungaria në çështjen e përcaktimit të fizionomisë politike të Shqipërisë u bashkua me kërkesën e Rusisë, të përkrahur aktivisht edhe nga Franca, për të krijuar jo një Shqipëri krejt të pavarur, por një shtet shqiptar me autonomi të brendshme.[18]

Një tjetër lëshim i Austro-Hungarisë kishte të bënte me caktimin e ardhshëm të kufijve të Shqipërisë dhe ai do të kishte pasoja të rëndësishme. Që nga fundi i tetorit në Vjenë po formohej bindja se bashkimi i gjithë krahinave të banuara prej shqiptarësh në shtetin e ri që do të krijohej nuk kishte mundësi realizimi në një kohë kur shihej qartë se në luftën kundër Turqisë Aleatët Ballkanikë do të korrnin fitore.[19]

Në pozita të njëjta qëndronte edhe Qeveria italiane. Qeveria e Romës jo vetëm që pranonte parimin e "kompensimit territorial" të domosdoshëm të fituesve, por parashikonte lëshime më të mëdha si në veri në dobi të Malit të Zi ashtu edhe në Verilindje në dobi të Serbisë. Aleanca midis shteteve ballkanike përbën një element të rrezikshëm për Trupat Osmane, që në tetor 1912 do t'i shpallte luftë Portës së Lartë. Kjo ishte një ngjarje që vendoste një hipotekë serioze mbi aspiratat e shqiptarëve. Shqiptarët do ta paguanin më shumë se kushdo tjetër

[16] *Po aty.*
[17] *Tel. i Bertie nga Parisi i dt. 27 nëntor 1912, BD, V.IX, P.II, d.nr.294, pp. 220,* M. Shatri, Vepër e cit.
[18] *Tel. i Grey për Goschen i dt. 28 tetor 1912, V.IX, P.II, d.nr.70, pp. 55-56,* M. Shatri, Vepër e cit. fq. 69
[19] Tel. i Cartwright për Grey me 26 tetor 1912, *V.IX, P.II, d.nr.64, pp. 52,* M. Shatri, Vepër e cit. fq. 66

humbjen e trupave osmane dhe një reduktim të pranisë së Perandorisë në Badishullin Ballkanik. Sigurisht që Perandoria nuk kishte marrë fund plotësisht por nxjerrja e saj nga Europa do të nxiste orekset e Serbisë, të Mali të Zi dhe të Greqisë mbi territoret e Shqipërisë, që nuk ka siguruar akoma statusin ndërkombëtar. Kjo konsideratë e thjeshtë por plotësisht reale, i ka shtyrë vazhdimisht krerët shqiptarë për t'iu kundërvënë projekteve të ndryshme për federatën ballkanike, pas përmbysjes së perandorive të mëdha shumëkombëshe. Shqiptarët janë krejtësisht të vetëdijshëm se përfaqësonin hallkën më të dobët në zinxhirin e shteteve ballkanike, që kanë filluar shumë më parë procesin e emancipimit kombëtar. Me fillimin e konfliktit ballkanik shqiptarët mbajnë një qëndrim të kujdesshëm asnjanës me ndonjë përpjekje të shkurtër kundër turqve si shenjë konkrete e dallimit nga trupat otomane. Por duhet theksuar se Lufta Ballkanike ka pasur një funksion përparimtar edhe për lëvizjen shqiptare. Ajo i bëri pa kuptim zgjidhjet e mëparshme gjysmake në trajtën e zgjerimit të të drejtave të pjesshme e të autonomis së brendshme. Pavarësisht se cilat ishin qëllimet e shteteve fqinje, ajo i sugjeroi asaj indirekt zgjidhje më radikale, i tregoi objektivisht rrugën e shkëputjes përfundimtare nga Turqia dhe të pavarësisë së plotë kombëtare. Ecuria e konfliktit i bindi udhëheqësit shqiptarë për të shpejtuar dhe me 28 nëntor 1912 Kuvendi Kombëtar, i mbledhur në Vlorë, nën kryesinë e Ismail Qemalit, shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Përmes këtij akti, formalisht të detyruar, synohej të shmangej që depërtimi i ushtarëve serbë, malazezë,e grekë në territorin shqiptar për të luftuar Osmanët të shndërrohej në një pushtim, prelud i një copëtimi territorial të vetë Shqipërisë. Ndryshe nga Aleatët ballkanikë, Rumania zyrtare shprehej për autonominë e Shqipërisë dhe kundër daljes së Serbisë në bregdetin shqiptar. Këtë qëndrim mbreti rumun, *Karoli I*, e arsyetonte me afrinë më të madhe të rumunëve me shqiptarët, sesa me popujt sllavë të Ballkanit. Ai e konkretizonte këtë me dëshirën që sa më shumë vlleh të përfshiheshin në shtetin shqiptar, në të cilin ata do të gëzonin më shumë se kudo të drejtat e tyre. Kjo edhe për faktin se në Rumani kishin mbërritur njoftime për përndjekjet e tmerrshme kundër kuco-vllehëve në krahinat e pushtuara prej grekëve.[20]

Diplomacia franceze ndërkohë u pozicionua në përkrahjen pa rezerva të qëndrimeve të shteteve ballkanike dhe të Rusisë lidhur me zgjidhjen e çështjes shqiptare. Parisi, përballë qëndrimit realist të Rumanisë për autonominë e Shqipërisë dhe nga frika se ajo do ta mbështeste Austro-

[20] *Tel. i Barclay për Grey me 6 dhjetor 1912, BD, V.IX, d.nr.342, pp.254,* Tek M. Shatri, Vep. e cit. fq.151

Hungarinë për çështjen shqiptare, doli haptazi kundër pjesëmarrjes së këtij shteti në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.[21]

Mbi këto baza midis palëve kryesore të interesuara në çështjen shqiptare u arrit një marrrëveshje në fazën e kontakteve paraprake; kjo ana e saj hapi rrugën për përçapje diplomatike të kombinuara të Fuqive të Mëdha pranë Aleatëve Ballkanikë. Tani jo vetëm Austro-Hungaria dhe aleatët e saj të Lidhjes Tripalëshe, por edhe Rusia me Fuqitë e tjera të Antantës filluan të bënin presione mbi shtetet ballkanike me qëllim që këto të rishikonin kërkesat e tyre. Deshën, s'deshën Aleatët ballkanikë pranuan më në fund ndërmjetësimin e Fuqive në traktativat me Turqinë dhe arbitrazhin e tyre në çështjen e caktimit të kufijve. Planet për copëtimin e plotë të Shqipërisë u lanë. Gjetja e një platforme pak a shumë të bashkërenduar për çështjen shqiptare në kontaktet paraprake bëri të mundur edhe marrëveshjen e gjashtë Fuqive për mbledhjen e përfaqësuesve të tyre në Londër.

LITERATURA

M. Shatri "Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913" Tiranë 1912.

A. Puto, "Pavarësia shqiptare dhe diplomazia e Fuqive të Mëdha 1912-1914" Tiranë 1978.

F. D'Amoja*, Declino e prima crisi dell'Europa di Versailles. Studio sulla diplomazia italiana ed europea (1931-1933),* Milano 1967.

P. Pastorelli, *Italia e Albania 1924-1927. Origini diplomatiche del trattato di Tirana del 27 settembre 1927,* Firenze 1967.

A. Biagini, *Momenti di storia balcanica (1878-1914). Aspetti militari,* Roma 1981.

F. Gaeta*, Democrazie e totalitarismi dalla prima alla seconda guerra mondiale,* Bologna 1982.

A. Biagini, *L'Italia e le guerre balcaniche,* Roma 1990.

M. Dogo*, Kosovo. Albanesi e serbi: le radici del conflitto,* Lungro di Cosenza 1992.

L. V. Ferraris*, Diario di una missione a Tirana,* in "Albania emergenza italiana", quaderno speciale di "LiMes. Rivista italiana di geopolitica", supplemento al n.1, 1997.

[21] *Tel. i Grey për Cartwright me 9 dhjetor 1912, BD, V.IX, d.nr.364,* Po aty, fq. 156

Prof. dr. Xheladin SHALA

KONFERENCA E AMBASADORËVE MË 1913 E NDAU POPULLIN SHQIPTAR

(*Me rastin e 100 vjetorit të Konferencës në Londër 1913-2013*)

Edhe pse u dha deklarata e përbashkët e Austro-Hungarisë dhe Rusisë në javën e parë të tetorit 1912, kinse për ruajtjen e "status quos" në Ballkan, Lufta Ballkanike për 15-20 ditë e ndërroi gjendjen, duke u vërejtur se sundimi i Perandorisë Osmane, në pjesën evropiane, kishte marrë fund. Nuk flitej më për status quon, por për realitetin e ri.

Shqiptarët bënë përpjekje për të mos u përfshirë në "vallen e lojërave diplomatike", megjithatë me fillimin e luftës u ndodhën në një situatë të vështirë nga kombinimet e ndryshme politike, meqë ishin lidhur marrëveshje sekrete antishqiptare. Në muajin tetor u paraqit rreziku i ri dhe i kobshëm për popullin tonë. Kështu, krahas sukseseve të Aleancës Ballkanike, u zhvillua edhe tragjedia e Shqipërisë. Andaj, forca e armëve të katër shteteve pushtuese ballkanike, të ndihmuara në mënyrë të organizuar e komplotiste nga Rusia, Franca dhe Anglia, i hodhi në plan të dytë kërkesat e ligjshme të shqiptarëve. Një hije e rëndë i pllakosi pothuajse të gjitha territoret e katër vilajeteve shqiptare gjatë muajve tetor-nëntor të vitit 1912, duke u pushtuar e masakruar pa mëshirë nga ushtritë e Aleancës Ballkanike. Pra, Lufta e Parë Ballkanike ishte **de jure** kundër Perandorisë Osmane, por **de facto** ishte luftë shfarosëse kundër kombit shqiptar.

Edhe pse më 3 dhjetor 1912 Perandoria Osmane u mund dhe kërkoi armëpushim, operacionet e ushtrive ballkanike i vazhdonin ekspeditat ndëshkuese për shfarosjen e përgjithshme të popullit shqiptar. Njeriu nuk mund ta marrë me mend se si rrokulliseshin ngjarjet historike të atyre muajve. Shqiptarët nuk u shqetësuan vetëm nga depërtimi i thellë i ushtrive të Aleancës Ballkanike në tokat shqiptare, por edhe nga deklaratat e Fuqive të Mëdha evropiane pas atyre ngjarjeve të stuhishme, meqë në fund të tetorit 1912 pamundësinë për ta ruajtur status quo-n në Ballkan e deklaruan Franca, Rusia dhe Anglia. Qëllimi i pushtuesve të tokave shqiptare ishte më se i qartë; të zihen pozitat e forta në terren për të grabitur sa më shumë territore të huaja.

Kështu që, pas asaj lufte të tmerrshme ballkanike rezultoi mbajtja e Konferencës së ambasadorëve në Londër nga 17 dhjetori 1912 deri më 12 gusht 1913, ku u bë shkelja më e paskrupulltë e të drejtave njerëzore e

kombëtare të shqiptarëve, nëpërmjet propozimeve të projekt-hartave për copëtimin dhe ndarjen e territoreve dhe popullit shqiptar.

Në mbledhjet e Konferencës së ambasadorëve "i pari dhe më i rëndësishmi midis këtyre problemeve është ai i Shqipërisë. Andaj – çështja shqiptare përbën, në të vërtetë, pikën qëndrore të të gjithë gjendjes… në rast se do të falimentonin marrëveshjet mbi çështjen shqiptare, kriza ballkanike do të bëhej krizë e Evropës. Gjithë çështja shqiptare qëndron në përcaktimin e kufijve të shtetit të ri".[22]

Në dy seksionet e caktuara në Konferencën e Londrës, mblidheshin veç e veç, ambasadorët e gjashtë fuqive, në një anë, delegatët osmanë dhe ata ballkanikë, në anën tjetër. Një komb i vetëm, do të thotë Shqipëria, nuk ka përfaqësues të njohur pranë Konferencës së Londrës.[23] Shqiptarët edhe kësaj radhe nuk ishin të ftuar, prandaj ajo do të shkaktojë në të ardhmen një kundërshtim të ligjshëm shqiptar.

Pra, as në Kongresin e Berlinit 13 qershor – 13 korrik 1878, as në Konferencën e ambasadorëve në Londër 17 dhjetor 1912 – 12 gusht 1913, nuk është pyetur fare populli shqiptar dhe është fakt që u nxorrën në ankand. Që nga fillimi i thirrjes dhe mbajtjes së mbledhjes së Konferencës së Ambasadorëve në Londër e deri në fund mbretëroi fryma e njëjtë e drejtuesve, ashtu sikur që është drejtuar Kongresi i Berlinit, do të thotë të pakësohet në minimum toka e Perandorisë Osmane në Ballkan – përkatësisht zvogëlimin e territoreve etnike shqiptare në këtë Gadishull, duke i rritur dhe zmadhuar në maksimum me territore të huaja të katër shtetet e Ballkanit, të cilat përkraheshin fuqishëm nga Rusia, Franca dhe Anglia, me çka do t'iu shërbenin atyre për gjeostrategjinë evropiane. E njohën vetëm një copë të Shqipërisë që do të luajnë shumë lojëra të ndyera dhe kishin qëndrim negativë ndaj saj.[24]

Kështu, në Gadishullin e Ballkanit – përkatësisht Ilirisë, është fiksuar viktima kryesore – shqiptarët, ku vërtet do ta kenë vështirë me të gjithë: me fuqitë evropiane, me osmanët, e sidomos me katër shtetet ballkanike.[25] Në këto dy tubime, ku u bë njëherë copëtimi dhe pastaj përgjysmimi i Shqipërisë, nuk ishin pjesëmarrës Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prej nga me të drejtë lind interesimi dhe legjitimiteti i saj që - të përmirësohen gabimet e fuqive tjera ndaj popullit shqiptar.

---

[22] AQSH. Vj. 23-40-3968, Gazeta italiane "Messaggero" e datës 10 shkurt 1913, shkruar nga Leonida Bisolati

[23] AQSH. Vj. 23-36-3680, Letër e dërguar më 29 janar 1913 ministrit të Jashtëm Berhtoldit

[24] Prof. Mehmet Vokshi, Shqipnija e shqiptarvet, Prishtinë 2001, 21

[25] Jusuf Buxhovi, Kongresi i Berlinit 1878, Prishtinë 2008, 44

Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, për kufijtë perëndimor, verior dhe lindor të Shqipërisë caktohet Austro-Hungaria, ndërsa për në jug dhe perëndim Italia, të cilat nuk i mbrojtën si duhet të drejtat legjitime të shqiptarëve, por i shikuan më tepër interesat e tyre. Vet projekti austro-hungarez largohej nga parimi etnik në dëm të popullit shqiptar, sidomos në veri dhe në lindje të Shqipërisë – Vilajeti i Kosovës.

Copëtimi dhe përgjysmimi i Shqipërisë ishte vënë në rend të ditës, gjë që u kuptua qysh në fillim. Gjatë atyre pazarllëqeve që bëheshin në kurriz të territoreve shqiptare, vet ***Berhtoldi***, ministër i Jashtëm austro-hungarez, u deklaroi përfaqësuesve serbo-malazez: "Ka mjaft për të gjithë". Gjithashtu, përfaqësuesit gjerman dhe italian deklaruan: "Për Austro-Hungarinë ishte me rëndësi që ta ruante detin Adriatik dhe për këtë kishte të drejtë, e për çështje të tjera do të jetë më dorëlirë".[26] Mirëpo, Austro-Hungaria, për të mos pësuar fijasko – politika e saj e jashtme, qëllim kryesor pas fillimit të Luftës Ballkanike, sa i përket çështjes shqiptare, kishte: mospranim për dalje tokësore të Serbisë në Adriatik ishte një nga pikat kryesore të politikës së saj; kufijtë e Shqipërisë do të përbënin pikën e dytë. [27] Edhe asokohe është thënë: "do të jetë e parealizueshme dëshira për t'a zgjidhur njëherë e mirë problemin e Ballkanit, në qoftë se toka shqiptare do bien në duar të huaja." [28]

Duhet theksuar se Serbia në prag të mbajtjes së Konferencës së Londrës nuk la gur pa luajtur, duke zhvilluar aktivitet në të gjitha qendrat më relevante evropiane me qëllim për ti bindur se formimi i shtetit shqiptar nuk ishte aspak në favor të shteteve ballkanike, duke u përpjekur që ti bindnin edhe të gjitha Fuqitë e Mëdha evropiane. Mirëpo, që në fillim shihej se propaganda dhe gënjeshtrat serbe nuk do arrinin sukses të plotë, por qëndrimi dhe mashtrimet serbo-ruse do të ndikojnë që të formohet një shtet gjysmak.

Kështu, përfaqësuesi serb në Vjenë, *Simiq*, në një letër dërguar në Beograd para mbledhjes së Konferencës së Londrës shkruan: "Në bisedë në mes përfaqësuesit rus, italian, grek dhe bullgar, krijova përshtypjen se Vjena nuk ishte dakort për copëtimin dhe ndarjen e të gjitha tokave shqiptare. Për këtë qëllim ne duhet të kënaqemi hëpërhë me "Serbinë e vjetër" (Kosovën dhe Maqedoninë, Xh.Sh.). Ndërkaq, Shqipërinë (e buzëdetit, Xh.Sh.) ta lëmë për ndonjë rast tjetër". [29]

---

[26] DASSIP – PO 1912, fasc.II, dos. IV, br. 4864

[27] Rajmond Poenkare, Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913), Prishtinë, Tiranë, Shkup 2006, 446

[28] AQSH. Vj. 22-25-256, nr.4280

[29] Dokumenti o spolnoj politici kralevine Srbije 1903-1914, Kniga V; Letër dërguar Pashiqit në Beograd 29-XI-1912

Konferenca e ambasadorëve në Londër nuk e pranoi si bazë për zgjidhjen e çështjes së kufijve të Shqipërisë parimin etnik, qoftë edhe në trajtën gjysmake, që e mori ai në propozimin e Austro-Hungarisë.[30] Ndërkaq, propozimet për vijën kufitare nga ana e Rusisë dhe aleatëve të saj ballkanikë, parashtruan cungim absurd – do të thotë katastrofal për Shqipërinë – gjë që ishte zhbërje e popullit dhe shtetit shqiptar që në zanafillë. Dallimet midis vijave kufitare të propozuara lidhur me kufijtë e Shqipërisë ishin të mëdha e absurde dhe ato thellësisht dalloheshin midis Qeverisë së Përkohshme të Vlorës e aleatëve ballkanikë, si dhe midis Austro-Hungarisë me aleatët ballkanikë dhe atë të Rusisë. Cungimi më i rëndë, me të cilin bëhej shpartallimi i Shqipërisë, ishte nga shtetet ballkanike që ishin afër me propozimin rus që përkraheshin nga Franca dhe Anglia. Andaj, ato propozime të paraqitura në tavolinën e Konferencës së Ambasadorëve në Londër lanë sherre të mëdha deri në ditët e sotme edhe pas 100 vjetësh.

Serbia, Mali i Zi dhe Rusia, që në themelet e politikës së tyre i kishin synimet ekspansioniste, projektuan plane ogurzeza, duke kërkuar 80% të territorit shqiptar në Ballkan, arritën ta gllabërojnë më tepër se gjysmën e Shqipërisë etnike – do të thotë mbi 50% të tokave shqiptare. Ata deklaronin haptas: "*Ne kombi serb jemi një rrezik për Evropën. Ne kemi gjithë ushtrinë ruse me vete dhe do marrim atë që do na pëlqej*".[31] Pra, kishte veprime të koordinuara pansllaviste dhe vërtet kanë marrë krejt atë që ua ka dashur shpirti i tyre i zi.

Ndërkaq, delegacioni "zemërgjerë", naiv e i shurdhër shqiptar, nuk i përfshiu në kërkesat e veta legjitime as tokat që ishin me shekuj shqiptare si: Tivarin, Ulqinin, Podgoricën, Sanxhakun e Jeni Pazarit, Sanxhakun e Nishit, që diplomati i mirënjohur Faik Konica dhe shumë mendimtarë tjerë i quanin Shqipëri Veriore, si dhe në jug - Gjirin e Artës. Duhet theksuar edhe fakti se nga Kosova nuk ishte përfshirë asnjë anëtarë në delegacionin për në Konferencën e Londrës. Andaj, ai delegacion ishte gjysmak, si një melodi e këputur, e lënë përgjysmë, pasi dihej historikisht se Kosova ishte territori më i kërcënuar nga armiqtë shekullorë sllavë, por njëkohësisht ishte edhe territori më rezistues për pushtuesit verior. Kur dihej edhe se në këtë hapësirë populli shqiptar përbënte grupim etnik kompakt dhe të një rëndësie të veçantë, sepse zinte udhëkryqin e Ballkanit.

[30] Historia e popullit shqiptar III, Tiranë 2007, 22; Dr.Xheladin Shala, Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918, Prishtinë 1989, 125

[31] Edith Durham, Njëzet vjet ngatërresa ballkanike, Tiranë 2001, 267

Kosova këmbënguli që të përfshihej brenda shtetit shqiptar, ku e meritonte të mbetej dhe ku e kishte vendin në aspektin historik e gjeografik. Mirëpo, ndaj Kosovës u bë një lojë e ndyrë, e pabesë, e mashtrimit dhe e tradhtisë, duke ia futur këmbët në prush të ndezur rreth një shekull. Një gjë ishte e vërtetë, diskutimet që u zhvilluan në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dhe shkresat që u sollën aty, ishin së tepërmi larg kërkesave reale të popullit shqiptar, i cili dëgjonte pak lajme dhe shikonte me dëshpërim si zhvilloheshin ngjarjet rreth këtij problemi jetik për popullin tonë, të cilët u izoluan tërësisht pas ndarjes së popullit shqiptar në dysh. Me fjalë tjera, asokohe u përjetuan padrejtësi të mëdha dhe zhgënjime tepër të hidhura.

Përfaqësuesit e Qeverisë së Vlorës në muajt e parë të vitit 1913 në *Forein Offisse* deklaruan: "Qëllimi i këtyre rregullimeve territoriale, që po bëhen tani, duhej të ishte vendosja e një paqeje të qëndrueshme, mirëpo mënyra se si po zgjidhej çështja shqiptare nuk mund të siguronte asnjë lloj paqeje… dhe se e gjithë kjo nuk mund të përfundonte, veç se me një armiqësi të vazhdueshme".[32] Në një rast tjetër delegatët e Qeverisë së Vlorës deklaruan: "Çështja e Shqipërisë po vendosej pa përfillur fare shqiptarët dhe se kufijtë e vendit të tyre po caktoheshin vetëm sa për të ndaluar një prishje midis Austro-Hungarisë dhe Rusisë. Gjithnjë sipas delegatëve, por edhe realisht ishte se - shqiptarët e Shqipërisë së njohur të pavarur asokohe do të vuanin për bukë (meqë ajo ishte një ndër strategjitë e politikës serbomadhe), sepse po u hiqeshin të gjitha mjetet e jetesës, pasi që e gjithë pjesa e tokës pjellore e atdheut po u caktohej Aleatëve ballkanikë dhe kështu ata do të detyroheshin të sulmonin fqinjët e tyre, ndërsa ajo shumicë e tyre që do të kalonte nën serbo-malazezët dhe grekët nuk do t'i nënshtroheshin kurrë zgjedhës që u imponohej, prandaj do të rronin në gjendje të përhershme kryengritjeje".[33]

Nga disa krerë të njohur të Shkodrës me rrethinë, i dërgohet telegram *Berhtoldit* në Vjenë më 25 janar 1913: "Në Shtetin shqiptar të hynë të gjitha ato territore të cilat për arsye etnike, gjeografike dhe historike janë tërësisht shqiptare, ndër të cilat pjesë shumë të rëndësishme janë: Shkodra, Ipeku, Mitrovica, Gjakova, Prizreni, Shkupi, Tetova, Prishtina, Dibra, Manastiri, Ohri dhe Janina, për të cilat kanë pretendime të pa

[32] Arben Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914, Tiranë 1978, 348

[33] Muhamet Shatri, Dokumentet britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Londrës 1912-1913; Çështja shqiptare në Konferencat dhe Kongreset ndërkombëtare, Albanologji 2, Prishtinë 2011, 618

bazuara shtetet ballkanike, sepse këto janë territore të njohura si tërësisht shqiptare… vetëm kështu do të arrihet ekuilibri evropian dhe paqa e qëndrueshme, përndryshe, duke na shkëputur vetëm njërën nga këto treva, nuk do të ketë tjetër veçse ç'rregullime të përhershme dhe gjakderdhje". [34]

Gjatë muajve shkurt dhe mars 1913 u zhvilluan edhe disa polemika të ashpra, duke u rritur tensioni sidomos ndërmjet Rusisë dhe Austro-Hungarisë. Bëhej fjalë shumë për Shkodrën, për qytetet e Rrafshit të Dukagjinit si të Pejës, Gjakovës, Prizrenit dhe për Dibrën me kërcënime të ndërsjella, gjë që shkaktoi edhe mobilizimin e ushtrive. Pra, përmenden vetëm qytetet të Rrafshit të Dukagjinit që ishin qytete të mesit të Shqipërisë – në jug të saj ishte shteti i pavarur, ndërsa në veri-lindje gjysma e Shqipërisë së robëruar. Fare nuk përmenden krahinat e pastra qind për qind shqiptare si: Peshteri, Drenica, Llapusha, Llapi, Gallaku dhe krahinat shumicë absolute me mbi 90% shqiptarë – Rrafshi i Kosovës, Pollogu etj., si dhe qytetet shqiptare: Mitrovica, Vushtrria, Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Presheva, Bujanoci, Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Kërçova, Struga, Ohri, Manastiri e shumë qytete e krahina tjera shqiptare. Asnjë krahinë apo qytet i Vilajetit të Kosovës nuk ishte me shumicë serbe, prandaj Lufta e Parë Ballkanike ishte thjeshtë pushtim klasik i tokave shqiptare.

Lidhur me kufijtë shqiptar, mbisundonte mendimi se ekzistonte rreziku i luftës në Evropë dhe mund të thuhet se as Lufta Italo-osmane, as Lufta e Parë Ballkanike nuk patën jehonë aq të madhe te fuqitë evropiane sa kufiri shqiptaro-shqiptar, pasi që Rusia ngulte këmbë për zvogëlimin sa më shumë të kufijve të Shqipërisë, duke shtruar kërkesa për Serbinë sikur të ishte fjala për kufijtë e vet. Ajo ishte dhe mbeti gjithnjë përkrahëse e simpatizuese tradicionale e sllavo-ortodoksëve të Ballkanit. Për t'i arritur qëllimet e tyre pushtuese, Serbia dhe Rusia para botës paraqitnin gënjeshtra dhe intriga kundër shqiptarëve. "Vetëm për disa serb në një krahinë ato bënin be se, e tërë krahina është sllave".[35] Serbët guxojnë t'i thonë Shqipërisë Veri-Lindore, "Serbi e vjetër" – atij vendi ku ndodhen: Peja, Prizreni, Gjakova - do të thotë zemra e Shqipërisë. Por, ne kemi të drejtë t'i thonim Sanxhakut të Nishit – Shqipëri e vjetër.[36] Për *Qeverinë e Pashiqit* "argumentet" lidhur me pretendimet e territoreve ndodheshin në "kishat", "manastiret", shkollat serbe, mahallat serbe dhe, natyrisht, bazoheshin në forcën e armëve. Ndërkaq, nuk dëshironin të

[34] AQSH. Vj.23-36-3682
[35] Edith Durham, Njëzet vjet ngatërresa ballkanike, Tiranë 1944, 106
[36] Faik Konica – Jeta dhe vepra, Prishtinë 1997, 150; Gazeta "Albania", 6/1898, 103

dëgjonin dhe ishin tepër alergjik kur përmendeshin komisionet e përziera pa paragjykime, plebishiti etj. Andaj, themelet e argumenteve në të cilat bazoheshin qeveritë sllavo-ortodokse ishin të parëndësishme dhe të pathemelta. Serbët kanë ndërtuar disa kisha, shumë pak në numër, por turqit kanë ngrehë ndër këto vende disa qindra xhamia, nëse do të thirreshim në objekte fetare. Andaj, si bëhet që për pretendime boshe, për disa kisha të vjetra të flijohen qindra mijëra shqiptar, pothuaj rreth një milion. Pastaj shqiptarët e Kosovës kanë marrë pjesë në disa dhjetëra kryengritje (54) kundër sundimit otoman. Ndërkaq, serbët e Kosovës kurrë nuk kanë marrë pjesë në asnjë mënyrë në kryengritje kundër turqve, pasi që ishin në pakicë dhe nuk ishin të zotët për asnjë veprimtari në këtë kuptim. Nuk ka emërtim "kryengritje serbe në Kosovë" deri më 1912.[37]

Me vendimet nga seanca e 22 marsit 1913 iu dha vulë një akti të shëmtuar, sipas të cilit, territoret më të vlefshme të Shqipërisë së Sipërme apo Shqipërisë Veri-Lindore u shkëputën nga trungu etnik shqiptar, pa të cilat, viabiliteti i shtetit të ri shqiptar dëmtohej shumë ndjeshëm në çdo aspekt. Kështu, rezoluta që u aprovua në mbledhjen e 22 marsit, u ratifikua nga Fuqitë e Mëdha më 26 mars 1913. Po atë ditë, më 26 mars, delegatët shqiptar, *Mehmet Konica* dhe *Filip Noga*, ia shprehën *Forein Offissit* shqetësimin e tyre të thellë dhe pikëpamjen shqiptare lidhur me vendimet e padrejta të Konferencës së Londrës nga seanca e 22 marsit. Pra, popujt që nuk i takonin Fuqive të Mëdha ishin në mëshirën e të mëdhenjve, atëherë drejtësia me rastin e diskutimit dhe caktimit të kufijve të Shqipërisë në Konferencën e ambasadorëve në Londër, ishte nocion abstrakt.[38]

Pra, çështja më e ndjeshme ishte çështja e kufijve shqiptar, sidomos për territorin e Vilajetit të Kosovës dhe një pjesë të madhe edhe për atë të Manastirit e Janinës, duke u bërë zgjidhje pa pjesëmarrje dhe kundër vullnetit të popullit shqiptar. Një nga bazat e strategjisë serbe kundër shqiptarëve ka qenë feja e tyre, të sigurtë se Evropa e krishterë, gjithsesi do të merrte anën e serbëve ortodoksë kundër shqiptarëve myslimanë. Serbët bënë çmos që ngjyrimi mysliman i shqiptarëve të theksohej sa më fortë. Mjaftonte që Evropa të bindej se shqiptarët ishin myslimanë të vërtetë e fundamentalistë, me qëllim që ajo t'i linte ata në mëshirën e shpatës serbe.[39] Dhe, vërtet propaganda dhe gënjeshtrat serbe ia arritën qëllimit, meqë asnjëra prej gjashtë Fuqive të Mëdha evropiane fare, madje aspak nuk u interesuan për tërë Vilajetin e Kosovës me 32.900

[37] AQSH. Fondi: 446, dos. 27, fq. 19-20
[38] Gazmend Rizaj, Shqipëria e Sipërme 1800-1913, Prishtinë 2011, 395
[39] Ismail Kadare, Ra ky mort e u pamë, Tiranë 2000, 213

km², të cilin ia lëshuan si në pjatë Serbisë, pse jetonin rreth 98% shqiptarë myslimanë. Në një Promemorie të mëvonshme të *Bedri Pejanit*, shkruan se Konferenca e Ambasadorëve në Londër ishte kryevepër turpi, meqë Kosova ishte pjesë përbërëse e atdheut shqiptar qysh nga koha parahistorike. Pastaj, shqiptarët dolën fitues ndaj xhonturqve në gusht të vitit 1912 kur e çliruan Shkupin me një ushtri revolucionare prej disa dhjetëra mijëra vetësh, madje duke ia diktuar kërkesat Portës së Lartë. Pra, shqiptarët derdhën lumenj gjaku për Kosovën dhe se Shqipëria nuk ka për të hequr dorë kurrë nga Çamëria dhe Kosova, duke kërkuar gjithnjë ti kthehen mëmëdheut, përfundonte pikëpamjet e veta Bedri Pejani.[40]

Fitohet përshtypja se populli shqiptar i Vilajetit të Kosovës ishte një popull i tepërt në këtë botë.[41] Andaj, me të drejtë është konstatuar: Në konferencën e Londrës kanë pësuar disfatë tragjike parimi etnik, mbi të cilin janë krijuar shtetet kombëtare evropiane dhe parimi i vetëvendosjes që ishte i pandashëm prej tij. Në të vërtetë, në Konferencën e Londrës, nuk janë përfillur kurrfarë parimesh, kurrfarë normash dhe kurrfarë ligjesh, pos atyre të interesit, të aleancës dhe të fuqisë. Aty, natyrisht konstatohet drejtë se, jo për herë të parë, dhe jo për herë të fundit, është parë se sa tragjike është të jesh i vogël dhe i vetmuar.[42] Pra, argumentet e paraqitura të shqiptarëve, në Konferencën e Londrës kishin një të metë të madhe, që i dobësonte shumë: ishin argumente të një populli jetim, që nuk bënte pjesë në familjet e mëdha të popujve gjermanë, latinë apo sllavë, të një populli pas të cilit nuk qëndronte vendosmërisht asnjë shtet i madh evropian.[43]

Thënë shkurt, diplomacia e Fuqive Evropiane e shkeli me dy këmbë popullin shqiptar në formën më tragjike më 1878 dhe 1913, duke e lejuar ushtrinë serbo-malazezo-greke, të ndihmuar në mënyrë të veçantë nga rusët dhe francezët, me qëllim që ta shkretërojnë dhe djegin çdo cep të tokës shqiptare, e cila ishte edhe ashtu e shkatërruar dhe ende tymonte nga ekspeditat e ushtrisë së Turgut Pashës.[44]

Pra, kufijtë e papritur dhe të papërligjur të cilët ia mveshi Shqipërisë, Konferenca e Londrës, ishin mbase më 1913 një flijim, duke i ngopur sllavët me toka shqiptare. Me atë e dobësuan në çdo pikëpamje Shqipërinë, gjë që mbollën farën e trazirave të pareshtura në Ballkan, për

[40] AQSH, Fondi 846, dos.4, dok.708138; po aty, dos.16, dok.708807
[41] Po aty, 220
[42] Rexhep Qosja, Çështja shqiptare, Prishtinë 1994, 114
[43] Po aty, 101
[44] Prof.dr.Hakif Bajrami, Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912, Prishtinë 2003, 214

arsyen e thjeshtë se, këta kufij u vendosën mespërmes zemrës së popullit shqiptar.[45]

Është fakt i vërtet se Fuqitë e Mëdha evropiane jashtë shtetit të njohur shqiptar në Konferencën e ambasadorëve në Londër më 1913, i la rreth 2/3 e territoreve të banuara nga shqiptarët në trevat e Ballkanit Perëndimor e Qendror. Prandaj, si në asnjë rast tjetër, në hartën politike të Evropës një shtet u gjend i rrethuar nga populli që është i njëllojtë me atë të shtetit amë.

Edhe sot pas 100 vitesh, gjendja është e tillë që më tepër se 7 milion shqiptar jetojnë në 4-5 shtete. Ajo ishte fryt i ndërhyrjes dhe ekspansionit të shovinistëve fqinjë, intrigave dhe përcaktimit alogjik të kufijve të Ballkanit nga metropolet evropiane. Mirëpo, duhet pranuar se kjo gjendje, ishte edhe fryt i paaftësisë të udhëheqjes politike shqiptare për të artikuluar dhe mbrojtur interesat jetike kombëtare me të gjitha format e luftës politike, ushtarake, kulturore dhe diplomatike. [46]

Me këtë rast duhet potencuar se, prej katër kryeqendrave të vilajeteve shqiptare – brenda shtetit të pranuar shqiptar në Konferencën e Londrës të vitit 1913, mbeti vetëm *Shkodra*. Ndërkaq, *Shkupi, Manastiri* dhe *Janina* mbetën jashtë Shqipërisë edhe pas 100 vitesh. S'do mend që edhe ajo e ka simbolikën e vet se, vetëm një e treta e territorit dhe popullit shqiptar u njoh si shtet i pavarur. Me politikat dhe diplomacitë e tilla të shqiptarëve, si dhe me ato konstruksione ndërkombëtare (Shën-Stefan, Kongresi i Berlinit, Konferenca e Londrës etj.), shqiptarët jo vetëm që i humbën territoret e tyre në Sanxhakun e Nishit, në Maqedoninë përreth Vardarit, në Sanxhakun e Jeni-Pazarit, të Tivarit dhe Plavë-Gucisë, apo në Çamëri dhe jugu i Shqipërisë, por pësuan tragjedi të mëdha të dëbimit masiv të papërshkrueshëm. Njohësi i mirë i rrethanave ballkanike të viteve 1912-1913, bashkëkohësi nga Gjermania, *Desiderius von Szegh*, lidhur me çështjen e caktimit të kufijve të Shqipërisë rezononte: "Caktimi i kufijve mund të jetë i drejtë vetëm atëherë kur ai të bëhet mbi baza etnografike. Vetëm kjo ofron parimin që Ballkani të jetë pronë e popujve të Ballkanit, vetëm ai siguron rezultatin aq të rëndësishëm për mbarë Evropën që në Gadishullin Ballkanik më në fund të mbretërojë paqja".[47] Një gjë është e saktë se po të respektohej parimi etnik, diskutimi i kësaj çështjeje do të zgjaste shkurt, brenda disa javëve, e jo ashtu si zgjati rreth 8 muaj diskutimi për kufirin shqiptar. Në Konferencën e ambasadorëve

[45] Eqrem Bej Vlora, Kujtime 1885-1925, Tiranë 2003, 340-341
[46] Çështja Çame dhe integrimi evropian, Konferenca shkencore 2004, Tiranë 2005, 88-89; AQSH, Fondi 446, dos.31, fasc.6, nr.708853
[47] Gazmend Rizaj, Shqipëria e Sipërme 1800-1913, Prishtinë 2011, 345

në Londër, nuk munguan intrigat, shpifjet, akuzat dhe konstatimet e fqinjëve tanë, armiq të betuar të kombit tonë. Gjithsesi, në mbledhjet e Konferencës "nuk munguan as favoret e zotërinjve ambasador për secilin prej katër shteteve ballkanike më vete, sipas interesave "personale" të shteteve që përfaqësonin, do të thotë aty u bë një pazar matrapazësh, nga ku u rrëmbye sa i lejoi zotësia, dhelpëria dhe fuqia e çdo "diplomati" më vete".[48]

Padyshim, është një fakt i pamohueshëm se lidhur me kufijtë shqiptar, është me vend e qëndrueshme kritika, sidomos në adresë të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, e cila ka mundur të ishte shumë më e zëshme për ta kundërshtuar lënien e territoreve aq të rëndësishme shqiptare jashtë diskutimit në Konferencën e ambasadorëve në Londër. [49]

Nga historianët tanë do të konstatohet drejtë se ata kufij tragjik, Konferenca e ambasadorëve në Londër, me insistimin dhe këmbëngulësinë e Rusisë i pranoi pa qenë të tillë kurrë në histori. Serbia dhe Mali i Zi me ndihmën ruse e aleatëve të saj i krijuan kufijtë kolonial me krime të papara mbi shqiptarët. Ajo ishte vërtet plaga më e rëndë që edhe sot e kësaj dite kullon trishtueshëm.[50]

Shqipëria në verë të vitit 1913 u krijua, por mbeti e plagosur rëndë. U formua vetëm Shqipëria bregdetare, apo e buzëdetit, duke mbetur jashtë atdheut pjesa më e madhe kontinentale e tokave tona etnike, pjesa më e pasur dhe më e bukur e saj, e cila rreth një shekull mbeti e zhytur në terrin e robërisë sllave. Këta kufij deri në fillim të shekullit XXI notuan në gjak. Kështu që, Konferenca e ambasadorëve prodhoi rreth një shekull histori shumë të dhimbshme dhe të përgjakshme, gjë që u konsiderua si skandal më i madh ndërkombëtar. Nga kjo rrjedhë që: "Kosova, kjo tokë shqiptare u dënua prej Fuqive të Mëdha evropiane të mbajë në kurriz një zgjedhë të re shumë më gjakpirëse se sa e përparshmja – zgjedhën militariste megalo-serbe".[51]

Mirëpo, nëse Serbia për 3-4 % të pakicës së saj çon aq shumë pluhur, e alarmon botën, do të ishte krejt normale që Shqipëria e vitit 1913 të interesohej dhe të punonte shumë më tepër për tokat e veta me mbi 95% të popullit autokton shqiptar të një gjaku, të një gjuhe dhe të një historie, që iu shkëputën padrejtësisht në vitet 1878-80, 1913 etj., e jo të harxhojnë energji kot së koti në përplasjet jo pak herë në mes veti deri në ditët e sotme, derisa atë energji kanë ku ta derdhin – në çështjen e pazgjidhur kombëtare në mënyrë definitive.

---

[48] Dhimitër Canco, Epiri – vështrim historik dhe etnografik, Tiranë 1999, 105-106
[49] Po aty, 350
[50] Dr.Hakif Bajrami, Kosova njëzet shekuj të identitetit të saj, Prishtinë 2001, 121
[51] Bajram Curri, (Trajtesa e dokumente), Tiranë 1982, 61

Për vetëm 48 vjet (1878-1926), Serbia, Mali i Zi dhe Greqia, me ndihmën dhe bekimin e Fuqive të Mëdha evropiane, e copëtuan pesë herë territorin e Shqipërisë (dy herë më 1878, 1913, 1921 dhe më 1926). Pothuaj kurrë nga të tjerët nuk është përmendur se, krijimi i një vargu shtetesh sllavo-ortodokse rreth territorit etnik shqiptar do të jenë rrezik permanent për popullin shqiptar me qëllime shfarosjeje. As Fuqitë e Mëdha evropiane, atë rrezik asnjëherë nuk e potencuan. Asokohe, gjatë diskutimeve për kufijtë shqiptar, serbët gjithnjë ankoheshin për "lëshuarjen" e bregdetit Adriatik e të detit Egje. Atë e bënin me qëllime të caktuara se kinse ishin mbetur të pakënaqur, meqë synonin t'i mbanin nën sqetull si të sigurta dhe të padiskutueshme para opinionit ndërkombëtar Kosovën dhe Maqedoninë. Këto metoda perfide serbe e ruse edhe tani përdoren në diplomacinë e tyre dinake dhe gënjeshtare, për ta mbuluar problemin e Vojvodinës, Kosovës Lindore, Sanxhakut të Jeni-Pazarit etj. Motoja e politikës dhe diplomacisë pansllaviste ishte dhe mbeti – sulmi mbrojtja më e mirë. Për kërkesat absurde të serbomëdhenjve, *Kosta Novakoviq*, ironizonte: "Kur e shkelën Kosovën pushtuesit serb lajmëruan botën që do t'i vënë prapë në vend "të drejtat e tyre historike" që kanë pasur më 1389 (përpara "Betejës së Kosovës"). Duke u mbështetur në këto "të drejta historike" mund të ngriheshin e të kërkonin sot të merrnin gjysmën e Evropës Italia, ose Franca, ose Greqia (Bizanti), ose Turqia, se i kanë pasur njëherë në dorë këto territore. Madje, Franca mund të kërkonte edhe një pjesë të Rusisë, se Napoloni ka vajtur njëherë më 1812 gjer në Moskë".[52]

Konferenca e ambasadorëve në Londër në pranverë dhe verë të vitit 1913 kishte caktuar një kufij të gabuar e trashanik, më të padrejtë e më fatkeq që mund ti bëhej një populli. Merreni me mend, Kosovën, epiqendër e lëvizjeve – kryengritjeve të mëdha shqiptare si asnjë pjesë tjetër e Shqipërisë, ia dhuruan si peshqesh Serbisë e Mali të Zi gjashtë Fuqitë e Mëdha të Evropës. Ndërsa, në Kosovë serbët nuk kanë shkrepur asnjë plumb për themelimin e shtetit modern serb të njohur më 1878, në një kohë që shqiptarët nga këto treva të Kosovës filluan lëvizjet (Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja Besa-Besë e Pejës, Tubimi madhështor i Ferizajt) dhe kryengritjet, sidomos në vitet 1909, 1910, 1912 për formimin e shtetit shqiptar.[53]

Kështu, territoret dhe qytetet e rëndësishme kombëtare u përdorën si "figura shahu". Por, "cirku më i madh në kapitullin e Konferencës së ambasadorëve në Londër e përbëjnë bisedimet, marrëveshjet dhe

[52] Rexhep Qosja, Çështja shqiptare, Prishtinë 1994, 94
[53] Gazeta "Koha", 12.06.1991, Prishtinë

mosmarrëveshjet rreth qyteteve shqiptare: Shkodrës, Gjakovës, Pejës, Prizrenit, Dibrës, Korçës, Gjirokastrës, Strugës, Ohrit etj. Porsi figurat në tabelën e shahut ato qiten herë në njërën anë, e herë në anën tjetër të kufirit: herë i lihen Shqipërisë e herë i jepen Serbisë, herë i lihen Shqipërisë e herë i jepen Malit të Zi, herë i lihen Shqipërisë e herë i jepen Greqisë. Andaj, argumentet me të cilat iu ka falur Gjakova Serbisë janë, pothuaj ato me të cilat Kosova iu ka falur Serbisë: aty, afër Gjakovës, është Manastiri i Deçanit, toka e të cilit, e dhuruar prej Perandorisë Osmane, shtrihet deri afër Gjakovës. Gjakova, prandaj, duhet të jetë e atij shteti i të cilit është Manastiri i Deçanit! "[54]

Pas vendimeve absurde të Konferencës së ambasadorëve në Londër, pasoi një dëshpërim i thellë dhe i papërshkrueshëm, qoftë nga ajo ndarje e panatyrshme e popullit tonë, qoftë nga masakrat e panumërta të pushtuesve tejet agresiv serbo-malazez në të dy anët e kufirit të mallkuar shqiptaro-shqiptar. Dhe, me të drejtë konstatohet se populli shqiptar prej politikës dhe diplomacisë së disa Fuqive të Mëdha ishte më i dëmtuari në Ballkan. E ka pësuar një dëmtim të tillë, në radhë të parë, pse ishte popull i vetmuar dhe i rrethuar nga të gjitha anët tokësore nga sllavo-grekët ortodoks, të cilët kurrë nuk e ndalën deri në ditët tona fushatën e shfrenuar dhe kërcënimet kundër popullit shqiptar, me qëllim që ta njollosin si mos më keq. Serbia kurrë nuk ndalet derisa nuk e sheh forcën ushtarake, meqë pa të askush nuk është i sigurt, e me një ushtri të fortë çdo gjë e ke të sigurt, gjë që këtë e kemi provuar shumë herë si popull, e kuptohet më së miri edhe në luftën e fundit 1997-1999.

E dihet historikisht e gjeografikisht, shqiptarët që mbetën jashtë vendimeve të Konferencës së Londrës, ishin, e janë pjesë përbërëse e popullit shqiptar, njëherë të copëtuar në Kongresin e Berlinit 1878, e pastaj të përgjysmuar arbitrarisht me dhunë me vendime të Konferencës së ambasadorëve në Londër më 1913.

Për një Shqipëri reale të vërtetë apo natyrore, në fakt është kërkuar qysh në vitin 1880 pas ndërkombëtarizimit të çështjes shqiptare nga Lidhja e Prizrenit edhe atë nga ana e diplomacisë britanike. Kështu, në një letër të *Lordit Groshen* – ambasador i Britanisë së Madhe pranë Oborrit të Sulltanit, më 26 korrik 1880, ia dërgonte *Lordit Granvillit*, ku shkruan: "Po të ishte themelue nji Shqipni e fortë, do të ishin zhdukë arsyenat e ndonji pushtimi nga ana e ndonji fuqie të madhe të huej në rast të ndonji shkatërrimi të Perandorisë Otomane. Nji Shqipni e tillë e fortë do t'i mbyllte rrugët në veri dhe do të mbante Gadishullin Ballkanikë ndër duer… Nji popullsi në pjesën ma të madhe muhamedane kishte me

[54] Rexhep Qosja, Çështja shqiptare, Prishtinë 1994, 107-108

qenë nji burim i madh pengues për popujt sllavë dhe grekë qi duen t'i zaptojnë këto vise. Kujtoj se mundësija e ndërhymjes evropiane në Gadishullin Ballkanikë pakësohet në përpjestim të krijimit të kombësisë shqiptare". Pra, vërtet *Lordi Groshen* parashikonte formimin e një Shqipërie të fortë dhe të madhe brenda kufijve të saj real kombëtar, që do të ishte formula më e sigurtë që kur potencohej: "Ballkani për popujt e Ballkanit".[55]

Mirëpo, harrohej një fakt: kur një trup i huaj bashkohet jo natyrshëm me një trup tjetër, ai patjetër do të krijoj qelbësirë, i cili, herët a vonë do të duhet të nxirret me operacion, gjë që për shumë dekada kufijtë shqiptar notuan në gjak.[56] Atëbotë, demokratja e mirënjohur angleze, *Durham*, do të deklarojë: "Ajo që mund të thuhet me siguri është se në Gadishullin e Ballkanit nuk është arritur një zgjidhje e qëndrueshme".[57] Edhe *Eduard Grei*, qysh më 1913 kishte deklaruar; "Po pajtohemi për hirë të shmangies së luftës, por historia do të na kritikojë". [58] Siç dihet fjalën kryesore në Konferencën e Londrës nga dokumentet kuptohet se e kishte ministri i Punëve të Jashtme të Anglisë *Eduard Grei*, i cili si diplomat i rryer e kishte të njohur se çfarë tregtie ishte bërë në Londër nga 17 dhjetori 1912 e deri më 12 gusht 1913, nga diplomacia vendimmarrëse angleze, ruse, franceze, gjermane, austro-hungareze dhe italiane, lidhur me tokat shqiptare. Kështu, për tregtinë bizare dhe tragjike për popullin dhe tokat shqiptare, Eduard Grei më 12 gusht pas mbarimit të Konferencës së Londrës në Dhomën e Komunave, në lidhje me caktimin e kufijve të Shqipërisë do të deklarojë: "Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të jap shkas për kritika të forta nga kushdo që e njeh vendin dhe që gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale. Duhet të mos harrohet se gjatë përpjekjeve për të gjetur zgjidhje të tillë qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja midis vet Fuqive të Mëdha dhe, në qoftë se vendimi mbi Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme në dobi të paqes në Evropë".[59]

Mirëpo, nuk shkon as një vit dhe fillon lufta e tmerrshme botërore në vitet 1914-1918. Me këtë rast duhet përkujtuar se populli shqiptar dhe udhëheqësit e tij legjitim, asnjëherë nuk janë pajtuar me vendimet e

---

[55] Prof. Mehmet Vokshi, Shqipnija e shqiptarvet, Prishtinë 2001, 61-62
[56] Edith Durham, Lufta e Shkodrës, Shkodër 2005, 138
[57] Po aty, 244
[58] Esat Bilali, Betejat e reja nuk fitohen me armët e vjetra, Lezhë 2004, 47
[59] Eduard Grey, Speeches on foreing affairs, London 1913, fq. 212; Prof.dr.Hakif Bajrami, Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912, Prishtinë 2003, 201 ; Arben Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914, Tiranë 1978, 260

Fuqive të Mëdha evropiane në Traktatin e Shën-Stefanit, Kongresin e Berlinit, Konferencën e ambasadorëve në Londër etj. Andaj, moszgjidhja e drejtë dhe definitive e çështjes shqiptare dhe mbetja pezull për më se 100 vjet, e gjen fajësinë e vet në radhë të parë te vendimet e gjashtë Fuqive të Mëdha evropiane në tubimet e sipërshënuara. Vërtet, kur të merren parasysh territoret shqiptare në veriperëndim, në veri, në lindje dhe në jug të Shqipërisë etnike, që ishin në kohën e pashallëqeve shqiptare të Shkodrës dhe të Janinës, lirisht mund të themi se – si rezultat i vendimeve të Kongresit të Berlinit më 1878 që i cungoi rëndë territoret shqiptare, duke ia shkëputur rreth 25.000 km² dhe Konferencës së ambasadorëve në Londër rreth 60.000 km² - jashtë kufijve të përcaktuar nuk mbeti një Shqipëri tjetër, por në fakt mbetën më tepër se dy sosh të përmasave të asaj që u krijua më 1913. Pra, territoret e shqiptarëve u rrudhën, u tkurrën shumë nga veprimet gjeostrategjike të pansllavizmit në Ballkanin Qendror dhe Perëndimor për afër një shekull e gjysmë dhe nga trungu etnik shqiptar u shkëputën mbi 80.000 km², pa i llogaritur edhe territoret që i janë uzurpuar me veprime barbare deri në lumin Tuna (Danubi) qysh nga Dardania e lashtë, përkatësisht territoret që i kishte dikur Gadishulli i Ilirisë.

Kosova e sotme ka vetëm 1/4 e Vilajetit të Kosovës të vitit 1877, meqë edhe Sanxhaku i Nishit ishte pjesë e Kosovës dhe i kishte rreth 44.000 km², përkatësisht vetëm rreth 1/3 e territorit të Vilajetit të Kosovës, i cili më 1912 kishte 32.900 km², ku bënin pjesë Sanxhaku i Jeni Pazarit dhe territoret në veri dhe në perëndim të Maqedonisë së sotme. Aktualisht, Republika e Kosovës i ka 10.887 km². Pra, Konferenca e ambasadorëve në Londër pas 34 vjetëve të mbajtjes së Kongresit të Berlinit ia shkëputi Shqipërisë nga 90.100 km² rreth 60.000 km² dhe njohu një Shqipëri me afër 30.000 km², duke e copëtuar disa herë dhe pastaj përgjysmuar, gjë që e bëri të gjymtë, të paqëndrueshme për ekzistencë dhe për vetëmbrojtje.

"Indipendenca e njohur në Konferencën e ambasadorëve në Londër më 1913 (edhe tani pas 100 vitesh, Xh.Sh.) kërkon më tepër se me dyfishu territorin e vet, gjë që nuk ka për qëllim ta plotësojë vetëm idenë e drejtë kombëtare të popullit shqiptarë, por edhe me i shërbye çështjes së paqes në Ballkan dhe Evropë".[60] Shqipëria, vërtet kurrë nuk ka pasur përkrahës. Ndërkaq, të gjithë popujt tjerë të Ballkanit, serbët, grekët, malazezët, bullgarët dhe rumunët, lirinë, pavarësinë kombëtare dhe formimin e zgjerimin jashtë mase të shteteve të tyre e kanë arritur me përkrahjen e madhe të fuqive evropiane.[61]

[60] Prof. Mehmet Vokshi, Shqipnija e shqiptarvet, Prishtinë 2001, 61
[61] Prof. Mehmet Vokshi, Shqipnija e shqiptarvet, Prishtinë 2001, 60-61

Lirisht mund të themi se nuk ka asnjë popull në Evropë që të ketë pësuar kaq shumë vuajtje, të ketë luftuar aq shumë për lirinë e të drejtat kombëtare dhe të jetë mashtruar e masakruar aq rëndë sa shqiptarët e Kosovës e të territoreve tjera rreth saj.[62] Ndërkaq, sipas koncepteve demokratike, çështja kombëtare zgjidhet një herë e përgjithmonë me krijimin e shtetit kombëtar, të unisuar dhe të pavarur. Pranimi i parimit të vetëvendosjes së kombeve nënkupton para së gjithash lirinë e plotë të propagandës për shkëputjen dhe për zgjidhjen e shkëputjes me anën e referendumit, të votimit, të përgjithshëm, të drejtpërdrejtë, të barabartë, të fshehtë nga ana e popullit që do të shkëputet.[63]

Pra, me gjithë Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, që është data jonë më e rëndësishme kombëtare deri më tani në historinë tonë, por që me këtë nuk u mbyll çështja shqiptare, sepse ajo edhe sot pret zgjidhjen definitive të drejtë edhe pas 100 vjetësh. Plagët dhe vuajtjet tona do të shërohen vetëm atëherë kur të realizohet dhe të pranohet pavarësia e plotë kombëtare. Mirëpo, në fund të fundit, synimi kryesor i të gjithë shqiptarëve, ka qenë, është dhe do të jetë bashkimi i të gjitha territoreve etnike shqiptare në një shtet kombëtar. Kështu, çështja e ish–Vilajetit të Kosovës, i cili para Kongresit të Berlinit 1878 i kishte rreth 44.000 km², kurrë nuk është heshtur pa u zgjidhur drejtë çështja jonë kombëtare në Ballkan, pasi që në histori thuhet: marrëveshjet e imponuara dhe paqja jostabile i shkaktojnë luftërat.

Duhet kuptuar njëherë e mirë se, asnjë pjesë e popullit tonë kurrë nuk ka pasur dhe nuk do të ketë qetësi e rehati, pa u realizuar ëndrra e të gjithë atdhetarëve shqiptarë – ribashkimi i kombit tonë në përgjithësi. Do të jemi të barabartë me shtetet fqinje, vetëm atëherë kur do të bëhet ekuilibri i forcave në mënyrë të përafërt, pasi që historikisht dihet se vetëm baraspesha e forcave i detyron popujt të jetojnë në paqe. Andaj, ne kërkojmë si të gjithë popujt tjerë atë që na ka falë Zoti, atë që na takon dhe atë që e meritojmë si të gjithë popujt e botës. Kështu që, bashkimi i territoreve shqiptare është më se real dhe i mundshëm, madje i paevitueshëm, konstatojnë shumë dijetarë.

Dhe krejt në fund; Kongresi i Berlinit i vitit 1878 dhe Konferenca e Ambasadorëve në Londër mbajtur më 1912-1913 i kanë ngatërruar shumë keq çështjet e Ballkanit – përkatësisht të Ilirisë. Ato kurrë nuk e siguruan paqen në territoret historike dhe etnike shqiptare.

Tani, me Shpalljen e Pavarësisë së kësaj Kosove të stërcunguar (Kosova ka sot një sipërfaqe prej 10.887 km², pra vetëm trungu është

[62] Lefter Nasi, Ripushtimi i Kosovës, Tiranë 1994, 5
[63] Po aty, 94

përfshirë, kurse degët në të gjitha anët i janë ndarë – Sanxhaku i Jeni Pazarit, Kosova Lindore, Maqedonia Veri-Perëndimore dhe Jug-Lindja në Mal të Zi) më 17 Shkurt 2008, mendojmë se po fillon një epokë e re e me perspektivë për kombin shqiptar. Megjithatë, mund të pohojmë; derisa nuk zgjidhet drejtë problemi bosht i këtij Gadishulli – çështja shqiptare, kurrë nuk do të ketë qetësi në territoret shqiptare që përjetuan tragjedi të tmerrshme të ndarjes dhe të përgjysmimit.

Rezyme

Pas luftës së tmerrshme ballkanike rezultoi mbajtja e Konferencës së ambasadorëve në Londër nga 17 dhjetori 1912 deri më 12 gusht 1913, ku u bë shkelja më e paskrupull e të drejtave njerëzore e kombëtare të shqiptarëve, nëpërmjet propozimeve të projekt-hartave për copëtimin dhe ndarjen e territoreve dhe popullit shqiptar. Shqiptarët edhe kësaj radhe nuk ishin të ftuar; prandaj ajo do të shkaktoi në të ardhmen një kundërshtim të ligjshëm shqiptar. Pra, as në Kongresin e Berlinit 13 qershor – 13 korrik 1878, as në Konferencën e ambasadorëve në Londër 17 dhjetor 1912 – 12 gusht 1913, nuk është pyetur fare populli shqiptar dhe është fakt që u nxorrën në ankand. Kështu, në Gadishullin e Ballkanit – përkatësisht Ilirisë, është fiksuar viktima kryesore – shqiptarët, ku vërtet do ta kenë vështirë me të gjithë: me fuqitë evropiane, me osmanët, e sidomos me katër shtetet ballkanike. Në këto dy tubime, ku u bë njëherë copëtimi dhe pastaj përgjysmimi i Shqipërisë. Në Konferencën e ambasadorëve në Londër për kufijtë perëndimor, verior dhe lindor të Shqipërisë caktohet Austro-Hungaria, ndërsa për në jug dhe perëndim Italia, të cilat nuk i mbrojtën si duhet të drejtat legjitime të shqiptarëve, por i shiquan më tepër interesat e tyre. Dallimet midis vijave kufitare të propozuara lidhur me kufijtë e Shqipërisë ishin të mëdha e absurde dhe ato thellësisht dalloheshin midis Qeverisë së Përkohshme të Vlorës e aleatëve ballkanikë, si dhe midis Austro-Hungarisë me aleatët ballkanikë dhe atë të Rusisë. Cungimi më i rëndë, me të cilin bëhej shpartallimi i Shqipërisë, ishte nga shtetet ballkanike që ishin afër me propozimin rus që përkraheshin nga Franca dhe Anglia. Andaj, ato propozime të paraqitura në tavolinën e Konferencës së ambasadorëve në Londër lanë sherre të mëdha deri në ditët e sotme edhe pas 100 vjetësh. Duhet theksuar se asnjë krahinë apo qytet i Vilajetit të Kosovës nuk ishte me shumicë serbe, prandaj Lufta e Parë Ballkanike ishte thjeshtë pushtim klasik i tokave shqiptare. Ndërkaq, serbët e Kosovës kurrë nuk kanë marrë pjesë në asnjë mënyrë në kryengritje kundër turqve, pasi që ishin

në pakicë dhe nuk ishin të zotët për asnjë veprimtari në këtë kuptim. Nuk ka emërtim "kryengritje serbe në Kosovë" deri më 1912.

Me vendimet nga seanca e 22 marsit 1913, iu dha vulë një akti të shëmtuar, sipas të cilit, territoret më të vlefshme të Shqipërisë së Sipërme apo Shqipërisë Veri-Lindore u shkëputën nga trungu etnik shqiptar, pa të cilat, stabiliteti i shtetit të ri shqiptar dëmtohej shumë ndjeshëm në çdo aspekt. Pra, çështja më e ndjeshme ishte çështja e kufijve shqiptar, sidomos për territorin e Vilajetit të Kosovës dhe një pjesë të madhe edhe për atë të Manastirit e Janinës, duke u bërë zgjidhje pa pjesëmarrje dhe kundër vullnetit të popullit shqiptar. Kufijtë e papritur dhe të papërligjur të cilët ia veshi Shqipërisë, Konferenca e Londrës, ishin mbase më 1913 një flijim, duke i ngopur sllavët me toka shqiptare. Me atë e dobësuan në çdo pikëpamje Shqipërinë, gjë që mbollën farën e trazirave të parreshtura në Ballkan, për arsyen e thjeshtë se, këta kufij u vendosën mespërmes zemrës së popullit shqiptar. Si në asnjë rast tjetër, në hartën politike të Evropës një shtet u gjend i rrethuar nga populli që është i njëllojtë me atë të shtetit amë. Edhe sot pas 100 vitesh, gjendja është e tillë që më tepër se 7 milion shqiptar jetojnë në 4-5 shtete. Ajo ishte fryt i ndërhyrjes dhe ekspansionit të shovinistëve fqinjë, intrigave dhe përcaktimit alogjik të kufijve të Ballkanit nga metropolet evropiane. Mirëpo, duhet pranuar se kjo gjendje, ishte edhe fryt i paaftësisë të udhëheqjes politike shqiptare për të artikuluar dhe mbrojtur interesat jetike kombëtare me të gjitha format e luftës politike, ushtarake, kulturore dhe diplomatike. Një gjë është e saktë se po të respektohej parimi etnik, diskutimi i kësaj çështjeje do të zgjaste shkurt, brenda disa javëve, e jo ashtu si zgjati rreth 8 muaj diskutimi për kufirin shqiptar. Nga historianët tanë do të konstatohet drejtë se ata kufij tragjik, Konferenca e ambasadorëve në Londër, me insistimin dhe këmbëngulësinë e Rusisë i pranoi pa qenë të tillë kurrë në histori. Pothuaj kurrë nga të tjerët nuk është përmendur se, krijimi i një vargu shtetesh sllavo-ortodokse rreth territorit etnik shqiptar do të jenë rrezik permanent për popullin shqiptar me qëllime shfarosjeje. As Fuqitë e Mëdha evropiane, atë rrezik asnjëherë nuk e potencuan.

Pra, Konferenca e ambasadorëve në Londër në pranverë dhe verë të vitit 1913 kishte caktuar një kufij të gabuar e trashanik, më të padrejtë e më fatkeq që mund ti bëhej një populli. Merreni me mend, Kosovën, epiqendër e lëvizjeve – kryengritjeve të mëdha shqiptare si asnjë pjesë tjetër e Shqipërisë, ia dhuruan si peshqesh Serbisë e Mali të Zi gjashtë Fuqitë e Mëdha të Evropës. Ndërsa, në Kosovë serbët nuk kanë shkrepur asnjë plumb për themelimin e shtetit modern serb të njohur më 1878, në një kohë që shqiptarët nga këto treva të Kosovës filluan lëvizjet (Lidhja

Shqiptare e Prizrenit, Lidhja Besa-Besë e Pejës, Tubimi madhështor i Ferizajt) dhe kryengritjet, sidomos në vitet 1909, 1910, 1912 për formimin e shtetit shqiptar. Me të drejtë konstatohet se populli shqiptar prej politikës dhe diplomacisë së disa Fuqive të Mëdha ishte më i dëmtuari në Ballkan. E ka pësuar një dëmtim të tillë, në radhë të parë, pse ishte popull i vetmuar dhe i rrethuar nga të gjitha anët tokësore nga sllavo-grekët ortodoks, të cilët kurrë nuk e ndalën deri në ditët tona fushatën e shfrenuar dhe kërcënimet kundër popullit shqiptar, me qëllim që ta njollosin si mos më keq. Duhet kuptuar se, Serbia kurrë nuk ndalet derisa nuk e sheh forcën ushtarake. E dihet historikisht e gjeografikisht, shqiptarët që mbetën jashtë vendimeve të Konferencës së Londrës, ishin, e janë pjesë përbërëse e popullit shqiptar, njëherë të copëtuar në Kongresin e Berlinit 1878, e pastaj të përgjysmuar arbitrarisht me dhunë me vendime të Konferencës së ambasadorëve në Londër më 1913.

Kosova e sotme ka vetëm 1/4 e Vilajetit të Kosovës të vitit 1877, meqë edhe Sanxhaku i Nishit ishte pjesë e Kosovës dhe i kishte rreth 44.000 km², përkatësisht vetëm rreth 1/3 e territorit të Vilajetit të Kosovës, i cili më 1912 kishte 32.900 km², ku bënin pjesë Sanxhaku i Jeni Pazarit dhe territoret në veri dhe në perëndim të Maqedonisë së sotme.

Lirisht mund të themi se nuk ka asnjë popull në Evropë që të ketë pësuar kaq shumë vuajtje, të ketë luftuar aq shumë për lirinë e të drejtat kombëtare dhe të jetë mashtruar e masakruar aq rëndë sa shqiptarët e Kosovës e të territoreve tjera rreth saj. Ndërkaq, sipas koncepteve demokratike, çështja kombëtare zgjidhet një herë e përgjithmonë me krijimin e shtetit kombëtar, të unjisuar dhe të pavarur.

Hajrudin S. MUJA

100 VJET NGA *"DITA E KIJAMETIT NË TOKË"*

Kohë më parë, kryetari i Bashkësisë Islame të Malit të Zi - Rifat Fejziq, paralajmroj se më 5 mars 2013, do të organizojë faljen e xhenazes, për viktimat e boshnjakëve të vrarë më 1913 në Plavë e Guci [Vijesti:3.1.2013]. Meqë ai gëzon pozitën e kryetarit të një bashkësie fetare, në të cilën nuk përfaqëson veç boshnjakët, por edhe të tjerët që i përkasin kësaj bashkësie, atëherë ndjej se ka bërë një gabim, që nuk ka përfill grupet tjera që përfaqëson. Unë s'kam ndërmend të replikoj me të, le ta mbajë "*për nderë*" ai dhe të tjerët që "*e kanë bërë dinin - dinarë*", por dëshiroj të merrem me atë, se çfarë në të vërtetë ka ngjarë në marsin e 100 vjetëve më parë, në një kohë që u bë e njohur si "*dita e kjametit në tokë*".

Në llurën e krizave Ballkanike që kishte filluar prej vitit 1908, të shqetësuara për mundësinë e krijimit të një shteti shqiptar me shumicë muslimane [Claer:2009], shtetet ortodokse ballkanike i shpallën Perandorisë "*kryqëzatë të shenjtë*". Kjo shpuri në Luftën e Parë Ballkanike, të njohur si '*koha e shkaut të dytë*, më 8 tetor 1912, me synimin e tyre primarë, të grabitjes së tokave shqiptare [Swire:1929]. Një krizë e këtillë ndikoj në krijimin e grupacioneve shqiptare, bullgare, greke, etj., që më shumë se të luftonin pushtetin osman, luftonin njëri-tjetrin [Hall:1994], kryesisht kundër jo-ortodoksëve – muslimanëve shqiptarë e boshnjakë dhe shqiptarëve katolikë. Deri në fundin e atij viti, mijëra shqiptarë me gra, plq e fëmijë ishin masakruar nga ushtria serbo-malazeze. Shumë fshatra, pasi i kishin plaçkitur ishin hedhur në flakë [NY Times, 31.12.1912], shumë familje kishin pushuar së ekzistuari. Njerëzit vriteshin e digjeshin si minj. Lumenjt ishin mbushur me kufoma. Gratë, fëmijët e pleqt thereshin me bajoneta ose digjeshin të gjalla [Durham:1991]. Ata pak që kishin shëptuar, me revole në ballë detyroheshin ti nënshkruanin "*falënderimin*" Petrit Karagjorgjeviq, që "*i kishte çliruar*" prej 'turkut' [Šeparović–Ademaj:1991]. Se cili qe "çlirimi" i tyre, mjafton të kujtojmë urdhërat e kapitenit Gjurishiq dhe nënkolonelit Miliçeviq: "*vritni të gjithë*", apo atë të B. Nushiqit, që shkruante se liria do të vinte vetëm atëherë "*kur të digjej edhe shtëpia e fundit dhe kur të vritej edhe fëmija i fundit në Drenicë!"* [Bislimi:2011]. Ata inkurajonin vazhdimisht ushtarakët okupues kriminel se: "*Sa më pak turq e shqiptar, aq më madhështore merita e juaj atdhetare*". Por ama,

shumë prej tyre kuptonin se: "*Duhet të vdesin disa gjenerata të shqiptarëve që të harrohet çfarë bënë serbët ndaj tyre*" [Lahu:1995]. Kishte thënë Tacit: "*Ubi Solitu Dinem Faciunt, Pacem Appellan*" (Atje ku bëjnë shkreti, e quajn paqë).

Por, ato që na interesojnë neve me këtë rast, janë ngjarjet e marsit dhe prillit të vitit 1913, që në kujtesën popullore njihet si "*dita e kjametit në tokë*". Pamje të frikshme kishin mbuluar tokën shqiptare. Kudo grupe të lidhura njerëzish që po i shpinin drejt humnerës masakruese, fshatrat në flakë, grabitje të pajës së nuseve e vajzave, bylmetyrave e dimrishtrave. Tani u kishte ardhur radha tua merrnin edhe atë që e konsideronin të shenjtë – bindjet e tyre fetare, duke i konvertuar muslimanë e katolikë në fenë ortodokse. Prova e parë e konvertimit 'zyrtar' do të bëhej përmes formimit të një shoqate të fshehtë në Pejë, të quajtur "Liga", e përbërë kryesisht nga zejtarë e tregtarë. Kjo shoqatë propagandonte me të madhe se *feja e të parëve* ishte feja ortodokse, dhe se kisha e Pejës me atë të Deçanit, ishin kishat e stërgjyshërve të tyre. Nëpër fshatra kishin dërguar mësues për ta bindur e detyruar popullatën shqiptare për ndërrimin e fesë [Babić:1984]. Meqë shoqata nuk pati sukses në misionin e caktuar, shpejt pushoj së ekzistuari, për ta pasuar pastaj dekreti mbretëror i 'gospodarit' Nikolla Petroviq dhe të autoriteteve ushtarake 'çlirimtare' malazeze, sipas të cilës e gjithë popullsia muslimane dhe një pakicë e popullsisë katolike që jetonte në krahinën e Plavë-Gucisë dhe viset e Kosovës, detyrimisht duhej të ndërronin fenë dhe të kalonin në besimin ortodoks. Dekreti hynte në fuqi më 15 mars 1913 dhe duhej të zbatohej brënda një afati dhjetëditorë [Plava:2002]. Prej kësaj kohe, shqiptarët muslimanë e katolikë si dhe boshnjakët muslimanë u gjendën mbrenda një tmerri të paparë, u seleksionuan më të mirët, tetë ylema të njohur, shtatë haxhinj (të pasur), dy profesorë, tridhjetë persona të parisë, pesëdhjetedy burra – trima... edhe njëqind meshkuj të tjerë: "*Tanë hafî ja janë çua n'kamë, Zoti i vraftë po nam po bajnë, ni burrë t'mirë kund nuk po e lanë...*" [Bislimi:2011]. Por, konvertimet kishin nisur edhe më parë, me fillimin e luftrave Ballkanike. Tashmë pushteti malazez, kishte deportuar shqiptarë nga Peja, Gjakova e Tuzi, në kampe të përqëndrimit në Podgoricë e Nikshiq. Në fillim të shkurtit 1913, në kampin e Nikshiqit kishte 323 shqiptar, të cilëve në fillim të marsit, ua shtuan edhe 233 nga Gjakova. Të gjithë këto ishin të shtyrë në moshë, por me ndikim e autoritet [Shkëndija:41/1991]. Më 4 mars 1913, edhe 300 shqiptar të Junikut u deportuan në kampin e Leskocit, u dogj fshati Batushë dhe u vranë pleq, gra e fëmijë [Shkëndija:44/1991]. Ajo që populli e kujton si "*dita e kjametit në tokë*", kishte filluar me një grup plavjanësh, të cilët më 5

shkurt 1913, i kishin dërguar ankesë Mbretërisë së atëherëshme, lidhje me arrogancën dhe terrorin që ushtria e saj po shkaktonte mbi muslimanët e kësaj krahine [Cana:1996]. Emrat e regjistruar të ankuesve pranë gjykatës së Mbretërisë, tregojnë qartë se konvertimet kishin filluar edhe më parë, pasi aty ishin regjistruar si: Danilo (Halil Beg Rexhepagiqi), Ivan Ivanioviq (Mulla Cani), Uroshi (hoxha - Mulla Sadiu), etj. Këto ishin 11 nënshkruesit e ankesës, njerëzit më të respektuar të Plavës, shqiptarë e boshnjakë, të cilët "*me vendimin e gjykatës ushtarake*", pasi nuk pranuan të konvertoheshin në ortodoksi, u dënuan me vdekje dhe u pushkatuan në Racin të Plavës nën urdhërat e Vukota Pantoviqit. Në fakt, kundër tyre nuk u bë as edhe një gjykatë formale, kurse vëllezërit Feraj që u pushkatuan aty, nuk qenë regjistruar as formalisht në lista. Në raport u tha, se ata u dënuan me vdekje, për shkak se kishin bashkëpunuar me "kaçakët" [Delić:2011]. Me këtë emër, kishin emruar pjestarët e Lëvizjes Çlirimtare, që i rezistonin dhunës sllave [Vickers:1999], duke i paraqitur ato si keqbërës e jashtligjorë, me çka synonin t'i linin vetes duart e lira, për ti vrarë pa dhënë asnjë përgjegjësi. Por, siç tregojnë burimet e kohës, 'faji' i tyre, nuk ishte pjesmarrja në "Lëvizjen e Kaçakëve". Nën urdhërin e Milivoje Dragoviqit (dok.#412), kryetari i atëhershëm i Komunës së Plavës Radovan Popoviq, kishte bërë arrestimet. Fillimisht u kërkuan të konvertoheshin në ortodoksi, dhe të respektonin flamurin malazez. Mulla Sadiu, Bilal-aga, Shyqri Feraj dhe të gjithë njëzëri, të vendosur u përgjigjën kriminelëve: "*...ne nuk ju pengojmë juve; nuk do t'i vendosim kapicat malazeze, ne pështyjmë në to, ne mbetemi muslimanë...*" [Memić:2003]. Në vendin e pushkatimit, ai ngriti një dorë dhe ikurajoj edhe të tjerët, të shqiptonin për së fundi herë dëshminë. Padia formale kundër tyre ishte bërë tre ditë pas vrasjeve, me urdhërin e Milan Veshoviqit për *"interes të shtetit"*. Gjykata ishte formuar më 3 mars, kishte filluar punën të nesërmen me 4, kurse një ditë më pas, kishte marrë vendimin për pushkatimin e 15, e më pas të 29 qytetarëve. Të njëjtën ditë, u pushkatuan edhe dy grupe me nga tetë plavjanë. Pasi i vranë këto, u paraqiten "vullnetar", për t'u konvertuar në ortodoksi 108 veta, prej tyre 94 muslimanë e 14 katolikë. Një ditë më parë, ishte thënë se edhe 15 muslimanë ishin konvertuar në ortodoksi. Ishin këto ndërmarrje të kobëshme të politikës malazeze, sipas shumë mendimtarëve, një hakmarrje për humbjen e madhe që pësoj ushtria e Mark Milanit më 20 janar të vitit 1880. Disa të tjerë e kërkojnë zanafillen e kësaj, nga urrejtja e madhe që Vasojeviqët (dikurë edhe ata shqiptarë) ushqenin kundrejt shqiptarve e muslimanëve të Plavë - Gucisë, prej disfatës së malazezëve

në luftën e Nokshiqit (4 dhetor 1879) [Hrvatski Dnevnik:1941]. Por dihet se Vasojeviqët, ishin elita kryesore e ushtrisë malazeze dhe e gjithë qeveria e kësaj elite ishte e tyre. I këti fisi ishte edhe biri i ish-kreut të Luginës së Beranës – Avro Cemoviq, njeriu që kryesonte bandën ushtrake nën direktivat e mbretit Nikollë. Në rrolin e serdarit, në rrethet e Rozhajës e Tutinit, ai kishte lënë mbresat e një eprori shumë të vrazhdë e me mungesë edukate! Në terenin e Ribariqit e të Tutinit, kishte bërë krime të rënda, që i kishte raportuar prefekti i Mitrovicës: "*ata kanë djegur shtëpi, kanë vrarë njerëz të pafajshëm, kanë plaçkitur bagëti e kanë dhunuar gratë e pafuqishme muslimane*" [Kosovarja:1/1991]. Në lidhje me këtë, komandanti i divizionit të 20-të serb të Ibarit, kishte raportuar se: "*çetat e parregullta malazeze, nën Avro Cemoviqin, janë kompromentuar me çdo ligj legal...*" Emërtimi i këti tipi në rrolin e serdarit, tregonte qëllimin "moral" që kishte Nikolla, kurse urrejtja e Avros kundrejt shqiptarëve e boshnjakëve realizonte dëshirën e tij për kërcënimin e gjërave më të ndjeshme, siç ishin feja, kombi dhe tradita, që gjithsesi nënkuptonin dëshirën për të asgjësuar përfundimisht shqiptarë e boshnjakë, dikurë sundues të Ballkanit.

Nji ditë të djelë... qindra roje ushtarake e civile malazeze, të mbyrthyera në armë, u panë në çdo lagje të qytetit e në katunde… u dëgjuan zërat e kasnecëve malazezë që shqiptonin: "Dan osvete - kršćenje ili mušketru" (dita e hakmarrjes – krishterizimin ose vdekjen).

Me aq sa na tregon rapsodia popullore, Avro Cemoviqi doli me urdhër të prerë, duke u bërë ftesë shqiptarëve musliman e katolikë dhe boshnjakëve muslimanë, që të shkonin në kishë: *"Besë e fe aty me n'rrue"*, ndryshe vdekja do të jetë 'shpëtimi i tyre'. Ata do ti kujtonin Avros, se për aq shumë vjetë që kishin qenë sundimtarë, një gjë të tillë nuk e kishin kërkuar prej tyre [Mjeku:2008], por edhe ishin betuar vendosmërisht: "*Pasha Zotin kjoft livdue, kurr njat punë s'kam me punue!"*. Refuzimi i tyre për ndrrimin e fesë, i dha shancin Avros për të zbatuar krimin, duke mbledhur rreth 800 burra me gra e fëmijë, në një fushë të rrethuar me tela, ku duhej të bëhej kryqëzimi i tyre, në Qafën e Previsë, ndërmjet Murinës e Andrijevicës.

Studjuesi A.Zejnullahu ka shënuar kujtesën popullore: "*Nji ditë të djelë... qindra roje ushtarake e civile malazeze, të mbyrthyera në armë, u pane në çdo lagje të qytetit e në katunde… u dëgjuan zërat e kasnecëvet malazezë që shqiptonin: >Dan osvete - kršćenje ili mušketru<"* (dita e hakmarrjes – krishterizimin ose vdekjen). Fusha e Qafës së Previsë kishte marrë pamje të frikshme. Rojet malazeze të mbërthyer me pushkë e bajoneta kishin rrethuar fushën të gatshëm për zbatimin e krimit.

Priftërinjtë dhe igumenët e shumtë organizonin fushatën, pranë kazaneve të ujit të bekuar dhe stivës së kapicave malazeze. Dhespoti në krye mban nji kryq të madh me dorë të shtrirë përpara turmës së popullit, që urdhërohej të ndërronte besimin [Dituria Islame:207/2007].

Pas refuzimit të këtij urdhëri, ata u detyruan të hapnin një gropë të madhe, që shpejt do të bëhej varri i tyre. Në një epizod të këtillë të dhembshëm, një fëmi e pyet babain "*Ç'janë kto vorre babë tuj punue?* E ai i përgjigjet: *"Nuk janë vorre tuj punue, janë llogore për me luftue"*, ose në një variant tjeter: "*Nuk janë vorre, por janë llagore, me luftue me Cernagore!"* I pari që kishte rënë "shehid" në këtë varr masiv ishte Ramë Isuf Kukaj, i cili sipas rapsodit, kishte lënë porosinë: "*Sën ma t'mir s'paska n'jetë, me dhanë jetën për vatan t'vet"* [Gjonbalaj:1996]. Në popull ka mbetur kujtesa e një të riu, me emrin Jakup Pepiq, një shqiptar me qeleshe, të cilin, kur e kishin marrë forcat malazeze, para se ta vrisnin, i kishin thënë: "*A po e vë kapuçin e malazezëve, e ne po t'a falim jetën?*". E ai, u ishte përgjigjur se edhe po të kishte tri jetë nuk do ta pranonte një turp të tillë. Ishte ky njëri prej atyre që u pushkatuan këtu, pasi nuk pranuan të konvertoheshin. Kur kishte ardhë e ëma, ai i kishte thënë: "*Gajret nënë, do të shihemi në Ahiret!"*.

Čedo Ćulafić, në monografinë "*Prokletijski meterizi*", kishte regjistruar më 1965, rrëfimin prej një gruaje 66 vjeçare (atëherë 14 vjeçe), që kishte qenë çobaneshë në Previ dhe e kishte parë gjithë këtë ngjarje të tmerrëshme: "*Disa prej tyre qanin e dridheshin, duke u lutur që tua falnin jetën.... Ushtarakët ua merrnin orët, unazat po edhe veshjet e tyre... pastaj i vranë dhe i mbuluan me fare pak dhe, që pastaj brënda natës u zbuluan nga egërcitë... Më vonë mund të vinin të afërmit e tyre e tua mbulonin më mirë kufomat...*". Në rrëfimin e dytë, zë vend Faze Gjonbalaj. Ajo si nënë, nuk donte të besonte se biri i saj – Çela ishte pushkatuar aty. Me disa gra të tjera të Vuthajve, pas një jave, ajo u nis të shkonte vetë në Previ: "*filluam të hapnim një pjesë të ati varri... dolen trupat e të vdekurve që ishin hedhur aty pa asnjë rregull... trupa të kalbur, kundërmonte një duhmë e padurueshme... e mbuluam varrin dhe u kthyem në Vuthaj duke qarë* [Cana:1996]".

Në këtë kohë, në rrethinën Plavë-Guci, kishte mbi 10.000 muslimanë, ndërkohë që numri i ortodoksëve, nuk kapte as 2000 [Andrijašević-Stojanović:2003]. Sipas disa të dhënave të tjera, të vitit 1912, Plava e Gucia kishte 12.8% popullsi ortodokse (serbë e malazezë), të gjithë të tjerët ishin shqiptarë e boshnjakë muslimanë, me një numër shumë të vogël katolikësh. Qindra familje të Plavës, Gucisë, Pejës dhe Gjakovës (aty ku ishte më i theksuar konvertimi), u shpërngulën përgjithmonë në

Shqipëri. Mijëra të tjerë u dëbuan nga Dibra, në shtatorin e këtij viti, të cilët u vendosen për rreth Tiranës e Elbasanit. Të pafatët, në tentim për ikje, binin në pritat malazeze. 13 gucijanë që kishin vendosur të largoheshin për në Kelmend, ranë në pritë të tillë, 5 u vranë në vend, të tjerët u dënuan me vdekje, nga gjykata ushtarake e Gucisë. Shaban Braha, në shkrimin *"Gjenocidi Srbomadh dhe Qëndresa Shqiptare",* shënonte 1.813 të pushkatuar prej 28 fshatrave të Plavë-Gucisë, në mesin e tyre 1.337 të rritur, 897 meshkuj dhe 420 gra, dhe 476 fëmijë. Të tjerët, u lajmruan "vullnetarisht" të kalojnë në "fenë e të parëve", kurse një pjesë e tyre u larguan kryesisht në drejtim të Shqipërisë, për ti shpëtuar shpatës së kasapit "të civilizuar". Tek informonte Ministrin e Mbrendshme, brigadieri malazias Mashan Bozhoviq, i thoshte se në periudhën shkurt-korrik, si pasojë e "*konvertimeve në fenë e të parëve*", nga Gucia në Shkodër, u shpërngulën 795 qytetarë. Sigurisht që numri i tyre ishte shumë më i lartë nga sa e paraqiste brigadieri.

Disa të tillë, në gjendje të mjeruar i kishte takuar Edith Durhami në Malësitë e Shkodrës, që kishin mbërri tu shpëtonin masakrave: *"që bëheshin në emër të krishterimit... Muslimanët ose duhej të pagëzoheshin ose i priste vdekja. Të luturit në mënyrë islame qe ndaluar. Qenë therur plot njerëz, disa grave të të cilëve u kishin zbuluar fytyrën, i kishin pagëzuar e në disa raste edhe ç'nderuar*" [Durham:2001]. Tek i fliste sekretari i komandantit Vukotiq, zonjës Durham, i thoshte se: "*qëllimi i politikës së Malit të Zi ishte që t'i hiqte qafe të gjithë muslimanët e t'i kolonizonte trojet shqiptare... vramë të gjithë burrat e fisit të Rugovës, i mposhtëm ata e pastaj çdonjërin e therëm me shpatë. Ju siguroj, nuk mbeti asnjë i gjallë*". Të njëjtën gjë i thoshte Durhamit për Shkodrën, një drejtor poste në Cetinë: "*Në Shkodër nuk do të gjejsh asnjë të sëmurë, u kemi gjetur ilaç... i shpojmë të gjithë me bajoneta... Ne preferojmë tokën dhe pozitën, jo një grusht shqiptarësh të ndyrë. Evropa do të na japë një milion, që ta ndërtojmë një qytet të bukur si Cetina...*" [Durham:1991] Një tjetër officer serb, i thoshte se muslimanët: "*duhej shfarosur... kur toka të bëhet e jona, nuk do të ketë më problem musliman...*" Kurse një farefis i mbretërisë së Petroviqëve, i lavdërohej asaj se, nëse Evropa do ti jepte Mali të Zi një pjesë të mirë nga Shqipëria, ata do ta zgjidhnin shpejt çështjen e shqiptarëve, duke shfarosur çdo shqiptar aty [Durham:1914]. Por siç vërenë Durhami, ata kishin edhe një mision tjetër: "*pasi kishin plaçkitur çdo gjë që mund të rrëmbehet nga armiku, kishin nisur të plaçktinin vetë ushtrinë e tyre. Gratë e një fisi vidhnin burrat e një fisi tjetër, u vidhnin palltot, bile edhe këpucët kur ishin duke fjetur*".

Kishin në plan zbatimin e porosisë që Danillo kishte dërguar përmes Njegoshit: "*ne jemi betuar t'i shfarosim ata*", që kështu të vendosnin "*drejtësinë*" malazeze, kurse fëmijët e tyre pastaj ti dërgonin nëpër shkolla serbe, që të bëhej sllavizimi i tyre i shpejtë dhe gjuha shqipe të zhdukej në një të ardhme të afërt. Disa prej tyre sot mund ta konsiderojnë veten 'boshnjakë'. Tejet e indinjuar, znj. Durham thoshte se (Fuqitë e Medha) ishin bërë si një kafaz me bisha, ku nuk ishin mbydhur korba, por skifterë të gatshëm për të përlarë. Dhe sapo hapet dera, ato tregojnë se duhet të bëjnë si në të gjitha kafazet e tjera, pra të shqyejn. Ata kësaj radhe donin të shqyenin muslimanët e ballkanit që i konsideronin si të "*kastit të pestë*", si mbeturina të një epoke të kaluar, me të cilët nuk mund të integroheshin në shtetet që ishin planifikuar të formoheshin [Carmichael:2002]. Duke përshkruar tregimet e të parëve, imami i xhamisë së Gucisë – Režep Adem Radončić, në punimin amator "*Istorija Gusinja*" (Historia e Gucisë), përshkruan fillimin e konvertimeve të dhunëshme, se si të gjithë, ndërmjet konvertimit dhe vdekjes, pranonin më me dëshirë këtë të fundit. Por, sipas tij, duhej të paraqiteshin njerëz të mençur, të cilët edhe pse vonë, do ta shpëtonin Plavën e Gucinë nga shfarosja totale. Ndër të parët, ai përmendë muftiun Mulla Saba Muminoviq, i cili, pasi kishte mbledhur gucijanët, u kishte thënë se ai do të ishte i pari, që do të konvertohej në ortodoksi, duke asryetuar "*me të drejtën sherjatike*" në raste të këtilla. Jo pse vërtetë mendonte kështu, sepse të gjithë e njihnin për karakterin dhe imanin e tij të fortë, por duke kuptuar, që ky urdhër qeveritar, qëndronte pas planit për zhdukjen totale të muslimanëve e shqiptarëve në këtë vend, dhe kjo ishte e vetmja mënyrë e mbijetesës së këtyre viteve [Memić:2003]. Ai ishte i sigurtë se edhe kjo e kishte një fund. Brenda kësaj 'leje' për tu konvertuar me qëllim mbijetese, gjithsesi u jepte urdhërin dhe këshillën e prerë, që "*në rastin më të parë të rikthehesin në fenë e tyre"* [Karić:2005]. Në këtë mënyrë, të konvertuarve u jepeshin menjëherë emra ortodoksësh sllavë: Ukshini bëhej Vukashin, Rama - Rade, Tahiri - Tihomir, Bajrami - Bllagoje, etj. Veç kësaj, ata paiseshin edhe me nga një kumbarë që ua caktonte prifti, por kishte prej tyre që detyroheshin vetë ta gjenin një të tillë, tek fqinjët ortodoksë. Nëse të konvertuarit që kapeshin në rrugë kishin harruar emrin e tyre me të cilin ishin pagëzuar, dënoheshin, shpesh edhe me pushkatim. Edhe pse këto, për një kohë të gjatë mbeten tema tabu, gjestet jonjerzore të "trimave" malazez të mbretit Nikollë, i ruajtën ngjarjet e atyre viteve, në kujtesë të transmetuar prej një brezi në tjetrin. Një i moshur që i kishte mbushur të '90-tat, i quajtur Haxhi Ademi, kishte dalë në "Çarshi" për të blerë duhan, pa menduar se 'trimat'

malazez, mund të vinin dorë mbi dikë të pa aftë, për të treguar 'trimërinë' e tyre. Kur ra në patrullën malazeze, e morën, e kapën për mjekrre, dhe e rrahën për vdekje! Në të njëjtën kohë, një vajzë e re po bëhej nuse në një familje të Martinajve, kur "trimat" malazez e morën duke e mbajtur e duke e dhunuar gjatë gjithë natës, deri në vdekje. Të nesërmen, kufomën e saj të lakuriqësuar e qitën në rrugë, morën edhe kufomën e plakut, ja hoqen të gjitha rrobat, dhe e vendosen mbi kufomen e vajzës, duke mos lejuar tu afrohet asnjërin për dy ditë me radhë! Familja dhjetë antarëshe e fshatit Meteh, u vra nga kumbara i tyre, dukuri e panjohur deri në atë kohë! Në një rast tjeter, Haxhi Medo Medunjanin, kishte jetuar në mardhëne të mira me fqiun Simon. Kur u përhap gjithandej ushtria malazeze e Vesojeviqëve, Haxhiu u fsheh në tavanin e shtëpisë, për ti shpëtuar krimit malazez, të cilët nuk kursenin të rriturit as fëmijët. Tek qëndroj aty për një kohë, pa fqiun Simonin, të cilin edhe pse mendoj se do ti ndihmonte, u bë xhelati i tij. Janë të mjaftueshme këto ilustrime për t'i dhënë lexuesit nivelin e tmerrit që kishin shkaktuar malazezët mbi popullatën e pafajshme e të pa armatosur muslimane në krahinat e Plavës e të Gucisë dhe në viset e Kosovës. Nga kujtesa e të moshuarve të lagjeve të ndryshme, nëpër ara e livadhe, shtriheshin trupa të pajetë njerëzore, dhe për ditë të tëra nuk goxonte kush ti përkiste, që "të marrin mësim të tjerët", se një gjë e tillë i priste të gjithë ata, që nuk pranonin "*kryqin e shenjtë*" [Karić:2005]. Të atit të Shaban Kolinës të Gusisë ia nxorën sytë me bajonetë për së gjalli në prani të fëmijëvet e të gruas, kurse në Budovicë të Plavës, Rexhep K. Feratajn e lidhën në trungun e një dardhe, ia nxorën sytë me thikë dhe në fund e dogjën për së gjalli [Braha:1990]. Në llurën e këtyre tmerreve, kur në këto anë kishin ardhur Vojvodë Ilija Plamenac dhe Janko Vukotiq, dhe tek po shetisnin, ishin takuar me Mehmed beg Rexhepagiqin, me të cilin, pasi e njohën, zhvilluan një bisedë. E pyetën "*Sa vjeç je*"? U tha: "*Zotni, jam afër 300-shit*!". E pyetën: "*Po, si ashtu*?" U tha: "*Lehtë, shumë lehtë, unë ngadalë po mbushi të 100-tat, kurse... prej se keni ardhur ju, mi keni shtuar edhe 200 të tjera...*"

"*Si mund t' i shkojë ndërmend mbretit Nikollë, t'ua imponojë me armë e me dhunë muslimanëve shqiptarë të ndërrojnë fenë? A mendon ai për luftimet e përgjakshme që e presin?*" [Ismailqemal Vlora, 12 prill 1913]

Projekti i mbretit Nikollë, për konvertimin e shqiptarëve musliman e katolikë në ortodoksi, njëkohësisht po realizohej edhe në Kosovë, ku po vepronin serbo-malazezët dhe pjestarët e organizatës "*Cërna Ruka"* (Dora e zezë). Në ballë të kësaj fushate mizore, qëndronte Sava Lazarević (Batarja). Ai i kishte vënë shqiptarët ndërmejt vdekjes dhe konvertimit,

por duke ua lënë edhe opcionin e tretë të shpërnguljes, *për ata që nuk mund ti zinte*! Në shtëpitë e shqiptarëve, në realizimin e misionit të vet, Sava merrte me vete një pop serb e shumë paraushtarakë serbo-malazez, hynte në shtëpi dhe u jepte ultimatumin e konvertimit, pa kohë mendimi. Në të kundërtën i vriste të gjithë, pa dallim moshe e gjinie. Një veprim të këtillë Sava e kishte filluar, vetëm pasi ishte siguruar, se shumica e shqiptarëve i kishin dorëzuar armët. Fillimisht thuhej se edhe në Lugun e Baranit, 68 familje shqiptare muslimane ishin detyruar të ktheheshin "*në fenë e të parëve*". Në fshatin Gorazhdevc të Beranit të Epërm, Sava dhe Velko Kapiteni kishin tubuar të parët e fshatit dhe nën presionin e dhunës i kërcënonte tua ndërronin fenë! Kishin thirrur kryeplakun Hazir, duke i kërkuar që të mblidhte popullin dhe t'u printe në kishë, për tu pagëzuar me urdhërin e prerë: "*Nestra e diella asht qillue, tanë në kishë kena me shkue…"* dhe kërcënimin: "*Si mos dishit me u kryque, unë vet Sava kam me ju msue…!",* që i vente në pozitën për jetë a vdekje! Por edhe përgjigja e Hazirit ishte e shkurtër, se nuk do ta ndrronte fenë "*pa e gri e pa e coptuar"*[Bicaj:2003]. Vargjet e këngës, tregojnë në mënyrë të hollësishme për qëndrimin burrëror të Hazir Alisë, i cili nuk u gjunjëzua fare para kriminelëve, por përkundrazi, iu kërcënua se: "*S'ke gjetë kishë për m'u kryque…"*. Meqë ata nuk pranuan me asnjë kusht dhe asnjë çmim, atëherë Sava me xhelatët e vet çetnikë, i urdhëron shqiptarët e atij fshati, t'i gropojnë varret e veta, në një mal afër kishës së Gorazhdevcit, ku i pushkatoi të gjithë [Dituria Islame:207/2007]. Në kujtesën e rapsodit, fjalët e fundit të Hezirit qenë: "*Bini vllazën, ju, shahadet, ka ni gisht çone përpjetë... more Savë mos t'kofsha falë, Shahadetin, s'mun ma nalë…"* [Krasniqi:2008]

Një epizod i ngjajshëm tregohet, kur ata u ndalën në kullen e Bajraktarit të Vranovcit, nën bajrakun e të cilit ishin 30 fshatra. Aty i dhanë urdhërin kërcënues bajraktarit që për tri ditë, të mblidhte tërë Bajrakun dhe me burra, gra e fëmijë të shkonte në një kishë ortodokse të Pejës, për t'u pagëzuar "*në fenë e të parëve*", sipas urdhërit të mberitit Nikollë. I nxënë ngusht, pa armë për mbrojtje, Bajraktari u thotë se territori i tij ishte i madh dhe s'kishte mundësi t'i tubonte të gjithë për tri ditë, por 'do t'a bënte' këtë, sa më parë që të mundej. Pas konsultimit që bën me krerët e fiseve, të cilëve ua shpjegon kërkesën dhe qëllimin e Savës për ndërrimin e fesë, të gjithë përfaqësuesit e fiseve dhe masa e gjerë popullore, vendosin që asnjëri nga ato të mos e pranojë kryqëzimin para vdekjes. Të kërcënuar me vrasje masive, popullata e këtyre anëve, u detyrua të nisej për në Pejë. Karavanit të frikësuar, i dolën para serbët e Gorazhdecit, që për të fituar "meritën", u përpoqen ti fusnin në kishën e

tyre, që aty të bëjnë pagëzimin [Mjeku:2008]. Të besatuem të gjithë se: "*fe as emen s'domë me ndrrue*", u thanë atyre se dëshironin të shkonin në kishën e madhe të Pejës, për të ndrrua aty fenë në mënyrë "solemne".

Në vazhdim, te "*Ura e Gurit*", nëpër të cilën përshkonte rruga, i prisnin xhelatët e Malit të Zi dhe priftërinjt e tyre, në mënyrë që kur të kalonte turma shqiptare, t'a stërpiknin me "*ujë të bekuar*", të gatshëm që në rast refuzimi, ti ekzekutonin të gjithë. Drama fillon këtu, kur xhelatët malazias provokojnë të riun Zenel Bajraktari, duke i futë dhunshëm në dorë flamurin malazez dhe duke e detyruar ta puthte e ta mbështillte në ballë, gjë që ai e refuzoj, nga ku u krijua rrëmujë. Derisa xhendarmëria kërkon 'dorasin', para tytave u del bajraktari: "*Unë jam bajraktar dhe unë përgjigjem për këtë popull të pafajshëm*". U krijua tollovi në hyrje të Pejës, filluan keqtrajtimet. Nuk mundën të gjejnë Zenelin, por vranë Bajraktarin dhe 40 burra të tjerë [Bicaj:2003].

Dëshmitarët thonin se në Gjakovë nuk kishte më muslimanë, por u vranë edhe disa shqiptarë të konfesionit katolik, te vendi i quajtur *"Muri i Sadik Agës",* më i riu 16 vjeç dhe më i vjetri 55 vjeç [Zenelaj:2010]. Flitet edhe për konvertimin e 850 familjeve të tmerruara katolike në ortodoksi! Por ajo që nxiti shtetet evropjane të reagojnë, qe vrasja e priftit katolik Patër Luigj Palaj, të cilit, nën urdhërat e një prifti bandit ortodoks, ju kërkua të hiqte dorë publikisht nga besimi i tij katolik, në favor të ortodoksisë lindore, dhe pasi refuzoj, u sakatos me bajoneta [Islami:2003]. Aty, edhe 300 burrave e grave të lidhura u kërkuan ndrrimin e fesë, nga katolicizmi në ortodokdsi [Zenelaj:2010]. Shtypi i kohës, bënte të ditur se vetëm në një shtëpi, në rrethinën e Gjakovës, ishin masakruar e pastaj ishin djegur 72 shqiptarë [Shala:1990]. Në fshatrat Ponoshec, Morinë dhe Skivjan kishin vrarë 580 shqiptarë dhe kishin djegur shtëpitë e tyre. Në këtë të fundit kishin pushuar së ekzistuari 26 familje. Në këto fshatra kishin dhunuar edhe 36 femra dhe para popullit kishin therur 8 pleq mbi 80 vjeç, kurse në Deçan kishin vrarë 12 fëmijë në praninë e nënave të tyre [Shkëndija:45/1991].

Në Ferizaj, priftërinjt katolikë ndiqeshin në çdo hap, për ti likuiduar. Priftit të Ferizajit, për tre muaj i kishin hequr të drejtën e shëlbesës në kishë, kushdo që shkonte te prifti, që fliste me të ose shkonte në meshë, arrestohej. Me metoda poshtruese 400 familje katolike të Janjevës [Bajrami:2006], i detyronin të hiqnin dorë nga feja e tyre dhe të pranojnë konvertimin në besimin skizmatik. Në fshatin Shashar, mblodhen të gjithë burrat e 90 familjeve katolike, që po punonin në ara, i lidhen me litarë, e pastaj filluan plaçkitjen e shtëpive dhe dhunimin e grave e vajzave të tyre, kurse në Noshec, i vranë 30 burra që i gjetën duke

pushuar [Islami:2003]. Pas këtyre llahtarive: *"familjet që kanë mbetur të shkreta i kanë përzënë jashtë kufirit"* [Zekaj:2008]. Gazeta "*Shqypnija e Re*" më 26 tetor 1913 shkruante se: "*Ma tepër se 8.000 shqyptarë të Malcies Gjakovës gjinden këtu t'ikun prej ndjekjeve të serbëve e malazezëve*…" [Zenelaj:2010].

Këso llahtarishë bënin edhe në vende të tjera të viseve shqiptare. Në Bushat, Shkjez e Trush, edhe pse katolikët mbanin kryqe në vete e figura në shtëpi, nuk i ndanin prej muslimanëve, se donin të vinin dorë mbi gjithçka, ua dogjën të gjitha shtëpitë! 32 veta që i vranë duke mbrojtur bashkëshortet e veta, që nuk i lejuan ti varrosin, deriqë erdhi Ipeshkvi i Sapës [Bushati:2005]. Në zinxhirin e ngjarjeve të një shekulli, kjo konsiderohej ndër më të trishtueshmet, pasi prekja në fe dhe kombësi, ishin e keqja më e madhe që mund t'i ndodhte një populli. Ngjarjet rrëqethëse, kishin tronditur dhe dëshpëruar shpirtërisht edhe Ismailqemal Vlorën, i cili në një intervistë dhënë gazetës italiane më 12 prill 1913, shprehej: "*Si mund t' i shkojë ndërmend mbretit Nikollë, t'ua imponojë me armë e me dhunë muslimanëve shqiptarë të ndërrojnë fenë? A mendon ai për luftimet e përgjakshme që e presin?*"

Vdekja ose konvertimi i këtyre njerëzve të pafajshëm, pasqyronte jo vetëm barbarinë e armikut, por edhe neglizhencën e fuqive të mëdha ndaj shqiptarëve muslimanë e katolikë. Gjatë gjithë punës së Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-1913), që mbante fatin e shqiptarëve në dorë, asnjë fjalë nuk u tha për këtë makabër që po bënin mbi shqiptarët "popujt e civilizuar". Vetëm në Protokollin e Mr.H.C. Norman-it, datë 26 mars 1913, paraqitej ankesa e Mehmet Bej Konicës dhe Filip Nogës (delegat të qeverisë së përkohëshme shqiptare), se si çështja e Shqipërisë po zgjidhej pa përfilljen e shqiptarëvet dhe se kufinjt e saj po caktoheshin vetëm për të parandaluar një prishje midis Austro-Hungarisë dhe Rusisë, për të cilën shqiptarët nuk kishin të bënin fare [Shatri:2012]. Prej me 10 të këti muaji, Ministri i Punëve të Jashtme të Austrisë, ishte i informuar dhe i shqetësuar për veprimet e serbo-malazeze në viset e pushtuara të shqiptarëve. Gray njoftonte Cartwright'in, se qeveria e tij nuk do ta pranonte propozimin rus mbi Kufinjet e Shqipërisë, për shkak të rrezikut për maskra, përgjegjës i të cilave nuk dëshironte të ishte ai! [Shatri:2012]

"*Pagëzimet bëhen me tortura. Njerëzit hidhen në ujin e akullt të lumit e pastaj vihen e piqen pranë prushit të zjarrit, derisa kërkojnë mëshirë. Dhe çmimi për gjithë këtë është kthimi në fenë e krishterë – ortodokse"* [Edith Durham].

Çështjen e konvertimit të dhunshëm mbi shqiptarët muslimanë e katolikë, Fuqitë e Mëdha do ta merrnin më me seriozitet, vetëm pas

reagimit që i dërguan Vatikani dhe Austro-hungaria, pas vrasjes së meshtarit të kishës së Gllogjanit Luigj Palaj, i cili u kishte kërkuar shqiptarëve, të mos dorëzonin armët dhe t'i rezistonin dhunës konvertuese në ortodoksizimin sllav. Vetëm atëherë ata, intervenuan duke u bërë thirrje Qarqeve Ndërkombëtare në shqyrtimin e nenit të 30-të, të marrveshjes së Berlinit, ku Mali i Zi duhej të respektonte lirinë e besimeve dhe sigurinë e pasurive të tyre. Formuan komisionin e posaçëm ndërkombëtar, për të hetuar rastin e vrasjes, por edhe për të verifikuar pohimet e Serbisë, se shqiptarët kërkonin vullnetarisht konvertimin në "fenë e të parëve", siç dëshmonte "Tribuna" serbe [Zenelaj:2010]. Gavriloviqi i kishte thënë "në besë" nënkonsullit Austro-Hungarez, se: "*Çështja e konvertimeve me dhunë të shqiptarëve muslimanë, ka qenë një gjë e planifikuar dhe e qëllimshme nga Serbia*" [Zenelaj:2010]. Por, i gjithë potenciali i propagandas politike ishte drejtuar drejt 'konvertimit vullnetar', se shqiptarët e mbetur gjallë, po konvertoheshin "vullnetarisht" në ortodoksi! Një burim dokumentar i kohës, pretendonte se vetëm më 23 shkurt 1913, në Gjakovë ishte bërë "vullnetarisht" konvertimi i 503 familjeve të kësaj ane. Ishin lajmrue 'vullnetarisht' për kryqëzim edhe 1.400 muslimanë, prej 11 fshatrave të tjera muslimane të Pejës, ku deri më 21 'vullnetarisht' ishin kryqzue 7.000 shqiptarë, kurse sipas një zyrtari të zonës, në ortodoksi kishin kaluar ose kishin shprehë dëshirën të kalojnë rreth 14.000 muslimanë [Andrijašević-Stojanović:2003]. Drejtuesit e tyre, me flamur në dorë, duke kënduar, kishin ardhur të paraqesin kërkesën dhe kishin vendosur kryqin ortodoks! Kështu njoftonte edhe Cemović, se në rrethinat e Plavës - Gucisë, vetëm më 23 mars 'vullnetarisht' ishin kryqzuar në ortodoksi 3.000 muslimanë [Andrijašević-Stojanović:2003]. Aty madje Vuthjanët 'kishin kërkue' që edhe xhamitë t'i konvertonin në kisha, por nuk kishte lejuar 'shpirtmadhëria' malazeze [Bicaj:2003]. Nga bilanci që jepte ushtaraku Gjorgje Shekularac, ishin konvertuar në ortodoks 12.000 muslimanë, ndërkaq pushteti policorë e ushtarak i Serbisë, arsyetonte se: "*shqiptarët po shprehin dëshirë të kalojnë në fenë ortodoks*e" [Pirraku:2003].

Mbi këtë konvertim vullnetarë, Durhami do të shkruante: "*Pagëzimet bëhen me tortura. Njerëzit hidhen në ujin e akullt të lumit e pastaj vihen e piqen pranë prushit të zjarrit, derisa kërkojnë mëshirë. Dhe çmimi për gjithë këtë është kthimi në fenë e krishterë – ortodokse"* [Durham:2001]. E tmerruar nga këto masakra, ajo i ktheu dhuratën që ja kishte dhuruar Krajl Nikolla: "*unë nuk mund ta mbaj më për asnjë çast dekoratët e përlyer me gjak të pafajshmish*" ["Spekter" tetor 2000]. Kalimi në ortodoksi ishte bërë – siç shkruante Božović: "*për të shpëtuar kokën"*,

pasi qeveria lokale, kishte ushtruar dhunë të paparë mbi to. Prej terrorit, kishin qenë të shpëtuar vetëm ata njerëz, që ishin paraqitur për konvertim 'vullnetar'. Kështu, të shumtët që ishin konvertuar, posa u dha urdhër për lirinë e plotë të besimit, vraponin në ndonjë lum, ku i fërkonin ato pjesë të trupit, të cilat ua kishte prekë Popi, aq shumë me rërë, derisa u dilte gjaku [Zekaj:2008]. Prej aty shkonin në xhami, ku formonin rendet dhe faleshin.

Po kujt do t'ja linte fajin Nikolla, kur u detyrua të pranojë realitetin? Në reagimin e ankesës së Myftiut të Gucisë permes të Kryemyftiut të Malit të Zi [Cana:1996], Nikolla i tha: "*S'është e mundur të bëhen të gjitha këto nën qeverisjen time… ju keni kërkuar të pagëzoheni me dëshirë*". Por, kur u zu ngusht prej fakteve të shumta, në mënyrë hipokrite e mbylli bisedën: "*Këtë e bëri Avro (Cemoviqi) krye në vete"* [Čulafić: "Prokletijskih Meterizi"]. Pastaj bëri atë që mundi, nuk lejoj të bëhen hetime e të merren masa ndaj krimeinelëve, sepse kriminelin e kishte shumë afër vehtes. Sipas raportit të vitit 1941, në Zagreb e kishte lutur Serdarin Cemoviq të pranonte fajësinë, që më pas ta gradonte me gradën e gjeneralit. Meqë ai nuk pranoj, u helmua [Pavičević:1929] ose u zhduk në të kthyer nga Cetina ndërmjet Mojkoviqit e Mateshevës. Këtu edhe u ndërprenë hetimet dhe mbeti temë tabu, pasi për të nuk u guxua të shkruhej e të flitej më.

Mbi këto konvertime, fillimisht kishte shkruar Dr. Jovan Cvijiq [1966], i cili në vend të mbretit Nikollë, fajësonte ish-hoxhën e mëhershëm të Plavës Mulla Hajro (Balsha) Bashiqin, i cili pasi ishte konvertua në ortodoksi, në rrolin e kryetarit të gjykatës ushtarake, kishte nënshkruar vendimet e Avro Cemoviqit për vrasjen e njerëzve të pafajshëm, që nuk pranonin të konvertoheshin në ortodoksi. Po kështu shkruante edhe shkrimtari i njohur i kësaj ane Radovan Zogoviq, në përmbledhjen e tij të njohur të këngëve "*Prkosne strofe*", ku kishte botuar një këngë me titull: "*Uspomene iz Balkanskog rata*" (Kujtime nga Lufta Ballkanike). Më pas, vëllai i Avros – Markoja, në gazetën Beogradase, botoj një shkrim të gjatë, duke shfajësuar vëllaun e tij Avron ["Vreme", 13.01.1941]. Një tjetër që provoj të bënte të njohur këtë tragjedi, ishte Gjeneral-majori i ushtrisë Jugosllave Zufer Musiq, biri i hoxhë Sadiut, të vrarë në Racin, por nuk arriti ta botojë. Čedo Čulafić që deshi të bënte të njëjtën gjë, u pengua nga zyrtarët e Komunës së Plavës. Kurse prova e Idriz Šahmanović-it, si nxënës i shkollës së Mesme pranë Medresesë së Shkupit, u pengua nga një mësimdhënës i Fakultetit Filozofik – prof. dr. Pera Slijepčević. Sidoqoftë, qeveria malazeze u detyrua të nxjerrë proklamatën për ndalimin e fushatës së dhunëshme konvertuese, duke u

pozicionuar pro lirisë së besimit. Sipas dokumenteve të kohës, pas proklamatës: "*Masa e popullit ngarendi me vrap drejt lumit Gërçar, ku u pastrua dhe i fërkoi me rërë gjymtyrët e trupit që ishin stërpikur me ujë të bekuar*". Në këtë mënyrë, prej 12.000 të konvertuarve, vetëm 5 familje qëndruan në ortodoksi, të tjerët u rikthyen në Islam [Karić:2005]. Ndërkohë, nënkonsulli Austrohungarez në Prizren, njoftonte ministrinë e Jashtme të Vjenës se: *"Me keqardhje them, se të konvertuarit shqiptar katolikë, nuk kanë treguar aq vendosmëri sa të konvertuarit musliman shqiptar. Nga 1000 katolikë shqiptarë të konvertuar me dhunë në fenë ortodokse, në prani të komisionit, vetëm 50 veta janë kthye në fenë e tyre të mëparëshme"* [Zenelaj:2010].

Një shkresë e ardhur nga Gjakova dhe e nënshkruar nga ana e ushtarakut serb Kolonelit Vukotić, fajësonte malazeztë të cilët nuk kishin përdorur taktikën dhe udhëzimin e dhënë, në mënyrë të mençur dhe të mire, gjatë këti konvertimi. Sipas tij, ata ishin të udhëzuar që njëherë t'i linin anash shqiptarët e konfesionit katolikë, në mënyrë që të mos reagonin Autsro-Hungaria dhe Italia. Ndërkaq, pasi ta mbaronin punën me shqiptarët muslimanë, atëherë me ata do të bëhej edhe më lehtë dhe në mënyrë më të zbutur e më mashtuese. Ai shprehte indinjatë që malazeztë kishin vrarë Atë Palin, jo pse i dhimbsej, por pse u kishte zbuluar tërë të palarat, brutalitetin dhe qëllimin e konvertimeve me dhunë të shqiptarëve [Zenelaj:2010].

Sipas studiuesit Zejnullahu, këngët dhe krijimet e rapsodëve tregojnë me detaj atë që ndodhi më 1913-ën, ndërsa një shifër zyrtare e viktimave, kurrë nuk është bërë e mundur të nxirret. Por vetëm për të konvertuarit thuhet se mund të kenë qenë në rreth 12.000 [Dituria Islame:207/2007]. Kosta Novakoviq, në "*Kolonizimi dhe serbizimi i Kosovës*", shkruante se gjatë viteve 1912-1913, u vranë 120.000 shqiptarë: burra, gra, fëmijë, pleq, numër me të cilin pajtohet edhe Sergije Dimitrijeviq ["Bujku", 12.11.1992]. Kjo ishte masakra më e tmerrëshme që kishte parë Ballkani deri në këtë kohë. Sipas analistëve, Serbia kishte zbrazur më shumë granata kundër shqiptarëve sesa kishte zbrazur në luftë kundër Turqisë [Shkëndija, 23/1991]. Motoja e kësaj lufte ishte: "*shqiptarët të zhduken*" [Shkëndija, 19/1991].

GJUHËSI

Shefkije ISLAMAJ

GJUHËSIA SHQIPTARE NË 100-VJETORIN E PAVARËSISË

Gjuhësia shqiptare e shekullit 20 karakterizohet me zhvillim të shkallëshkallshëm në pajtim me zhvillimin shoqëror-politik, në pajtim me proceset shoqërore-politike e ekonomike që e kanë karakterizuar shoqërinë shqiptare në përgjithësi përgjatë një shekull pavarësie. Zhvillim të përshpejtuar ajo e njeh në gjysmën e dytë të shekulli 20. Arsyet e shpërpjesëtimit të këtij zhvillimi nuk janë të natyrës shkencore, por janë, para se gjithash, arsye historike dhe shoqërore-politike. Shekulli 20 është shekulli i ngjarjeve të mëdha për kombin shqiptar e, rrjedhimisht, për gjuhësinë shqiptare – formimi i shtetit shqiptar, formimi i institucioneve shtetërore, formimi i institucioneve arsimore – shkencore, Por, shekulli 20 për shqiptarët ishte edhe shekull i luftërave globale e lokale, shekull i rënieve dhe i shkatërrimeve, prandaj, mund të thuhet, se gjuhësinë shqiptare e ka ndjekur fati i shqiptarëve. Gjuhësia shqiptare është relativisht e re, konsolidimi i saj është pak a shumë i vonshëm në raport me atë të gjuhëve të tjera evropiane. Njëqind vjet të gjuhësisë shqiptare, të sistemuar e të vendosur në rrugë të mbarë, nuk kanë mjaftuar për trajtimin e aq shumë problemeve që lidhen me gjuhën shqipe, me historinë e strukturën e saj, me korpusin e me ligjërimin shqip. Detyra të mëdha në kushte të kufizuara, shkëputja nga tradicionalja dhe nxitimi nga bashkëkohorja - janë vetëm disa nga karakteristikat e zhvillimit të gjuhësisë shqiptare. Po rikujtojmë se kur në gjuhësinë shqiptare po vendoseshin fillimet e studimit institucional të problemeve të saj, në Evropë gjuhësia moderne, e filluar me strukturalistët dhe pak më pas me Shkollën e Pragës, po mbushte katër dekada dhe tashmë ishin formuar edhe shkolla të tjera, ndërsa shumësia e ideve të reja në shumë fusha gjuhësore kishte përmbysur shumëçka të ndritshme të shekujve pararendës të traditës së pasur të hulumtimit e të studimit të problemeve të gjuhës e të gjuhëve në përgjithësi. Megjithatë, do të ishte plotësisht e padrejtë të mos spikateshin rezultatet e mëdha të arritura në gjuhësinë shqiptare për një shekull në shumë fusha të dijes gjuhësore. Shekulli 20 është shekulli i studiuesve shqiptarë. Puna e madhe dhe rezultatet e arritura shkencore nën drejtimin e prijatarëve tanë - Xhuvani, Çabej,

Cipa, Riza, Domi, Demiraj dhe e studiuesve të brezit të dytë e të tretë, bënë që të vihen themelet e një gjuhësie bashkëkohore, e cila do të formësojë qartë detyrat e kohës dhe do të përvijojë rrugën për studime të pandalshme në të gjitha fushat e albanologjisë gjuhësore.

Gjuhësia shqiptare që prej fillimeve të saj ka qenë, para së gjithash, shkencë mbi gjuhën shqipe, dhe kjo vazhdon edhe sot, edhe pse ndërkohë, brenda saj, janë zhvilluar më shumë a më pak edhe degë të tjera të gjuhësisë, natyrisht zhvillime këto të kufizuara e të kushtëzuara nga shumë faktorë e nga shumë rrethana. Veçantitë e zhvillimit të saj përgjatë një shekulli, po kështu, janë përcaktuar nga zhvillimi i përgjithshëm i shkencës shqiptare dhe i albanologjisë në përgjithësi. Shumësia dhe larmia e teorive dhe e metodologjive bashkëkohore linguistike nuk i kanë shkuar për shtati kërkesave reale të gjuhësisë shqiptare për arsyet e mirënjohura. Mund të thuhet se në tre dhjetëvjetëshat e fundit ka pasur përpjekje që këto teori e metodologji të modifikohen e t'i përshtaten lëndës gjuhësore të shqipes. Nëse përgjatë shtatëdhjetë vjetëve kanë mbizotëruar studimet etimologjike, dialektologjike e onomastike, studimet mbi strukturën fonetike, morfologjike e sintaksore, studimet e dhjetëvjetëshave të fundit do të shtrojnë edhe çështje semasiologjike, çështje të gjuhësisë së tekstit, të gjuhësisë kontekstuale, të analizës së diskursit, të pragmatikës, të teorisë së aktit ligjërimor, të sociolinguistikës, e të tjerat më pak; përgjatë dhjetëvjetëshave të fundit mbizotërojnë studimet mbi gjuhën standarde dhe kulturën e gjuhës; hetohet rritje e interesimit për studimet, bazën empirike të të cilave në rend të parë e përbën lënda gjuhësore e shqipes; por hetohet edhe mungesë e lidhjes së qëndrueshme teoriko-metodologjike, e lidhjes me ndonjë shkollë a drejtim të caktuar linguistik.

Kur flasim për zhvillim e gjuhësisë shqiptare patjetër duhet të theksojmë se fillimi i shekullit XX shqiptarët i gjeti pa shtet, pa gjuhë të përbashkët e pa alfabet të përbashkët. Krijimi i shtetit shqiptar më 1912 shtroi një varg çështjesh që lidhen me funksionimin e shtetit të ri. Njëra ndër to qe nevoja për një gjuhë të përbashkët në shkallë kombëtare. Çështja e gjuhës kombëtare nuk ishte vetëm një çështje simbolike, po ishte, sidomos, edhe çështje praktike, duke pasur parasysh nevojat e shtuara komunikuese që shtronte funksionimi i shtetit të ri shqiptar. Katër vjet para shpalljes së pavarësisë Kongresi i Manastirit zgjidhi problemin e alfabetit, në të vërtetë i bashkoi shqiptarët në një rrafshin shkrimor me çka çeli rrugë edhe për njësime të tjera që do të vijojnë. Shtysa që dha Kongresi i Alfabetit do të kurorëzohet me themelimin e veprimtarinë e Komisisë Letrare të Shkodrës (1916-18) dhe me mbajtjen e Kongresit

Arsimor të Lushnjës (1920) - dy ngjarje këto të rëndësishme në hullinë e përpjekjeve të ndërgjegjshme të shkrimtarëve e të intelektualëve të kohës për gjuhën shqipe dhe për proceset standardizuese. Me gjithë vështirësitë, me gjithë kontekstin e përbërë historiko-shoqëror e gjuhësor, shumica e lëvruesve të gjuhës shqipe të kohës, janë pajtuar për çështjen themeltare: shqiptarët duhet të kenë një gjuhë të përbashkët kombëtare. Komisia Letrare e Shkodrës, me përpjekjen e një numri të madh intelektualësh të kohës, i dha rrugë të drejtë kësaj çështjeje, megjithëse, duhet ta pranojmë, rezultatet vijuese në këtë drejtim vazhduan të mbeten modeste. Duhet të kalojë më shumë se gjysmë shekulli deri në zgjidhjen përfundimtare - njësimin gjuhësor të shqiptarëve dhe miratimi i rregullave drejtshkrimore në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972, të cilit i parapriu edhe Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968).

Çka mund thuhet tjetër shkurt për zhvillimin e gjuhësisë shqiptare në këtë në përvjetorin e madh të krijimit të shtetit shqiptar? Mund të thuhet se 100 vjet pavarësie janë shumë të rëndësishme edhe për shkencën shqiptare në përgjithësi dhe, rrjedhimisht, për gjuhësinë shqiptare në veçanti. Ngritje e instituteve shkencore albanologjike në vitet 50 të shekullit të kaluar ishin një nxitje tepër e rëndësishme për zhvillimin e një veprimtarie të organizuar, të pasur e të gjerë e krahas saj edhe për përgatitjen e kuadrit për shumë fusha të dijes gjuhësore. Siç na është e njohur gjuhësia shqiptare ka trashëguar nga e kaluara një trashëgimi modeste studimesh albanologjike të kryera kryesisht nga studiues të huaj që kanë meritën e pamohueshme në këto studime (Bopi, Mikloshiqi, Pederseni, Majeri, Jokli e të tjerë), ndërsa tashmë kishte ardhur koha që këto studime t'i merrnin në duar studiuesit shqiptarë.

Në fillimet e veta, prandaj, gjuhësisë shqiptare i ra hise më shumë të shtronte detyra sesa t'i realizonte e t'i zgjidhte ato. Do të duhej të kalonin pothuajse më shumë se tre dhjetëvjetësha që ajo të merrte përpjetën e vet e të konsolidohej si shkencë me vete me objekt të qartë e me metodologji të mirëfilltë shkencore. Gjuhësia shqiptare kishte detyrat dhe përgjegjësitë jo vetëm të vlerësimit të trashëgimisë modeste të studimeve shqiptare, por edhe të plotësonte kërkesat e reja e të ngutshme të arsimit e të kulturës shqiptare – me tekste bazë gjuhësore për të gjitha nivelet e arsimit shqiptar dhe të fillonte të shtrinte kërkimet shkencore edhe në fusha të reja e të pastudiuara deri atëherë. Të kësaj moshe mund të konsiderohen si shkenca të mëvetëvetësishme fonetika, gramatika dhe leksikologjia shqipe. Kështu studimet e gramatikës kanë ecur krahas studimeve në fushën e historisë së gjuhës dhe të dialektologjisë. Hov marrin më pas edhe semantika e stilistika. Gjuhëtarët tanë dhanë

ndihmesën në hartimin e rregullave të drejtshkrimit. Studiuesit Xhuvani, Çabej, Kostallari, Domi e Lafe bartën peshën e përgjegjësinë e madhe në këtë drejtim. Krahas drejtshkrimit dhe problemeve të tjera që lidhen drejtpërdrejt me problematikën e drejtshkrimit, normativistika shqiptare, ka qenë objekt i shumë studimeve dhe botimeve të veçanta, përfshirë këtu edhe terminologjinë e leksikun. Gjuhësia shqiptare kishte nevoja të mëdha edhe në fushën e leksikografisë. Mbi traditën e pasur leksikografike u ndërtua Kartoteka e leksikut me mbi katër milionë skeda, mbi të cilën kartotekë do të nisë fazë e re e hartimit të fjalorëve të gjuhës shqipe, e fjalorëve terminologjikë dhe e atyre dygjuhësorë. Rezultate të mira u arritën në të gjitha këto fusha dhe ato u materializuan me botime të veçanta, për t'u zgjeruar e plotësuar deri në ditët tona. Merita e nismës dhe e zhvillimit të këtyre studimeve u takon studiuesve shqiptarë që punuan me zellin e rilindasve duke pasur përgatitjen e duhur, gatishmërinë e pashoqe dhe sakrificën e rrallë. Në këtë 100 vjetor nderimi e mirënjohja për zhvillimin e gjuhësisë shqiptare deri në shkallën që e bëjnë atë të krahasueshme me gjuhësitë rajonale u shkojnë emra si këta Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Eqrem Çabej, Selman Riza, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Androkli Kostallari, Jorgji Gjinari, Stefan Prifti, Spiro Floqi, Jani Thomai, Emil Lafe, Xhevat Lloshi, Fatmir Agalliu, Anastas Dodi, Remzi Përnaska, Seit Mansaku, Kolec Topalli, Enver Hysa, Bahri Beci, Menella Totoni, Mehmet Çeliku, Tomor Osmani, Engjëll Angoni, Ali Dhrimo, Lirak Dodbiba, Ferdinand Leka, Ethem Lika, Miço Samara, Gjovalin Shkurtaj, Hajri Shehu, Agron Duro, Hëna Pasho, Rami Memushaj, Xheladin Gosturani, Çlirim Bidollari, Thanas Feka, Ludmilla Buxheli, Pavli Haxhillazi, Bardhyl Demiraj, Anila Omari, Tefë Topalli, Artan Haxhi, Valter Memisha, Kristina Jorgaqi, Petrit Kotri e shumë e shumë të tjerë më radhë në Shqipëri, kurse në Kosovë e Maqedoni emrat: Idriz Ajeti, Latif Mulaku, Besim Bokshi, Remzi Nesimi, Hilmi Agani, Sulejman Drini, Abdullah Zajmi, Mehdi Bardhi, Shaqir Berani, Shefki Sejdiu, Mehmet Halimi, Ruzhdi Ushaku, Murat Bajtë, Isa Bajçincë, Murat Blaku, Rexhep Doçi, Halit Halimi, Fadil Raka, Rexhep Ismajli, Tafil Këlmendi, Ragip Mulaku, Shefkije Islamaj, Qemal Murati, Abdullah Zymberi, Mehmet Ahmetaj e shumë e shumë të tjerë të brezit pasues. Më vjen keq që po lë pa përmendur edhe shumë të tjerë në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni e më gjerë, të cilët kontribuan në ndërtimin e gjuhësisë shqiptare, e ata nuk janë pak. Do të ishte padrejtësi e madhe të mos përmendnim studiuesit e vyeshëm arbëreshë F. Solano, A. Guzzetta, Françesko Altimari, Mateo Mandala, e shumë të tjerë. Studimet gjuhësore përgjatë pesëdhjetë vjetëve të kaluara

kanë vijuar të pasurohen nga studiuesit e huaj që lanë shtegun e hapur (Bopi, Majeri, Jokli, Pedreseni, Mikloshiqi, Taljavini, Vajgandi, Skoku e shumë të tjerë), për të vazhduar me studiuesit Desnickaja, Buholc, Fidler, Fridman, Olberg, Koderiq e shumë të tjerë.

Sot në gjuhësinë shqiptare me shpejtësi shtohet numri i studimeve nga të gjitha fushat gjuhësore, fusha që tashmë kanë një traditë të pasur studimi, dhe botimi i tyre në përmbledhje tematike, në botime monografike, në revistat shkencore sa vjen e shtohet. Nëse në fundshekullin 20, në kuadrin e studimeve monografike, kanë prirë ato dialektologjike - studimi i të folmeve dialektore ose i çështjeve të veçanta që lidhen me këto të folme, kurorëzim i hulumtimit dhe studimit të cilave është Atlasi dialektologjik, sot prijnë studimet monografike për probleme të veçanta sidomos nga morfologjia, sintaksa, leksikologjia dhe standardi gjuhësor. Mund të lavdërohemi sidomos me arritjet leksikografike – leksikografinë njëgjuhësore e dygjuhësore dhe atë terminologjike, ndërsa studimet stilistike në gjuhësinë shqiptare, ende të pakta, mbështeten mbi studimin e gjuhës dhe të stilit të shkrimtarëve në rrafshin sinkronik ose nga perspektiva e historisë së gjuhës letrare. Përpjekjet që të arrihet një raport më përkujdesës ndaj trashëgimisë së albanologjisë gjuhësore janë shprehur edhe në shënimin e përvjetorëve më të rëndësishëm të veprimtarisë kërkimore dhe arsimore, përmes organizimit të tubimeve shkencore dhe publikimit të rezultateve të tyre, por edhe me botimin e e veprave më të rëndësishme të albanologjisë shekullore, të albanologëve shqiptarë e të huaj dhe të studimeve mbi veprën e tyre. Sot numri i revistat shkencore që nxjerrin institutet shkencore dhe katedrat e universiteteve shqiptare është relativisht i madh. Disa nga ato tashme kanë moshë e traditë të pasur më shumë se gjysmëshekullore.

Historia e studimeve albanologjike, rrjedhimisht edhe gjuhësore, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit 20, nuk mund të shkruhet pa u përfshirë edhe studimet e bëra për dhjetëvjetësha me radhë në degët e në sektorët e Institutit Albanologjik. I themeluar këtu e pesëdhjetë e nëntë vjet më parë, me vetëm dy vite pune, dhe rinisur punën para 44 vjetëve, Instituti Albanologjik qe e mbeti jo vetëm institucion i rëndësishëm shkencor e kulturor i Kosovës e më gjerë, po edhe institut kombëtar - simbol. Trashëgimia shpirtërore e materiale e shqiptarëve të trojeve të mbetura jashtë Shqipërisë, do të bëhet fushëveprimtari e kujdes i një plejade të tërë studiuesish të zellshëm, brezash të ndryshëm, që do të përballojnë jo pak sfidash politike, profesionale, kuadrore, materiale, edhe të restriksioneve, të luftës, të pasluftës. Megjithatë, u sfidua koha, u

sfiduan vështirësitë dhe puna e bërë rezultatet e arritura në disa fusha albanologjike, sidomos në gjuhësi, janë prova më e mirë se Instituti Albanologjik e shpagoi vetën përballë shkencës shqiptare. Institutet shkencore, Akademitë e shkencave, Katedrat albanologjike, Seminaret albanologjike janë bartëset kryesore të zhvillimi të shumanshëm të gjuhësisë shqiptare. A funksionojnë këto institucione sot si është më së miri për zhvillimin e gjuhësisë shqiptare? Duhet ta them se mbetet shumë për t'u dëshiruar. A u duhen reforma këtyre institucioneve? Përgjigjja është po. Reformat duhet të përfshijnë modernizimin e përmbajtjes së kërkimit shkencor dhe modernizimin e metodologjisë dhe teknologjisë, përfshirë këtu edhe ristrukturimet e tjera të nevojshme. Por, shkencës shqiptare i nevojitet edhe kjo - që politika e ditës të rrijë sa më larg saj dhe që nevojat kulturore për dije albanologjike të mos përmbushen me pseudodije e me pseudostudiues. Gjuhësisë shqiptare i nevojitet shumë, edhe një strategji e përbashkët mbarëkombëtare, një strategji reale, funksionale e parimore, për hapësirën tonë të përbashkët gjuhësore.

Mbetet shpresa se do të kapërcehen pengesat jashtëgjuhësore, socio-politike dhe socio-linguistike në hapësirën shqiptare dhe se do të nisë një praktikë e re e bashkëpunimit ndërakademik e ndërinstitucional në shtrirjen mbarëkombëtare për ta bëra gjuhësinë shqiptare një shkencë moderne mbi gjuhën shqipe, mbi historinë, mbi të sotmen e mbi të ardhmen e saj.

Akademik Gjovalin SHKURTAJ

NJË MBËRRITJE ME RËNDËSI E AUTORES

(*Shefkije Islamaj,* "Gjergj Fishta,*Gjuha dhe stili"*, I, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2012; Libri I, 528 faqe; Libri II, 569 faqe)

Emri i Shefkije Islamajt, punonjëse shkencore në Institutin Albanologjik të Prishtinës, është dukur shpesh e më shpesh në faqet e revistave shkencore albanologjike, si autore studimesh gjuhësore e monografish me interes kushtuar problemeve të sinonimisë së gjuhës shqipe dhe kulturës së gjuhës, ndërsa viteve të fundit, me një prodhimtari të begatë, ajo na del si autore e një vargu librash kushtuar gjuhës së letërsisë artistike ose ligjërimit të autorëve dhe problemeve aktuale të kulturës së gjuhës shqipe në Kosovë e më gjerë. Kemi parasysh, ndër të tjera, ndihmesën e saj në "Fjalor i fjalëve të huaja", Prishtinë, 1988, ku ajo është bashkautore, krahas një numri studiuesish në zë dhe, kryekreje, monografitë e saj të botuara si libra më vete: "Çështje të sinonimeve në gjuhën shqipe", Prishtinë, 1985, "Gjuha e Jakov Xoxës, Veçori leksiko-semantike dhe stilistike", Prishtinë, 2000, 422 faqe, "Kultura gjuhësore dhe përdorimi estetik i gjuhës", "Toena", Prishtinë 2002, 420 faqe, librin "Gjuha, ligjërimi dhe fjala", botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë, 2004, 302 faqesh, për të cilin,disa vjet më parë,kam shkruar e botuar edhe një recension vlerësues (Shih: Gj.Shkurtaj, *Kundrime gjuhësore*, Tiranë, 2006, f.203-208) dhe libri "Gjuha dhe identiteti" "Toena", Prishtinë, 2008, 333 faqesh. Më 204, me një "kalim në lëmin mirëfilli letrar", ajo do të botonte edhe një roman me titullin "Mos më thuaj se më ke parë ëndërr" (Toena) , të cilin, gjithashtu, kam pasur kënaqësinë ta merrja si dhuaratë nga vetë autorja dhe, besoj, jam nga më të parët që, edhe e kam përshëndetur e përgëzuar, jo vetëm për romanin, po sidomos për zotësinë e të shkruarit edhe në prozën artistike të mirëfilltë. Ndërkaq, e dija se ajo ishte në vlagën e punës për projektin "Gjuha dhe stili i Gjergj Fishtës", monografi e gjerë shkencore, disa krerë të së cilës ajo i ka botuar në revista shkencore të Kosovës. Dhe ja, më në fund, në prag të festimeve të 100-vjetorit të Pavarësisë, prof. Shefkija na vjen me një dhuartë tjetër, ***me peshë të rëndë e të madhe nga sasia e faqeve, po edhe të atillë nga brendia e trajtimi***. Sa më sipër dëshmon më së miri për prodhimtarinë e saj të begatë studimore, me prurje të shumta shkencore që rrokin fusha të ndryshme të gjuhësisë së sotme, fryte të një veprimtarie studimore dhe hulumtuese tashmë shumë-vjeçare të autores, po edhe dëshmi e bukur e qëndrimit të gjallë qytetar,

kurdoherë në mbrojtje e në mbështetje të plotë të gjuhës shqipe e të mbërritjeve të saj, kurdoherë në kahun e mbarë të njësimit, normëzimit dhe shtimit të vlerave e të shprehësisë stilistike të shqipes standarde. Librat, studimet dhe artikujt e dr. Shefkije Islamajt kushtuar kulturës gjuhësore dhe përdorimit estetik të gjuhës shkojnë në hullinë e mbarë të gjuhëruajtjes e të gjuhëpastrimit, çelur e mbajtur gjallë me dije e atdhetari të zjarrtë nga akad. Idriz Ajeti, i cili, sikundër dihet, ka gjetur rast e kohë për t'u marrë shpesh edhe me probleme "të vogla" të nomës së shqipes në mjetet e informimit, me gjuhën e shkruar e të folur në mediat shqiptare. Këtë hulli, me shumë përkushtim, por edhe me dijen e zellin që i duhet një kahu sa të brishtë e delikat, aq edhe të rendësishëm e aktual, zonja Shefkije Islamaj e ka bërë të vetin dhe po jep ndihmesa mjaft të mira e me dobi për kohën e sotme.

Kur botoi librin "Gjuha e Jakov Xoxës-Veçori leksiko-semantike dhe stilistike", Prishtinë, 2000, i cili është përuruar dhe përcjellë më fjalë e vlerësime të mira edhe në Tiranë, nuk kam qenë në Shqipëri, por, që nga Kalabria (ku isha me punë për një periudhë kohe), e kam ndjekur dhe e kam lexuar atë libër, i cili, në mënyrë të hapët e gati shtergueshëm, shtron, shqyrton dhe analizoon krejt ngrehinën gjuhësore e stilistike të një autori të rëndësishëm shqiptar, të Jakov Xoxës, i cili, ndoshta më shumë se cilido nga autorët bashkëkohës, në prozën e gjatë u kishte bërë vend edhe fjalëve, frazeologizmave, onomastikës edhe etnografisë së të folurit kosovarçe në mjedisin myzeqar, mbjellë sikundër dihet në vitet '30 të shekullit të kaluar. Kam ndjekur recensionet e kumtimet e bëra për librin e dr. Shefkijes nga disa prej kolegëve në Tiranë dhe, pasi e kam lexuar edhe unë vetë librin, jam bindur se i janë dhënë vlerësime të merituara. Madje, dëshiroj të shtoj se atë monografi, ua kam këshilluar si model pune doktorantëve e pasuniversitarëve që do të ndërmarrin tema studimore nga lëmi i gjuhës së autorëve, duke mëtuar që, qoftë edhe me vonesë, *për disa prej autorëve më kryesorë, të kemi studime sa më të plota rreth gjuhës e ligjërimit artistik*. Gjejmë rastin të themi se monografia e Shefkije Islamajt kushtuar gjuhës së Jakov Xoxës, bashkë me studimin e Fatmir Agalliut për gjuhën e Fan S. Nolit dhe artikujt tanë për gjuhën e Naim Frashërit, për romanin "Vdekja më vjen për syve të tillë" të Rexhep Qoses, për ligjërimin e Dritëro Agollit, Ndoc Gjetjes, Visar Zhitit dhe, së mbrami, për disa dukuri të gjuhës së I. Kadaresë (bashkë me T.Çaushin), po të shtojmë edhe librin e N.Sotirit "Fjalori i I.Kadaresë" ishin, ndoshta, gjithçka që ishte shkruar deri më sot për ligjërimin e autorëve shqiptarë, prandaj studiuesja jonë meriton të përgëzohet për nismën dhe mbërritjet e saj në atë lëmë. Po, le të ndalemi

në librin e saj më të ri "Gjergj Fishta,*Gjuha dhe stili*, I, (Fonostilistika dhe morfostilistika) Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2012, 528 faqe; Libri II, (Sintaksa stilistike dhe Leksiku, 569 faqe, të cilin e kam marrë qysh para dy javësh dhe e kam shfletuar, po edhe pjesën më të madhe edhe lexuar, me ëndje e me kujdes, prandaj, bashkë me fallenderimin që i takon se ma ka dhuruar librin, po lejohem ***të shpreh edhe unë disa vlerësime e pohime rreth vlerave të librit***, duke e konsideruar atë ***një mbërritje me rëndësi të autores, Shefkije Islamaj, po edhe si një ndihmesë të vlefshme e të mirëseardhur për një fushë ende të re***, por me vlera e mundësi për prurje e studime të rëndësishme rreth ligjërimit të autorëve shqiptarë të sotëm e të traditës, sipas një boshti ku peshorja stilistike e hijeshia gjuhësore, bashkë me leksematikën dhe "ojnat" fonetike e morfosintaksore, zbulojnë vlerat e vërteta të çdo shkrimtari të madh.

Libri "Gjergj Fishta,*Gjuha dhe stili*" mendoj se meriton të njihet, së pari, nga rrethet e mjediset shkencore të gjuhësisëe të letërsisë, po edhe nga masa e gjerë e arsimtarëve, sidomos e atyre të shkollave të mesme e të universiteteve shqiptare, duke qenë se aty, në përmasa e me thellësi të lakmueshme teorike e tekstologjike, si dhe me argumentime e shembullzime të përzgjedhura e të përthekuara më së miri me boshtin tematik të veprës, jepet një paraqitje e plotë, ndoshta edhe shteruese, e pasurisë, larmisë dhe vlerave të gjuhës e stilit të Gjergj Fishtës, njërit nga figurat më emblematike të letërsisë shqiptare.

Dhe, për të mos u zgjatur, po lejohem të vlerësoj,në mënyrë të veçantë pjesën e parë hyrëse të veprës, me titullin "Gjergj Fishta dhe vepra e tij, (Libri i parë, f.15-121 (pra, një studimi introduktiv prej më se 100 faqesh), të cilën do të dëshiroja ta kishin në dorë dhe ta lexonin me nge e me kalem në dorë të gjithë fishtologët dhe shkollarët shqiptarë, sepse aty, mund të thosha pa drojë se gaboj: më qartë e më kthjelltazi se askund tjetër në sa është shkruar deri më sot për Gjergj Fishtën, jepen të gjitha ***vlerësimet*** dhe ***dritë-hijet*** që i përkasin një figure si Ai.

Me lejen e të pranishëmve të nderuar, po lejohem të dal nga paraqitja e kumtit tim të shkruar, për të ilustruar me faqet e librit,disa prej pikave a "nyjave" të prekura me dorë të sigurtë nga studiuesja Islamaj në monografinë e saj, të cilat, për mendimin tim, janë me shumë rëndësi dhe vlerë aktuale. Fjalën e kam për sythat me titujt:

Midis lavdëruesve dhe mohuesve (f.22-32);
Receptimi i veprës (f.33-27);
Pse lexohet pak Fishta, sot? (f.37-39);
Pse duhet ta lexojmë Fishëtn sot? (f.39-40);
Si ta lexojmë Fishtën sot? (f.41-43);

Si ta vlerësojmë objektivisht Fishtën? (f.43-45);
Vepra e tij dhe epika popullore (f.46-60);
Vepra e tij dhe studimet gjuhësore-stilistike (f.61-66);
Stilistika gjuhësore (f.67-69);
Vepra e tij dhe botimet kritike (f.70-76);
Mbi një gjuhë të përbashkët shqipe (f.77-87);
Veçori të përgjithshme gjuhësore (f.88-102);
Të meta gjuhësore e stilistike (f.103-104);
Çështje drejtshkrimore (f.105-115).

Së mbrami, po theksoj se libri i Shefkije Islamajt mbështet në literaturë të gjerë, të shfrytëzuar e të cituar me kujdes, natyrisht, edhe duke mos qenë e mundur të jetë shteruese, as për gjithçka është shkruar për gjuhën e ligjërimin e veprave të Fishëts, sidomos artikuj e kumtesa të botuara në revista që dalin në Shqipëri, por që mesa duket jo gjithmonë përcillen edhe në Kosovë, po edhe disa trajtesa kushtuar gjuhës e stilit të letërsisë artistike në përgjithësi, në të cilat kemi sjellë ndihmesën tonë modeste sidomos me shtjellimet ne krerët e librit "Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran" (më herët si dispensë për studentët e Institutit të Lartë të Arteve, pastaj edhe si libër me shtyp të lartë (SHBLSH, Tiranë, 1988) dhe në librin "Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe" (Kristalina, K-H, Tiranë, 2003), pastaj në librat "Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur" (SHBLU, Tiranë, 1996), "Pesha e fjalës shqipe" - Studime të zgjedhura për gjuhën e letërsisë artistike - (UFO Press,Tiranë, 2009), porse këta libra, autorja nuk i ka pasur në dorë dhe nuk i përmend, por, pavarësisht nga kjo, *mua më pëlqen të vë re se jemi në të njëjtën hulli gjuhëmbrojtëse e gjuhëpastruese, jemi në të njëjtin kah të qëndrimit pohues e dashamirës të shqipes standarde dhe të rrjedhave të saj të mbara që do t'i sjellë asaj zhvillimi i mëtejshëm kulturor e më gjerë.*

E uroj dhe e përgëzoj edhe njëherë prof. Shefkije Islamaj, pikë së pari, për punën aq zelltare e të mirëseardhur që ajo është duke i blatuar kulturës së gjuhës dhe rrjedhave të sotme të normës gjuhësore në Kosovë e më gjerë, sepse na pëlqen që ajo, ashtu siç u ka ka hije gjuhëtarëve të vërtetë, *vijon pa asnjë lëkundje t'i dalë zot dhe ta mbrojë gjuhën standarde*, shqipen tonë të përbashkët e të përpunuar, duke e vështruar atë pikërisht ashtu siç është (dhe siç i takon të jetë sot e mot, sa të jetë jeta) si treguesin më të dukshëm të përbashkësisë kombëtare, shpirtërore e kulturore të shqiptarëve.

(*Paraqitur në përurimin e monografisë së prof.dr. Shefkije Islamajt "Gjergj Fishta – Gjuha dhe stili" në ASHSH, Tiranë, 22.10.2012*)

Shefkije ISLAMAJ

BOTIMI I PLOTË I VEPRËS SË FISHTËS – THESAR I KULTURËS SHQIPTARE

Kohë më parë Botimet *Fishta* publikuan veprën e plotë letrare e publicistike të Gjergj Fishtës. Është ky një lajm i mirëpritur prej gjithë artdashësve shqiptarë. Duke qenë se vepra e Fishtës konsiderohet thesar i çmuar i kulturës shqiptare, botimi i plotë i veprës së tij merr një rëndësi të shumëfishtë. Për të gjallë të poetit vepra e tij u botua dhe u ribotua shume herë. Për arsyet e gjithënjohura, pas vdekjes së tij, botimi i saj është bërë me vonesa të mëdha, ndërkaq në dy dhjetëvjetëshat e fundit ajo pati një botim shumë të madh. Në këtë kontekst secila nga veprat e tij e ka historinë e vet te botimit. *Lahuta ne Malcis* u botua më shumë herë se veprat e tjera dhe është e kuptueshme, sepse konsiderohet kryevepra e poetit. Kështu ajo filloi të botohet në vitin 1905 (në të vërtetë na dalin dy data, edhe viti 1904), në formën e një kënge me titull *Te ura e Rrazhnicës* e që përmbante në të vërtetë pesë këngë: *Marash Uci, Besa e lidhme*, *Kushtrimi, Ora e Shqypnis*. Shtatë vjet më vonë, më 1912, ajo u ribotua pa ndryshime, po kësaj radhe me titullin *Lahuta e Malcis, Marash Uci,* nga shtypshkronja "Nikaj"në Shkodër. Ajo kishte edhe një ribotim më 1932 me titullin *Lahuta e Malcis, Marash Uci. Lahuta e Malcis* si botim i plotë me 30 këngë, u botua në vitin **1937,** ndërsa u ribotua më **1939,** për arsye të jehonës së madhe që pati dhe kërkesave të lexuesve. *Lahuta e Malcis* u botua tri herë në Romë: në vitin **1958**, **1989** dhe **1991,** nga *Urbinati* dhe Qendra e katolikëve shqiptarë. Më **1990** u botua në Lubjanë të Sllovenisë në botim të revistës shqiptare *Alternativa*. Më **1997** e botoi Shtypshkronja françeskane në Shkodër. Po më **1997** e botoi "Rilindja" e Prishtinës, kurse më **1999** Sht. bot. "Dija&Buzuku", po kështu në Prishtinë. Po në vitin 1999 e botoi edhe Shtëpia botuese "Çabej" Tiranë. Në vitin **2000** e botoi "Toena" në Tiranë, kurse në vitet **2000 e 2002** Logosi në Shkup. Më **2001** nisi botimi i veprës së Fishtës në 10 vëllime nga Sht. bot. ***Gjergj Fishta* & Biblioteka *Gollettiana,*** brenda këtij kompleti ajo është përfshirë në vëllimin e katërt dhe u botua më **2002**. Më **2003** *Lahutën e Malcis* e botoi shtëpia botuese "Eugen" e Tiranës. Shtëpia botuese "Botime françeskane" e botoi *Lahutën e Malcís* më **2006.** Lahuta ka vazhduar të botohet deri sot. Kjo është historia e botimit të Lahutës, histori kjo që po vazhdon e do të vazhdojë. Po kështu sikur *Lahuta e Malcis* edhe veprat e tjera të Fishtës si *Mojsi Golemi e Deli Cena* (fragmente), veprat lirike: *Mrizi i Zanave, Pika voëset* e *Vallja e*

Parrizit, veprat dramatike: *Sh'Françesku i Asizit, Shqyptari i gjytetnuem, Juda Makabe, Baritë e Betlemit, Sh'Luigji Gonzaga, Shqyptarja e gjytetnueme, Ifigenija n'Aulli, Odisea* dhe *Jerina ose Mbretnesha e Luleve,* veprat satirike: *Anzat e Parnasit, Gomari i Babatasit, Visku i Babatasit, Taralloqja e Ballkanit* dhe *Nikolejda,* shkrimet publicistike të botuara në shtypin e kohës me karakter politik, shoqëror, arsimor, kulturor, gjuhësor, etj. kanë historitë e tyre të botimit. Deri sot ato janë botuar shumë herë dhe nga botues të shumtë. Vepra e Fishtës është botuar por jo plotë edhe nga redaksia e botimeve *Rilindja* në vitin 1997 në katër vëllime, kurse gjatë viteve 2000-2010 edhe nga Botimet françeskane.

Sot këtu kemi nderin ta përurojmë kompletin e veprave të Fishtës që na e sjell Shtëpia botuese *Fishta,* me botues Frano Kullin. Ky është kompleti më i plotë deri sot i veprës së Gjergj Fishtës. Ai ka dhjetë 10 vëllime brenda të cilave në vëllimet 1 e 2 gjejmë *Lirikat* e tij, në vëllimin 3 - *Përkthimet*, në vëllimin 4 - *Epikën,* në vëllimet 5 e 6 - *Dramatikën, Satirikën* në vëllimet 7 e 8 dhe *Publicistikën* – në vëllimin 10*,* me gjithsej 3413 faqe. Siç shihet edhe nga ky komplet veprimtaria e letrare e publicistike Fishtës është shumë e gjerë dhe e larmishme ndërsa për vlerën e saj, rëndësinë e saj letrare e kulturore, në përgjithësi, e kanë thënë fjalën e tyre tashmë studiuesit e saj. Ky botim i plotë i veprave të Fishtës do t'i mundësojë lexuesit të sotëm shqiptar ta njohë më mirë këtë veprimtari të gjerë e të larmishme letrare e publicistike. Në të vërtetë ky botim na e zbulon shumanshëm Fishtën si shkrimtar e estet, Fishtën si njeri, atdhetar e fetar, na e zbulon Fishtën si erudit, veprimtar, politikan, publicist, gjuhëtar, mësues. Përgatitjen e këtij kompleti e ka bërë redaksia në përbërjen e secilës gjenden emra të njohur të studimeve letrare e gjuhësore, të cilët janë, njëkohësisht, edhe ndër njohësit më të mirë të veprës së Fishtës. Ata janë dr. Ndue Zef Toma i cili ka përgatitut poezinë, prof.dr.Tefë Topalli epikën dhe përkthimet, prof.dr.Stefan Çapaliku satirën dhe prof.dr. Hamit Boriçi publicistikën bashkë me dr.Ndue Zef Tomën. Secili nga 10 vëllimet shoqërohen me nga një pasthënie në të cilët autorët përmbledhtë dhe në vija të përgjithësuara sqarojnë përmbajtjen dhe punën e tyre si redaktorë të këtyre vëllimeve. Botimi shoqërohet me ndërhyrje nga ana letrare – gjuhësore e me shpjegime të nevojshme filologjike. Botimi i këtij kompleti ka rëndësi të dyfishtë për lexuesin shqiptar: e para ka rëndësi njohëse – krijohet mundësia e secilit ta njihet me veprën e plotë të Gjergj Fishtës dhe, e dyta ka rëndësi shkencore – krijohet mundësia e studimit të mëtejshëm nga aspekte të ndryshme historiko-letraro-gjuhësore, në të vërtetë krijohet mundësia të lexohet e rilexohet në mënyrë kritike.

Ata që e kanë studiuar Fishtën e dinë se si shkrim i parë kritik për veprën letrare të Fishtës konsiderohet shkrimi i botuar në gazetën „La nazione albanese“, Pallagorio,15.4.1905, kushtuar botimit të Këngës së parë të *Lahutës së Malcis* - Te Ura e Rrzhanicës. Ndërkaq, sipas gjasash „më së pari gjuha e Fishtës është bërë objekt referimi, po jo studimi, nga studiuesi dhe komentuesi bashkëkohës i poetit, At Viktor Volaj para viteve ’40, sidomos, gjuha e tij poetike, kur Volaj ka botuar me shënime përmbledhjen „Mrizi i Zanavet“, kryesisht, duke u ndalur tek disa rregulla „Për këndimin metrik të vjershavet“. Edhe Justin Rrota do të tërheqë vërejtjen për disa veçori të gjuhës epike të Gjergj Fishtës. Për gjuhën e Fishtës quhet me peshë të veçantë edhe botimi: „Shpalime rreth Lahutës“ i autorit Tahir Kolgjini, botuar në Stamboll më 1969. Duhet të thuhet se deri sot mungojnë përpjekjet serioze për interpretimin dhe shpjegimin e veprës së Fishtës nga ana filologjike, sidomos gjuhësore, ose ato janë përpjekje fare modeste. Në këtë vijë botimi i këtij kompleti është ndihmesë e çmueshme për ta kuptuar e njohur më mirë veprën e Fishtës. Mund të thuhet më tej se redaksia e këtij kompleti ka bërë përpjekje të na sjellë një botim sa më të arrirë nga ana shkencore duke bërë edhe një redaktim të përgjithshëm filologjik. Puna e kësaj redaksie, e përpiluesve dhe e redaktorëve të këtij botimi, nuk është punë thjesht botuese, por është punë profesionale shkencore.

Të shohim ç’kanë bërë redaktorët e këtyre vëllimeve më konkretisht. E para që duhet të thuhet është se receptimi i veprës letrare të Gjergj Fishtës në opinionin shqiptar të kohës kur u shkrua e botua, por edhe vite më pas, ishte tejet i madh, ashtu sikur mund të thuhet edhe për funksionin e ndikimin e saj të madh shoqëror. Ai ishte shkrimtari më i lexuar në kohën e tij. Gjerësia e ndikimit të tij në vend ishte e paparë deri atëherë. Veprën e Fishtës e kanë lexuar jo vetëm lexuesit e ashtuquajtur “aktivë”, por edhe ata që nuk kanë lexuar kurrë. Fati i leximit të veprave të Fishtës ishte pothuajse i njëjtë në Shqipëri e jashtë saj, në trojet e shqiptarëve. Duke qenë se funksioni shoqëror, kulturor e moral i një letërsie ndërron në raport me rrethanat shoqërore, kulturore e politike, kuptimi i përgjithshëm i një vepre letrare duhet t’i nënshtrohet interpretimeve dhe vlerësimeve të ndryshme, edhe të reja. Në këtë kontekst edhe vepra e Fishtës sot duhet të interpretohet e të vlerësohet ndryshe, pra edhe të lexohet e të receptohet ndryshe. Për këto arsye lexuesi i sotëm i veprës së Fishtës, nuk është fjala për lexuesin e specializuar, duhet të ndihmohet me shpjegime e sqarime të ndryshme gjuhësore. Duke e ndier si detyrë shkencore e morale, që veprën e Fishtës dhe vetë Fishtën t’ia afrojnë lexuesit shqiptar me përmasat e tyre të vërteta, botuesi dhe redaksia e këtij botimi i ka hyrë një punë aspak të lehtë dhe jo pa dyshimin se mund edhe të kritikohen. Një nismë e tillë ka mbështesën

edhe te fakti se vepra e Fishtës sot botohet, ribotohet, studiohet, interpretohet, por fatkeqësisht ajo nuk lexohet shumë, për të mos thënë lexohet pak nga lexuesi i ri. Sigurisht një moslexim të tillë po e përjetojnë edhe veprat e shkrimtarëve të tjerë të mëdhenj, sepse sot lexohet në përgjithësi pak, sepse letërsia sot është bërë e konkurrueshme prej medieve të tjera, kurse leximi i veprës së Fishtës nuk lidhet vetëm me fatin e tij të keq në letërsinë shqipe për afro 50 vjet.

Kryevepra e Fishtës *Lahuta e Malcis* është shkruar për lexuesin e kohës së poetit dhe ai lexues kishte nivelin kulturor dhe psikologjik, mendësinë e filozofinë, etikën e estetikën e popullit shqiptar në përgjithësi, prandaj ajo u pranua e u këndua aq gjerësisht. Por, ky nivel kulturor dhe psikologjik, kjo mendësi dhe filozofi, sikur edhe kjo etikë e estetikë, sot gati se nuk njihen ose janë ndryshuar shumë. Kjo është një arsye tjetër pse botuesi dhe redaksia e këtij botimi i kanë hyrë një pune aspak të lehtë – botimit të veprës së plotë të Fishtës me shënime filologjike. Botimi është konceptuar "për një lexues mesatar, pa hyrë në shpjegime të thella filologjike, kulturore dhe etnokulturore". Qëllimi i botuesit dhe i redaktorëve është më së i qartë "përcjellja e veprës së Fishtës tek lexuesi i sotëm, me "krehje" sa më të lehta në formë dhe më shënime të domosdoshme e të thjeshta: për leksikun, frazeologjinë e herë-herë strukturën e ndërlikuar".

Vepra letrare e publicistike e Fishtës sot është futur në të gjitha shkollat shqipe, por a është gjetur mënyra më e mirë për të prezantuar atë dhe shkrimtarët e tjerë të traditës para nxënësit shqiptar është tjetër punë. Mosleximi i veprës së Fishtës nuk mund të lidhet kryekëput, siç e lidhin mjaft studiues e të tjerë, me tematikën jo aktuale të veprës së tij, as edhe me formën artistike të tejkaluar a me estetikën "arkaike" siç e thonë disa, por edhe me gjuhën e vështirë të saj. Së këndejmi puna e bërë nga redaksia në këtë aspekt që këtë gjuhë, për aq sa ka qenë e mundur ta çojë te lexuesi i sotëm, meriton mirënjohjen.

Duhet ta themi se problemin e mosleximit të shkrimtarëve të traditës nuk e kanë vetëm shqiptarët. Edhe kulturat e tjera kanë shkrimtarë që lexohen vështirë sot pikërisht për arsyet e sipërthëna, por që gjejnë mundësinë për t'i "shfrytëzuar" vlerat e tyre në formimin e brezave. Po kështu, kulturat e tjera, shoqëritë e tjera, kanë krijuar standarde të veçanta për vlerësimin dhe për trajtimin e traditës, prandaj edhe për leximin dhe receptimin saj. Në këtë drejtim ky botim them se shënon një gur përpjekjeje me peshë për këtë lexim e receptim sot, sepse e dimë fare mirë se një rrugë e përshtatshme që do ta lehtësonte receptimin e veprës së Fishtës është "përshtatja" e saj me kërkesat didaktike, etike, estetike e gjuhësore, ashtu siç e bëjnë të tjerët dhe siç janë bërë do punë të vogla në këtë drejtim edhe

te ne me veprën e Naimit, të Çajupit, më në fund siç janë përshtatur nga Mitrush Kuteli *Cikli i Kreshnikëve,* nga Odise Grillo *Lahuta e Malcis*, apo vepra e De Radës a e ndonjë shkrimtari tjetër, të cilat vijojnë të jenë burime për përjetime estetike edhe sot. Sigurisht që përshtatja dëmton pak a shumë dhe jo vetëm anën thjesht gjuhësore, por në anën tjetër ndihmon njohjen e trashëgimisë kulturore, ndihmon përjetimin estetik dhe krijimin e shijes estetike. Vepra letrare e Fishtës dhe publicistika e tij kërkojnë sot lexues të parapërgatitur. Por, botuesve dhe studiuesve që merren e do të merren me këtë punë nuk duhet t'u mungojë përpjekja në asnjë rast për t'ia ruajtur autenticitetin, veçoritë epiko-heroike ose lirike, veçoritë kuvendtare-arkaike dhe gjuhësore-stilistike. Në këtë drejtim për aq sa kam pasur mundësinë ta vërejë autorët kanë treguar kujdesin e duhur.

Ata që e njohin mirë veprën e Fishtës kanë pasur mundësinë të shohin se vepra e Fishtës edhe pse e konsideruar vepër me vlera të larta artistike e gjuhësore nuk ka arritur t'i shmanget dot, si e thotë, pos të tjerëve, edhe Namik Resuli "disa të metave, disa përsëritjeve të tepërme e një farë "proliksiteti" që e bën at herë monotone e diku diku të çalë". Në këtë ana puna e redaktorëve të saj në këtë botim, mund të përligjet lehtësisht.

Ata që e njohin mirë veprën e Fishtës kanë pasur mundësinë të shohin se vepra e Fishtës shpreh pasuri të madhe etnokulturore e psikologjike, që na vjen përmes dokeve, zakoneve, riteve, miteve, legjendave, shprehjeve e kategorive të ndryshme gjuhësore si proverba, ndërtime të ngurosura, mallkime, urime, përshëndetje, shumë nga të cilat sot nuk jetojnë dhe as nuk njihen nga lexuesi i sotëm. Që t'i afrohen ato lexuesit janë parë me të drejtë të arsyeshme shpjegimet e nevojshme. Dhe këtë e bëjnë mirë studiuesit si anëtarë të redaksisë së këtij botimi.

Ata që e njohin mirë veprën e Fishtës kanë pasur mundësinë të shohin se vepra e Fishtës shpreh pasurim të ndjeshëm me leksik dhe frazeologji: pasuri të madhe të dialektizmave, të gegizmave lokale, të arkaizmave, të fjalëve të huaja, të leksikut me përcaktuesin fetar e të neologjizmave vetjake, kjo e ka bërë në shumë raste të domosdoshme të jepen shpjegime të nevojshme për t'u kuptuar vepra letrare e publicistike e Fishtës. Edhe nga kjo anë studiuesit si anëtarë të redaksisë së këtij botimi kanë bërë punë të dobishme. Shpjegimet gjuhësore filologjike për fjalët, shprehjet e rralla, krahinore e dialektore, për emra personalitetesh e ngjarje janë shpjeguar në formën e fusnotave në çdo faqe me sinonime, perifrazime të kuptimit, kur e kur me shprehje të përshtatshme frazeologjike dhe me shënime historike në raste të veçanta. Sipas autorëve si mbështetje filologjike për këtë qëllim janë shfrytëzuar: *Fjalori i Bashkimit* (*Fjaluer i Rii i Shqypes*, 1908; bashkë me *Fjalorin italisht-shqip*, 1986); *Fjalori* i

Fulvio Kordinjanos, 1938,; *Visaret e Kombit,* Vëllimi XI, i Nikollë Gazullit, 1941; *Shpalime rreth Lahutës* i Tahir Kolgjini, Stamboll 1969; *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja* i Mikel Ndrecës, 1988; *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe,* 1980; *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe* i Jani Thomait, 1999; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar,* 1986 etj.; kompleti i veprës së Fishtës, *Rilindja,* Prishtinë, 1997, si dhe studimet, publicistike, monografike shkencore kushtuar Fishtës në dy dekadat e fundit.

Ata që e njohin mirë veprën e Fishtës kanë pasur mundësinë të shohin se vepra e Fishtës shpreh në rrafshin e fonologjisë dhe të morfologjisë modifikime të shumta dhe ato është vështirë të dallohen pa një studim tejet të hollë për të kuptuar nëse këto modifikime janë bërë në mënyrë të ndërgjegjshme, nga arsyet poetike e stilistike. Këto modifikime ose lëvizje strukturore në rrafshin fonologjik e morfologjik, në të shumtën e herës, kanë bazë nxitjen artistike. Megjithatë një dorë modifikimesh të tilla janë të paqëllimshme, të pamotivueshme artistikisht dhe mund të konsiderohen si gabime, shmangie, pakujdesi ose si jo parimësi gjuhësore dhe drejtshkrimore. Këtë gjë e kanë pasur parasysh studiuesit redaktorë të këtij botimi komplet, prandaj mendoj se është bë një punë e nevojshme, sepse siç del nga fjalori i Fishtës i nxjerrë në formë elektronike Fishta përdor deri edhe katër a pesë variante a forma fonetike të një fjale (*kamadoras, kamandoras, kamandorës, kambandores; nentrasha, nenshtrasha, ndeshtrasha, ndigio, ndigijo, ndigjo rranë, rrazë, rraxë; lumoj, limoj, lmoj; kaçabet, kaçubet; djelm, djelmoça, djelmosha, djemoça, djaloça, djalosha kajmekam, kajmekan; kahmotit, kahmot; kahera, kaherë; rrqasë, rrshas; kamadoras, kamandoras, kamandorës, kambandores, mjegull, ndjegull; kanu-ja, kanuni, haru-ja, haruni* etj.) Dhe paraqitja këtyre varianteve nuk përligjet gjithmonë me funksionin stilistik, ritmik ose eufonik. Shpresoj që autorët t'ia kenë dalë me sukses përdallimin në këtë rrafsh dhe ta kenë cenuar sa më pak tekstin e Fishtës. Që puna të dalë më e mirë, autorët, kanë bërë krahasimin me të gjitha botimet e veprave me qëllim të mënjanimit të gabimeve të mundshme shpesh edhe të pashmangshme.

Ata që e njohin mirë veprën e Fishtës kanë pasur mundësinë të shohin se vepra e Fishtës shpreh do probleme edhe me drejtshkrimin. Siç na është e njohur për të gjallë të tij nuk u arrit një normëzim i kodifikuar as brenda dialekteve e as i një gjuhe të përbashkët letrare. As Komisia e Shkodrës (1916-17), ku Fishta luajti një rol të madh, nuk arriti të ndryshonte gjendjen në fushën e standardizimit të një drejtshkrimi që do të pranohej gjerësisht. As ai vetë nuk ndoqi kodin që u përcaktua në këtë Komisi. Edhe pse pas Komisisë së Shkodrës, vërehet një qëndrueshmëri

më e madhe në drejtshkrimin e Fishtës, sidomos në rrafshin fonetik e morfologjik, mund të thuhet se ai nuk u kujdes shumë për drejtshkrimin e tij, në të vërtetë drejtshkrimi në veprën e tij letrare shpreh mjaft lëkundje e joparimësi. Këto joparimësi drejtshkrimore vërehen më së shumti në: përdorimin grupeve të bashkëtingëlloreve *nd, mb, ng,* etj., në përdorimin e togjeve *ue, ie, ye,* etj., përdorimin e theksit dhe të shenjave diakritike për gjatësinë e hundorësinë, etj.; shkrimin e *ë*-së theksore, *ë*-së patheksore, *ë*-së fundore; shkrimin e trajtave të shumësit; përdorimin e foljeve ndihmëse dhe të formave arkaike dialektore të pjesoreve gege; përdorimin e rasave dhanore-rrjedhore; përdorimin e trajtave të shkurtra; përdorimin e disa parafjalëve dhe pjesëzave; përdorimin e formave me metatezë; përdorimin e apostrofit; përdorimin e vizës ndarëse; shkrimin e shkronjës së madhe, etj., etj. Për këtë arsye autorët e përgatitjes së këtij kompleti janë përcaktuar që të bëjnë mjaft ndërhyrje dhe në këtë drejtim ata kanë arritur të bëjnë një normëzim duke u përpjekur maksimalisht për të mos prekur metrin, rimën, ritmin, theksin.

Duke e përfunduar këtë fjalë paraqitëse për botimin e plotë të veprës së njërit prej shkrimtarëve më të mëdhenj shqiptar, veprës së Gjergj Fishtës, dua të them se botimi i plotë i veprave të një autori si Fishta kërkon punë të ngulmët, përkushtim e zell dhe mbi të gjitha njohje jo vetëm të veprës së autorit, por edhe të dije të hollë filologjike. Ky botim nga kjo anë ka plotësuar kriteret bazë për t'u quajtur botim me vlerë profesionale shkencore. Dua të them, po kështu se për një autor nuk ka dhuratë më të madhe sesa botimi i plotë i veprës së tij. Por ky botim nuk është dhuratë vetëm për Gjergj Fishtën, por dhuratë edhe për lexuesin shqiptar, i cili tashmë ka në dorë veprën e plotë të Gjergj Fishtës, të përgatitur me shumë kujdes nga ana profesionale dhe nga ana teknike.

(*P.S. Fjalë e paraqitur me rastin e përurimit të kompletit të Fishtës në Institutin Albanologjik të Prishtinës, më 15.5.2013*)

Sutki MALOHOXHA

HAFIZ ALI ULQINAKU NË KUJTIMIN E BREZAVE

Duke patur dëshirë t'i them disa fjalë për Hafiz Ali Ulqinakun në këtë mbrëmje përkujtimore, me rastin e 100 vjetorit të vdekjes së tij, po e filloj me një varg kuptimplotë dhe filozofik nga kryevepra e tij – Mevludi, ku thuhet:

A ti Dynjanë, a Dynjaja t'mujti ty?
A e mblodhe mallin ti a malli ty?
A e le Dynjanë, a Dynjaja t'la ty?
A ti Dynjanë a dynjaja t'rrejti ty?

Hafiz Ali, ne pasardhësit e tu, nuk u rrejtëm as nuk të harruam. Përkundrazi, me respekt të madh ndaj figurës dhe veprës tënde, sonte po e shënojmë 100 vjetorin e vdekjes. Hafiz Ali Ulqinaku lindi në Ulqin në vitin 1853, në familjen e një barkatari me banim në Ranë. Emri i babait të tij ishte Jakub Behluli, prej fisit Usta Ali, me profesion barkatar. Në Ulqin e thërrisnin edhe Hafiz Ali Gjoka.* Shkollimi i Hafiz Aliut u bë në dy faza, shkollën fillore dhe një pjesë të medresesë e kreu në Ulqin, ndërsa vazhdimin dhe përfundimin e saj në Shkodër, në medresenë e Bushatllinjve, ku mori edhe ixhazetin (diplomën). Në medresenë e Ulqinit mësues pati myftiun Sali ef. Hylen. Me rënien e Ulqinit nën Malin e Zi, familja e Aliut bashkë me qindra familje të tjera ulqinake u shpërngulën në Shkodër. Aliu në Shkodër, përveç përfundimit të shkollës, fitoi një përvojë të pasur nga personalitete kulturore e përparimtare të kohës nga traditat e shquara të qytetit të lashtë e me histori të shkëlqyer si dhe nga ndikimi i qyteterimit dhe kulturës perëndimore. Hafiz Aliu në vitin 1882 emërohet mësues i shkollës fillore në lagjen Dudas të Shkodrës. Në vitin 1884 u transferua në Lezhë, ku fillimisht kreu detyrën e mësuesit e të imamit. Falë cilësive të tij pozitive, në vitin 1899 merr titullin e nderit Myfti i Lezhës. Këtu do të vendoset familjarisht e do të qëndrojë 24 vjet radhazi, deri në fund të jetës së vet. Ky qytet do t'i bëhet si një vendlindje e dytë. Këtu do të njohë kulmin e karrierës së tij, do të realizojë prodhimtarinë më të rëndësishme kulturore dhe do të lërë pasardhësit që jetojnë edhe sot e kësaj dite. Hafiz Aliu vdiq në Lezhë dhe u varros në Shkodër, më 23 prill 1913 në oborrin e Xhamisë së Shaban-efendisë në lagjen Mahalla e Re, me një ceremoni

prekëse e me pjesmarrje të gjerë popullore. Varri i tij sot nuk gjendet.

Veprimtaria e Hafiz Ali Ulqinakut shtrihet në disa fusha kryesore, në atë të letërsisë, të gjuhësisë, të arsimit e në atë fetare. Në fushën e letërsisë kryesisht është përkthyes. Në vitin 1873 në Ulqin ka përkthyer Mevludin nga poeti i famshëm Sulejman Çelebi nga qyteti Bursa, duke përdorur alfabetin arabo-osman. Përveç përkthimit të Mevludit, ai bëri edhe disa përshtatje dhe shtoi disa vargje origjinale. Ka përkthyer edhe disa vargje me titull "Huda Rabbim" të dijetarit e filozofit turk Haki Erzurum. Përveç këtyre përkthimeve, përktheu dhe përshtati në vargje edhe disa njohuri fetare. Këto tri vepra i botoi në Stamboll në vitin 1887. Sa i përket fushës së gjuhësisë Hafiz Aliu ka hartuar tre fjalorë. I pari është turqisht-shqip në vargje, i dyti turqisht-shqip me rend alfabetik dhe i treti me të njëjtin kriter shqip-turqisht. Me nderim të vendlindjes të tre fjalorët i quajti "Ulqin". Të tre fjalorë gjithsejt kanë 1334 faqe dhe për bazë kanë të folmen e Ulqinit, me ndikime të folmes e Shkodrës dhe Lezhës. Fjalorët kanë vlera leksikografike, leksikologjike dhe dialektologjike për historinë e gjuhës. Fjalorët mbetën në dorëshkrim. Në fushën e arsimit ka hartuar një abetare shqipe të shkruar me shkronja arabe. Fillon me alfabetin që ka 40 shkronja, 30 bashkëtingëllore dhe 10 zanore. Ka edhe një gramatikë të shkurtër. Abetarja gjithashtu mbeti në dorëshkrim.

Në fushën fetare ka kryer detyra të ndryshme. Ishte hoxhë, imam dhe myfti. Në këtë fushë veprimtaria e tij ishte shumë e pasur, kështu që ruhet edhe përmendet edhe sot. Stambolli e ka vlerësuar shumë Hafiz Aliun. Në një shkresë nga Stambolli dërguar Hafizit thuhet: "Ylemasë së madh Hafiz ef. Myftisë së Lezhës, hirësisë suaj ju dërgojmë këtë shkrim, duke kërkuar një fetfa, si t'ua marrë mendja juaj, ne kemi nevojë për këshillat tuaja, prandaj me na urdhërue këtu në Turqi, si myfti, sepse gjykimi e fjala e zotnisë suaj ka rëndësi për ne". Ftesën Hafizi e rrefuzoi, nuk donte të bëjë karierë, por donte t'i shërbente popullit të vet.

Me Hafiz Ali Ulqinakun mburren tre qytete: Ulqini, Shkodra dhe Lezha. Studius të ndryshëm të këtyre qyteteve dhe anë e mbarë botës e vlerësojnë atë nga këndvështrime të ndryshme, disa në tërësi, disa në aspekte të veçanta. Për këtë figurë markante janë mbajtur tubime të shumta shkencore, simpoziume, mevlude dhe takime.

Për Hafiz Ali Ulqinakun janë mendime të ndryshme: a hyn apo jo në rrjetin e bejtexhinjve?

Është mendimi se me bejtexhinjtë, Hafiz Aliu ka lidhje vetëm me alfabetin arab. Por, nuk duhet menjanuar organizimin strukturor të

vargjeve të tija, përdorimin e figurave dhe kadencën metrike, ose ndryshe, prozodinë të cilën ai e përdor, në modelimet e strofave që janë të ngjajshme me ato të bejtexhinjve. Dihet se krijimtarinë e bejtexhinjve e cilësojnë: botëkuptimi islamik dhe ndikimi i letërsisë arabe. Duhet përmendur personalitetin e gjithanshëm të Hafiz Aliut. Në monografine "Heti, njeri i urtë i Shkodrës", të autorit Sami C. Zaja, kur flet për bejtexhinjtë e Ulqinit, për marrëdhëniet mes Shkodrës e Ulqinit në aspekte të ndryshme të jetës, për miqësinë mes humoristëve të të dy qyteteve, për ceremonitë e dasmave, jep të dhëna për miqësinë e Hetit** me Hafiz Ali Ulqinakun, për vlerat e tyre. Për këtë flet edhe bejtja e Hetit, ku thuhet:

Unë n'Ulqin s'desha me ardhë
Porse m'pruni zemra e bardhë,
M'pruni miku, zotni burrë
Që i don bejtet si n'furrë.

Një ngjarje e bukur e kësaj tradite është "ndeshja" e zhvilluar në mes të humoristëve të Shkodrës dhe të Ulqinit. Hafiz Ali Ulqinaku e kishte ftuar Hetin në një dasmë në Ulqin. Këtu Hetin e pritën me shumë përzemërsi dhe respekt për emrin dhe namin e madh që e kishte fituar. Në këtë gëzim ishte ftuar edhe bejtexhiu vendas "me namë", Cafi Hasanagës. Të dy bejtexhinjë i vendosën përballë njëri tjetrit në sofrën e dasmës, të rrethtuar nga shumë dasmorë. Bile edhe trapazanët ishin mbushur me gra dhe të gjithë prisnin me padurim fillimin e "duelit". Miku i Hetit - Hafiz Ali Ulqinaku, pasi uroi çiftin për lumturi, ftoi dy bejtexhinjë të fillonin, duke krijuar vetë ai një bejte aty për aty:

Le t'i lutna Perendisë
Për këtë dasmë në Ulqin,
T'na shkojë mbarë e plot lezet
Porsi mjalti me pekmez.

Ballë për ballë dy bejtexhinj
Njeni prit e tjetri qit,
Tash na knaqin tue këndue
E tue qeshë tash biem teftik.

Mbas kafazit rri grania
Kangë e bejte tue ndigjue,
Cafi i Zyles n'bejte idhnak
Heti i Sylos për merak.

Nga kjo shifet se edhe për këtë llojë të krijimtarisë letrare Hafizi ka patur aftësi.

Kush janë pasardhësit e tij?

Diçka më tepër për Hafiz Ali Ulqinakun mësova nga takimi im që e pata me mbesën e tij, zonjën Sulltanë Said Zylja në Shkodër, me datën 31 janar 1992. Në mes të tjerash, zonja Sulltanë më tha:

- Hafiz Aliu ka pasur një djal – Saidin dhe vajzën Fahrijen, e cila ka jetuar në Peshkopi. Ishte e martuar për Selim Sirrin. Pasi ky u sëmuar, erdhën për të jetuar në Lezhë. Ajo ka pasur dy fëmijë: Djalin Muhametin – gjinekolog dhe vajzën Fiqirijen, e martuar për Kurta-begun nga Shasi. Djali i Hafizit – Saidi gjithashtu ka ushtruar detyrën e hafizit. Ka lindur në vitin 1892 dhe vdiq në vitin 1946, në moshën 54 vjeçare. Detyrën e hafizit e përvetësoi nga i ati Hafiz Aliu. Hafiz Saidi ka një djalë – Abdullahin i cili jeton në Lezhë, dhe dy vajza: Sulltanën dhe Nurijen. Nga zonja Sulltanë mësova se Hafiz Aliu në abetare punoi 6 muaj me radhë. Abetarja është e shkruar me një dorëshkrim të mrekullueshëm. Tërë këtë kohë ka ndejtur pothuajse i mbyllur në një dhomë. Bashkëshortja e tij e vizitonte në dhomë vetëm atëherë kur i ipte ujë dhe drekën. Abetarja në dorëshkrim sot gjendet në Arkivin e Shetit në Tiranë. Zonja Sulltanë në shtëpi e ruante Mevludin e Hafizit, por me parathënien e djalit të tij – Hafiz Saidit. Mevludi ishte shumë i vjetër. Vendin dhe vitin e botimit nuk e kishte.

Me datën 2 shkurt 1992 në Lezhë u takova me zotëri Abdulla Said Hafizi, nipin e Hafiz Aliut. Gjatë një bisede miqësore, zorëri Abdulla më tha:

- Përveç abetares që jeni në dijeni, gjyshi im ka shkruar edhe fjalorin shqip-turqisht për më pak se 3 muaj. Origjinalin gjyshi e ka nisur për në Stamboll, me qëllim që të botohet atje. Kopja e këtij fjalori gjendet në Arkivin e Shtetit në Tiranë. E di se e kanë sjellur nga Berati. Qeveria turke e ka ftuar gjyshin tim për të shkuar në Stamboll, për të punuar si këshilltar në Këshillin e ylemave. Ftesën e ka rrefuzuar. Ftesa për të cilën bëhet fjalë sot e kësaj dite gjendet në Muzeumin e Lezhës. Zotëri Abdulla i kujtohet se Hafiz Aliu e kishte këshilluar bashkëshorten e tij që t'i ruajë shumë librat të cilat i takonin Hafiz Aliut, kuptohet pas vdekjes së tij. Aq e këshilloi, sa që i tha: -Nëse diçka ndodh në shtëpi, nëse shtëpia digjet, shiko ta shpëtosh pakon me libra, patjetër. Zotëri Abdulla në shtëpi kishte një kompozim të bukur. Një piktor lezhjan e kishte pikturuar Hafiz Aliun duke qëndruar në këmbë. Këtë kompozim shumë e ruante si ai, ashtu edhe tërë familja e tij. Hafiz Aliu i përket plejadës së nderuar të figurave

të shquara të kulturës sonë. Jeta e tij nuk ka qenë e qetë. Përkundrazi, ajo qe e vështirë, plot shqetësime e brenga, me lëvizje të detyruara nga rrethanat tragjike-historike. Edhe pse jetoi në këto rrethana, Hafiz Aliu falë talentit të tij të madh për të krijuar në disa fusha, na ka lënë një trashëgimi të vyer. Prandaj, vepra e tij duhet të kujtohet me nderim, me vlerësim e me mirënjohje nga brezat. Kështui, shpesh duhet të na kujtohet vargu me të cilin ia fillova dhe po e përfundoj, varg ky mbi të cilin të gjithë ne duhet të mendohemi:

A ti Dynjanë, a Dynjaja t'mujti ty?
A e mblodhe mallin ti a malli ty?
A e le Dynjanë, a Dynjaja t'la ty?
A ti Dynjanë a dynjaja t'rrejti ty?

.....

* Një herë në një tubim të gjërë popullor e pyetën Atë Gjergj Fishtën pse Hafiz Aliu quhej edhe Ali edhe Gjokë. Ata morën këtë përgjigje nderuese: "Hafiz Aliu e ka mendjen okë".

** Heti i Molla Sylos (emrin e kishte Muhamet) lindi në një familje qytetare shkodrane në një gjendje jo të mirë ekonomike, në vitin 1850. Që i vogël u dallua për zgjuarësi dhe vullnet për dije. Nuk pati mundësi të vazhdojë shkollën. Për një farë kohe ndoqi mësimet në mejtep mbi fushën e teqes afër Pazarit të Shkodrës. Zelli i madh për mësim e bëri që në mënyrë autodidakte të përvetësonte mirë turqishten e deri diku edhe arabishten. Pa bërë ndonjë shkollë shqipe e mësoi vetë gjuhën amtare. Që heret i lindi dashuria për poezinë popullore, krijimtarinë folklorike. Frekuentonte mjediset e ahengjeve, të hokatarëve. Ka punuar rrobaqepës në Pazar të Shkodrës. Në këtë mjedis zejtarësh është kultivuar shumë humori. Në moshën e thyer vuri çallmë dhe u mor me punë feje. U quajt Molla Het. Ka qenë shumë inteligjent dhe ka pasur kujtesë të fortë. Edhe pse ka jetuar shumë thjeshtë, kurrë nuk i ka shtrirë dorën kujt. Vdiq më 1928.

LITERATURA:

1. Faik Luli, Hafiz Ali Ulqinaku – Personalitet i kulturës shqiptare, në: Dituria islame, nr. 9 (70), Tiranë, 1995, fq. 4
2. Tonin Çobani, Gjuha ime është shqipja, në: Koha jonë, mr. 3, Lezhë, 1990, fq. 4.
3. F. Luli – I. Dizdari – Hafiz Ali Ulqinaku – Jeta dhe vepra, Logos, Shkup 2005, 36.
4. Po aty, fq. 456-457
5. Sami C. Zaja – Heti, Njeriu i urtë i Shkodrës, "Idromeno", Shkodër, 2000

Shënim: Kumtesa është lexuar në Mbrëmjen përkujtimore kushtuar 100 vjetorit të vdekjes së Hafiz Ali Ulqinakut, më 26 prill 2013.

ARKITEKTURË

Ing. arch. Mentor LLUNJI

EVOLUCIONI I (JO)TRANSPARENCËS SË INXHINIERISË STRUKTURALE

Hyrja

Kush duhet sot të jetë përgjegjës për projektet komplekse arkitekturale? Çfarë roli luan inxhinieri në arkitekturën e sotme? A duhet të mbes vetëm bashkëpunëtor i jashtëm apo duhet të ketë statusinë e një partneri të barabartë në procesinë projektues?

Këto, edhe shumë pyetje tjera lidhur me pozitën e konstruktorit të sotëm, kërkojnë përgjiigje dhe janë temë e diskutimit jo vetëm sot, por gati një shekull.

Arkitektura sot, është diçka ndërmjet artit, modes dhe strukturës. I ka karakteristikat e disciplinave të ndryshme, e mbi të gjitha, është e llojllojshme. Fakt është se, sot nuk ekziston kurrfarë stili internacional, apo një mënyrë e vetme e vështrimit të arkitekturës dhe botës perreth. Si duket shekulli i kaluar i ngjalli arkitektët, ato e rizbuluan lirinë të krijojnë dhe të paraqiten si artist dhe arkitekturën ta konsiderojnë dhe prezantojnë si art të vërtet. Zhvillimi i hovshëm teknologjik, i cili si i tillë qe inspirim në vete ka hapur dyert për forma të reja joeuklidiane, të cilat janë bërë aq të përditshme, njëjtë siç ishin dikur kupolat dhe format e ndryshme kubike. Pikërisht ky kompleksitet i formave kërkon që konstruktori të qëndrojë sa më afër arkitektit e mos të jetë vetëm një këshilltar i jashtëm. Diçka është e sigurt, se bërja e arkitekturës që nga fillimet e këtij profesioni ka qenë një aventurë interdisciplinare, pa kufij ndërmjet ëndrrës dhe realiteti, dizajnit dhe inxhinierisë dhe prej fillimit arkitektura nuk është arritur vetëm me përfshirjen e arkitektit, por me kontributin e ndërtuesve, filozofëve, historianëve dhe, mbi të gjitha, inxhinierëve. Kjo ndërvarshmëri e arkitekturës dhe inxhinierisë, me tëpër se kurrë më parë, ngacmon në diskutimin rreth çështjes së pozitës të inxhinierit strukturist në procesin krijues.

Në mes të artit dhe shkencës

Candela, inxhinieri meksikan me prejardhje spanjolle i cili krijoj reputacion botëror ne projektimin dhe ndërtimin e guaskave, shpjegoi më

së miri mardhënien e tensionuar inxhinier-arkitekt me fjalët**:** *"Faza e dytë projektuese, kryesisht përbëhet prej luftës së rëndë ndërmjet inxhinierit dhe arkitektit. Në njërën anë, inxhinieri tenton të fus modifikime, të cilat mund të jenë të domosdoshme, mirëpo në shumë raste edhe jo,ndërkaqë në anën tjetër arkitekti dëshiron ta mbajë formën dhe idejën e paramenduar, por nuk ka armë të luftojë argumentet shkencore të inxhinierit. Eshtë një dialog i pamundur ndërmjet njerzve që flasin dy gjuhë të ndryshme*".(5)

Me këte definim të interaksionit arkitekt-konstruktor, nuk pajtohen të gjithë. Eshtë një çështje tejet subjektive e cila përveç nga natyra komplekse e problemeve ndërtimore, në masë të madhe varet edhe nga personaliteti i arkitektit dhe strukturistit, si dhe nga qasja e të dytit ndaj arkitekturës. Eshtë çështje e kompatibilitetit të qëndrimeve, dijenive, karaktereve dhe historisë profesionale si të arkitektit ashtu edhe strukturistit. Sidoqoftë një numër i madh i inxhinierëve bashkëkohorë ka vendosur të pozicionohet si '*dorë e djathtë e arkitektit*' dhe ta kuptojë punën arkitekturale si vepër të pastër arti të cilës duhet t'i jepet mbështetje strukturale. Kjo qasje është shans i mirë sidomos për 'aventurierët' apo 'egzibicionistët' struktural, të cilëve vëç tjerash i mundësohet dalja nga monotonia si dhe hulmtimi në krijimin e formave të reja dhe impresive. Pa dyshim që eshtë qasje bashkëkohore, por edhe fakt është që krijohen struktura të cilat së paku nga aspekti ekonomik shpesh nuk janë të arsyshme dhe mund të ndodhë që mos të ofrojnë zgjidhjen më të mire strukturale. Mendimi i fundit kontestohet nëse pajtohemi se këto struktura janë skulptura të mëdha me një funksion të caktuar, te të cilat aspekti estetik duhet t'i lihet arkitektit; e nëse pajtohemi që aspekti estetik nuk duhet të diskutohet nga strukturisti, atëherë edhe çështja e kostos nuk duhet të konsiderohet. Këtë filozofi e ndajnë shumë inxhinierë bashkëkohorë. Akceptimi i profesionitit të strukturistit nga strukturisti si shërbim joimagjinativ, sidomos nga të painformuarit, dhe discipline racionale që ofron vetëm zgjidhje të pastërta teknike, reflekton me kufizime të shumta si në formë, ashtu edhe në funksion të objektit. Krijohen objekte ekonomike dhe të sigurta, megjithatë, historikisht është vërtetuar se këta inxhinierë janë të gjykuar në pasuksses. Akuzohen për mungesë imagjinate dhe mungesë të dëshirës për eksperimentime, si dhe në shumicën e rasteve zavendësohen me ato "më të sukseshmit", të cilët shpesh nuk janë edhe më të mirët. Lidhur me këtë Inxhinieri i famshëm shekullit XX, ***Ove Arup*** dha një mendim shumë interesant: *"Problemet kryesore të inxhinierëve, vijnë kryesisht nga arkitetektët, për shkaqet të cilat në shumicën e rasteve janë shumë të*

arsyeshme”(6). Ky konstatim, sa paradoksal aq edhe i vërtetë, më së miri e sqaron kompleksitetitin e problematikës. Sidoqoftë e vërteta, si gjithmonë, është diku në mes të këtyre dy qasjeve. Eshtë e qartë, se një masë e imagjinatës është e nevojshme /domosdoshme/ në projektimin e strukturave. Imagjinatë e cila do të ndihmojë që të arrihet kompromisi ndërmjet formës, funksionit dhe kritereve të stabilitetit dhe sigurisë. Kjo imagjinatë mund të pershkruhet edhe si aftësi për balancim ndërmjet logjikës strukturale dhe plotësimit të kushteve të kualitetit, si të hapsirave të brendshme ashtu edhe efektiti të imazhit të jashtëm; apo si balancim ndërmjet materialeve të përdorura dhe efektit ekonomik. Me një fjalë, kjo imagjinatë edhe në kuptimin më të ngushtë teknik mund te përshkruhet si art i vërtet.

Tregu i lirë e ka pozicionuar arkitektin si ‘s*howmen*’ në programin e quajtur projekt, dhe kjo edhe pse për shumë inxhinierë, e padrejtë, duhet të pranohet si realitet. Të paaftit, për mosukseset e veta do të fajësojnë vështërësinë e artikulimit profesional, ndërkaq inxhinierët e kohës do të ‘rrezikojnë’ dhe të lëshohen në sfida. Duke balancuar ndërmjet kritereve shkencore dhe inovimit të formave të reja, thjeshtë do ta ‘shpikin’ strukturën dhe do të bëhen inspirimi i arkitektëve. Inxhinieri i kohës nuk duhet të frikohet nga struktura, por duhet ta shohë atë si një vend, ku shtypja dhe tërheqja e luajnë lojën e vet, dhe në këtë lojë me kënaqësi të pranojë rolin e arbitrit /referit/. Duhet të ‘ndëgjojë’ materialet që të gjejë problemet. Në këtë mënyrë krijohen zgjidhje praktike të problemeve edhe më apstrakte arkitekturale. Më një fjalë, të rizbulohet liria inxhinierike, brenda kufijve shkencorë dhe të bëhet e gatshme të hyjë në arkitekturë, t’i ofrojë arkitekturës një structure dhe formë të re, të kërkohen simbolika të reja, për një filozofi sa radikale aq edhe liberale… thjesht, të thyhen barierat ndërmjet inxhinierisë dhe arkitekturës.

NË KËRKIM TË ORIGJINËS DHE IDENTITETIT

Origjina

Termi inxhinier është prodhim ekskluziv i revoluicionit industrial. Zhvillim i hovshëm i kohës, kërkonte specialista dhe njerëz të profesioneve të ndryshme. Edhe pse paradoksale, ”ndërtuesi” i asaj kohe ka qenë pergjegjës për dy detyra tejet kontradiktore; të merret me çeshtjet estetike dhe të garantojë ‘integritetin’ structural. Kjo ‘gjithëanshmëri’ e mjeshtërve të kohës qe shkaku kryesor i stagnimit shekullorë si në arkitekturë, ashtu edhe në inxhinierinë ndërtimore.Një mjeshtër I tillë nuk

mund të jetë produktiv qoftë për invencione arkitekturale apo ato të konstruksionit por, mundet vetëm të përcjellë njohuritë nga e kaluara. Kjo edhe ndodhi. Objektet nga koha romake e deri në kohën e katedralave gotike, apo xhamive otomane, shumë pak dallonin per nga arkitektura, e aqë më pak për nga zgjidhjet inxhinierike. Historiku i ndarjes së ketyre dy profesioneve lidhet me krijimin e Ecole des Ponts at Chausses në Paris me 1747(6). E qartë që në vitet e para diferencimi ka qenë I mjegulltë, arkitektet dhe inxhinierët kryenin po të njëjtën punë. Rritja e përmbajtjes shkencore në shek.XIX, bëri një hap përpara në diferncim. Zbulimi dhe aplikimi i materijaleve të reja në ndërtim padyshim këkonte analiza të veçanta, gjë që me në fund i qiti arkitektët nga 'loja', dhe konsolidojë pozitën e inxhinierit si përgjegjës të çështjeve të konstruksionit.Pozitë të cilën e mban edhe sot. Të ndikuar nga vala e revolucionit industrial inxhinierët tërësisht u preokupuan me hulumtimin dhe testimin e materialeve të reja si dhe metodave dhe teknikave të reja llogaritëse. Kështu materialet si çeliku, betoni, alumini, ferrocement-I bëhen ekskluzivitet vetëm I inxhinierëve. Pikërisht në atë kohë, fillon kompleksiteti në mardhënien arkitekt- inxhinier. Arkitektët e asaj kohe e shihnin punën e inxhinierit si diçka shumë funksionale dhe të pastër. Bile edhe i famshmi Frank Lloyd Wright dëshironte të njihej më tepër si 'inxhinier I madh'.Të njëjtin mendim e ndante edhe Le Courbisie I cili në veprën e hershme 'Vers un Architectur' thotë:"**Inxhinierët tonë janë aktiv, të dobishëm të balancuar dhe të kënaqur me punën e vet**". Në veprën e njohtur e S. Giedion-it "Space Time and Architecture" citohet njëri prej arkitektëve të famshëm të shekullit XIX,Cesar Dali i cili në vitin 1867 thotë:"**Vallë a duhen arkitektet ta hupin nderin për shkak të inxhinierëve**" duke aluduar në vështërësitë e artikulimit professional. Mund të thuhet se deri në vitet 20' të shekullit XX, inxhinieri ishte hero i llojit të vet. Rryma e ashtuquajtur funksionaliste mbijetoj luftën e dytë botërore , vitet 50'ta dhe stilin internacional në arkitekturë, si dhe depërtoj deri në fillim të viteve 70-ta. Kërkesat e pasluftës per objekte kapitale, ofronin mundësi per forma dhe volume të reja, të cilave duhej ti jepej një vulë shkencore.Kjo ndikojë që inxhinierija të inkorporohet me arkitekturë në baza të barabarta dhe kjo zgjati deri në fillim të viteve 70-ta. Zhvillimet e filozofive të reja në arkitekturë, me një fjalë, krijimi i të ashtuquajturve 'stileve private' te të cilët perfeksioni i funksionalitetit nuk konsiderohej më vlerë estetike, në një mënyrë ndikojë që roli i nxhinierit strukturist të dal në plan të dytë. Arsyeja e dytë është se inxhinierija strukturale në koncept nuk ka ndrruar me shekuj, kanë ndrruar vetëm materijalet.Ajo kulminacionin e vet e arriti në vitet 70-ta.

Si rrjedhojë, zgjidhjet për format e rendomta strukturale filluan të konsiderohen vetëm si një aplikim i ligjeve të njohtura natyrore, e jo si dicka e cila varet nga aftësia, sensi dhe pergatitja e inxhinierit. Teknologjia e pati ndikimin e vet pozitiv, por e zvogëlojë vlerën e inxhinierit si bartës të konceptit structural, dhe se kjo sot, po aqë i mveshet programereve të fuqishme, derisa inxhinieri balancon ndërmjet operatorit dhe strukturistit.

Identiteti

Me vite të tëra eshtë menduar se zgjidhja ideale do të ishte derdhja e këtyre dy profesioneve në nje person. Person i cili do të kishte sensin për gjykim estetik dhe njohuri të mjaftueshme shkencore që atë ide ta qesë në vepër. Këto ide janë derivuar dhe ushqyer nga shembulli i ***Nervy***-it, ***Torroya***-ës, ***Candel***-ës dhe sot ***Calatrav***-ës. Në veprën shpesh të cituar ***'***"*Space ,Time and Architecture*" autori ***Sigfried Gideon*** thekson se dëshira për unifikimin e këtyre dy profesioneve është e vjetër. Autori më tutje tregon: "*Më 1877 Akademia Franceze shpalli një konkurs me titull "Diferncimi i inxhinierve nga arkitektët*". ***Davioud,*** arkitekt me famë, fitoi shpërblimin e parë me pergjigjen: "*Harmonizimi i profesioneve kurr nuk do të jetë i vërtet, komplet dhe i frytshëm deri kur tvijë dita që inxhinieri, artisti, dhe shkenctari të bashkohen në një person*". Si duket kohët kanë ndrruar se sot e ardhmja qëndron në punë të ngusht ekipore e jo në individ me dije dhe talente enciklopodike. Aq më tepër që në vitet e ardhme zhvillimi indistrial do të kërkojë ndarje edhe më detaje të punës, keshtu që në vitet që vijnë ndoshta do të paraqitet nevoja për inxhinier të guaskave,inxhinier të objeketeve të varura e kështu me rradh. Lidhur me fenomenin inxhinierit arkitekt (***Torroya, Nervi, Calatrava, Maillard***-i, ***Candella*** etj.) strukturisti i famshëm ***Peter Rice*** në veprën e tij *"An engineer imagine" dha një mendim interesant: "Për inxhinierët ai është arkitekt, për arkitektët ai është inxhinier.Rëndësia e pozicionimit ka peshë të veçant, pasi specializimi është diçka që karakterizon kohën e sotme. Specializimi jo vetëm që tregon për njohurit dhe dijenitë e një personi, por cka është më me rëndësi, definon njeriun. Në fund të fundit inxhinieri është inxhinier dhe arkitekti është arkitekt"*. Mendim interesant dhe pakashumë fyes lidhur me fenomenin e inxhinierit arkitekt kishte edhe ***Le Courbisea*** i cili tha**:** *"A duhet të shohim inxhinierët duke u munduar të paraqiten si njerëz të cilët kanë sensibilitetin e artistit? Ajo do të ishtë vërtet e rrezikshm. Inxhinieri duhet te fokusohet dhe të mbes një llojë kalkulatori*."(6)**.** Edhe pse nga i famshmi arkitekt, mendim sot duket tejet qesharak. Sidoqoftë përcaktimi i identitetit profesional, është

mënyra më e mirë për sqarimin e origjinës, rolit dhe detyrave të secilit profesionist. Duhet pra, të definohet qartë pozita e arkitektit dhe inxhinierit. Dallimi ndërmjet kreacionit dhe invencionit është çelsi I të kuptuarit të diferncimit të këtyre dy profesioneve. Kjo është e një rëndësie të veçantë pasi ndihmon që të gjindet mënyra se si këta profesionist të punojnë të njëjten punë e të kontribojnë në më mënyra të ndryshme. Përgjigja pra, qëndron në krijimin e ekipeve multidisciplinare, apo një organizim interdisciplinar në baza të barabarta. Mënyrat e interaksionit janë te panumërta. Megjithatë, derisa koekzistimi dhe bashkupnimi arkitekt/strukturist nuk është zgjidh në menyrë institucionale atëherë, tregu dhe vetë inxhinierët do të duhen të zgjedhin mënyrën më të mire, e cila sigurisht që do të varet nga dëshirat, ambicijet dhe aftësitë e vet individit. Diçka është e sigurtë se problematika e interaksionit e ka burimin në mangësit e sistemit edukativ, sistem i cili në treg qet kuadër që nuk mund ti pergjigjet kerkesave të kohës dhe sistem i cili nga inxhinierët tenton të krijoj, siç ka dëshiruar Le Courbisiea (6), kalkulator, e jo të zhvillojë sensin, kreativitetin dhe mendimin pse jo filozofik për çështje strukturale. Ka evidencë se vetë mënyra tradicionale e shkollimit/edukimit të inxhinierëve të ardhshëm redukon dukshëm kreativitetin e tyre. Dallim i madh qëndron edhe në atë se arkitekti trajnohet dhe kurajohet të analizojë problemin në tërësi, gjërsa konstruktori vetëm një pjesë të tijë. Kurset e arkitekturës i japin rëndësi të madhe zhvillimit të imagjinatës, sintezës,planifikimit, gjërsa kurset inxhinierike theksojnë analizën dhe metodat e 'thata' llogaritëse. Kjo ndihmon që arkitektiti të pozicionohet si lider I grupit projektues , e pastaj edhe si autor i projektit. Këto qasje të ndryshme prodhojnë profesionist me dy fjalorë të ndryshëm, tek të cilat edhe fjalët project, funksion, bile edhe structure nuk kanë të njëjtin kuptim. Parodoksale është se egziston një mori e teksteve të shkruar nga arkitektët për arkitektët, mbi konceptimin e sistemve strukturore dhe kuptimin e reagimit të strukturave, lëmi të cilat si duket janë lënë anash nga autorët strukturist. Tekstet nuk japin konluzione dhe perfundime definitive, por janë të koncipuar ashtu që secili arkitekt I ardhshëm të zhvillojnë pikpamjet, stilet dhe filozofitë e veta mbi strukturën dhe arkitekturën. Kjo qasje i mungon sistemit të sotëm te edukimit të inxhinierëve. Inxhinieri në ditët e sotme lufton për pozitën e cila është ndërmjet ndërtuesit, projektuesit dhe artistit duke balancuar ndërmjet kreacionit dhe invencionit. Ky fakt apo realitet duhet të 'përkrahet' nga institucionet e edukimit të brezave të rinj. Me një fjalë duhet të sigurohet një edukim i mirëfilltë shkencor i ngjyrosur me nuanca të kreativitetit, të cilat do ti

ndihmojnë inxhinierëve të rinj që të kënaqen në profesionin e vet dhe duke hulumtuar, egzibicionuar, ti ikin monotonisë, të inspirojnë arkitektët, me një fjalë të bëhen lojtar të rëndësishëm në lojën e quajtur projekt. Nëse pajtohemi me fjalët e ***P.L Nervi***-it se *"perfeksioni estetik derivohet nga perfeksioni teknik"* (8) dhe se *"bukuria nuk vjen nga efektet e dekorimeve por nga harmonija e structures"* (8), atëherë termet si: arti, harmonija, poezia strukturale, kompozicioni, eleganca, kreacioni etj., nuk duhet të jenë ekskluzivitet i arkitektëve, por duhet të gjinden në fjalorin e çdo inxhinieri strukturist. Personaliteti arkitetkt-inxhinier i takonë shekullit të kaluar. Endrra për një 'mjeshtër' të tillë nuk është reale. Reale është krijimi i arkitektëve që do të kenë 'mirëkuptim' për çështjet strukturale, dhe inxhinierëve të cilët me një qasje më fluide do të bëhen lojtarë të rëndësishëm në krijimin arkitektural.

Dalja nga anonimiteti

Kompleksitieti i ndustrisë moderne ndërtimore ka ndikuar në implikimin e shumë profesionistëve në krijimine objekteve. Ndërvarshmeria e disciplinave të ndryshme e vështirëson vlerësimin e sasisë së implikimit të njërës zgjidhje në tjetrën. Ka shembuj të panumërta kur zgjidhja inxhinierike është konsideruar arkitekturë. Këtë më së miri e ka vërtetuar ***Nervy, Torroya, Candella*** dhe një seri e inxhinierëve që zgjidhjet e veta inxhinierike i kanë prezantuar në formë arti. Gati të gjithë shumëkatëshet në SHBA janë zbukurara me shtangimete e jashtme kundër erës;zbulim i inxhinierit të famshëm ***Fazlur Kahn***. Shekulli I kaluar na ka dhëne një numër të madh të arkitektëve të famshëm, dhe vetëm disa konstruktorë. Ndodhi që në shumicën e rasteve inxhinieri strukturist qe i gjykuar të qendroj prapa skenës dhe të plotësojë zbrastësirën ndërmjet arkitektit dhe ndërtuesit. Shkaku I këtij anonimiteit është shumë I thjeshtë: autorërsia i takon arkitektit. Me këtë konstatim më në fund duhet të pajtohen inxhinierët. Apo siç thotë vetë ***S. Calatrava:*** *"D=uhet të pranojmë se inxhinieri është i punësuar i arkitektit. Kështu është dhe do të jetë"*(4). 'Fajin' mbi pozitën anonime, strukturistët duhet ta 'lypin në rradhët e veta. Dikush thotë se vetë natyra e punës së arkitektit i mundëson atijë liri më të madhe të shprehjes së idejave dhe filozofive të veta, kundrejt inxhinierit i cili varet shumë nga '***Hook***-u, ***Newton***-i e të tjerët. Sidoqoftë këtë mendim e hedh poshtë Caltrava me fjalët *"se gjithmonë mbetën një 'këndë' i lire i cili është i mjaftueshëm për kreatorin/strukturistin të tregojë personalitetin e vet, dhe të mundësoj që kreacioni i tijë edhe në një rrethin të pastër teknike të bëhet vepër e vërtet arti*"(4). Jemi

dëshmitarë të ridefinimit të fenomenit të bukurisë dhe mardhënijes së saj me funksionin e objektit, cka ka rezultuar me objekte të zhveshur nga struktura, të cilat më tëpër përkujtojnë në skenografi, dizajn apo skulpturë se sa në nje arkitekturë të vërtet, e cila duhet të jetë në shërbim të shfrytzuesve. Arkitektura e tillë ka kërkuar më tepër se kurrëdoherë një bashkpunim të ngusht të arkitektit me strukturistin. Falë këtij bashkëpunimi, sot nga anonimiteti ka dalë një numër jo i vogël i strukturistve. Mjafton të permenden emrat si: ***Peter Rice***, për të cilin i famshmi Renzo Piano tha se: *"ka ndihmuar që problemet teknike t'i shëndrrojë në zgjidhje poetike***"** apo ***Cecil Balmond***, strukturisti momentalisht më i famshëm botëror, për të cilin legjenda e arkitekturës ***Philip Johnson*** tha se: ***"****ma ndrrojë vështrimin në strukturë dhe më beri të rizbulojë arkitekturën*"(1).

Ky lloj i implikimit të strukturistit në krijimin e një projekti besoj se duhet të jetë një model për të ardhmen. Inxhinieria strukturale nuk duhet të apstrahohet si grumbull ligjesh strikte, por duhet të shihet si një profesion i cili ofron mundësi të mëdha kreative. *Ajo çka duhet, është vetem kurajo, kujdes, dhe mbi te gjitha besim.*

LITERATURA

Balmond C., *Informal, Prestel* (London 2002).

Brown A. ***Peter Rice***: *The engineers contribution to contemporary architecture Thomas Telford Publishing*, London 2000.

Jodidio Ph Renzo Piano, *Taschen* 2004.

Jodidio Ph. *Santiago Calatrava*,Taschen 2002.

Holgate A. The art in structural design, Oxford University Press 1986.

Holgate A. *Aesthetic of built form, Oxford University Press* 1992.

Gideon S. Space, *Time and Architecture: The Growth of New Tradition, Harvard University Press 5th* edition 2003.

Nervi, P.L. *The Works of Pier Luigi Nervi - Frederick A. Praeger - New York.*

Rice P. *An Engineer Imagines*, Artemis London 1994.

Torroja E. *The structures of Eduardo Torroja - New York* 1958.

Underwood R. Chiuini M. , *Structural design-a practical guide for architects John Wiley & Sons inc* 1998.

Hulumtim

Dr. Zhilbert TAFA*

ALGORITME TË REJA PËR ANALIZËN DHE PËRMIRËSIMIN E BARRIERAVE SENSORIKE NË IMPLEMENTIME STOHASTIKE USHTARAKE

Hyrje

Teknologjitë informatike-komunikuese (IK), me shkallën e prezencës së vet dhe nivelin e lartë të integrimit në të gjitha sferat e jetës, sot paraqesin ndër shtyllat më të rëndësishme të zhvillimit të shoqërisë. Tendencat moderne teknologjike kanë kahe të zmadhimit të kapaciteteve përpunuese, memorike dhe komunikuese të IK pajisjeve. Krahas kësaj, nga pajisjet në fjalë kërkohet që të kenë kosto të ultë dhe të jenë të optimizuara në pikëpamje të ndryshme. Po ashtu, viteve të fundit, sidomos bazuar në të arriturat e komunikimeve celulare dhe satelitore, nga teknologjia kërkohet që të jetë e pranishme pavarësisht nga pozita gjeografike dhe nga kushtet e furnizimit me energji elektrike. Ky koncept tani në literaturë është i njohur si kompjutimi i gjithëpranishëm (angl. *Ubiquitous computing*) apo Interneti i gjërave (angl. *Internet of Things - IoT*). Ai nënkupton integrimin e pajisjeve kompjuterike në pothuaj çdo instancë të jetës, duke filluar nga ambienti shtëpiak - jetësor, në ambientin punues, në komunikacion, në natyrë etj. Nga aspekti teknologjik, sot nuk ekziston një standard i cili do të mundësojë përcjelljen e të gjitha llojeve të të dhënave nga çfarëdo pike në botë, duke qenë njëkohësisht i optimizuar për nga të gjitha IK parametrat, siç janë: shpejtësia e komunikimit, vonesa, siguria, mobiliteti, kostoja, autonomia e furnizimit me energji etj. Kështu, p.sh., për Internet-komunikimin multimedial për nevoja shtëpiake, duke marrë parasysh koston dhe faktorët tjerë komunikues, ADSL teknologjia (apo ndonjë teknologji tjetër me brez të gjerë) mund të jetë metoda më e përshtatshme. Në anën tjetër, për përcjelljen e sinjaleve nga territoret pa infrastrukturë telekomunikuese të projektuar (siç janë shkretëtirat dhe oqeanet), komunikimi satelitor mund të jetë i vetmi opsion. Ndërsa, nëse kemi të

bëjmë me përcjelljen e sinjaleve të shkurtra vëzhguese (ushtarake, shkencore, ekologjike, etj.) nga rrjetat sensorike, ku shpejtësia e komunikimit nuk është faktor limitues, ndërsa parametër limitues është autonomia e furnizimit me energji dhe "padukshmëria" e teknologjisë, komunikimet e shkurtra *wireless* (përkth. *pa tel*) të inkorporuara në rrjetet *wireless* sensorike (*Wireless Sensor Networks - WSN*) mund të janë opsioni më adekuat. Sidoqoftë, për t'u arritur mundësia e komunikimit, pavarësisht nga koordinatat gjeostacionare dhe nga rrethanat e implementimit, në shumicën e rasteve nevojitet të realizohet integrimi i teknologjive të ndryshme informatike dhe komunikuese në një sistem të përbashkët. Arkitektura e këtyre sisteme është e përbërë nga disa nivele. Shtresa e cila ka për detyrë përmbledhjen e të dhënave nga bota fizike është, po ashtu, edhe shtresa më e ndërlikuar sepse, përveç kufizimeve të rëndomta të IK pajisjeve, ka kufizime shtesë në lidhje me dimensionet fizike dhe jetëzgjatjen e funksionimit të nyjave të furnizuara në mënyrë autonome. Kur flasim për nyja në kontekstin e IoT arkitekturës, mendojmë në mikrokompjuterë të cilit, përveç që kanë mundësi të ekzekutimit të programeve kompjuterike dhe të komunikimit *wireless*, kanë edhe mundësi të transformimit të dukurive fizike në ekuivalente elektrike me qëllim të përcjelljes së tyre. Kështu, është e mundur që në afërsi të kraterit vullkanik të instalohet rrjeti i cili muaj me radhë mund të bëjë monitorimin e gazrave të dhe valëve sizmike, duke u furnizuar nga energjia e baterive [1]. Në anën tjetër, në aplikacionet e shtëpive inteligjente dhe në monitorimin mjekësor ([2], [3]), përveç jetëzgjatjes së madhe të nyjave autonome, nga nyjat kërkohet që të jenë të dimensioneve miniaturale, si dhe të mos ndikojnë në rezultatet e matjes dhe në sjelljet e subjekteve matës. Për më tepër, në aplikacionet ushtarake, nga mikrokompjuterët e rrjetëzuar kërkohet të kenë edhe qëndrueshmëri të madhe elektromekanike.

Përfundimisht, emërues i përbashkët i varianteve të ndryshme të IoT arkitekturës janë sistemet e përbëra nga IK pajisjet e vogla të cilat komunikojnë (në mënyrë *wireless*) duke përcjellë ekuivalentin elektrik të dukurisë fizike deri te rrjeti konvencional kompjuterik apo deri te qendra për vizualizimin dhe analizën e të dhënave.

IoT në aplikimet ushtarake - barrierat sensorike

Aplikacionet ushtarake janë njëkohësisht edhe aplikacionet më të ndërlikuara nga grupi i të gjitha IoT aplikacioneve. Edhe pse IoT është koncept më i gjerë i cili drejtpërsëdrejti nuk i përfshin aplikacionet

ushtarake, për shkak të sensibilitetit të informatës në këtë domen, teknikisht, arkitektura e rrjetit mbetet e njëjtë. Për dallim nga Interneti i rëndomtë, këtu rrjeti shpesh herë instalohet në mënyrë *kuazi-stohastike*, p.sh., me hedhjen e mikrokompjuterëve - nyjave nga aeroplani apo me anë të lancimit të tyre me anë të artilerisë. Në këto situata, nga nyjat pritet që të kenë cilësi shumë të larta elektro-mekanike, ndërsa nga rrjeti pritet që të vetë-organizohet pa ndërmjetësimin e njeriut.

WSN paraqet teknologji e cila, në kuadër të IoT arkitekturës, gjendet si ndërmjetësuese midis njësisë informatike dhe dukurisë fizike. Për shkak të përparësive të mëdha, sidomos në pikëpamje të dimensioneve fizike të nyjave dhe autonomisë energjetike të tyre, siç u cek më parë, kjo teknologji gjen përdorim të gjerë në aplikacionet ushtarake. Kështu, p.sh., duke përdorur WSN, në territorin e caktuar mund të detektohet prezenca e agjenseve kimike apo biologjike pa ndërmjetësimin e njeriut. Territori i caktuar mund të sigurohet nga prezenca e armikut e madje edhe të detektohen llojet e armëve që posedon grupacioni ushtarak duke kaluar nëpër regjionin e caktuar. Disa nga aplikimet e WSN në mbledhjen e të dhënave nga fusha ushtarake, në sigurimin e objekteve ushtarake dhe në sigurimin e trupave dhe regjioneve ushtarake janë dhënë në publikimet [4] - [10], ndërsa një përmbledhje aplikimesh ushtarake të rrjetave në fjalë është dhënë në [11]. Në këto raste, rrjeti bën sensimin e dukurive fizike dhe dërgon informatat e kërkuara drejt qendrës vëzhguese në largësi. Në secilin nga rastet, nyjat janë të furnizuara nga bateria, kanë dimensione fizike miniaturale (të rangut 1 cm^3 cm^3 apo më të vogël) dhe rezistencë të lartë në ndikime elektromekanike. Duke përfshirë këta kufizime në resurse, ata njëkohësisht paraqesin IK sisteme të kompletuara, sepse në vete përfshijnë mikrokontrollorë apo mikroprocesorë, njësi memorike, njësi komunikuese, *interfejse* etj. Përcjellja e sinjalit zakonisht realizohet duke përdorur njërën nga teknologjitë *wireless* të radiusit të vogël, për shkak të minimizimit të shpenzimit të energjisë.

Krahas IK aspekteve tjera, ndër aspektet më të rëndësishme të vlerësimit të kualitetit të një WSN rrjete të instaluar në mënyrë kuazi-stohastike, është edhe aspekti i *mbulueshmërisë* dhe aspekti i *konektivitetit*. Mbulueshmëria nënkupton masën në të cilën dukuria e cila monitorohet është përfshirë në fushën sensorike, ndërsa konektiviteti paraqet aspektin komunikues - masën e lidhshmërisë informatike të secilës nyjë me qendrën monitoruese (në mënyrë direkte apo duke përdorur nyjat ndërmjetësuese). Konektiviteti dhe mbulueshmëria janë dy parametra që mund të implikojnë njëri-tjetrin, sepse fusha elektromagnetike dhe ajo sensorike ndikohen pak a shumë nga të njëjtit

faktorë. Për këtë, siç konkludohet në [12], konektiviteti implikohet nga mbulueshmëria nëse rrezja e transmisionit nuk është më e vogël se dyfishi i rrezes së sensimit.

Njëra nga aplikimet më aktuale të WSN të përfshira në hulumtimet shkencore është formimi i të ashtuquajturave *barrierave sensorike*. Barrierat sensorike paraqesin varg mikrokompjuterësh të renditur midis dy qendrave komunikuese *s* the *t* (fig. 1). Këta nyje janë të pajisur me sensorë apo edhe me pajisje të tjera për regjistrimin e sinjaleve multimediale me qëllim që të detektojnë çdo tendencë të kalimit të një vije - kufiri të caktuar.



Fig. 1. *Barriera e shumëfishtë sensorike*

Një koncept i këtillë ka potencial përdorimi sidomos në domenin ushtarak kur duhet, në mënyrë „të padukshme“, të sigurohet kufiri i një zone të caktuar ushtarake. Sfidë të posaçme shkencore dhe inxhinierike paraqet rasti kur këto barriera duhet të instalohen në mënyrë kuazi-stohastike, me anë të mjeteve dhe armëve të ndryshme ushtarake. Në këtë situatë kualiteti i detektimit të cakut mund vetëm të vlerësohet (në nivel të probabilitetit). Në bazë të këtij vlerësimi pastaj mund të përcaktohen edhe ndikimet e parametrave të ndryshme në kualitetin e barrierës dhe të shqyrtohen mundësitë e plotësimit të saj deri në vlera të larta të probabilitetit të detektimit. Barrierat sensorike mund të jenë të dobëta ose të sigurta. Barrierat e dobëta sensorike paraqesin ata barriera të cilat nuk mund të kalohen (pa detektim) në drejtim perpendikular në krahasim me vijën e shtrirjes së barrierës. Këta barriera janë interesante atëherë kur caku nuk e din pozitën e nyjave dhe tenton të kalojë vijën sipas principit të rrugës më të shkurtër. Në anën tjetër, shpesh herë është e nevojshme të formohet barriera e sigurt sensorike e cila ofron detektim, pavarësisht nga trajektorja e lëvizjes së cakut.

Në secilin nga rastet e lartpërmendura, analiza e formimit dhe përmirësimit të barrierave sensorike, është çështje multidisiplinare e cila

në vete përfshin disa aspekte, e posaçërisht aspektet informatike, komunikuese dhe matematikore.

Modelimi matematikor

Në kuadër të modelimit matematikor, përfshihen dy aspekte:

- Aspekti i modelimit të fushës elektromagnetike apo sensorike,
- Aspekti i modelimit të metodës së instalimit.

Modelet e përshkrimit matematokor të fushës sensorike-elektromagnetike, të cilit më së shumti gjejnë aplikim në literaturë, janë: modeli binar (apo i *Bulit*), modeli i *Elfeut*, modeli *Shadow-Fading*, dhe *Neyman-Pearson* modeli.

Modelet e lartpërmendura janë të renditura nga më i thjeshti deri te ai më i ndërlikuari. Secili nga modelet e lartpërmendura shpreh probabilitetin e detektimit të pikës së caktuar në regjion apo probabilitetin e konektimit të dy nyjave. Shpjegimi i detajizuar, i secilit nga modelet, nuk i takon gjerësisë së shpjegimit të këtij artikulli. Lexuesi i interesuar mund të gjejë modelet e shpjeguara dhe të sistematizuara në punimin e doktoraturës së autorit.

Edhe pse, modeli më i thjeshtë, modeli binar është i përshtatshëm kur duhet të nxirren konkludime më të përgjithësuara në lidhje me kualitetin e shërbimit të rrjetës (angl. *QoS – Quality of Service*). Në bazë të këtij modeli mund të fitohet kufiri i poshtëm dhe i lartë të parametrave të ndryshme të rrjetit, edhe pse fusha elektromagnetike dhe sensorike në realitet ka forma të parregullta.

Modeli binar mund të prezantohet me relacion:

$$p(x) = \begin{cases} 1, x \leq R_1 \\ 0, x > R_1 \end{cases} p(x) = \begin{cases} 1, x \leq R_1 \\ 0, x > R_1 \end{cases} \quad \text{... (1)}$$

Siç shihet nga relacioni (1), në regjionin e diskut rreth nyjës së rrjetit, dukuria detektohet me probabilitet 1. Jashtë këtij regjioni, kjo dukuri është e padetektueshme për nyjën e caktuar. Duhet cekur se në këtë formulim nuk janë të integruara ndikimet e rrethinës në formën e fushës elektromagnetike dhe sensorike, si dhe pikëpamjet tjera të instalimit real. Sidoqoftë, për shkaqe të lartpërmendura, ky model më së shpeshti sot aplikohet në literaturë. Edhe në vazhdim të kësaj analize do të implementohet modeli binar.

Metoda e instalimit, sikur se u cek më parë, është kuazi-stohastike.

Këtu shqyrtohen dy modele të instalimit të rastësishëm:

- Kur rrjeti është i instaluar në mënyrë uniforme të rastësishme.
- Kur rrjeti është instaluar në mënyrë stohastike kuazi-lineare (p.sh. nga aeroplani).

Rasti i parë është shpeshherë i përfshirë në literaturë për modelimin e instalimit të rastësishëm. Në këtë rast, përllogaritja e gjasës bazohet në modelimin e dukurisë me anë të procesit të pikës së *Poason*-it, i cili shprehet me:

$$P(N(A)=k)=\frac{e^{-\rho A}(\rho A)^k}{k!}P(N(A)=k)=\frac{e^{-\rho A}(\rho A)^k}{k!}$$

... (2)

Formula (2) paraqet gjasën që saktësisht *k* nyje të gjenden brenda regjionit A. Me ρ këtu shprehet dendësia e rrjetit.

Rasti II) mund të modelohet në disa mënyrë, kryesisht duhet integruar çvendosjen e nyjave për shkaqe të ndryshme (inercioni, ndikimi i erës etj.) në krahasim me linjën e fluturimit të aeroplanit. Një modelim i këtij implementimi është distribucioni i ndryshëm i probabilitetit nëpër dy boshte. Përgjatë boshtit të instalimit (x), distribucioni mund të jetë i rastësishëm dhe uniform, ndërsa tërthorazi me boshtin e instalimit (y), pozitat e nyjave mund të përcjellin distribucionin normal të probabilitetit të dhënë me relacionin:

$$f(y)=\frac{1}{\sigma\sqrt{2\pi}}e^{-\frac{(y-\mu)^2}{2\sigma^2}}f(y)=\frac{1}{\sigma\sqrt{2\pi}}e^{-\frac{(y-\mu)^2}{2\sigma^2}}$$

... (3)

Duke u bazuar në teorinë e gjasës, dhe duke u bazuar në relacionin (2), për të dy implementimet mund të nxirret se gjasa e detektimit te barriera e dobët sensorike, është:

$$Pd=1-e^{-2\rho rh}$$

... (4)

... ku *h* është gjerësia e regjionit, *ρ* është dendësia e rrjetës dhe *r* është rrezja e sensimit (apo komunikimit).

Nga relacioni (4) mund të nxirret një konkludim shumë i rëndësishëm, përkatësisht mund të përcaktohet dendësia e nevojshme e

rrjetit për t'u arritur probabiliteti i caktuar i detektimit të cakut gjatë kalimit të regjionit tërthorazi kur rrjeti është i instaluar në mënyrë të rastësishme dhe uniforme. Ky implikim është dhënë në relacionin:

$$\rho = \frac{1}{2rh} ln \frac{1}{1-P_d} \rho = \frac{1}{2rh} ln \frac{1}{1-P_d} \quad \text{... (5)}$$

Për qëllime ushtarake, në bazë të literaturës, vlera e gjasës përmbi 0,95 për detektimin e cakut trajtohet si vlerë e lartë e probabilitetit. Duke u bazuar në relacionin e lartpërmendur dhe duke marrë parasysh që radiusi i sensimit zakonisht sillet (por nuk është i kufizuar) në diapazonin 10-20 m, nëse dihen dimensionet e regjionit, thjesht mund të përllogaritet numri i nevojshëm i nyjave të cilët me gjasë të madhe detektojnë çdo kalesë të regjionit në drejtim perpendikular në krahasim me linjën e shtrirjes së gjatësisë.

Analiza matematikore ka nivelin e lartë të saktësisë kur rrezja e sensimit (apo komunikimit) është shumë më e vogël sesa dimensionet e regjionit. Kur këto madhësi bëhen të krahasueshme, mund të paraqiten *efektet kufitare* [13] të cilat më mirë mund të përfshihen me simulimin kompjuterik të rastit konkret.

Analiza e barrierave të forta sensorike, së bashku me mundësinë e përmirësimeve, është dhënë me anë të simulimit kompjuterik.

Metodat e përmirësimit të barrierave sensorike

Duke u bazuar në modelet e lartpërmendura dhe në mundësitë teknike të aplikacioneve, opsionet në drejtim të rritjit së gjasës për t'u arritur mbulueshmëria e duhur, janë:

- Rritja e radiusit elektromagnetik apo sensorik,
- Rritja e dendësisë së rrjetës,
- Përdorimi i mobilitetit (të nyjave) apo robotëve në rrjet.

Metoda e parë shpeshherë është vështirë të arrihet apo edhe e pamundur, për shkak të karakteristikave fizike të sensorëve apo për shkak të kufizimeve në pikëpamje të furnizimit me energji elektrike. Metoda e dytë është kryesisht e kufizuar për shkak të çmimit të rrjetit, por edhe për shkak të ripërdorimit të nyjave, kolizionit dhe interferencës elektromagnetike. Në pikëpamjen e fundit mund të paraqiten probleme në qasje të mediumit, në MAC (*Medium Access Control*) dhe *routing* protokole, në vonesën e propagimit të të dhënave në rrjet, e posaçërisht

në brezin disponabil të secilës nyjë. Për shkaqe të lartpërmendura, qasja më sfiduese dhe më aktuale në pikëpamje të rritjes së kualitetit të rrjetit, është përdorimi i mobilitetit në rrjet. Ky aspekt do të jetë i përfshirë edhe në simulatorin kompjuterik në vijim.

Algoritmet e reja për plotësimin e barrierave duke përdorur mobilitetin në rrjetë

Simulimi kompjuterik është realizuar në gjuhën programuese *Java* dhe përfshin metodat e programimit të orientuar në objekte. Programi implementon modelin binar të sensimit, instalimin e rastësishëm uniform në dy dimensione (x dhe y) si dhe instalimin i cili është uniform në një drejtim (boshti x) dhe normal në drejtim perpendikular (boshti y). Për të implementuar këtë, janë përdorur gjeneruesit programues të numrave të rastësishëm dhe gjeneruesit e shpërndarjes së *Gaus*it të integruar në gjuhën Java. Pamja e GUI (*Graphical User Interface*) të simulatorit është dhënë në figurë 2. Parametrat hyrës janë: numri i nyjave statike, rrezja e sensimit apo komunikimit, dimensionet e territorit, mënyra e instalimit dhe deviacioni standard σ.

Detyrë e simulatorit është që, duke përdorur algoritmet përkatëse, të gjejë përçarjet e barrierës dhe të udhëheqë robotët apo nyjat mobile drejtë mbulimit të këtyre përçarjeve. Në këtë drejtim përdoren dy metoda te reja distributive. Të dy metoda bazohen në formimin e *grafeve* të lidhura nga burimi deri te destinacioni. Burimi merret të jetë njëra vertikale e regjionit, ndërsa destinacioni të jetë vertikalja tjetër.

Pas instalimit të rrjetit, nyjat komunikojnë me njëra-tjetrën nëse gjenden në distancën komunikuese. Në rast se distanca e tyre është më e vogël se dyfishi i rrezes së sensimit, në pikëpamje të sensimit, ato dy nyja mund të quhen „të lidhur“. Kur flitet për konektivitet, kjo distancë duhet të jetë minimum sa vetë rrezja komunikuese e fushës elektromagnetike. Sidoqoftë, këtu do të përfshihen vetëm aspektet e mbulueshmërisë, duke implikuar edhe konektivitetin me rregullimin e parametrit të radiusit. Në figurën 2 janë të paraqitur nyjat e numerizuara dhe është shënuar lidhshmëria e tyre në pikëpamje të lartpërmendur.



Fig. 2. *Simulatori për përcaktimin e gjasës së formimit të barrierave sensorike*

Secila nyje ka numrin identifikues. Pasi të arrihet komunikimi *wireless* i secilës nyjë me fqinjët e vet (*linkat real*), krijohen edhe *linkat virtual* (të përbërë nga „lidhjet“ sensuese midis nyjave). Në aspektin matematikor këtu krijohet një bashkësi e përbërë nga *grafet e lidhur* dhe nga *grafet trivialë*. Në aspektin programues, por edhe realisht në implementimin e projektuar, secili nga këta grafe është i identifikuar me numrin më të vogël identifikues të nyjes në grafin përkatës. Forma e thjeshtëzuar tekstuale e algoritmit është dhënë në vijim.

Algoritmi fillon nga njëra vertikale. Secila nyjë e cila gjendet në afërsi më të vogël nga kjo vertikale sesa rrezja e sensimit, trajtohet si nyjë burimore. Për secilën nga nyjat burimore, kërkohet e ashtuquajtura *nyja e fundme*. Nyja e fundme paraqet nyjën e cila i takon grafit të caktuar dhe e cila është më e afërta destinacionit. Kjo nyjë është shënuar si *RUN nyja*. Algoritmi duhet të krijojë urë nga RUN nyja në nyjen tjetër kah destinacioni dhe ky proces duhet të jetë iterativ deri në krijimin e grafit të lidhur nga skaji në skaj.

Urat mund të krijohen në disa mënyrë:

- Nëse informata në lidhje me pozitën e RUN nyjës (e cila mund të fitohet si kombinim nga teknologjia GPS dhe nga metoda e triangulimit) i përcillet qendrës së kontrollit, ajo mund ta udhëheqë robotin i cili do ta hulumtojë rrethinën e RUN nyjes (bazuar në kriteret A apo B të shpjeguara në vijim) dhe e cila

pastaj mund të pozicionojë nyjen në pozitën e duhur.

- Nëse rrezja e komunikimit është mjaft e madhe në krahasim me dendësinë e nyjave mobile, përkatësisht nëse me probabilitet të madh mund të thuhet se në radiusin e komunikimit të secilës nyjë fikse do të gjendet së paku një nyjë mobile. Në këtë rast, lëvizjen do ta bëjë ajo nyjë e cila është më e afërt RUN nyjes. Po ashtu, kontrolli i lëvizjes do të bëhet nga RUN nyja e jo nga qendra e kontrollit.

Kriteri A:

Për grafin e dhënë $G_u G_u$, nyja *t* është nyja më e përshtatshme për të formuar urën me RUN nyjën *u* të grafit $G_u G_u$, nëse janë të plotësuar kushtet në vijim:

Nëse pozita e nyjës *t* (përnga boshti *x*) është më afër destinacionit sesa koordinata x e RUN nyjës *u*, përkatësish nëse është $t_x > u_x t_x > u_x$.

Nëse distanca midis *u* dhe *t* është minimale në krahasim me të gjitha distancat që kanë nyjat tjera të cilat nuk janë element të grafit $G_u G_u$ dhe të cilat plotësojnë kushtin nën a), përkatësisht nëse është:

$$t: t_x > u_x \ \wedge \ d_{ut} = \min(d_{ui}) \text{, për çdo } i \text{ për të cilin vlen } i_x > \ u_x$$

... ku $d_{ut} d_{ut}$ dhe $d_{ui} d_{ui}$ janë distancat e Euklidit të nyjes *u* me *t* dhe me *i*, respektivisht.

Kriteri B:

Për grafin e dhënë $G_u G_u$, nyja *t* është nyja më e përshtatshme për të formuar urën me RUN nyjën *u* të grafit $G_u G_u$, nëse janë të plotësuar kushtet në vijim:

Nëse pozita e nyjës *t* (përnga boshti *x*) është më afër destinacionit sesa koordinata x e RUN nyjës *u*, përkatësish nëse është $t_x > u_x t_x > u_x$.

Nëse nyja e cila nuk është element i grafit $G_u G_u$ e plotëson kushtin nën a) dhe në krahasim me të gjitha nyjet e tjera që i plotësojnë kushtet e larëpërmendura maksimizon raportin:

$$\frac{RUN(G_t)-RUN(G_u)}{m}\frac{RUN(G_t)-RUN(G_u)}{m}$$

...(6)

RUN(Gt) dhe RUN(Gu) paraqesin mbulueshmërinë maksimale (në drejtim të *x*-it) të grafeve Gt dhe Gu, respektivisht. Parametri *m,* i dhënë në përshkrimin e kritereve A dhe B, përllogaritet nga relacioni (7) në vijim, rezultati i të cilit pastaj rrumbullakësohet në numrin natyror më të madh:

$$m = \frac{d_{tu}-2R_s}{2R_s} m = \frac{d_{tu}-2R_s}{2R_s}$$

...(7)

Variabla *m* paraqet numrin optimal të nyjave mobile apo robotëve të cilët duhet çvendosur në pozita të caktuara për t'u arritur formimi i barrierës së fortë sensorike në rrjet me probabilitet afër 1.

Rezultatet e simulimit kompjuterik dhe konkludimet

Simulatori i zhvilluar në gjuhën programuese *Java* përfshin analizën e mbulueshmërisë për dy radiuset reprezentative të implementimeve tipike ushtarake, përkatësisht për Rs=10m dhe Rs=18m. Radiuset më të mëdha se këta, në mënyrë kuadratike rrisin gjasën e mbulueshmërisë së barrierës dhe për këtë nuk paraqesin fokus të interesimit.

Në analizë janë përfshirë dy metodat e përmendura të instalimit, duke i vendosur ato në pozita ekuivalente të krahasimit. Kështu, duke u bazuar në rregullin 68-95-99,7 për shpërndarjen e Gausit, pritet që rreth 99,7% e nyjave të bjerë në rrethinën gjeografike të ±3σ të mesatares – vijës së mesme. Për këtë arsye, gjerësia e regjionit është marrë të jetë 6σ.

Simulatori i konfirmon të gjitha rastet e projektuara matematikisht, ku asgjësohen kushtet kufitare (sepse *Rs<<l, w*; l-gjatësia e regjionit, w-gjerësia e regjionit), me ç rast bëhet edhe verifikimi i funksionalitetit të simulatorit. Me paraqitjen e kushteve kufitare, në krahasim me vlerat e fituara matematikisht, simulatori jep vlera më precize të probabilitetit dhe të numrit të nevojshëm të nyjave mobile apo robotëve.

Rezultatet e analizës tregojnë se influencën më të madhe në kualitetin e formimit të barrierave sensorike (por po ashtu edhe të konektivitetit përgjatë linjës së shtrirjes) ka radiusi i sensimit (apo komunikimit).

Faktori i dytë është preciziteti i instalimit, ndërsa faktori i tretë është numri i mikrokompjuterëve statikë.

Kur është fjala për mbulimin e linjës së caktuar me fushë elektromagnetike apo sensorike, instalimi linear do të mundësojë kursime në numër të nyjave në rreth 40%.

Duke përdorur kriterin A, rezultatet e simulimeve tregojnë përparësi të madhe të instalimit kuazi-linear në krijimin e barrierave sensorike në krahasim me instalimin uniform të rastësishëm. Moment shumë i rëndësishëm në rrjetë paraqitet kur numri i ndërprerjeve barazohet me numrin e nevojshëm të robotëve apo nyjave mobile për t'u mbuluar ndërprerjet. Në këtë rast, për secilën ndërprerje nevojitet të përcaktohet vetëm një nyjë e re mobile. Kjo pikë kritike mund të jetë po ashtu edhe pika në bazë të së cilës projektuesi i rrjetit mund të përcaktojë dendësinë e nevojshme të rrjetit në mënyrë që, në pikëpamje të çmimit dhe shfrytëzimit të resurseve, përdorimi mobilitetit në rrjet të jetë i arsyeshëm. Në fund, tregohet se, me distribucionin *stohastik* të $n_1 n_1$ nyjave statike mikro-kompjuterike, numri i nyjave të nevojshme mobile për t'u arritur lidhshmëria lineare e rrjetit sensorik është konstant kur raporti $\frac{a\ a}{R_s R_s}$ është konstant, ndërsa *a* paraqet brinjën e katrorit. Kjo mundëson procesin e lehtë të shkallëzimit, përkatësisht mundëson gjetjen e numrit të nevojshëm të nyjave mobile për regjion të gjatësisë së çfarëdoshme, nëse dihen varshmëria e parametrave për një regjion të caktuar kuadratik.

Në fund, analiza dhe algoritmat e propozuara ofrojnë informata të rëndësishme në projektimin e rrjeteve të instaluara në mënyrë stohastike. Kjo posaçërisht është e rëndësishme në implementimet stohastike ushtarake ku është e nevojshme që rrjeti mikrokompjuterike të projektohet me kujdes të madh, me qëllim që të sigurohet niveli i lartë i probabilitetit për detektimin e dukurive. Po ashtu, nëse në rrjet implementohet algoritmi i cili përfshin të dy kriteret e lartpërmendura (A dhe B), duke përdorur secilin nga ata në raste specifike, rrjeti statik mund në mënyrë efikase automatike të kontrollojë lëvizjen e robotëve apo nyjave mobile, me qëllim të përmirësimit të mbulueshmërisë dhe konektivitetit. Po ashtu, në këtë rast, numri i nyjave mobile është i optimizuar.

Në pikëpamje të ngritjes së efikasitetit të projektimit të algoritmeve në fjalë, autori është i pari në literaturën përkatëse i cili përdor CMMI (angl. *Capability Maturity Model Integration*) metodologjinë e inxhinierisë softuerike të prodhuar në MIT (*Massachusetts Institute of*

Technology) për përshkrimin e procedurave efikase të projektimit të algoritmeve të shpjeguara.

Në pikëpamje të avancimit të saktësisë së përllogaritjeve kompjuterike, autori inkuadron edhe metodat e përpunimit të përmbajtjeve multimediale të fituara nga hartat digjitale. Këtu, duke u bazuar në procesin e segmentimit të fotografisë digjitale dhe, pastaj, edhe në ekstrakimin e karakteristikave të fotografisë (përshkruar me MPEG parametrat apo transformacionin e Radonit), autori propozon përdorimin e mapave konceptuale në përshkrimin e kushteve të instalimit në kuadër të simulatorit, përkatësisht propozon inkuadrimin e metodave të modelimit konceptual të aplikuara në përmbajtje multimediale [14] në softuerin përkatës. Mapat konceptuale mundësojnë projektimin e softuerit i cili do të njohë terrenin dhe i cili, në mënyrë automatike, mund që secilës nyjë t'ia korrigjojë pozitën gjeografike dhe modelin e sensimit, varësisht nga kushtet dhe rrethanat e instalimit. Softueri i avancuar në këtë mënyrë mund të sigurojë një simulator të precizitetit të lartë i cili në vete përfshin numër më të madh parametrash të nevojshëm për vlerësimin e pikëpamjeve të ndryshme të rrjetit të instaluar.

REFERENCAT

[1] ***G. W. Allen, J. Jonson, M. Ruiz, J. Lees, and M. Welsh***, "*Monitoring Volcanic Eruptions with a Wireless Sensor Network*," *Proc. of the Second European Workshop on Wireless Sensor Networks*, pp. 108-120, 2005.

[2] ***M. Welsh***, "*CodeBlue: Wireless Sensor Networks for Medical Care and Disaster Response," Division of Engineering and Applied Sciences*, *Harvard University*, 2004.

[3] ***M. Welsh, D. Myung, M. Gaynor***, and ***S. Moulton***, "*Resuscitation Monitoring with a Wireless Sensor Network*," *Journal of the American Heart Association*, 2003.

[4] ***W. M. Merill***, "*Defense Systems: Self-healing Land Mines," Ch. 18 in Wireless Sensor Networks: A System Perspective*," *N. Bulusu and S. Jha (eds.), Artech House*, 2005.

[5] ***J. D. Adams, R. Whitten***, and ***B. S. Rogers***, "*Chemical, Biological, and Explosive Vapor Detection with Micro Cantilever Array Sensor,*" *SPIE*, Orlando, USA, 6538-23, 2007.

[6] ***P. Naz, S. Hengy***, and ***P. Hamery***, "*Soldier Detection Using Unattended Acoustic and Seismic Sensors*," *SPIE,* Ornalndo, USA, pp. 8047-8060, 2012.

[7] ***S. H. Lee, S. Lee, H. song***, and ***H. S. Lee***, "*Wireless Sensor Network Design for Tactical Military Applications: Remote Large-Scale Environments*," *Proc. of IEEE Military Communications Conference, MILCOM 2009*, Boston, USA, pp. 1-7, 2009.

[8] ***M. Merril, L. Cirod, B. Schiffer, D. Mclntire., G. Rava, K. Sohrabi, F. Newberg, J. Elson, and W. Kaiser***, "*Dynamic Network and Smart Sensing Enable Next-gerenation Landmines*," *IEEE Pervasive Computing*, vol. 3, no. 4, pp.84-90, 2004.

[9] ***R. Dulski, M. Kastek, P. Trazskawka, M. Szustakowski***, and ***M. Zycykowski,*** "*Concept of Data Processing in Multisensor System for Perimeter Protection*," *Proc. of SPIE*, Orlando, USA, vol. 8019, 2011.

[10] ***J. He, R. A. Norwood, M. Fallahi, and N. Peyghambarian***, "*Smart Border: Ad-hoc Wireless Sensor Networks for Border Surveillance*," *Proc. of SPIE*, Orlando, USA, vol. 8019, 2011.

[11] ***Pejanovic, M., Tafa, Zh., Dimic, G., Milutinovic, V***., "*A Survey of Military Applications of Wireless Sensor Networks*," *Proc. of IEEE Mediterranean Conference on Embedded Computing*, Bar, Montenegro, pp. 196-199, 2012.

[12] ***X. Wang, G. Xing, Y. Zhang, C. Lu, R. Pless, and C. Gill***, " *Integrated Coverage and Connectivity in Wireless Sensor Networks*," *Proceedings of the 1st International Conference on Embedded Sensor Systems*, pp. 28-39, 2003.

[13] ***Zh. Tafa***, „*Algoritmet e reja për rritjen e probabilitetit të formimit të barrierave të sigurta sensorike duke përdorur nyjet mobile*", Tezë e doktoraturës, Beograd, Serbi, 2012.

[14] ***S. Vrochidis, C. Doulaverakis, A. Gounaris, E. Nidelkou, and Y. Kompatsiaris***, "*A Hybrid Ontology and Visual-Based Retrieval Model for Cultural Heritage Multimedia Collections*," *International Journal on Metadata Semantics and Ontologies*, vol.3, no.3, pp. 167-182, 2008.

*** ZHILBERT TAFA - DOKTOR**
I SHKENCAVE ELEKTROTEKNIKE

Është lindur në Ulqin më 16.07.1974. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Ulqin, në gjuhën shqipe, ku disa vite u shpërblye si nxënësi më i dalluar në gjeneratën e vet.

Fakultetin elektroteknik në degën e elektronikës ka kryer në Podgoricë, po ashtu si një ndër studentët më të dalluar të gjeneratës.

Pas diplomimit punësohet në *Telekom* të Malit të Zi, por njëkohësisht angazhohet honorar edhe në vende tjera si: në shkollën e mesme në Ulqin; në Universitetin "Luigj Gurakuqi", në Shkodër; në firmën *Comtrade,* në Prishtinë; në ligjërime për OJQ ndërkombëtare dhe të vendit; në komisione dhe grupe punuese profesionale etj. Duke punuar vazhdon studimet postdiplomike në Fakultetin Elektroteknik të Podgoricës ku magjistron me notën mesatare 10, në katedrën e Shkencave kompjuterike, me tezën "*Kontribut zhvillimit të sistemeve sensorike wireless me akcent në aplikimet mjekësore*". Hulumtimi shkencor në kuadër të magjistraturës paraqet aplikimin e parë në Mal të Zi në pikëpamje të monitorimit të sinjaleve fiziologjike (ECG dhe PPG) në kohën reale, duke përdorur teknologjitë *wireless* (përkth. pa tel). Po ashtu, asokohe (viti 2005), ky ishte edhe njëri ndër aplikimet e para në botë i realizuar në këtë mënyrë. Në këtë lëmi multidisiplinare, e cila në vete përfshin elektronikën, programimin kompjuterik dhe komunikimet kompjuterike, dr. Tafa publikoji një numër të caktuar punimesh, kryesisht në konferenca ndërkombëtare dhe në kapituj për libra të publikuara në SHBA.

Studimet e doktoraturës i regjistron në Fakultetin Elektroteknik në Beograd, në katedrën e Inxhinierisë kompjuterike dhe teorisës së informacionit, në vitin 2008, ndërsa titullin *Doktor i Shkencave Elektroteknike* e merr në vitin 2012, duke mbrojtur disertacionin *Algoritmet e reja për përmirësimin e probabilitetit të formimit të barrierave të forta sensorike duke përdorur nyjat mobile*".

Gjatë kësaj periudhe ai, midis tjerave, publikon edhe katër punime në revista udhëheqëse botërore (me impakt faktorë) nga domeni i teknologjisë. Fokusi i tezës së doktoraturës ishin algoritmet e reja që autori zhvilloi në domenin e analizës dhe përmirësimit të mbulueshmërisë dhe konektivitetit në rrjetet senzorike, duke përdorur mobilitetin në rrjet. Autori në mënyrë origjinale përdori teknika të ndryshme nga disa lëmi të inxhinierisë elektroteknike dhe kompjuterike, siç janë: algoritmet, teorinë e grafeve dhe probabilitetin, programimin kompjuterik, komunikimet kompjuterike, CMMI metodologjinë dhe modelimin konceptual. Shumicën e artikujve i ka publikuar në gjuhën angleze.

Dr. Zhilbert Tafa është bashkëpunëtor në projekte pranë Universitetit të Malit të Zi në Fakultetin Elektroteknik të Podgoricës dhe është anëtar i Grupit për Elektronikën Aplikative (APEG) pranë Fakultetit Elektroteknik në

Podgoricë. Po ashtu është i angazhuar ligjërues në Universitet në Shkodër dhe në Tiranë. Është anëtar i Dhomës së Inxhinierëve të Malit të Zi dhe është i licencuar për projektimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve telekomunikuese dhe kompjuterike. Nga Qeveria e Malit të Zi, dr. Tafa është i emëruar edhe si ekspert gjyqsor për lëmin e teknologjive informatike-komunikuese.

Dr. Tafa ishte recensent për librin "*Smart Healthcare Applications and Services"* dhe aktualisht është recensent në pranimin e publikimeve për revista dhe konferenca prestigjioze botërore, siç janë: *IEEE Communications Magazine, IEEE Mediterranean Conference on Embedded Computing dhe IEEE Wireless Communications and Networking Conference*.

PUBLIKIMET E DERITANISHME SHKENCORE

Kapituj librash dhe tezat:

- ***Tafa, Zh***., "*Sensor Networks in Pervasive Healthcare Computing*," in *Smart Healthcare Applications and Services: Developement and Practices*, R□cker, C., Ziefle, M. (Eds)., DOI: 10.4018/978-1-60960-180-5.ch002, ISBN: 978-1-60960-180-5, IGI, USA, New York, pp. 24-45, 2011.
- ***Tafa, Zh***., "*Ubiquitous Sensor Networks*," in *Wireless Sensor Networks: Concepts, Multidisciplinary Issues, and Case Studies*, Gavrilovska, Lj., Krco, S., Milutinović, V., Stojmenovic, I., Trobec, R. (Eds)., DOI: 10.1007/978-1-84996-510-1_13, ISBN: 978-1-84996-509-5, Springer-Verlag, UK, London**,** pp. 267-268, 2010.
- ***Tafa, Zh***, "*Mobile Health Applications and New Home Care Telecare Systems: Critical Engineering Issues*", in *Handbook of research on Distributed Medical Informatics and E-Health,* Lazakidou, A., & Siassiakos, K. (Eds)., DOI: 10.4018/978-1-60566-002-8.ch021, ISBN: 978-1-60566-002-8, PA: Information Science Publishing, USA, New York, pp. 305-323, 2008.
- ***Tafa, Zh***., "*Algoritmet e reja për përmirësimin e probabilitetit të formimit të barrierave të forta sensorike duke përdorur nyjet mobile*", tezë doktorature, Universitetit i Beogradit, Beograd, Serbi, 2012.
- ***Tafa, Zh***., "*Kontribut zhvillimit të sistemeve sensorike wireless me akcent në aplikimet mjekësore*", tezë magjistrature, Podgoricë, Mali i Zi, 2006.

Revistat dhe konferencat shkencore:

- ***Tafa, Zh***., "*Robot-Assisted Algorithms on Providing Path Connectivity and Barrier Coverage in Stochastic Network Deployments*", *Third International ICST Conference on Ad Hoc Networks*, France, Paris, Sept. 2011.
- ***Tafa, Zh***., "*Towards Improving Barrier Coverage Using Mobile Robots*," *Proc. of IEEE Mediterranean Conference on Embedded*

Computing, Tivar, Montenegro, pp. 166-169, 2012.

- ***Pejanovic, M., Tafa, Zh., Dimic, G., Milutinovic, V***., "*A Survey of Military Applications of Wireless Sensor Networks*," *Proc. of IEEE Mediterranean Conference on Embedded Computing*, Tivar, Montenegro, pp. 196-199, 2012.
- ***Rakocevic, G., Tafa, Zh., Milutinovic, V***., "*A Novel Approach to Data Mining in Wireless Sensor Networks," Unconditionally accepted for Ad Hoc & Sensor Wireless Networks* (journal, impact factor 0.309/2010), 2012.
- ***Tafa, Zh., Milutinović, V., Rakočević, G***., and ***Mihajlović Đ.***, "*Effects of Inter-disciplinary Education On Technology-driven Application Design*," *IEEE Transactions on Education,* (journal, impact factor 1.328/2010), 2011.
- ***Omerović, S., Babović, Z., Tafa, Zh., Milutinović, V***., and ***Tomazhić, S***., "*Concept Modeling: From Origins to Multimedia*," *Multimedia Tools and Applications, Springer*, (*journal, impact factor* 0.626/2010), 2011.
- ***Tafa, Zh***., "*Detectability of Static and Moving Targets in Randomly Deployed Military Surveillance Networks*," *Ad Hoc & Sensor Wireless Networks*, vol. 3, no. 3, pp. 291-312, (*journal, impact factor* 0.309), 2011.
- ***Tafa, Zh,*** "*A Wireless Sensor System for the Home Care solutions*," *IPSI conference*, Belgrade, Serbia, April, 2009.
- ***Tafa, Zh***., "*Wireless systems to remote monitoring of biomedical signals*," *ISHIMR, Proceedings of the 12th International Symposium on Health Information Management and Research,* Sheffield, UK, 2007.
- ***Stojanović, R., Mrkić, N., Tafa, Zh., Gardšević, R., Perakis, K***., *"PhysiLAB – A flexibile system in telemetry*," *ETRAN*, Belgrade, 2006.
- ***Tafa, Zh., Stojanovic, R.***, "*Monitoring of basic physiological signals using Bluetooth," 5th European Symposium on Biomedical Engineering,* Patras, Greece*,* 2006.
- ***Stojanovic, R., Tafa, Zh., Lekic, N***., "*An approach to monitoring of biomedical signals using Bluetooth*," *Applied Electronics, IEEE-IEE-NTRC International Conference*, Pilsen, Czech Republic, 2006.
- ***Tafa, Zh., & Stojanović, R***., "*Monitoring of physiological signals using Bluetooth*," *Simposium IT2006*, Zabljak, Montenegro, March, 2006.
- ***Tafa, Zh. & Stojanovic, R.***, "*Bluetooth–based approach to monitoring biomedical signals*," *Proceednigs of the 5th WSEAS International Conference on Telecommunications and Informatics*, Istanbul, Turkey, 2006.
- ***Stojanović, R., Tafa, Zh, Djurasović, N., Šćekić, N***., ***and Ivanović, V.***, "*Calculation of the Fast Fourier Transform using general purpose microcontrollers*," *Simposium IT2004*, Zabljak, Montenegro, 2005.
- ***Tafa, mr. ZH.,*** "*Projektimi i aplikacioneve mobile në mjekësi"*, DIJA nr. 7/2009, Ulqin, Mali i Zi.

PSIKOLOGJI

Hulumtim

Leonora HASANGJEKAJ

PARAGJYKIMET DHE DISKRIMINIMI GJINOR TEK TË RINJTË

Abstrakt

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë të kuptohet se sa paragjykues janë të rinjtë në vendin tonë dhe se a janë të diskriminuara femrat në shoqërinë tonë si pasojë e paragjykimeve. Siç është parë nga studimet e mëhershme, ka shumë dëshmi që tregojnë se femrat janë të diskriminuara si pasojë e paragjykimeve, në nivel botërorë. Ky hulumtim ishte i tipit kuantitativ dhe është realizuar me anë të metodës së anketimit, me ç'rast janë anketuar 100 të rinj nga vende të ndryshme të Kosovës. Hulumtimi është bërë me të rinj të gjinisë mashkullore dhe femërore. Pas përpunimit të të dhënave të përfituara me anë të këtij studimi, kemi ardhur në përfundim se hipoteza e paraqitur në këtë hulumtim "*Femrat janë të diskriminuara si pasojë e paragjykimeve."* është mbështetur.

Hyrje

Historia botërore dhe jeta e çdo individi janë të mbushura me raste të përditshme mospëlqimesh dhe urrejtjesh pa shkak. Lufta e shqiptarëve me serbët në Kosovë, demonstrimet e dhunshme dhe aktet terroriste të grupimeve të veçuara politike në Shqipëri, përbuzja ndaj homoseksualëve, qëndrimet negativiste apo mosvlerësuese ndaj femrave e shumë shembuj të tjerë janë tregues të vazhdueshëm të besimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve të gabuara, pa shkak dhe shpesh të pavetëdijshme të individëve ndaj grupeve të caktuara shoqërore. Njeriu, pavarësisht nga kultura, nuk i shmanget dot tendencave *për të mos pëlqyer* të tjerët që dallojnë nga vetja, *për t'u sjellë* në mënyrë diskriminuese ndaj tyre si dhe *për t'i konceptuar* dhe vlerësuar ata si injorantë dhe të rrezikshëm. Këto janë tri momente të rëndësishme në tendencat njerëzore të përshkruara më sipër, që shpesh quhen paragjykime, diskriminime apo stereotipe (Dragoti, 2004). Paragjykimi vlerësohet si qëndrim, zakonisht negativ, ndaj anëtarëve të disa grupeve

dhe që bazohet vetëm në anëtarësinë e tyre në këto grupe. Cilësitë individuale të anëtarëve të këtyre grupeve nuk kanë rëndësi, ata nuk pëlqehen, sepse, thjesht u përkasin grupeve të tilla. Në qoftë se do të largohen prej tyre dhe do të futen në grupin tonë, ata do të vlerësohen si njerëz pozitiv (Dragoti, 2004). Ndërsa Gordon W. Allport (1954) e përcakton paragjykimin si një qëndrim apo ndjenjë armiqësore ndaj një personi vetëm sepse ai ose ajo i përket një grupi të cilit i janë caktuar cilësitë e pakëndshme. Në vëllimin e tij themelor, "Natyra e Paragjykimit", Allport e ka definuar paragjykimin si "Një antipati e bazuar në një përgjithësim të gabuar dhe të pandryshueshëm, që mund të ndjehet ose të shprehet, dhe që mund të drejtohet ndaj një grupi si një e tërë, ose drejt një individi ngaqë ai është anëtar i atij grupi". Ai thekson se ky qëndrim armiqësor nuk është thjesht një paragjykim i nxituar para se personi t'i din faktet. Ai është një gjykim që u reziston fakteve dhe injoron të vërtetën dhe ndershmërinë. Paragjykimet nuk i përshtaten me lehtësi informacionit ose përvojave të reja; përkundrazi, faktet e reja ose modifikohen për t'iu përshtatur modelit ekzistues të paragjykimit ose injorohen. P.sh., në qoftë se personat me paragjykime raciale ndeshin një anëtar të këndshëm të një grupi që ata nuk e pëlqejnë, ajo që ka më shumë mundësi të ndodhë është se ata do ta shikojnë atë më shumë si "një përjashtim nga rregulli" sesa do të ndryshojnë qëndrimin e tyre ndaj grupit si grup (Pettijohn, 1996). Paragjykimi është parë të ketë tre komponente: njohëse, emocionale dhe të sjelljes. E para nga këto është e barabartë me atë që përcaktohet si stereotip. E dyta është një përgjigje e pastër emocionale ose vlerësues e grupit, pa ndonjë përmbajtje të veçantë semantike. Dhe e treta përbëhet nga sjelljet dhe tendencat e sjelljes që diskriminojnë një grup, ose në favor të një grupi (Dovidio, etj., 2010). Paragjykimi është një problem i madh sot në botë. Në Afrikën e Jugut, ka qenë i njohur racizmi; në Gjermani neonazistët terrorizojnë emigrantët turq; Në Lindjen e Mesme arabët dhe izraelitët paragjykojnë njëri-tjetrin, në ish Bashkimin Sovjetik shpërthejnë konfliktet etnike mbi bazë paragjykimesh. Por, edhe shqiptarët aktualisht po paragjykohen për kulturën, qëndrimet, politiken madje edhe për kolerën. Ndërkohë, mbi bazën e paragjykimeve historike në Kosovë, konflikti social arriti në nivelin e luftës së armatosur midis shqiptarëve dhe serbëve (Dragoti, 2004).

Burimet e paragjykimeve

Siç duket, paragjykimi ka shumë shkaqe. Madje edhe idividët me të njëjtin paragjykim mund të kenë arsye të ndryshme për të. P.sh., njerëzit

zakonisht pëlqejnë ata me të cilët ngjajnë ose ata me të cilët mendojnë se ngjajnë. Ky përgjithësim vlen jo vetëm për ngjajshmëritë në ngjyrën e lëkurës ose në cilësi të tjera fizike, por edhe për shijet, interesat, besimet, qëndrimet dhe vlerat. Studimet kanë treguar se ne mendojmë që njerëzit e së njëjtës racë me ne kanë qëndrime me tonat (Brewer, 1986). Burimet e paragjykimeve janë:

Konflikti ndërgrupor. Sipas kësaj pikëpamje paragjykimi shfaqet si realitet i garës midis dy grupeve. Kur dy grupet konkurrojnë për një burim vlere, grupi që fiton nuk e ndan burimin me grupin që humbet. Kështu, grupi kundërshtar shikohet si rrezik, kërcënim dhe shpejt lind e zhvillohet paragjykimi (Allport, 1954).

Kategorizimi social. Henri Tajfel (1978) e bazon idenë e vet në konceptin e kategorizimit social: që është idea se qëniet njerëzore synojnë të klasifikojnë njerëzit e tjerë në kategori. Në këtë proces ne e ndajmë intuitivisht popullsinë e botës në dy kampe: grupi ynë dhe gjithë të tjerët. Ne shikojmë njerëzit në grupin tonë në mënyrë më favorizuese sesa ata jashtë grupit tonë. Tajfeli supozon se tendencat në grup-jashtë grupit formohen kur kategorizimi bazohet në kritere të parëndësishme dhe të palidhura me njëri-tjetrin. Në qoftë se jemi femra, ne favorizojmë femrat e tjera dhe disfavorizojmë meshkujt.

Kategorizimi dhe tendencat perceptive. Kur i ndajmë njerëzit në kategori ne i shikojmë ata si individë të veçantë, por me cilësi unike. Kështu, perceptimi ynë kthehet në tendencë (Quattrone, 1986). Zakonisht anëtarët e grupit tonë krijojnë përshtypjen për grupin tjetër se ata janë individë të njëjtë, kanë të njëjtat cilësi e karakteristika, prandaj grupi quhet homogjen. Ndërsa grupi ynë shikohet si më i diferencuar. Dhe ne ndjejmë se "ne jemi individë, ndërsa ata janë njëlloj të gjithë" (Linville, 1982).

Personaliteti paragjykues. Shumë studime dëshmojnë se paragjykimet ndaj grave, homoseksualëve, të zinjve, të moshuarve dhe minoriteteve etnike tentojnë të bashkë-ekzistojnë në të njëjtët individë dhe këta individë janë kryesisht ata me personalitet autoritarist (Dragoti, 2004).

Teoria e konfliktit real. Pikëpamja që shpjegon se rivaliteti i drejtpërdrejtë për vlera të caktuara kur burimet janë të kufizuara shkakton armiqësinë midis grupeve quhet teoria e konfliktit real (Levine dhe Campbell, 1972). Njëri grup mund të luftojë më mirë në betejën për tokë, pemë, ose pushtet. Grupi që humbet bëhet i frustruar dhe i fyer, ndërsa fituesi ndihet i kërcënuar dhe i pambrojtur, madje para se konflikti i gjatë të arrijë kulmin. Ka shumë mundësi që shumë paragjykime në botë të stimulohen nga realiteti i rivalitetit (Dragoti, 2004).

Teoria e identitetit social. Sipas kësaj teorie, secili prej nesh përpiqet të shtojë vetërespektin tonë, i cili ka dy komponentë: identitetin personal dhe identitetet e ndryshme sociale që rrjedhin nga grupet, të cilëve u përkasim. Me fjalë të tjera, ne mund të ndërtojmë vetërespektin nëpërmjet arritjeve tona dhe duke u afruar me grupet që janë relativisht të suksesshme (Tajfel dhe John Turner, 1986).

Teoria e ngjashmërisë gjenetike. Sipas teorisë së ngjashmërisë gjenetike tendenca për të mos pëlqyer njerëzit e grupeve të tjera është pjesë e natyrës së trashëguar të njeriut. Sipas disa studiuesve (Reyndds etj., 1987) personat e një grupi etnik të caktuar kanë më tepër gene të përbashkëta sesa ata të grupeve të ndryshme etnike. Prandaj, individët janë më të pranueshëm për anëtarët e grupit të tyre që kanë të njëjtat gene, sesa për anëtarët e grupeve të tjera (Dragoti, 2004).

Feja dhe paragjykimi. Ata që përfitojnë nga pabarazia sociale dhe që e kuptojnë se njerëzit janë krijuar njëlloj, përpiqen të gjejnë një justifikim për realitetin e pabarabartë. Shpesh ky justifikim është besim tek Zoti, se Zoti e ka vendosur rregullin social mbi tokë. Pra, edhe feja është një paragjykim për të justifikuar pabarazinë sociale. Por, megjithëse lidhjet fe-paragjykim janë raporte shkak-pasojë, ende nuk mund të thuhet përfundimisht se cili prej tyre është shkaku (Dragoti, 2004). Një burim tjetër i paragjykimit është reciprociteti i qëndrimeve në komunitetin ose subkulturën ku rritet njeriu. Psikologët kanë zbuluar ndryshime midis rajoneve, kulturave dhe grupeve në qëndrimet e paragjykuara. Individët që lëvizin në zona të ndryshme, ose që identifikohen me grupe të ndryshme janë të prirur t'i ndryshojnë qëndrimet e tyre të paragjykuara për t'u konformuar me normat ose standardet e mjediseve të tyre të reja sociale (Pettijohn, 1996).

Llojet e paragjykimeve

Paragjykimet shfaqen në forma të ndryshme. Ato shpesh janë bashkime të qëndrimeve dhe të sjelljes dhe shoqërojnë diskriminimin në veprime dhe praktika institucionale siç është racizmi dhe seksizmi (Dragoti, 2004). Format e zakonshme të paragjykimeve janë ato raciale, seksuale dhe moshore (Pettijohn, 1996).

Diskriminimi gjinor-seksizmi

Sapo lind fëmija, të rriturit që e rrethojnë bëjnë dallimin e parë të tij: djalë ose vajzë. Ky dallim do ta shoqërojë foshnjën gjithë jetën e tij. Mbi bazën e një dallimi të tillë ngrihet kategorizimi social i çdo individi dhe ndërtohet diskriminimi përkatës gjinor, ai që shpesh quhet seksizëm.

Gjysma e popullatës së botës janë femra. Megjithatë, në shumë kultura femrat trajtohen sikur të ishin minoritet: ato janë përjashtuar nga pushteti ekonomik dhe politik; janë objekt i stereotipeve të forta negative dhe ndeshen ngado me diskriminimin në shumë sfera të jetës. Praktikat diskriminuese gjinore mund të hasen edhe në legjislacionin e shumë vendeve. Forca e një paragjykimi të tillë është e madhe ngaqë ka një shtrirje shumë të gjerë, të paktën në gjysmën e popullsisë së botës (Dragoti, 2004). Kjo ndodhë sepse njerëzit shpesh u përmbahen besimeve mbi atë sesi duhet të jenë burrat e si duhet të jenë gratë. Shpesh këto stereotipe seksuale janë mësuar që në fëmijëri, por vazhdojnë të ndikojnë mbi sjelljen edhe në moshë të rritur. P.sh., disa njerëz besojnë se gratë e kanë mendjen vetëm të lindin fëmijë, se ato janë tej mase emocionale, dhe se janë vazhdimisht të varura nga të tjerët. Burrat disa herë shihen si njerëz me inteligjencë të lartë dhe si të paracaktuar për të udhëhequr (Pettijohn, 1996). Studimet kanë treguar se seksizmi, ashtu si racizmi, vazhdon të përbëjë një problem për shoqërinë tonë. P.sh., Zinkhan dhe Stoidain (1948) zbuluan se në qoftë se një burrë e një grua janë duke pritur që t'u shërbehet në një repart të shitores, mundësia më e madhe është që burrit t'i shërbehet të parit. Shumë studime kanë vërtetuar prirjen që ekziston kundër punësimit të grave në të gjitha llojet e punëve. Kluegel dhe Smith (1986) mbështetën idenë se besimet dhe stereotipet për gratë janë shpesh pjesë e traditave historike, por që pranohen me vështirësi nga shumica e njerëzve. Disa studiues dallojnë dy veçori të stereotipeve gjinore, që ruajnë vazhdimisht ekzistencën e tyre. *Së pari,* shumë njerëz mendojnë se disa cilësi të personalitetit u takojnë vetëm meshkujve dhe disa të tjera vetëm femrave, dhe askush nuk mund të jetë njëkohësisht edhe femër edhe mashkull (Deaux dhe Lewis, 1984). Por, orientimet e rolit gjinor*,* që bazohen në opinionet e njerëzve për karakteristikat e tyre tradicionale femërore apo mashkullore nuk e mbështesin supozimin e mësipërm. Sipas Spence (1985), ata që mendojnë se kanë cilësitë e meshkujve konsiderohen me orientim *mashkullor*, ndërsa ata që mendojnë se kanë veçoritë e femrave vlerësohen me orientim *femëror*. Siç del nga studimi i Spence-it, meshkujt synojnë ta shikojnë veten në radhë të parë si meshkuj, ndërsa femrat e shikojnë veten kryesisht femërore. Por, ndërkohë, disa meshkuj janë femërorë në orientimet e tyre gjinore, ndërsa disa femra janë mashkullore. Por ka edhe njerëz që i kanë të dyja orientimet. Këta individë, që mund të jenë konkurrues dhe të pavarur, të ndjeshëm dhe mbështetës, quhen *androgjenë* (Bem, 1974).

Në orientimin e katërt përfshihen *të padiferencuarit*, që janë individë me veçori të pakta femërore apo mashkullore, që nuk mjaftojnë për t'i cilësuar meshkuj apo femra në orientimet e tyre. Veçoria *e dytë* e stereotipeve gjinore lidhet me besimet dhe konceptet se meshkujt dhe femrat janë thellësisht dhe tepër të ingranuar me gjininë përkatëse, që nga momenti kur lindin, dhe e ndikojnë sjelljen e tyre gjatë gjithë jetës. Por, problemi nuk qëndron në ekzistencën e stereotipeve gjinore, por në njohjen e situatave kur këto stereotipe ndikojnë perceptimin social; në identifikimin e vështirësisë së tyre; dhe në perspektivën e zhvillimit të tyre (Dragoti, 2004).

Ne vërejmë shumë ndryshime midis vajzave dhe djemve në shtëpi, në rrugë, brenda në klasë, në fushën e lojës, gjatë pushimeve të shkollës. Për shembull, në përgjithësi, djemtë janë aktiv, lozonjarë, të besueshëm, të guximshëm, kërkues, të zhurmshëm, nganjëherë të ashpër, poterexhi, agresiv, kundërshtues dhe luftëtar, frikësues dhe të vështirë për tu kontrolluar. Vajzat janë pasive, të buta, shpesh të turpshme, të ndruajtura, më pak komunikuese, frikësohen lehtë, i pranojnë urdhrat, janë më të vetëkënaqura dhe relativisht të lehta për t'u kontrolluar (National Council for Teacher Education, 2003).

Sandra Bem (1974) përpunoi Listën Bem të roleve seksuale (LBRS), një anketë rolesh seksuale me 60 mbiemra për të matur tiparet femërore dhe mashkullore të njerëzve. Ajo zbuloi se tipare të veçanta ishin të lidhura stereotipikisht, përjashtimisht me njërin ose me tjetrin seks. P.sh., tipare femërore janë fisnikëria, ndjeshmëria, ngrohtësia, zëri i butë dhe dashuria për fëmijët. Tipare mashkullore janë ambicja, dominimi, shpirti i garës, agresiviteti dhe prirja për të udhëhequr. Bem zbuloi se, ndërsa shumë njerëz zënë shumë pikë në shkallën e feminitetit ose në atë të maskulinitetit, disa njerëz zënë shumë pikë në të dyja shkallët. Kjo karakteristikë e personalitetit quhet androgjini. Njerëzit androgjinë ndikohen më pak nga stereotipet seksuale.

Faktorët që përcaktojnë aktivitetin e stereotipeve gjinore

Rolet janë pritjet e mësuara të përcaktuara për format e standardizuara të sjelljes. Rolet gjinore janë të mësuara në familje, nga prindërit, vëllezërit e motrat më të vjetër, dhe anëtarët tjerë të cilët ofrojnë modele të përshtatshme për gjininë e një personi. Të mësuarit është përforcuar në pikat e duhura. Dy deri në tre vjeçarët mësojnë se ata janë djem dhe vajza. Atyre u janë dhënë emra të gjinisë së caktuar, rroba të ndryshme, lodra të ndryshme, ushqime të ndryshme, vajzave u janë dhënë kukulla dhe enë kuzhine për të luajtur, djemve u janë dhënë armë, makina dhe

aeroplanë. Nga mosha pesë vjeçare, fëmijët kanë të zhvilluara stereotipet e roleve gjinore të definuara qartë në lidhje me sjelljet, tiparet dhe madje edhe përvojat e përshtatshme (National Council for Teacher Education, 2003).

Kay Deaux dhe Brenda Major (1987) vlerësojnë tri faktorë si përcaktues në forcën ndikuese të stereotipeve gjinore: perceptuesin, objektin dhe situatën. Perceptuesit dallohen nga aftësia dhe kapaciteti që kanë konceptet dhe besimet e tyre për të ndikuar perceptimet e tyre. Sandra Bem (1981) i quan "skematikë gjinorë" ata njerëz që kanë orientime të roleve gjinore mashkullore ose femërore, madje shton se ata e ndajnë botën në dy pjesë, mashkullore dhe femërore. Ndërsa, njerëzit që janë më të balancuar në orientimet e tyre janë "askematikë gjinorë"; për ta seksi nuk është kategori sociale përcaktuese. Skematikët gjinorë i kushtojnë më tepër vëmendje gjinisë së të tjerëve kur vendosin raporte pune apo komunikimi; ata formojnë përshtypje negative për personat që dhunojnë normat kulturore mbi sjelljet e pranueshme mashkullore apo femërore (Dragoti, 2004). Edhe cilësitë e *personit objekt* mund të aktivizojnë stereotipet gjinore. Njerëzit që duken në pamjen e jashtme tepër mashkullorë apo femërore mendohet se janë të tillë edhe në drejtimet tjera (Deaux dhe Lewis, 1984). Madje edhe ofiqi "zotëri" apo "zonjë" mund ta ndikojë stereotipin gjinor.

Diskriminimi i femrave

Legjislacioni në shumë vende të botës nuk e lejon diskriminimin e femrave, madje në disa vende si në SHBA që nga viti 1990 ai e ndalon shprehimisht. Megjithatë femrat vazhdojnë të kenë pozita të disfavorshme në shoqëri, qoftë edhe në kulturat perëndimore (Dragoti, 2004).

Disa fakte që e tregojnë diskriminimin e femrave në botë:

Dy të tretat e fëmijëve pa shkollë në botë janë femra (Kombet e Bashkuara, 1991).

Në Arabinë Saudite femrat e kanë të ndaluar të ngasin makinën. Ndërsa në Sudan ato nuk mund të shkojnë jashtë shtetit pa lejen e burrit, babait ose të vëllait (Beyer, 1990).

Në Koreně e Jugut, lindin 14 për qind më tepër foshnja meshkuj se foshnja femra, ndërsa në Kinë 18 për qind abortet që seleksionojnë gjininë dhe lindjet e foshnjave të vdekura kanë penguar lindjet e 76 milion femrave (Kristof, 1993; Klassen, 1994).

Në Indi këngët e dasmave përgatitin vajzat për keqtrajtimin e mundshëm dhe dhunën fizike në shtëpinë e burrit. Rrahja e gruas, për shembull, është përshkruar si një pjesë e natyrshme e takimeve të natës.

Ky problem i keqtrajtimit të grave duket se ka ringjallur praktikën e vrasjes së fëmijëve femra në disa pjesë të vendit. Në Punjab dhe Haryana, vdekja e foshnjave femra është më e madhe sesa e foshnjave meshkuj (National Council for Teacher Education, 2003).

Të gjitha shoqëritë bëjnë dallimet shoqërore midis burrave dhe grave dhe, për një masë më të madhe apo më të vogël, gratë në të gjithë botën kanë status më të ulët, më pak burime dhe më pak fuqi se meshkujt (UNDP, 2005). Pabarazia gjinore mbetet e zymtë sidomos kur shqyrtohet përfaqësimi i grave në nivelet më të larta të pushtetit. Edhe në vende relativisht barazimtare të tilla si Shtetet e Bashkuara, udhëheqëset e fuqishme femra - edhe pse gjithnjë e më të pranishme - mbeten mjaft të rralla. Për shembull, vetëm 14 për qind e senatorëve të SHBA janë femra (Dovidio, etj., 2010).

Në vendet industriale është tepër i dukshëm diskriminimi i femrave në punë, që shfaqet në formën e pagesës së ulët dhe të punëve me status të ulët në krahasim me meshkujt. Shumë psikologë mendojnë se kjo ndodh ngaqë nuk ka kaluar koha e mjaftueshme që femrat të marrin përfitimet e ndryshimeve legale dhe sociale që kanë ndodhur në dekadat e fundit. Një shpjegim tjetër, që ka më tepër mbështetës, argumenton se megjithëse janë hequr barrierat e mëdha e të dukshme ndaj grave, ka disa forca të fshehura që vazhdojnë të funksionojnë kundër femrave në shumë aspekte (Dragoti, 2004).

Studimet e bëra në Indi tregojnë se djemve nuk u jepen vetëm ushqime të veçanta, kujdes më i mirë mjekësor, por gjithashtu janë të inkurajuar të jenë poterexhi dhe agresiv. Ata marrin përforcime pozitive, pasi ata kthehen 'fitimtarë' nga një përleshje rruge. Djemtë janë të trajnuar për rolet e tregut dhe për porositë shtesë në familje. Vajzave u janë caktuar punët e shtëpisë, kujdesja për vëllezër dhe motra, kujdesia për të sëmurët, kujdesja për bagëti etj. Kjo është me sa duket një mësim për rolin e ardhshëm të tyre, që është e ardhmja e vetme e parashikuar për vajzat. Po ashtu të gjitha vendimet për vajzat merren nga të tjerët. Atyre nuk u jepet zgjidhje/alternativë (National Council for Teacher Education, 2003). Disa nga faktorët që luajnë rol të rëndësishëm në procesin e diskriminimit të femrave janë:

Roli i parashikimeve. Një nga faktorët që pengon përparimin e femrës në shoqëri janë edhe parashikimit ose pritjet që kanë ato për rolin e vet. Në përgjithësi, femrat kanë parashikime të niveleve të ulëta për karrierën e tyre, në krahasim me meshkujt. Ato presin që të marrin paga fillestare madje edhe ato, që janë në kulmin e suksesit në punë, marrin paga më të ulëta se meshkujt (Major dhe Konar, 1984).

Studiuesit mendojnë se femrat kanë parashikime të tilla për veten ngaqë ato e dinë nga përvoja, se mesatarisht femrat paguhen më pak se meshkujt. Një argumentim tjetër është fakti se femrat kanë perceptim më të dobët për lidhjen e punës me të ardhurat monetare sesa meshkujt. Ato vlerësojnë aspektet e tjera të punës siç janë marrëdhëniet shoqërore me kolegët, më tepër sesa meshkujt (Jackson dhe Grabski, 1988). Pavarërisht nëse të tilla diferencime kanë bazë apo jo, si rregull njerëzit marrin në jetë atë që presin të marrin.

Roli i vetëkonfidencës. Mendohet se konfidenca është treguesi i vetëm më i mirë i suksesit. Konfidenca është intimiteti, besimi, familjariteti, siguria në komunikimin me të tjerë ose me veten. Kush parashikon të ketë sukses shpesh e arrinë atë. Ndërsa femrat nuk kanë gjithmonë sigurinë e suksesit, nuk janë familjarizuar me të, nuk besojnë sa duhet, prandaj shpesh dështojnë. Ky aspekt ndoshta ndikon pjesërisht faktin që ato nuk arrijnë barazinë e plotë me meshkujt në shumë fronte pune. Suksesi që arrin femra e rritë vetëkonfidencën e saj, dhe formon identitetin social tek ajo. Prandaj, fidbeku pozitiv dhe suksesi janë shumë të rëndësishëm për femrat, më të rëndësishëm se për meshkujt (Dragoti, 2004).

Dallimet atribuitive në suksesin e femrave dhe meshkujve. Faktori i tretë që vepron kundër femrave përfshin dallimet e atribuimeve që iu bëhen arritjeve të femrave dhe atyre të meshkujve. Studime të ndryshme dëshmojnë se disa persona synojnë t'ia atribuojnë suksesin e meshkujve faktorëve të brendshëm, siç janë përpjekjet ose aftësitë, ndërsa për të njëjtat arritje tek femrat i gjejnë atribuimet tek shkaqet e jashtme siç është fati apo lehtësia e detyrës (Deaux, 1982; Nieva dhe Gutek, 1981). Të tilla vlerësime shprehen në shpërblime dhe promocione të diferencuara për meshkujt dhe për femrat. Këto tendenca nuk shfaqen në çdo aspekt të punës dhe në çdo kohë. Në disa raste, kur vëmendja e personit që bën vlerësime të tilla drejtohet direkt në rezultatin e arritur nga ata që gjykohen, këto tendenca mund të dobësohen (Izraeli, Izraeli dhe Eden, 1985).

Reagimet negative ndaj drejtuesve femërorë. Pavarësisht, se njerëzit nuk deklarojnë paragjykimet e tyre ndaj drejtueseve femra, të dyja palët, meshkujt dhe femrat, e konsiderojnë lidershipin femëror si të paparashikuar. Ata nuk e vlerësojnë të përshtatshëm rolin drejtues të femrës me stereotipin që mbart. Butler dhe Geis (1990) thonë se, shumë njerëz kur ndeshen me drejtuese femra, demonstrojnë shprehje joverbale negative, si shprehje pakënaqësie apo refuzimi në fytyrë. Këto shprehje janë të dëmshme sepse ndikojnë tek anëtarët e tjerë të grupit, të cilët

mund t'i interpretojnë këto reagime si tregues që femra drejtuese nuk është kompetente dhe e suksesshme në këtë rol. Sipas Glick dhe Fiske (1996) paragjykimi ndaj gruas ka dy komponente 'armiqësore' dhe 'dashamirëse'. Seksizmi armiqësor ndëshkon gratë që devijojnë nga një rol tradicional vartës, ndërsa seksizmi dashamirës shpall pozitën mbështetëse, por ende të varur, të grave. Në Shqipëri diferencimi gjinor i femrës vazhdon të jetë i ndjeshëm, pavarësisht se më parë ka qenë diskriminim i hapur që mishërohej në kodet e kanunit dhe zakonet e normat tradicionale të shoqërisë patriarkale shqiptare. Sistemi i mëparshëm imponues social detyroi shoqërinë t'i jepte një vend të konsiderueshëm femrës në punë dhe në familje; madje e ndaloi diskriminimin e saj në rregullat, normat dhe ligjet institucionale të shtetit dhe shoqërisë së kohës (Dragoti, 2004).

Siç u pa nga studimet e mëhershme, ka shumë dëshmi që tregojnë se femrat janë të diskriminuara si pasojë e paragjykimeve, në nivel botërorë.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të kuptohet se sa paragjykues janë të rinjtë në vendin tonë dhe se a janë të diskriminuara femrat në shoqërinë tonë si pasojë e paragjykimeve. Hulumtimi është zhvilluar mbi hipotezën: "*Femrat janë të diskriminuara si pasojë e paragjykimeve."* dhe mbi disa pyetje si: "*A është i rëndësishëm edukimi i vajzave?", "A paragjykojnë më shumë meshkujt apo femrat?", " A paragjykojnë më shumë njerëzit nga zonat rurale apo nga ato urbane?"* dhe *"Cilat tipare i karakterizojnë më tepër femrat dhe cilat meshkujt?".*

II. Metodologjia

Pjesëmarrësit

Hulumtimi është bërë me metodën hulumtuese të anketimit me mostër konveniente (të favorshme). Përzgjedhja e mostrës është bërë në mënyrë aksidentale. Pjesëmarrës në këtë hulumtim kanë qenë të rinjtë nga vendet e ndryshme të Kosovës, të moshës prej 18 deri në 37 vjeç. Mostra është përbërë nga 100 pjesëmarrës, ndarja gjinore e të cilëve ka qenë 47% femra dhe 53% meshkuj. Pjesëmarrësit kanë qenë nga vendet urbane si dhe nga ato rurale.

Instrumenti

Hulumtimi ka qenë i tipit kuantitativ. Si instrument për grumbullimin e të dhënave për hulumtim është përdorur pyetësori i marrë nga udhëzuesi për mësues "*Discrimination based on sex, caste, religion and disability"* i krijuar nga National Council for Teacher Education (2003).

Pyetësori ka qenë anonim. Të dhënat demografike të kërkuara në pyetësorë kanë qenë: vendbanimi, gjinia, mosha, shkollimi, statusi martesor dhe nacionaliteti. Pyetësori ka qenë i përbërë nga 31 pyetje dhe 42 tipare; dhe ka qenë i ndarë në katër pjesë. Pjesa e parë ka përmbajtur pyetje qëllimi i të cilave ka qenë të kuptuarit e qëndrimeve të pjesëmarrësve ndaj edukimit të vajzave. Me pyetjet e pjesës së dytë të pyetësorit është synuar të kuptohet se çfarë mendojnë pjesëmarrësit për barazinë gjinore. Në pjesën e tretë është synuar të kuptohet më shumë për ndarjen e punëve midis vajzave dhe djemve. Ndërsa pjesa e katërt, dhe njëherit pjesa e fundit, ka qenë e përbërë nga tiparet, me qëllim të kuptimit se me cilat tipare më tepër karakterizohen femrat, me cilat meshkujt dhe cilat janë të përbashkëta për të dy gjinitë. Pyetjet kanë qenë të tipit të mbyllur. Analizat e të dhënave janë bërë me programin SPSS.

Procedura

Anketimi është aplikuar në vende të ndryshme si në shtëpitë e pjesëmarrësve, në rrugë, në sheshe, biblioteka etj. Së pari, pjesëmarrësve u është treguar qëllimi i hulumtimit dhe është kërkuar pëlqimi i tyre për të marrë pjesë në hulumtim. Pra, pjesëmarrjësit kanë marrë pjesë në anketim në mënyrë vullnetare, pjesëmarrja nuk ka qenë e detyruar. Pastaj u janë dhënë udhëzime për plotësimin e pyetësorit. Atyre u është dhënë kohë e nevojshme për plotësimin e pyetësorit, që do të thotë se koha për plotësimin e pyetësorit nuk ka qenë e kufizuar.

III. Rezultatet

Në hulumtim gjithsej kanë marrë pjesë 100 pjesëmarrës, ku 47 prej tyre kanë qenë të gjinisë femërore dhe 53 të gjinisë mashkullore (figura 1). Ndërsa ndarja e pjesëmarrësve sipas vendbanimit është paraqitur në tabelat 1 dhe 2, ku 26 femra apo 55.3% e tyre kanë qenë nga vendet urbane dhe 21 femra po 44.7% kanë qenë nga vendet rurale; dhe 25 meshkuj apo 47.2% e tyre kanë qenë nga vendet urbane, ndërsa 28 meshkuj apo 52.8% kanë qenë nga vendet rurale.

Tabela 1. Ndarja e pjesëmarrësve femra sipas vendbanimit

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Urban	26	26,0	55,3	55,3
	Rural	21	21,0	44,7	100,0
	Total	47	47,0	100,0	

Në tabelat në vijim janë të paraqitura përgjigjet në pyetjet mbi qëndrimet e pjesëmarrësve në lidhje me barazinë gjinore në raport me gjininë të nxjerrura përmes SPSS krostabulimeve (*crostabulations*).

Tabela 4 paraqet përgjigjet për *Djemtë dhe vajzat kanë nevojë për arsim të barabartë.* ku 100% e femrave dhe 98.1% e meshkujve janë përgjigjur *Pajtohem*, ndërsa 0% e femrave dhe 1.9% e meshkujve janë përgjigjur *Nuk pajtohem*.

Tabela 4. Djemtë dhe vajzat kanë nevojë për arsim të barabartë

		Gjinia e pjesëmarrësit		
		Femër	mashkull	Total
Djemtë dhe vajzat kanë nevojë për arsim të barabartë.	Pajtohem	100,0%	98,1%	99
	Nuk pajtohem	0%	1,9%	1
Total		100,0%	100,0%	100,0%

Në tabelën 5 janë paraqitur përgjigjet për *Si djemve ashtu edhe vajzave duhet t'u jepet sasi e barabartë e ushqimit.* ku Pajtohem janë përgjigjur 95.7% e femrave dhe 83.0% e meshkujve, ndërsa Nuk pajtohem 4.3% e femrave dhe 17.0% e meshkujve.

Tabela 5. Si djemve ashtu edhe vajzave duhet t'u jepet sasi e barabartë e ushqimit

		Gjinia e pjesëmarrësit		
		femër	mashkull	Total
Si djemve ashtu edhe vajzave duhet t'u jepet sasi e barabartë e ushqimit.	Pajtohem	95,7%	83,0%	89,0%
	Nuk pajtohem	4,3%	17,0%	11,0%
Total		100,0%	100,0%	100,0%

Ndërsa për *Të dyve duhet t'u jepet përkujdesje shëndetësore dhe mjekësore e barabartë kur është e nevojshme.* 100,0% e femrave dhe e meshkujve janë përgjigjur Pajtohem, ndërsa 0% e tyre janë përgjigjur Nuk pajtohem (tabela 6).

Tabela 6. Të dyve duhet t'u jepet përkujdesje shëndetësore dhe mjekësore e barabartë kur është e nevojshme

		Gjinia e pjesëmarrësit		Total
		femër	mashkull	
Të dyve duhet t'u jepet përkujdesje shëndetësore dhe mjekësore e barabartë kur është e nevojshme.	Pajtohem	100,0%	100,0%	100,0%
Total		100,0%	100,0%	100,0%

Në pohimin *Të dyve mund t'u caktohen detyra / përgjegjësi të njëjta.* Pajtohem janë përgjigjur 72.3% e femra dhe 50.9% e meshkujve, kurse 27.7% e femrave dhe 49.1% e meshkujve janë përgjigjur Nuk pajtohem (tabela 7).

Tabela 7. Të dyve mund t'u caktohen detyra / përgjegjësi të njëjta

		Gjinia e pjesëmarrësit		
		femër	mashkull	Total
Të dyve mund t'u caktohen detyra / përgjegjësi të njëjta.	Pajtohem	72,3%	50,9%	61,0%
	Nuk pajtohem	27,7%	49,1%	39,0%
Total		100,0%	100,0%	100,0%

Tabela 8. paraqet përgjigjet për *Të dyve duhet t'u jepet e njëjta liri.* ku 97.9% e femrave dhe 88.7% e meshkujve janë përgjigjur Pajtohem, dhe 2.1% e femrave dhe 11.3% e meshkujve janë përgjigjur Nuk pajtohem.

Tabela 8. Të dyve duhet t'u jepet e njëjta liri

		Gjinia e pjesëmarrësit		
		femër	mashkull	Total
Të dyve duhet t'u jepet e njëjta liri.	Pajtohem	97,9%	88,7%	93,0%
	Nuk pajtohem	2,1%	11,3%	7,0%
Total		100,0%	100,0%	100,0%

DISKUTIMI

Në fillim të këtij hulumtimi kemi folur për praninë e dukurisë së paragjykimit dhe diskriminimit gjinor në tërë botën, dhe natyrisht Kosova nuk bënë asnjë përjashtim në këtë drejtim. Natyrisht, nuk kemi pritur të hasim ndonjë dallim të konsiderueshëm nga ajo që gjendet kudo nëpër botë. Nga rezultatet e paraqitura më lartë mund të konstatohet se hipoteza

mbi të cilën është zhvilluar ky hulumtim: *"Femrat janë të diskriminuara si pasojë e paragjykimeve."* kryesisht është mbështetur. Rezultatet e nxjerrura nga ky hulumtim po ashtu përputhen me rezultatet e studimeve të bëra më herët nga Zinkhan dhe Stoidain (1948); Beyer (1990); Kristof (1993); Klassen (1994) etj.

Përveç hipotezës "*Femrat janë të diskriminuara si pasojë e paragjykimeve."* ky hulumtim është zhvilluar edhe mbi disa pyetje si: "*A është i rëndësishëm edukimi i vajzave?", "A paragjykojnë më shumë meshkujt apo femrat?", " A paragjykojnë më shumë njerëzit nga zonat rurale apo nga ato urbane?"* dhe *"Cilat tipare i karakterizojnë më tepër femrat dhe cilat meshkujt?".*

Për pyetjen "*A është i rëndësishëm edukimi i vajzave?"* pjesëmarrësit kryesisht janë pajtuar me pohimet që tregojnë se edukimi i vajzave është i rëndësishëm. Dy çështje me të cilat pjesëmarrësit janë pajtuar më pak kanë qenë: *Ndihmon në ngritjen e moshës së martesës dhe zvogëlon vdekshmërinë e nënave, foshnjave dhe të fëmijëve*. ku 56% e pjesëmarrësve janë përgjigjur Pajtohem dhe 44% Nuk pajtohem; dhe *Ndihmon në reduktimin e madhësisë së familjes.* ku 62% janë përgjigjur Pajtohem ndërsa 38% Nuk pajtohem. Ndërsa në lidhje me çështjet tjera mbi rëndësinë e edukimit të vajzave pjesëmarrësit kanë shfaqur përqindje të vogël të mospajtimit (tabela 3).

Një tjetër çështje që është synuar të kuptohet në këtë hulumtim është se a ndikon gjinia në paragjykime dhe në diskriminimin gjinor dhe a janë më paragjykues meshkujt apo femrat. Me analizat e bëra me programin SPSS është gjetur signifikanca .000 (tabela 19) që tregon se gjinia ndikon në paragjykime dhe në diskriminimin gjinor. Nga analizat e bëra po ashtu është zbuluar se meshkujt janë më paragjykues sesa femrat me një mesatare prej 28.0189 për meshkujt dhe 25.7021 për femrat (tabela 18).

Përmes këtij hulumtimi po ashtu është provuar të kuptohet edhe dallimi në paragjykime dhe diskriminimin gjinor sa i përket vendbanimit. Signifikanca e gjetur përmes analizës me programin SPSS ka qenë .240 (tabela 35) që do të thotë se dallimi nuk është signifikant dhe tregon se vendbanimi nuk ndikon në paragjykimet dhe diskriminimin gjinor. Rezultatet në këtë hulumtim kanë treguar që në zonat urbane është më i shprehur paragjykimi dhe diskriminimi gjinor sesa në zonat rurale me një mesatare prej 27.3137 për zonat urbane dhe 26.5306 për zonat rurale (tabela 34).

Ndërsa sa i përket ndarjes së punëve në shtëpi nga ky hulumtim është kuptuar se ekziston tendenca që femrave t'u caktohen punët që kryhen brenda shtëpisë dhe shihen tradicionalisht si punë që duhet të kryhen nga

femrat, ndërsa punët që kryhen jashtë shtëpisë dhe shihen si fizikisht më të rënda t'u caktohen meshkujve. Këtë e dëshmojnë përgjigjet e pjesëmarrësve të paraqitura në vijim, ku për punët si: *të pastroj dyshemenë* 48% e pjesëmarrësve janë përgjigjur vajza, 6% djali; *të ndihmoj në gatim* 67% janë përgjigjur vajza, 2% djali; *të ju sjellë një gotë me ujë* 24% e pjesëmarrësve janë përgjigjur vajza, 8% djali; *të përgatitë çaj për mysafìr* 59% janë përgjigjur vajza, 5% djali; *të lajë rrobat / të ndihmoj në përhapjen e tyre jashtë për tharje* 65% janë përgjigjur vajza, 7% djali. Ndërsa për punët si *të sjellë bukë / perime nga tregu* 4% e pjesëmarrësve janë përgjigjur vajza, 31% djali dhe *të sjellë ujë nga pusi* 4% janë përgjigjur vajza, 50% djali (figurat 2-9).

Synim tjetër i këtij hulumtimi ka qenë të kuptohet se cilat tipare i karakterizojnë femrat dhe cilat meshkujt. Nga rezultatet e nxjerra në hulumtim del se femrat shihen më tepër si: të varura, të pasigurta, lëndohen lehtë, dekurajohen lehtë, llafazane dhe flasin butë. Ndërsa meshkujt shihen si: të zhurmshëm, të ashpër, të guximshëm, agresiv, të pavarur, udhëheqës, këmbëngulës dhe dominant (tabela 36). Këto rezultate përputhen me rezultatet nga hulumtimet e bëra në Indi të paraqitura më heret në udhëzuesin për mësues të krijuar nga National Council for Teacher Education (2003) dhe me rezultatet e anketës së bërë nga Sandra Bem (1974).

Gjykuar nga rezultatet në përgjithësi del se hipoteza mbi të cilën është zhvilluar ky hulumtim "*Femrat janë të diskriminuara si pasojë e paragjykimeve."* është mbështetur. Mirëpo, sa i përket validitetit të këtyre rezultateve nuk mund të thuhet që janë plotësisht valide për shkak të kufizimeve që janë shfaqur gjatë hulumtimit, e që natyrisht mund të ndikojnë në këto rezultate.

Kufizimet

Një ndër kufizimet kryesore të këtij hulumtimi është se ky ka qenë një hulumtim i vogël, me një mostër të vogël. Kufizim tjetër ka qenë mënyra e përzgjedhjes së mostrës, e cila ka qenë mostër aksidentale, që do të thotë se nuk mund të bëhet përgjithësimi për të gjithë popullsinë sespse kjo nuk mund të jetë mostër mjaft përfaqësuese. Për shembull, në qoftë se anketimi është kryer në një bibliotekë herët në mëngjes në një ditë të caktuar, njerëzit që do të mund intervistohen do të jenë të kufizuar në ata që kanë qëlluar atje në kohën e caktuar, dhe kjo mostër nuk do të përfaqësojë pikëpamjet e anëtarëve të tjerë të shoqërisë në një zonë të tillë, në qoftë se studimi do të ishte kryer në kohë të ndryshme të ditës dhe disa herë në javë. Kufizim tjetër është edhe mospërfshirja në

hulumtim e pjesëmarrësve nga të gjitha vendet e Kosovës. Rezultate më përfaqësuese dhe më përgjithësuese do të fitoheshin sikur hulumtimi të kishte një shtrirje më të gjerë e po ashtu në hulumtim të përfshihej edhe një numër më i madh i pjesëmarrësve. Po ashtu si kufizim në këtë hulumtim ka qenë edhe mospërfshirja e pjesëmarrësve të të gjitha moshave.

Rekomandimet

Në hulumtimet tjera që do të zhvilloheshin në këtë fushë do të ishte më e favorshme të përdorej një mostër më e madhe, meqë një numër më i madh subjektesh do të siguronte një validitet të jashtëm dhe do të mundësonte përgjithësimin e të dhënave për popullatën e gjerë. Po ashtu për hulumtimet e ardhshme do të rekomandohej pjesëmarrja e subjekteve nga të gjitha rajonet e Kosovës me qëllim që të arrihet një mostër sa më përfaqësuese. Hulumtimet në të ardhmen, gjithashtu do të ishte mirë të përfshinin subjekte të të gjitha moshave dhe me nivel të ndryshëm të edukimit dhe të arsimimit për të kuptuar se a ndikojnë dhe në çfarë niveli ndikojnë këto variabla në paragjykime dhe në diskriminimin gjinor. Gjithashtu do të ishte e mirëseardhur që hulumtimet në të ardhmen në këtë fushë të përqendroheshin në shkaqet e paraqitjes së dukurisë së paragjykimit dhe diskriminimit gjinor.

Referencat

Dragoti, E. (2004). *Psikologjia Sociale.* Shqipëri.

Allport, G. W. (1979). *The Nature of Prejudice.* Reading, MA: Addison-Wesley.

Pettijohn, F. T.(1996). *Psikologjia: Një hyrje koncize.* Botimi I Dytë, Shtëpia Botuese "LILO", Tiranë.

Brewer, M. (1986). The role of ethnocentrism in intergroup confict: In S. Worchwl.

Tajfel, H. (Ed.). (1978). *Differentiation between social groups: Studies in the social psychology of intergroup relations*. London: Academic Press.

Quattrone, G. A. (1986). On the perception of a group's variability. In S. Worchel & W.G Austin (Eds.), *Psychology of inter-group relations* (2nd ed.). Chicago: Nelson Hall.

Linville, P. W. (1982). The complexity-extremity effect and age-based stereotyping. *Journal of Personality and Social Psychology,* 42, 193-211.

Levine, R. A. and Campbell, D. T. (1972) *Ethnocentricism: theories of conflict, ethnic attitudes and group behavior*, New York: Wiley.

Tajfel, H. & Turner, J. C. (1986). The social identity theory of inter-group behavior. In S. Worchel & L. W. Austin (Eds.), *Psychology of Intergroup Relations*. Chigago: Nelson-Hall.

Kluegel, James R., and Eliot R. Smith.(1986). *Beliefs about Inequality: Americans' Views of What Is and What Ought to Be.* New York: Aldine de Gruyter.

Deaux, K. & Lewis, L. L. (1984). The structure of gender stereotypes: Interrelationships among components and gender label. *Journal of Personality and Social Psychology*, 46, 991-1004.

MJEKËSI

DËMTIMET PULMONARE NË DERMATO-POLIMIOZIT

Artur Zoto[1], Elez Selimi[2], Hasan Hafizi[2], Elizana Petrela[3], Teuat Backa[1], Arjan Harxhi[4] Renato Osmënaj[5], Zamira Ylli[6]
[1]Departmenti i Reumatologjisë, Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[2]Departmenti i Sëmundjeve të Mushkërive, Spitali Universitarë i Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Shqipëri
[3]Departmenti i Statistikës, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[4]Departmenti i Sëmundjeve Infektive, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[5]Department i Imazherisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[6]Departmenti i Imunologjisë, Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
Corresponding author
Artur Zoto, mjek reumatolog në QSU "Nënë Tereza" Tiranë, Shqipëri

Rezyme

Hyrje. Dermatomioziti dhe Polimioziti janë sëmundje autoimuno-inflamatore dhe sistemike të cilat krahas dëmtimit të muskujve dhe lëkurës prekin edhe organe të ndryshme, ku një ndër më kryesorët është sistemi respirator. Dëmtimet pulmonare në dermato-polimiozit perfshijnë dëmtime intersticiale, pneumoninë aspirative si dhe insuficiencën respiratore.

Qëllimi. Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i dëmtimeve pulmonare në pacientët me dermato-polimiozit, lidhja e tyre me alterimet e ekzaminimeve imunologjike, gjininë si dhe vlerësimi i ekzaminimeve të përdorura për evidentimin e tyre.

Metoda. Ky është një studim kohort prospektiv që analizon 51 pacientë me dermato-polimiozit. Pacientët janë ekzaminuar me teste laboratorike siç janë antikorpet antinukleare dhe anti-histidyl t

ribonukleik acid sintetaza. Pulmonet janë ekzaminuar me radiografi, skaner me rezolucion të lartë dhe spirometri.

Rezultatet. Dëmtimet pulmonare intersticiale janë evidentuar ne 15 (29.4%) pacientë, pneumonia aspirative në 6 (11.8%) pacientë dhe insuficienca respiratore në 1 (2%) pacientë. Insuficienca ventilatore restriktive u evidentua në 13 (25.5%) pacientë.

Përfundimi. Manifestimet pulmonare janë të shpeshta në dermato-polimiozit. Këto manifestime janë anatomike dhe funksionale. Alterimet e sistemit imun janë një faktor i rëndësishëm në shfaqjen e dëmtimeve pulmonare. Skaneri me rezolucion të lartë është ekzaminimi më sensitive për evidentimin e dëmtimeve pulmonare.

Fjalë kyçe: *miozitis*, sëmundje intersticiale, antikorpe antinukleare.

Hyrje

Dermatomioziti dhe Polimioziti janë sëmundje autoimuno-inflamatore dhe sistemike të cilat krahas dëmtimit të muskujve dhe lëkurës prekin edhe organe të ndryshme, ku një ndër më kryesorët është sistemi respirator. Dëmtimet pulmonare mund ti paraprijnë dermato-polimiozitit prej vitesh ose mund të shfaqen njëkohësisht me manifestimet muskulare dhe të lëkurës (1). Dëmtimet pulmonare janë manifestimi ekstra muskular më i shpeshtë në dermato-polimiozit (2). Këto dëmtime shpesh herë bëhën shkak për rritjen e morbiditetit dhe vdekshmërisë. Sëmundja intersticiale e pulmoneve, pneumonia aspirative si dhe insuficienca respiratore hasen shpesh në këta pacientë. Prevalence e dëmtimeve pulmonare në pacientët me dermato-polimiozit është e ndryshme dhe varet nga disa faktorë siç janë popullata e marrë në studim si dhe metodat ekzaminuese.

Qellimi

Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i dëmtimeve pulmonare në pacientët me dermato-polimiozit, lidhja e tyre me alterimet e ekzaminimeve imunologjike, gjininë si dhe vlerësimi i ekzaminimeve të përdorura për evidentimin e tyre.

Metoda

Ky është një studim kohort prospektiv që analizon 51 pacientë me dermato-polimiozit. Këta pacientë kanë qënë të shtruar në klinikën e Reumatologjisë në Qëndrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, Shqipëri si dhe Spitalin e Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" Tiranë. Të gjithë pacientët plotësojnë kriteret e diagnozës për dermato-polimiozitin (3, 4). Nga ky studim janë përjashtuar pacientët të cilët kishin patur ose kanë sëmundje të tjera të cilat infuencojnë në shfaqjen e

dëmtimeve pulmonare si sarkoidoza, tuberkulozi. Gjithashtu nga ky studim janë përjashtuar pacientët të cilët kanë patur histori të ekspozimit ndaj pluhurave si asbesti dhe silici si dhe duhan pirësit. Nënat shtatëzane dhe ato në laktacion gjithashtu janë përjashtuar nga studimi. Pacientët janë ekzaminuar me analiza laboratorike si keratin fosfokinaza, laktat dehidrogjenaza, aldolaza, antikorpet antinukleare dhe anti-histidyl t ribonukleik acid sintetaza. Sistemi respirator është ekzaminuar me radiografi, skaner me rezolucion të lartë si dhe spirometri. Për diagnozen e dëmtimeve pulmonare intersticiale u vlerësuan imazhet nodular, retikulonodulare, xham i patejdukshëm dhe hoje bletësh (5). Për pneumoninë aspirative janë marrë imazhet që evidentojnë hapësira ajrore opake në pulmone me një shperndarje lobare ose segmentale, ndryshime atelektazike në vartësi të bronkut të kompromentuar nga materiali i aspiruar me elemente inflamatore bronkial dhe te regjionit pulmonare. Në insuficiencën respiratore kemi ngritjen e difragmës, reduktim të volumit pulmonar dhe atelektazë bazale. Provat e funksioni pulmonar janë ekzaminuar me spirometër dhe janë vlerësuar në bazë të kritereve të Shoqatës Amerikane të Toraksit (6). Pacientët në të cilët raporti i volumit të detyruar ekspirator në sekondën e parë me kapacitetin vital të detyruar është normal ose i rritur dhe kanë ulje të kapacitetit vital të detyruar me pak se 80 % janë konsideruar me insuficiencë ventilatore restriktive, ndërsa pacientët në të cilët raporti i volumit të detyruar ekspirator në sekondën e parë me kapacitetin vital të detyruar është më i vogël se 70 % dhe kapaciteti vital i detyruar është normal ose i ulur janë konsideruar me insuficiencë ventilatore obstruktive. Të dhënat janë shprehur si përqindje e vlerave të parashikuara, bazuar në gjininë e pacientit, moshën, gjatësinë dhe peshën.Për të vlerësuar nëse alterimi i ekzaminimeve imunologjike ndikon në shfaqjen e dëmtimeve pulmonare pacientët janë ndarë në dy grupe. Në grupin e parë janë pacientët me alterime të ekzaminimeve imunologjike ndërsa ne grupin e dytë janë pacientët te cilët nuk kanë alterime imunologjike. Për të vlerësuar influencën e gjinisë në dëmtimet pulmonare pacientët janë grupuar në femra dhe meshkuj. Rezultatet e ekzaminimeve të përdorura për evidentimin e dëmtimeve pulmonare u regjistruan më vete.

Analiza Statistikore

Të dhënat e vazhdueshme janë paraqitur në vlerë mesatare dhe deviacion standart. Të dhënat diskrete janë paraqitur në vlerë absolute dhe në përqindje. Diferencat mes variablave diskret u analizuan përmes testit Kolmogorov Smirnov dhe testit Hi katror. Lidhjet mes variablit të

varur me variablat e pavarur u analizuan përmes regresionit logjistik binar. Për gjetjen e gjasave të pranisë së dëmtimeve pulmonare për variablat u llogarit raporti i gjasave si dhe intervali i besimit 95 %. U llogarit sensitiviteti midis ekzaminimeve. Të dhënat u analizuan përmes programit të paketës statistikore për shkencat sociale versioni 19.0. U konsideruan sinjifikative vlerat $p \leq 5$ %.

Rezultatet

Mosha mesatare e pacientëve është 48.84±9.30 vite. Kohëzgjatja e sëmundjes është 6.20±3.62 vite. Paciente femra janë 42 ((82.35%) dhe pacientë meshkuj janë 9 (17.65%). Pacientë me antikorp antinuklearë pozitiv janë 27 (52.9%) dhe anti-histidyl t ribonukleik acid synthetase 19 (37.25%) pacientë. Me dëmtime pulmonare në radiografi rezultojnë 5 (9.8 %) pacientë, në skaner me rezolucion të lartë 22 (43.1%) dhe me dëmtime te funksionit pulmonar në spirometri janë 13 (25.5 %) pacientë. Me dëmtime pulmonare rezultojnë 22 (43.1%) pacientë, nga të cilët, me dëmtime pulmonare intersticiale janë 15 (29.4 %) pacientë, pneumoni aspirative 6 (11.8 %) dhe insuficiencë respiratore 1 (2.0%) pacientë (**tabela 1**). Dëmtimet pulmonare intersticiale janë sinjifikative në raport me dëmtimet e tjera $p < 0.001$.

Tabela 1. Dëmtimet pulmonare në dermato-polimiozit

Variablat	Numri i pacientëve	Përqindja (%)	p
Dëmtime pulmonare intersticiale	15	29.4	<0.001
Pneumoni aspirative	6	11.8	
Insuficiencë respiratore	1	2.0	
Normal	29	56.8	

Me dëmtime të funksionit pulmonar në spirometri rezultojnë 13 (25.5 %) pacientë të cilët janë të gjithë me insuficiencë ventilatore restriktive. Dëmtimet pulmonare janë evidentuar më shpesh tek pacientët te cilët kishin alterime të ekzaminimeve imunologjike (grupi 1). Në këtë grup (grupi 1) pacientësh të cilët janë me antikorpe antinukleare pozitiv dhe anti-histidil t-ribonukleik acid sintetazë pozitiv nga 27 (100.0 %) pacientë, 17 (63.0 %) prej tyre rezultojnë me dëmtime pulmonare dhe 10 (37.0 %) rezultojnë normal, ndërsa në grupin e dytë (grupi 2) ku janë pacientët me antikorpe antinukleare negative dhe anti-histidil t-

ribonukleik acid sintetazë negativ nga 24 (100.0 %) pacientë, vetëm 5 (20.8 %) janë me dëmtime pulmonare, ndërsa 19 (79.2 %) pacientë rezultojne normal **(tabela 2).** Dëmtimet pulmonare në grupin e parë janë sinjifikante në raport me grupin e dytë p < 0.001.

Tabela 2. **Demtimet pulmonare sipas ekzaminimeve imunologjike**

Variablat	**Totali N (%)**	**Dëmtime pulmonare N (%)**	**Normal N (%)**	**p**
Grupi 1	27 (100.0)	17 (63.0)	10 (37.0)	
				<0.001
Grupi 2	24 (100.0)	5 (20.8)	19 (79.2)	

Përmes regresionit logjistik binar, u pa se këta pacientë kanë 6,5 here më shumë gjasa për të patur dëmtime pulmonare **{OR: 6,5; 95% CI: (1,6-28.37)}**, krahasuar me pacientët të cilët nuk kanë alterime të ekzaminimeve imunologjike.Në pacientet femra dëmtimet pulmonare janë evidentuar në një përqindje më të lartë se sa tek meshkujt. Në 42 (100.0 %) paciente femra, 20 (47.6 %) prej tyre kanë shfaqur dëmtime pulmonare dhe 22 (52.4 %) rezultojnë normal, ndërsa në 9 (100.0 %) meshkuj vetëm në 2 (22.2 %) janë evidentuar dëmtime pulmonare dhe 7 (77.8 %) rezultojnë normal **(tabela 3**). Dëmtimet pulmonare të evidentuara tek femrat janë sinjifikante në raport me dëmtimet e shfaqura tek meshkujt p = 0.005.

Tabela 3. Dëmtimet pulmonare femra-meshkuj

Variablat	**Totali N (%)**	**Dëmtime pulmonare N (%)**	**Normal N (%)**	**p**
Femra	42 (100.0)	20 (47.6)	22 (52.4)	
				=0.005
Meshkuj	9 (100.0)	2 (22.2)	7 (77.8)	

Sensitiviteti i skanerit me rezolucion të lartë për evidentimin e dëmtimeve pulmonare në raport me radiografinë është 81.5% dhe në raport me provat e funksionit pulmonar është 62.8%. Sensitiviteti i spirometrisë ne raport me radiografinë është 72.2%.

Diskutimi

Dëmtimet pulmonare në këtë studim janë evidentua në 43.1 % të pacientëve dhe sipas opinionit tonë dëmtimet pulmonare janë një

manifestim ekstra muskular i rëndësishëm në pacientët me dermato-polimiozit. Sipas autorëve të tjerë dëmtimet pulmonare janë të zakonshme në pacientët me dermato-polimiozit dhe shfaqen në rreth 40% të pacientëve duke rritur morbiditetin dhe mortalitetin (1, 2). Dëmtimet pulmonare intersticiale, pneumonia aspirative dhe insuficienca respiratore janë manifestimet pulmonare të evidentuara në këtë studim me dominim të dëmtimeve pulmonare intersticiale. Ky dëmtim është evidentuar në 29.4% të pacientëve dhe është sinjifikantë në raport me dëmtimet e tjera. Dëmtimet pulmonare intersticiale janë evidentuar nga autorë të ndryshëm nga 20-30% të pacientëve dhe shpesh herë ato janë prezente në momentin e diagnozes (1, 7). Dëmtimet pulmonare intersticiale janë një manifestim i zakonshëm në pacientët me dermato-polimiozit dhe prevalenca e tyre varion nga 5-65% dhe varet nga popullata e marr në studim si dhe ekzaminimet diagnostikuese (8). Prezenca e dëmtimeve pulmonare intersticiale shoqërohet me rritjen e mortalitetit në pacientët me dermato-polimiozit (9, 10). Krahas dëmtimeve pulmonare intersticiale në studimin tonë është evidentuar edhe pneumonia aspirative në 11.1% të pacientëve. Autorë të tjerë këtë dëmtim e kanë gjetur në 17% të pacientëve (11). Ky dëmtim ndodh zakonisht në pacientë me dëmtime të muskujve farangealë si dhe të pjesës së sipërme të ezofagut (12). Insuficienca respiratore është një komplikacion i rrallë në pacientët me dermato-polimiozit (13,14). Në studimin tonë ky komplikacion është evidentuar në 2% të pacientëve. Hipoventilimi ndodh si rezultat i dëmtimit të muskujve respirator. Autorë të ndryshëm e kanë evidentuar insuficiencën respiratore në më pak se 5% të pacientëve (15). Krahas dëmtimeve anatomike të pulmoneve në këtë studim janë evidentuar edhe dëmtime të funksionit pulmonar. Provat e funksionit pulmonar në studimin tonë evidentojnë insuficiencë ventilatore restriktive në 25.5% të pacientëvë. Studiues të ndryshëm evidentojnë insuficiencë ventilatore restriktive në pacientët me dermato-polimiozit (12). Një rezultat i rëndësishëm i këtij studimi eshtë se dëmtimet pulmonare janë evidentuar në një përqindje më të lartë në pacientët që kanë alterime të sistemit imun dhe se këta pacientë kanë më shumë gjasa për te bërë dëmtime pulmonare gjatë dekursit të sëmundjes. Kjo tregon se sistemi imun është i implikuar në shfaqjen e dëmtimeve pulmonare. Autore te tjerë theksojnë se antikorpet antinukleare janë faktorë të rendësishëm në shfaqjen e dëmtimet pulmonare dhe50-70% e pacientëve që kanë pozitiv antikorpin antinuklar dhe anti-histidyl t ribonukleik acid sintetaze kanë dëmtime pulmonare (12, 16). Dëmtimet pulmonare në studimin tonë janë evidentuar më shpesh në pacientet femra dhe këto dëmtime janë sinjifikante. Ndoshta numri i vogël i meshkujve ka ndikuar

në këtë rezultat. Në studim tonë skaneri i evidenton dëmtimet pulmonare në një përqindje më të lartë se radiografia dhe spirometria dhe është më sensitiv. Duhet theksuar se spirometria në studimin tonë i evidenton dëmtimet pulmonare edhe kur radiogrfafia rezulton normal dhe është me sensitive.

Përfundimi.

Dëmtimet pulmonare janë manifestim ekstra muskular i zakonshëm në dermato-polimiozit dhe hasen shpesh. Këto dëmtime janë anatomike dhe funksionale. Dëmtimet pulmonare intersticiale dhe insuficienca ventilatore restriktive janë dëmtimet pulmonare që hasen më shpesh në pacientët me dermato-ploimiozit. Alterimi i sistemit imun është faktor shumë i rëndësishëm që influencon në shfaqjen e dëmtimeve pulmonare. Gjinia ndikon në manifestimet pulmonare Skaneri me rezolucion të lartë është ekzaminimi më sensitive për evidentimin e dëmtimeve pulmonare.

Referencat

1.Yang Y, Fujita J, Tokuda M, Bandoh S, Ishida T. Chronological evaluation of the onset of histologically confirmed interstitial pneumonia associated ith polymyositis/dermatomyositis. Intern Med 2002;41:1135-41.

2.Torres C, Belmonte R, Carmona L, Gómez-Reino FJ, Galindo M, Ramos B, et al. Survival, mortality and causes of death in inflammatory myopathies. Autoimmunity 2006;39(3):205-15.

3. Bohan A, Peter JB. Polymyositis and dermatomyositis (second of two parts). N Engl J Med. Feb 20 1975;292(8):403-7.

4. Bohan A, Peter JB. Polymyositis and dermatomyositis (first of two parts). N Engl J Med. Feb 13 1975;292(7):344-7.

5. Travis WD, King TE Jr, Bateman ED, Lynch DA, Capron F, Center D et al. American Thoracic Society/European Respiratory Society international multidisciplinary consensus classification of the idiopathic interstitial pneumonias. Am J Respir Crit Care Med 2002;165:277-304.

6. Miller MR, Hankinson J, Brusasco V, Burgos F, Casaburi R, Coates A et al. Standardisation of spirometry. Eur Respir J 2005;26:319-38

7. Douglas WW, Tazelaar HD, Hartman TE, Hartman RP, Decker PA, Schroeder DR et al. Polymyositis-dermatomyositis-associated interstitial lung disease. Am J Respir Crit Care Med 2001;164(7):1182-85

8. Fathi M, Lundberg IE. Interstitial lung disease in polymyositis and dermatomyositis. Curr Opin Rheumatol 2005;17(6):701-6

9.Arsura EL, Greenberg AS. Adverse impact of interstitial pulmonary fibrosis on prognosis in polymyositis and dermatomyositis. Semin Arthritis Rheum 1988;18:29-37.

10.Lakhanpal S, Lie JT, Conn DL, Martin WJ II. Pulmonary disease in polymyositis/dermatomyositis: a clinicopathologic analysis of 65 autopsy cases. Ann Rheum Dis 1987;46:23-9.

11. Marie J, Hachulla E, Cherin P, Hellot MF, Herson S, Levesque H, et al. Opportunistic infections in polymyositis and dermatomyositis. Arthritis Rheum 2005;53:155-65.
12. Fathi M, Lundberg IE, Tornling G. Pulmonary complications of polymyositis and dermatomyositis. Semin Respir Crit Care Med 2007;28(4):451-8.
13. SanoM, SuzukiM, SatoM, Sakamoto T, Uchigata M. Fatal respiratory failure due to polymyositis. Intern Med 1994;33(3):185-7.
14. Selva-O'Callaghan A, Sanchez-Sitjes L, Munoz-Gall X, Mijares-Boeckh-Behrens T, Solans-Laque R, Angel Bosch-Gil J, et al. Respiratory failure due to muscle weakness in inflammatory myopathies: maintenance therapy with home mechanical ventilation. Rheumatology(Oxford) 2000;39(8):914-6.
15. Dickey BF, Myers AR. Pulmonary disease in polymyositis/dermatomyositis. Semin Arthritis Rheum 1984;14:60-76.
16.Schwarz MI. Pulmonary and cardiac manifestations of polymyositis dermatomyositis. Thorac Imaging 1992;7:46-54.

Prof. dr. Gojard CERGA
(Universiteti *Kristal* – Tiranë)

BIOPSIA

Hyrje

Pavarësisht nga zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë mjekësore, veçanërisht imazherisë, ende mjekësia ka nevojë për ekzaminimet histopatologjike. Duhet të theksojmë se edhe vetë histopatologjia është zhvilluar për së tepërmi me metodat e studimit histokimik dhe histoenzimologjik të cilat ndihmojnë në një diagnozë sa më të saktë të sëmundjes. Për të pasur rezultate sa më të mira në studimet histopatologjike është e domosdoshme te njihet mirë procedura e bërjes së biopsisë si dhe fiksimi i materialit të marrë me metodikat e duhura. Për këtë qellim në këtë studim po theksojmë biopsinë dhe në një punim tjetër do të flitet për procedurat e fiksimit.

Marrja dhe përpunimi i saktë i materialit bioptik: kyçi i suksesit në një ekzaminim histopatologjik

Çfarë është biopsia?

Biopsia është metoda kryesore e punës në shërbimet e anatomise-patologjike. Deshifrimi i fjalës biopsi do të thotë të studiosh (të shohësh) një material të "gjallë", d.m.th. material që merret nga njeriu gjatë jetës. Kjo metodë shkencore ekzaminimi, fillimisht u përdor për të diagnostikuar tumoret, ndërsa sot është shtrirë për të vënë diagnozën e sëmundjeve të ndryshme në shumë organe dhe inde. Biopsia është një procedure praktike e cila bazohet në marrjen e një pjese të vogël indi nga një organ i caktuar (lëkurë, mëlçi, veshka, gjëndrat limfatike, mushkëri, formacione tumorale etj.) i cili pasi trajtohet në mënyrën e duhur shkencore (fiksim, derdhja ne parafine dhe prerja, ngjyrimet e duhura) i nënshtrohet ekzaminimit mikroskopik për të konkluduar mbas analizës dhe sintezës se elementeve të veçantë. Praktikisht, nuk ka mbetur organ që të mos i nënshtrohet ekzaminimit bioptik apo punksion biopsisë. Tashmë, ekzistojnë mjaft aparate të përsosura për të marrë pjesë shumë të vogla indesh nga organet e brendshme, si p.sh.: nga mukoza e traktit digjestiv (fibrogastroskopia), atij respirator (bronkofibroskopia), nga zorra e trashë (kolonoskopia) etj . (1,2,7).

Punksion biopsia është nga metodat më të rëndësishme për përcaktimin e diagnozës, për studimin e dekursit të sëmundjes dhe për të

parë efektin e terapisë. Nëpërmjet punksion-biopsisë sigurohen materiale nga organe të rëndësishme si veshkat, mëlçia, limfonodulat, tiroidia, masat tumorale etj. Sot nuk ka inde të organizmit që nuk mund të studiohet me ndihmën e biopsisë dhe punksion biopsise. Zhvillmi i nëndegëve të histopatologjisë si histokimia, histoenzimologjia dhe mikroskopia elektronike kanë bërë të mundur që sëmundja te studiohet në dinamike jo vetëm në nivelin qelizor, por edhe në atë subqelizor (organelat e qelizës). Shumica e metodave të marrjes se biopsisë bëhen në kushtet e hospitalizimit të përkohshëm (disa orë) dhe i sëmuri e pret përgjigjen në shtëpi pas disa ditësh. (3,4)

Procedurat bioptike kanë mjaft vlera praktike: (1,5,6,7).

Se pari, jo në pak raste të ekzaminimit histopatologjik hasen vështirësi të mëdha për vendosjen e një diagnoze shkencërisht të saktë. Në të tilla raste është mjaft e lehtë që materialin histologjik ta shohin njëkohësisht disa histopatologë dhe mbas diskutimit të arrijnë ne një diagnozë sa më të saktë.

Se dyti, po kështu, është fare i lehtë dhe pa shpenzime dërgimi i preparatit histologjik dhe blloqeve te parafinës në një institucion më të specializuar brenda ose jashtë vendit për ta konsultuar.

Se treti, nëpërmjet prepareteve të arkivuara në kohë, jepet mundësia që të bëhen studime të mirëfillta shkencore lidhur me sëmundje të caktuara tumorale ose jo tumorale. Edhe në vendin tonë duhet t'i referohemi sëmundshmërisë në bazë të statistikave tona dhe mandej mund të krahasohen me ato të vendeve të tjera.

Se katërti, ekzaminimet bioptike janë një moment i duhur për ngritjen tekniko-profesionale gjatë diskutimeve kliniko-morfologjike. Në tavolina të rrumbullakëta, mjekët histopatologë dhe ata klinikistë, diskutojnë për raste të caktuara, duke paraqitur pyetje dhe opsione të ndryshme për diskutim. Në diskutim mjekët, duke u mbështetur në rastin konkret, paraqesin eksperiencën e tyre personale, si dhe të dhënat nga literatura e huaj. Pra këto diskutime do të vlejnë për ngritjen profesionale të të gjithë mjekëve.

Se fundi, por jo me pak i rëndësishëm është studimi në dinamikë i sëmundjes nëpërmjet biopsive të përsëritura, duke krijuar një tablo të qartë mbi mënyrën e evoluimit të sëmundjes. Një gjë e tillë ka një vlerë të veçantë për sëmundjet kronike, si të mëlçisë, veshkave etj. Pavarësisht që në kohën e sotme shkencat mjekësore diagnostikuese kanë bërë përparime të mëdha, sidomos në fushën e imazherisë dhe enzimologjisë, ende është nevoja e përdorimit të biopsisë si metodë diagnostikuese dhe studiuese. Ndërsa ekzaminimet laboratorike shpeshherë studiojnë gjurmët

që dalin nga lezioni patologjik dhe nëpërmjet tyre gjykohet mbi sëmundjen, ato morfologjike janë këqyrja e vetë sëmundjes.

Më qartë mund të bënim këtë krahasim: Vlera e ekzaminimeve laboratorike është e krahasueshme me studimin e gjurmëve që mund të tregojnë me përafërsi se sa njerëz kanë hyrë në një auditor, por nuk janë në gjendje të thonë se sa janë meshkuj e sa femra, sa janë bionde e sa brune, se si janë veshur këta njerëz etj. Ndërsa ekzaminimi histopatologjik është sikur të hapësh derën e auditorit, t'i numërosh njerëzit, të përcaktosh me saktësi gjithçka tjetër. Dhe për më tepër kjo është më se e vërtetë në rastin e studimit të lezioneve neoplazike. Biopsitë, përgjithësisht realizohen nëpërmjet heqjes kirurgjikale te një indi të caktuar.

Metodat kryesore qe përdoren për marrjen e materialit për biopsi

Ekzistojnë tri metoda kryesore për marrjen e materialit bioptik: (5,7,9)

a. Marrja e materialit me *incision* (prerje) ku merret vetëm një pjesë e lezionit. Kjo metode aplikohet me qëllimin e thjeshtë për të vendosur diagnozën e sëmundjes.

b. Marrja e materialit me *ekscizion*, që nënkupton heqjen e tërë zonës së lezionuar, deri në kufij të indeve të shëndosha. Kjo procedurë do të shërbejë si për përcaktimin e diagnozës ashtu edhe për mjekim. Pra, në të tilla raste ndërhyrja kirurgjikale konsiderohet e përfunduar pavarësisht nga diagnoza histopatologjike që do të vendoset.

c. Marrja e materialit me *punksion* (mëlçi, veshka, limfonodul etj.). Kjo metodë e marrjes së indit përdoren disa sete njëperdorimshe (bisturi, age speciale me shiringat respektive) dhe mund të aplikohet me mjaft lehtësi nga mjeket klinikistë në mënyrë ambulatore.

Përgjithësisht, vendimin për të bërë një biopsi me incizion apo ekscizion e merr kirurgu, në vartësi të madhësisë së lezionit (sa më i vogël të jetë, ai aq më e arsyeshme është të hiqet komplet), thellësisë së lezionit (për lezionet në thellësi preferohet të bëhet incizioni), natyra e lezionit (tumoret beninje hiqen totalisht, ndërsa ato malinje varet nëse ka dhënë metastaza etj.).

Rregullat e përgjithshme që duhet të zbatohen gjatë një biopsie.(10,11)

Për kryerjen e një procedure bioptike ekzistojnë *disa rregulla të përgjithshme* që me gjithë se dihen, shpesh neglizhohen duke dëmtuar procedurën e realizimit të saktë të biopsisë.

a. Në rastet kur ka lezione të mëdha këshillohet të merren materiale për biopsi në zona të ndryshme, mbasi zonat diagnostikuese mund të jenë të lokalizuara. Nga përvoja e histopatologëve të shumtë rezulton se shpeshherë lezionet histopatologjike paraqiten të ndryshme në copa të ndryshme.

b. Në rastin e lezioneve ulceriale (tumorale ose jo), marrja e materialit bioptik në qendër të ulcerës mund te përfaqësojë vetëm nekroze dhe inflamacion, prandaj këshillohet që në materialin e marrë për ekzaminim të përfshihen zonat periferike deri në kufijtë e indit të shëndoshë.

c. Rëndësi të veçantë ka që në marrjen e materialit bipotik të tentohet që të merret në thellësi ku të përfshihet si tumori edhe stroma nën të.

Dihet fakti që epiteli i prekur nga kanceri ka tendenca të shkëputet nga stroma nën të, prandaj kërkohet një trajtim i kujdesshëm i këtyre rasteve.

d. Duke njohur faktin që shpeshherë lezionet e vendosura në thellësi shoqërohen me një reaksion proliferativ të indit përreth si dhe mund të shoqërohen me një inflamacion kronik, fibroze, kalcifikim deri në formimin metaplazik të kockës, del e nevojshme që materiali i marrë për biopsi të jetë mjaft i thellë dhe gjithëpërfshirës, përndryshe mundet që të merret vetëm materiali i sipërpërmendur dhe të gabohet në diagnozë.

e. Ne rastet kur merren shume copëza indore është e domosdoshme që të dërgohen që të gjitha për ekzaminim histopatologjik, sepse disa herë fragmentet e vogla dhe që nuk paraqesin ndonjë veçori mikroskopikisht mund të mbajnë elemente diagnostikues hispatologjikisht. Nga përvoja ka rezultuar se është mjaft i dëmshëm dërgimi i materialit për ekzaminim hispatologjik në dy laboratorë të ndryshëm, duke ndarë materialin në dysh, sepse disa herë janë vënë dy diagnoza dhe vetëm kur është bërë ballafaqimi e preparateve kemi parë se që të dy kanë pasur të drejtë, mbasi në njërin material ka pasur elemente të ndryshëm nga materiali tjetër.

f. Mbasi materiali është marrë nga kirurgu, është e domosdoshme që të ekzaminohet makroskopikisht nga ai, por pa e dëmtuar dhe bërë gërryerje sipërfaqësore apo larjen e materialit me ujë, etj. gjë që do të çonte në vështirësimin e trajtimit të materialit bioptik nga ana e laboratorit histopatologjik.

g. Materiali i marrë për biopsi duhet të fiksohet menjëherë sa është hequr nga trupi, prandaj solucionet fiksuse duhet të jenë të parapërgatitura ne sallat e kirurgjisë.

Metodika e marrjes së biopsisë së limfonodulave.(13,14,15)

Do të ndalem ne veçanti në ekzaminimin histologjik të nyejve limfatikë, sepse është procedura më e shpeshtë dhe kryesore, jo vetëm në ekzaminimin e patologjisë se indit limfoid, por është pjesa kryesore e punës së përditshme e laboratoreve histopatologjike në spitale. Në nyjat limfatike sipërfaqësore, përveç patologjive inflamatore dhe metastatike neoplazike, nga organet e ndryshme, konstatohen edhe shumica e limfomave malinje. Të gjitha këto flasin qartë për rendësin e këtij ekzaminimi. Për ketë arsye ka rendësi qysh nga zgjedhja e nyjës që do të merret për ekzaminim hispatologjik, teknika e marrjes se tij, mënyra e dërgimit në laboratorin hispatologjik, përpunimi i duhur i materialit deri ne ngjyrimet e duhura dhe ekzaminimin përfundimtar histopatologjik.

a. Përcaktimi i rajonit të marrjes së gjëndrës limfatike.

Në rastet kur kemi zmadhim të limfonodulave në një zonë të caktuar do të merret një gjëndër që vlerësohet nga kirurgu pa ndonjë përzgjedhje të veçantë. Ndërsa ndryshon puna kur kemi të bëjmë me poliadenopati, sepse në të tilla raste duhet të evitohet marrja e limfonodulit nga zona inguinale apo aksilare mbasi janë zona që shpesh paraqesin alteracione postinflamatore.

Në këto raste do të preferohej të hiqeshin gjëndrat sipërfaqësore të qafës, por edhe këtu duhet të orientohemi drejt duke evituar marrjen e limfonodulave submandibulare, pasi në to drenohet kryesisht limfa, nga rajone të tilla si: hunda, goja dhe hapësira të tjera të fytyrës, ku proceset reaktivo-inflamatore të natyrës infeksioze, kimike, alergjike etj., janë shumë të shpeshta dhe si rrjedhojë reflektohen me ndryshime reaktivo-hiperplazike, duke kompromentuar morfologjinë e këtyre limfonodulave. Pra, preferohen limfonodulat e qafës, por duhet t'u shmangemi nyjeve që janë në afërsi me enët e mëdha, për arsye se mund të dëmtohen ato.

b. Përcaktimi i nyjes që duhet hequr në një rajon të dhënë. (12,13,14)

Në rastet kur në një rajon kemi disa nyje të zmadhuara, duhet të hiqet ajo që është me përfaqësuesja që zakonisht konsiderohet ajo që është më e madhe.

Në të gjitha rastet kur e lejojnë kushtet teknike, krahas nyjes së madhe merret edhe një nyje me përmasa më të vogla, mbasi disa herë në limfonodulat e mëdha krijohen lezione sekondare, si nekroze e inflamacion që vështirësojnë përcaktimin e diagnozës.

*c. Kriteret teknike qe duhet te zbatohen ne biopsine e limfonodu*lit.(13,15)

Një rëndësi të veçante ka zbatimi i kritereve teknike në marrjen e limfonodulit. Limfonoduli duhet të hiqet i teri së bashku me kapsulën dhe indin e shkrifet lidhor-dhjamor përreth. Kjo sepse mjaft shpesh, varësisht

nga gjendja e kapsulës dhe e indit përreth shërben si orientim i rëndësishëm në diagnozën diferenciale të patologjive të ndryshme, sidomos në drejtim të proceseve malinje limfoproliferative. Nyja duhet të hiqet me delikatesen më të madhe, pa ushtruar asnjë presion mbi të, si dhe duhet të hiqet komplet dhe jo pjesërisht. Dihet fakti se procese të ndryshme patologjike me lokalizim në limfonodulet, sidomos limfomat malinje, proceset metastatike etj., mund të fillojnë apo të prekin vetëm një pjesë të limfonodulit.

d. Dërgimi i biopsisë në kushte të mira teknike:

Kjo ka një rëndësi të veçantë në procedurën e ekzaminimit bioptik. Limfonodulat janë të mbështjella nga një kapsule e fortë që pengon hyrjen e solucionit fiksues në brendësi të tyre. Në rastet kur shërbimi i morfologjisë është pranë klinikes, këshillohet që limfonoduli të dërgohet menjeherë ashtu siç është dhe, morfologu e pret me kujdes dhe mund të zbatojë edhe biopsinë "gjurmë". Në rastet kur shërbimi anatomo-patologjik është larg (në një qytet tjetër), këshillohet që nyja të pritet me bisturi të hollë gjatë boshtit më të vogël dhe të futet në një enë të bollshme e cila mban 20-fishin e volumit të limfonodulit.

Si solucion fiksues më i mirë është ai i autorit *Helly* apo fiksuesi *Dubosque (Brazil)*, kur këto mungojnë, mund të përdoret formalina 10%.

LITERATURA

Leopold G. Koss: Diagnostic Cytology and its Histopathoogic Bases. J.B. Lippincott & Company, 1992.

Cumar V. et al. : Basic Pathology. W.B. Saunders Company Philadelphia, 1992.

Otto Saphir: A Text on Systemic Pathology, Grune & Stratton, 1958.

Annderson J.R.: Muir's Textbook of Pathology, Edward Arnold ,1985.

Sternberg S.S.: Diagnostic Surgical Pahology, Raven Press, 1989.

SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE

Rosai J.: Ackerman's Surgical Pathology, The C.V. Mosby Company, 1989.

Kotran K. et al.: Robbins Pathologic Basis of Disease, J.B. Lippincott, 1999.

Cagle T.Ph.: Color Atlas and Text of Pulmonary Pathology,Lippincott Williams & Wilkuns, 2005.

Houser S.: Lung Pathology, Human Press, 2005.

Crocker J and Burnett D.:The Science of Laboratory Diagnosis, John Wiley & Sons Ltd, 2005.

Lever W.: Histopathology of the Skin, Lippincott Williams & Willkins, 2007.

Rroku C.: Patologjia e Nyjave Limfatike, Tirane, 1985.

Rroku C. dhe Pavli E.: Teknika Histopahollogjike, Tirane, 1979.

Roku C. e bp.: Morfologjia Patologjike, Tirane, 1975.

Bitri P. e bp.: Anatomia Patologjike, Tirane, 1981.

Dr. Ganimete HOXHA

KALA-AZAR

(*Leishmaniossis visceralis , sëmundja e zezë)*

Laishmanioza është sëmundje endemike që shkakton dëmtime *granulomatoze* në lëkurë dhe organe *viscerale*; sëmundje parazitare e shkaktuar nga protozoa e gjinisë Leishmania. Përhapja e sëmundjes bëhet përmes mushkonjave të tipit *flebotomas*. Jeton në vendet e nxehta tropikale dhe subtropikale. Në vendin tonë është i njohur tipi mediteran që shkakton formën viscerale *kala-azar*. Strehuesit e parazitë janë: qenët, brejtësit, njeriu. Njeriu është infektues pas 7 – 21 ditësh. Ekzistojnë 3 forma të sëmundjes: forma *kutane*, forma *mukokutane*, forma *viscerale – kala-azar*.

Prezantim rasti

F. C: I lindur më 1962, lajmërohet në mars të vitit 2004 me plogështi, humbje oreksi, djersitje, hiperpigmentim të lëkurës në ekstremitetet e poshtme. Bëhen analizat laboratorike SE: 26, ER: 4.5, HGB: 121, HTC: 0.38, LE: 3.9, TROMB.: 29, EHO Abdomeni: hepari dhe lieni i zmadhuar. Hospitalizohet në spitalin e përgjithshëm të Tivarit, pastaj në konsultim me hematologun në kliniken hematologjike në Podgoricë. Bëhet diagnostifkimi serologjik i palcës kockore ku gjinden format amostigote të parazitit *leishmania viscerale donovani -Kala-Azar*. Hospitalizohet në kliniken infektive dhe fillon terapia adekuate me antimon 5 valent- Glukantin 28 javë. Përkeqësimi dhe recidivi i sëmundjes paraqitet ne vitin 2006, hospitalizohet në Kliniken Infetkive të sëmundjeve tropike në Beograd. Tretmani vazhdohet me *Amfoterecin* B, sipas protokollit. Në vitin 2010 vjen deri te përkeqësimi i gjendjes dhe vendoset të bëhet *splenektomia* me *holecistektomi*. Pas operacionit gjendja e pacientit dukshëm keqësohet, dominojnë temperaturat e larta, plogështi, *anoreks*i, *trombocitopeni*, *hipoproteinemi*. Terapia me *amfotericin B* jep efekte anësore, ndaj propozohet terapia antiparazitare *Miltefoline (Impavido)* 100 mg. Pacienti vdiq dy muaj para se të merrte terapinë e propozuar.

Konkluzion

Kala-Azar (sëmundja e zezë) është sëmjundje kronike dhe vdekjepru-rëse, krahas luftimit te sëmundjes me glukantin dhe amfotercin B u paraqit rezistenca. Është sëmundje e rëndësishme për mjekësinë klinike dhe shëndetin publik.

Prevenca

Vaksinë kundër sëmundjes nuk ka, mund vetëm të bëhet mbrojtja nga mushkonjat, dezinsektim, largimi nga gërmadhat dhe mbeturinat, zvogëlimi i rezervoarve të parazitit (qenët, brejtësit).

Fjalë kyçe: *Laishmanioza, kala-azar.*

Prezantim rasti: laishmanioza eshte semundje endemike qe shkakton demtime granulomatoze ne lekure dhe organet viscerale. semundje parazitare e shkaktuar nga protozoa e gjinise leishmania.

Qellimi i punimit

Prezentimi i rastit me kala-azar, hroniciteti i semundjes dhe rezistenca ne terapine e perdorur-rasti specifik.

Metodat e punes

Të dhënat e rastit të marra nga kartela elektronike, raportet mjekesore, fletëlëshimet spitalore si dhe percjellja e rastit qe nga semundja dg, e deri ne vdekje. Ekzistojne 30 lloje te leishmanis. te ne eshte i njoftun tipi mediteran-laishmania donovani.Përhapja e semundjes behet permes mushkonjes flebotomas-papataqi.. jeton ne vendet me klime tropikale dhe subtropikale, rezervuar te parazitit jane brejtesit, qenet, njeriu. Insektet jane infektuese per njeriun pas 7-21 ditë, koha nga kafshimi i insekteve te infektuar e deri te paraqitja e semundjes te njeriu sillet prej prej 7-deri disa muaj per formen lekurore, ndersa 10dite e deri disa vjet per formen viscerale. Sëmundja paraqitet ne 3 forma: I kutane, II mukokutane, III viscerale- kala azar (vdekja e zeze). Leishmanioza është e regjistruar ne 88 vende të botës. Format me të rënda të sëmundjes janë në Azi (Indi, Nepal, Bangladesh); Afrikë (Sudan) dhe në Amerikën Jugore – Brazil.

Në Mal të Zi janë regjistruar 40 raste kala-azar, nga viti 1995 deri në vitin 2006, ndërsa në vitin 2007 - 2 raste; 2008 - 3 raste. (Marrë nga statistikat e Instituti për Shëndetin Publik në Podgoricë).

P r e z e n t i m r a s t i

F. C.: i lindur ne vitin 1962. Pacienti lajmërohet në vizitë në maj të vitit 2004, me plogështi, anoreksi, djersitje, në ekstremitete të poshtme, hiperpigmentim, dhimbje permanente nën brinjën e djathtë, sidomos pas ushqimit. Në ekzaminimin fizikal, mushkëritë dhe zemra pa veçori patologjike. Abdomeni i butë i ndjeshëm në epigastrium dhe nën brinjen

e djathtë, hepari palpohet për 2 gisht, ndërsa lieni - një gisht. Ekstremitetet – pa deformitete, me hiperpigmentim të lekurës nga gjunjët e deri te shputat. Anam. e jetës: ka vuajtur nga ulcera e duodenit. Anam. e familjes: motra i ka vdekur nga leukemia. Pacienti menjëherë dërgohet për ekzaminim laboratorik dhe eho të abdomenit. Rezultatet lab. janë se 26, eritr 4.5x10 9/l, le 3.9x10/9l tromb 29x10 9/l eho abdomeni lieni dhe shpretka të zmadhuar, voluminoz rreth 900ccm. V. f. : prania e disa konkrementeve hospitalizohet në Spitalin e Tivarit. Pastaj, për diagnostifikim të matutjeshëm dërgohet në Kliniken Hematologjike, në Podgoricë. Është bërë punktimi i palcës kockore, shikimi mikroskopik; ngjyrosje sipas gejmsit – vërehen format amostigote të parazitit laishmania donovani. Pacienti udhëzohet në Kliniken Infektive, ku edhe fillon terapia adekuate me antimonin 5 valent–glukantin 28 ditë. Gjendja e pacientit dukshëm përmirësohet, kthehet në shtëpi, ku edhe i bën vizitat e vazhdueshme konsultuese. Hospitalizimi i dytë bëhet në vitin 2006, bëhet përkeqësimi i gjendjes: me temperaturë, plogështi, anoreksi, dhimbje barku, hiperpigmentim i lekures, hepatosplenomegali dhe titrit të lartë të antitrupave në lajshmania në Institutin për Sëmundje Tropike dhe Infektive në Beograd. Te pacienti vërtetohet se ka të bëjë me recidiv të sëmundjes dhe rezistence në terapi: glukantin. Hospitalizimi pasues përsëri në Beograd pas 3 muajve ku aprovohet terapia me amfotericin **b,** sipas protokollit dhe diagnostifikimi plotësues për shkak te trombocitopenise. Në Institutin e Mjekësisë Nukleare bëhet pul-kinetika e jetegjatësisë dhe sekvestrimit të trombociteve. Trombocitet jetonin vetëm 4 ditë (7 ditë normal), ndërsa prodhimi i tyre është 2x më tepër se normal. Në vitin 2008 bëhet sërish hospitalizimi në Klinikën Kirurgjike, Urologji; intervenim në testis - *dg hidrocela*. Në maj të vitit 2010 ndodh përkeqësimi i sëmundjes; hospitalizohet në Beograd, ku dhe vendoset të bëhet *splenektomia* me *holecistektomi*. Nga kjo periudhë gjendja e pacientit nuk përmirësohet; temperaturat janë perzistente, plogështi *trombocitopeni*, anemi. Trombocitet në rënie: 27-26-24 x10 9/l; trajtohet me terapi *antiparazitare rehidruese* dhe transfuzione të herëpasshershme, por pa sukses. Pas *splenektomisë*, gjendja e pacientit dukshëm keqësohet, përsëritet terapia me *amfotericin b*. Në muajin tetor paraqiten kundërefekte dhe ndërpritet terapia. Konsiliumi i mjekëve vendos të merret preparati *impavido caps 100 mg (impavido*). Pacienti vdiq në pritje të terapisë 2 muaj më pas.

Konkluzioni

Te pacienti krahas luftimit me *antimonin 5 valent glukantin*, *amfotericin b,* u paraqit rezistenca dhe pacienti vdiq pas 6 vjet sëmundje.

Përkeqësimi i dukshëm ndodhi pas *splenektomisë*. Jetoi vetëm 6 muaj pas. Pra: *kala azar është sëmundje kronike, vdekjepruse.*

Prevenca

Vaksinë kundër sëmundjes nuk ka te ne të regjistruar, mbrojtja nga mushkonjat, dezinsektimi me preparate të nevojshme – repelentan, mbrojtja individuale, largimi nga gërmadhat, mbeturinat, zvogëlimi i rezervuarve te lëjshmanisë, qenët, brejtësit.

LITERATURA

Prof. dr. Fran Mihajlovič
Prof. dr. sci. Josip Fališevac
Dr. sci. Branko Bezijak
Dr. sci. Boris Mravunac

FARMACI

Mr. pharm. Mehrixhana DERVISHI - LLAZORJA

BIMËT MJEKËSORE NË TRAJTIMIN E ÇRREGULLIMEVE NERVORE

Me mijëra vjet njerëzit kanë përdorur vetëm medikamentet që kanë gjetur në natyrë. Me zhvillimin e kimisë dhe me sintezën e substancave të llojllojshme, hapen mundësitë e papara për shërim të çrregullimeve dhe sëmundjeve trupore dhe mendore. Në shtetet e zhvilluara medicina zyrtare largon medikamentet tradicionale natyrore dhe fito terapinë si metodë joefikase dhe joshkencore. Përdorimi i bimëve dhe ilaçeve tjera natyrore mbetet i kufizuar vetëm në shtetet e ashtuquajtur botës së tretë. Mirëpo, për shkak të dëshpërimeve të shpeshta në medikamentet sintetike, veçanërisht për shkak të pasojave serioze dhe të papëlqyeshme anësore, si dhe çmimeve të larta, viteve të fundit po përjetojmë një revolucion të *medicinës herbale*. Nga ana tjetër, mediat gjithandej informojnë për "*mrekullitë e ilaçeve natyrore*" dhe "*shërime mahnitëse*", çka, për fat të keq, çon në konfrontim me medicinën zyrtare dhe shpesh shtinë huti tek pacientët dhe familjet e tyre dhe i bëjnë këta të largohen nga metodat e dëshmuara dhe efikase të medicinës zyrtare. Nga ana tjetër, qëndron fakti se shumë prej medikamenteve që përkrah medicina, në fillim janë prodhuar në mënyrë natyrore e josintetike. Qasja shkencore për një problem terapeutik kërkon jo vetëm të dëshmohet efikasiteti dhe të shpjegohet mënyra e ndikimit, por duhet të dëshmohet se një ilaç nuk ndikon kur përvojat individuale flasin për një lloj ndikimi. Në botë është duke u rritur numri i institucioneve medicinale që ofrojnë qasje integrale dhe komplementare në kurim me ilaçe sintetike dhe natyrore. Rregulli bazik në medicinë është dhe „*Primum non nocere*", çka do të thot „*Së pari të mos damtojë*" pacientin. Kjo nënkupton jo vetëm që pacientit nuk i jepet ajo çka numd ta përkeqësojë gjendjen e tij, por edhe nuk i privohet ajo çka mund t'i ndihmojë për shërim. Në shumë situata personit me probleme mendore, kjo këshillë është e pranushme dhe racionale.

Kantarion- Hypericum perforatum (St. John's Wort)

Kantarioni ka një traditë të lashtë, diku më shumë se 2400 vjet të përdorimit në medicinën popullore për përmirësimin e disponimit, mënjanimin e ngërçit nervor, pagjumësisë dhe në stabilizimin psiko-neuro-vegjetativ. Ekstrakti i standardizuar, i sajuar nga kantarioni, në shumë shtete mund të gjendet në tregun e lirë. Bëhet fjalë për ilaç natyror i cili është padyshim efikas, përballohet mirë, ka mekanizma të njohura ndikimi dhe ka substanca të identifikuara të ndikimit. Produktet nga kantarioni tek ne janë të popullarizuara, shitja e tyre është në rritje sidomos tek personat që preferojnë ilaçet e natyrshme, është shumë me rëndësi që mjekët ta njohin mirë këtë bimë, mes tjerash dhe për mundësitë e kombinimit me ilaçe tjera. Me që bëhet fjalë për ilaç natyror, për të cilin është dëshmuar se është efikas dhe përballohet mirë, rekomandohet përdorimi i tij për shërimin e depresioneve të lehta dhe për çrregullime anksioze.

Farmakodinamika. Përbërjet e identifikuara të kantarionit janë *hipericina*, *pseudohipericina*, *hiperforina*, *biapigenina*, *rutina* dhe *kvercitrina*. Ndikimi antidepresiv i ekstratit hiperik lidhet me inhibimin e monoaminooksidazës A, si dhe me inhibimin selektiv të rimarrjes së *serotoninës*, pastaj me blokimin e receptorit 5-HT2 të serotoninët, me ndikimin në GABA, në receptorët benzodiazepine dhe 5-HT1 serotonine, me zvogëlimin e tretjes së interleukinit, në rend të pare të IL-6 dhe të kortizolit.

Farmakoterapia. Ekstrakti i hiperikës në rend të parë rekomandohet për shërimin e çrregullimeve të lehta dhe të mesme të anksiozitetit dhe depresionit, veçanërisht tek individët që nuk duan "kiminë" dhe ilaçet sintetike, por preferojnë metodat natyrore të shërimit. Kantarioni mund të ndihmojnë edhe për çrregullimet afektive sezonale. Duke ju falënderuar efektit antidepresiv dhe anksiolitik, ekstrakti i hiperikës mund të ndihmoj dhe në lënien e duhanit. Në bazë të hulumtimeve permanente është vërtetuar efektiviteti në shërimin e depresionit në menopauzë.

Efektet anësore. Efektet anësore janë të rralla dhe rëndomë të lehta (ose të buta). Janë të shënuara acarime gastrointestinale, tharje e gojës, lodhje, marramendje, dhe reagime të buta alergjike. Në studimin e përcjelljes së pacientëve pas blerjes së ilaçit, janë shënuar ma pak se 2% të atyre që nuk e marrin më tutje për shkak të efekteve anësore. Për shkak të mundësisë së foto ndjeshmërisë të shkaktuar nga hipericina, e që paraqitet me skuqje dhe kruarje të lëkurës, rekomandohet kujdesi nga rrezitja. Hulumtimet kanë treguar se dozimet e larta deri në 1800 mg, vetëm pak e rrisin ndjeshmërinë në UV dritë por nuk është shënuar

fotosenzitiviteti. Nëse paraqitet përzierje dhe distres gastro-intestinal rekomandohet marrja e ilaçit bashkë me ushqim. Nuk janë regjistruar raste vdekje si pasoj e hiperdozimit. Gjatë dozave deri në 1800 mg nuk janë shënuar ndryshime në EKG sikur ndryshim i frekuencës, PR, QRS, dhe QTc intervaleve. Gjatë përdorimit të përbashkët të ekstraktit të kantarionit me *inhibuesit selektiv*ë të *serotoninës* është përshkruar *sindroma e serotininit*, çka shpjegohet me *inhibimin e monoaminooksidazës*.

Interaksionet. Hiperferini, siç duket është induktor i CYP 3A4, derisa nuk ka efekt në CYP 2D6. Ekstrakti i hiperikës mund të ulë përqindjen e *ciklosporinës, digoksinit, kontraceptivave orale, teofilinit, karbamazepinit, fenobarbitonit, fenitoinit, varfarinit.* Ekziston mundësia e pengesave serioze me rastin e përdorimit të njëkohësishëm me frenues selektiv të ruajtjes së serotoninit dhe me frenues MAO.

Kava-kava - Piper methysticum (Kawanorm)

Bima ***kava-kava*** gjithnjë e më shumë tërheq vëmendjen për shkak të ndikimit të saj të mirë anksiolitik. Për te flitet si për „*yllin e bimëve*“ (*herbal superstar*), sepse ndoshta do të mund të zëvendësojë benzodiazepinet. Sepse, derisa benzodiazepinet mund të shkaktojë varshmëri, pengesa në memorie dhe përshkallëzimin e depresionit, kava-kava përmirëson disponimin dhe funksionet kognitive, dhe të gjitha këto pa shkaktuar varshmëri. Hulumtuesi në ishullin ***Fixhi Levin***, që nga viti 1884 ka vërejtur se kava-kava "*kthjellon mendjen dhe mundësitë intelektuale*". Kjo rrjedh nga fakti se rrënja e bimës kava-kava në ishujt e Oqeanit Pacifik me mijëra vite përdoret për çaj në ritualet religjioze për qetësim dhe relaksim.

Farmakodinamika. Substancat aktive janë kavapironet: *kavaini*, *dihidrokavainet*, *metisticini*, *dihidrometisticini*, *jangonini* dhe *dezmetiloksijangonini*. Kavapironet ndikojnë kundër frikës, nxisin aktivitetin gabaergjik, ulë sistemin mezolimbik dhe neuronet dopaminergjik të serotoninit. Përmirësojnë kualitetin e gjumit pa përdoruar supresionet REM për gjumë. Supozohet se kanë dhe efekte spazmolitike, antipiretike, analgetike dhe lokal-anestetike.

Farmakokinetika. Kavapironet janë lidhje të theksuara liofile, çka do të thotë se treten shpejt, sidomos kur konsumohen bashkë me ushqim. Koncentrimi kulmorë arrihet për 1,8 orë, kurse koha mesatare e tretjes rreth 9 orë.

Indikacionet. Ekstrakti i kava-kavës largon ose zbut ankthin, tensionin dhe frikën, gjendjen e shqetësimit dhe nervozizmit e qetëson,

lehtëson fjetjen dhe përmirëson kualitetin e gjumit, ashtu që rekomandohet për kurimin e çrregullimeve të lehta të anksiozitetit. Pengesat anksioze në menopauzë gjithashtu reagojnë mire në ekstraktin e kava-kavës.

Efektet anësore. Ilaçet bimore që kanë në përbërjen e vet ekstraktin e bimës kava-kava rëndomë përballohen mirë në dozat e rekomanduara. Janë të rralla reagimet alergjike, pengesat në organet e tretjes dhe vertigo. Në fillim të kurimit mund të ketë përgjumësi dhe lodhje. Mund të vij dhe deri te zgjerimi i bebëzave të syrit dhe te akomodimi i syrit. Shënohet dhe rritja e enzimave hepatike, ulja e albuminave dhe proteinave, si dhe rritja e kolesterolit tek Aborixhinët që kanë konsumuar shumë bimën kava-kava. Njëra nga substancat, besohet jangonin mbete në shtresën keratine të lëkurës, thonjve dhe flokëve, dhe mund të shkaktoj ngjyrosjen në të verdhë. Tek të sëmurit nga sëmundja Parkinson mund të përkeqësojnë dobësinë dhe dridhjen e muskujve.

Interaksionet. Ekstrakti i bimës kava-kava mund të theksoj ndikimin e ilaçeve SQN siç janë barbituratet, antidepresivet sedative, antipsihotikët sedative, benzodiazepinet, hipnotikët. Përdorimi i njëkohësishëm i ekstraktit të kava-kava dhe benzodiazepineve mund të shkaktoj letargji dhe dezorientim.

Valeriana - Valeriana officinalis

Për shkak të popullaritetit në Evropë, por dhe nëpër botë ka marrë emrin "*valiumi natyror*", sepse me sukses largon frikën dhe pagjumësinë. Në tregun evropian shiten më shumë se njëqind përbërje të valerianës.

Farmakodinamika. Substanca aktive është acidi valerik, derisa ekstrakti i standardizuar valepotriat është eliminuar. Ekstrakti i valerianës ngjashëm me benzodiazepinin përforcon aktivitetin gabaergjik.

Indikacionet. Në dozat prej 50 deri 100 mg ekstrakti përdoren për forma të lehta të anksiozitetit dhe pagjumësisë, veçanërisht në situatat e stresit. Mund të ndihmoj edhe në lënien e benzodiazepinit por në këtë rast nevoiten doza më të mëdha. Mund të përmirësojnë fjetjen tek konsumuesit e duhanit, kafes dhe atyre që kanë probleme me gjumë.

Efektet anësore. Nuk janë përshkruar bashkëveprime serioze, por megjithate, nuk rekomandohet përdorimi i njëkohësishëm me alkool dhe benzodiazepine.

Ginkgo - Ginkgo biloba

Ginko biloba i përket familjes *Ginkgoacea* dhe i vetmi ka mbijetuar periudhën e akullit, rritet vetëm në Azi, ku me mijëra vite nderohet si dru

i shenjtë për shkak të vetive shëruese. Është bima e vetme që ka mbijetuar bombën atomike në Hiroshima. Gjithnjë e më shumë po tërheq vëmendjen e medicinës përëndimore. Ka marrë emrin „*antidot kundër frigës nga plakja*“.

Farmakodinamika. Ginkgo përmirëson qarkullimin e dobësuar të gjakut të trurit dhe përmirëson funksionet e trurit, duke zbutur ose eliminuar simptomat e marramendjes, dhimbjen e kokës, zhurmën e veshëve, harresën, përqendrimin e dobësuar, pagjumësinë, pa disponimin, ndjenjën e ankthit dhe frikës. Substanca aktive janë glikozidet (bioflavonidet), që janë antioksidant të fortë dhe ngadalësojnë koagulimin e gjakut dhe ginkolidet të cilët përmirësojnë qarkullimin e gjakut dhe ndikojnë në mbrojtjen e neuroneve. Sipas disa studimeve përmirësojnë dhe funksionin seksual.

Indikacionet. Kryesisht përdoret në neurologji për zbutjen dhe ngadalësimin e harresës së pleqërisë në dozat prej 120 deri 160 mg në ditë, por nëse ilaçi përballohet mirë doza mund të rritet deri në 240 mg në ditë. Mund të jepet edhe për shërimin e depresionit, sidomos të moshuarve. Indikacione interesante për psikiatri janë dhe vertigo, migrena dhe impotenca e tipit vaskular.

Efektet anësore. Rëndomë janë të rralla. Tek personat e ndjeshme mund të shkaktoj probleme në organet e tretjes. Acidi ginkolik është alergjen i fort i kontaktit dhe mund të ngacmoj reagime kur merret në doza më të mëdha.

Interaksionet. Rekomandohet kujdes me rastin e marrjes së bashku me aspirinë dhe me ndonjë antidepresiv , për shkak të zvogëlimit të aftësisë së koagulimit të gjakut.

Ginseng - Panax ginseng, P. Quinque- folius, Eleutherococcus senticosus

Në medicinën aziatike me mijëra vjet përdoret si tonik për rehabilitim dhe si dhe për shërim të përgjithshëm. Në perëndim ka marr emrin edaptogenit dhe bimës antistres. Përbërjet e saj përdoren në mënyrë perorale, intranazale ose parenterale, dhe dallojmë atë aziatik (*Panax ginseng*), amerikan (*Panax Quinque-folius*) dhe siberik (*Eleutherococcus*). Si problem paraqitet një numër i madhë i përbërjeve të tyre në treg dhe duhet të jemi mirë të informuar për të zgjedhur ate që na përshtatet.

Farmakodinamika. Substancat aktive janë ginsenozidet ose heleuterozidet (deri tani janë 7) dhe ato kanë në përbërje glikozidin sapunik triterpenoid, dhe ndikimi shpjegohet me ndikimin qendror

kolinergjik dhe të kohëpaskohshëm dopaminergjik, si dhe me stimulimin e aktivitetit te qarkut hipotalamus hipofiza.

Efektet anësore. Sindroma e keqpërdorimit të gingsenit paraqitet me nervozizëm, hipertension, pagjumësi, diarej të mëngjesit dhe erupsione të lëkurës te personat që marrin 3 gram në ditë gjatë 1-3 javë. Janë përshkruar dhe episode manjakale të shkaktuara nga *ginseng* dhe *sindroma e Stevens-Jonsonit*.

Rauvolfia serpentina

Kjo bimë në medicinën tradicionale indiane *ayurveda* përdoret më shumë se 2000 vjet, dhe prej saj është izoluar antipsikotiku i parë që njihet - *rezerpin*. Për shkak të efektit qetësues rrënja e tharë është përdorur në shërim të çrregullimeve të ndryshme mendore. Rezerpini më nuk pëdoret në shërimin e skizofrenisë për shkak të efekteve anësore dhe për shkak se ka antipsikotik më të sigurt dhe më efikas. Rezerpini dhe analogët e tij përdoren ende për shërimin e hipertensionit të lehtë. Komisioni Gjerman ka lejuar *Rauvolfia serpentina* për hipertension esencijal të lehtë në veçanti të ndërlidhur me anksiozitet. Për shkak të efekteve anësore të mundshme dhe bashkëveprimin me ilaçe të tjera nuk përdorohet për të sëmurit nga depresioni ulkusi, si dhe për gratë shtatzanë dhe pas lindjes. Kjo bimë nuk është e përshtatshme dhe nuk rekomandohet për vetëshërim.

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 11/2013, viti XI, Ulqin

E boton
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi
Kryetar: prim. dr. Gani Karamanaga

Redaktor teknik: Gazmend Çitaku

Kontakti
E-mail: ***ganik@t-com.me***
Bashkëpunëtorëve u jemi mirënjohës për ndihmesa.
Artikujt duhet të jenë të regjistruar në WORD dokument.
Duhet të jenë të lektoruar dhe të korrektuar.
Nuk duhet të jenë të faqosur e as të dizajnuar.

Shtypi
PRESS STUDIO
ULQIN, 2013

Tirazhi
300 copë